Studimi është ballafaquar me sfida të metodologjisë dhe të instrumenteve të cilat burojnë nga vështirësitë për masat, nivelet dhe dinamikën e manifestimit të veprimtarive kriminale të organizuara.

Përsa i përket instrumenteve të punimit janë përdorur intervistat, bazuar mbi pyetësin 1: "*Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri-Kosovë, 2008-2015*", pyetësor i cili u është dërguar 120 personave politike, publike, shkencore, akademike, ekspertëve të sigurisë, ekspertë të drejtësisë etj, nga të cilët janë përgjigjur 65 hulumtues, studiues, pedagogë, politikanë, ministra, deputetë, gazetarë, analistë dhe ekspertë të fushës në Shqipëri, Kosovë dhe ekspertë ndërkombëtarë. Të dhënat e plotësuara nga të intervistuarit në pyetësor janë përfshirë në një program të veçantë, janë përpunuar rezultatet e tyre dhe mbi bazën e tyre janë prodhuar tabela, grafike dhe figura sipas çështjeve e nënçështjeve të trajtuara në studim. Gjithashtu, janë marrë intervista të thelluara me disa nga politikanët, zyrtarët e zbatimit të ligjit, ekspertë të njohur në Shqipëri, Kosovë dhe ekspertë ndërkombëtarë dhe opinionet, mendimet, sugjerimet e rekomandimet e tyre janë përpunuar, analizuar dhe pasqyruar në këtë studim. Kampionimi u zgjerua me 702 pyetësorë. Pyetësi 2 "*Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri-Kosovë, 2008-2015*", u shpërnda në katër universitete, nga të cilat dy universitete

në Shqipëri, dhe dy universitete në Kosovë. Dy universitete publike, Universiteti i Tiranës Fakulteti i Drejtësisë dhe ai i Prishtinës, si dhe dy universitete për Studime të Sigurisë në Kolegjin ISPE, (Studime Evropiane, për të Ardhmen Evropiane), në Prishtinë dhe Akademinë e Sigurisë Tiranë. Bazuar edhe në numrin më të lartë të popullsisë, në Shqipëri u shpërndanë 400 pyetësorë, ndërsa në Kosovë 302 pyetësorë. Konkretisht: Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, dega “Juridik i përgjithshëm”, niveli “Bachelor”, 200 pyetësorë, viti i parë, 100 studentë, dhe viti i dytë, 100 studentë. Akademia e Sigurisë Tiranë, Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit të Krimin, dega “Siguri dhe Hetimi i Krimin” dhe dega “Siguria publike”, Bachelor, 200 pyetësorë, viti i parë, 100 studentë dhe viti i dytë, 100 studentë. Universiteti “Hasan Prishtina”, Prishtinë, Fakulteti Juridik, dega “Juridik i përgjithshëm”, niveli “Bachelor”, viti i katërt, 152 studentë. Kolegji ISPE (Studime Evropiane, për të Ardhme Evropiane), Prishtinë, Fakulteti Studime të Sigurisë, dega “Studime të sigurisë”, niveli “Bachelor”, 150 pyetësorë, viti i parë, viti i dytë dhe viti i tretë, 150 studentë. Të dhënat demografike bazë të institucioneve arsimore të të anketuarve paraqiten në tabelën 1.1.


Tabela 1.1 Të dhëna demografike bazë të institucioneve arsimore të të anketuarve.

Vendi	Institucioni Arsimor i të anketuarve	Nr. i respondentëve
Shqipëri	Akademia e Sigurisë, Tiranë	200
	Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë	200
Kosovë	Kolegji Universitar ISPE, Fakulteti i Studimevetë Sigurisë, Prishtinë	150
	Universiteti "Hasan Prishtina", Fakulteti Drejtësisë, Prishtinë	152
Total		702

Burimi: Përgjigjet e pyetësorit 2 “Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri, Kosovë, 2008-2015”. (plotësuar nga studentët e fakulteteve të Drejtësisë dhe të Sigurisë në Prishtinë dhe Tiranë). Përpunim i Autorit (2016).

Në mënyrë tabelare rezulton se nga 702 të anketuar, në Shqipëri janë anketuar gjithsej 400 studentë ose 56.98%, dhe në Kosovë 302 studentë ose 43.02%, nga të cilat në Akademinë e Sigurisë, Tiranë, 200 studentë ose 28.50%, në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë 200 studentë ose 28.50%, në Kolegjin Universitar ISPE Prishtinë, 150

studentë ose 21.36 %, dhe në universitetin ”Hasan Prishtina”, Prishtinë 152 studentë ose 21.64%. Shtetësia e të anketuarve paraqitet në grafikun 1.1.



Grafiku 1.1 Shtetësia e të anketuarve.

Në mënyrë grafike paraqitet shtetësia e të anketuarve, ku nga 702 të anketuar, rezulton se në Shqipëri janë anketuar gjithsej 400 studentë ose 56.98%, dhe në Kosovë 302 studentë ose 43.02%. Fusha e studimit të të anketuarve paraqitet në tabelën 1.2.

Tabela 1.2 Fushat e studimit të të anketuarve.

Nr.	Fusha e studimit	Nr. i të anketuarve
1	Drejtësi	352
2	Studime të Sigurisë	150
3	Siguri dhe Hetime Kriminale	170
4	Rend dhe Siguri Publike	30
	Total	702

Sipas tabelës 1.2 nga 702 të anketuar, rezulton se në degën “Drejtësi” janë anketuar gjithsej 352 studentë ose 50.14%, nga të cilët në universitetin publik, Fakulteti i Drejtësisë, Tiranë, 200 studentë ose 28.50%, në universitetin “Hasan Prishtina”, Prishtinë, 152 studentë ose 21.64%, në kolegjin universitar ISPE, Fakulteti i Studime të Sigurisë, 150 studentë ose 21.36%, në Akademinë e Sigurisë, Tiranë 200 studentë ose 28.50%, nga të cilët në degën “Siguri dhe hetime kriminale” 170 studentë ose 24.21% dhe në degën “Rend dhe siguri publike” 30 studentë ose 4.27% e të anketuarve. Tabela për gjininë e të anketuarve paraqiten në tabelën 1.3 dhe grafikun 1.2.

Tabela 1.3 Gjinia e të anketuarve.


Gjinia	Numri i të Anketuarve
Femra	376
Meshkuj	326
Total	702

Sipas tabelës 1.3 dhe grafikut 1.2¹ për gjininë e të anketuarve rezulton se, nga 702 të anketuar, janë anketuar gjithsej 376 femra ose 53.56%, ose 50 femra më shumë ose 3.56% dhe 326 meshkuj ose 46.44% e të anketuarve. Ndërsa, nga krahasimi i të dhënave për gjininë e të anketuarve, në përputhje me shtetësinë rezulton se, në Shqipëri janë anketuar 29.30 % femra dhe 19.34% meshkuj, ndërsa në Kosovë janë anketuar 24.26% femra dhe 27.10% meshkuj. Dega dhe viti i studimit të të anketuarve paraqiten në tabelën 1.4, ndërsa grafiku i përqindjes sipas degës dhe vitit të studimit të anketuarve paraqitet në grafikun 1.3.

Tabela 1.4 Dega dhe viti i studimit të të anketuarve.

Dega e Studimit	Viti i Parë		Viti i Dytë			Viti i Tretë		Viti i Katërt
	Studime te Sigurise	Drejtesi	Rendi dhe Siguria publike	Siguria dhe Hetimi Kriminal	Studime te Sigurise	Studime të Sigurisë	Drejtesi	
Nr i të Anketuarve	166	217	30	47	38	50	152	
% e të Anketuarve	24%	31%	4%	7%	5%	7%	22%	

¹ Për arsye metodologjike tabelat, grafikët dhe figurat që nuk janë tekstiv gjenden në shtojcën e studimit.



Grafiku 1.3 Grafiku i përqindjes sipas vitit të studimit të të anketuarve.

Sipas tabelës 1.4 dhe grafikut 1.3 rezulton se: nga 702 të anketuar, në vitin e parë janë anketuar 166 studentë ose 24%, në vitin e dytë 352 studentë ose 47%, në vitin e tretë 50 studentë ose 7% dhe në vitin e katërt 152 studentë ose 22% e të anketuarve.

Gjatë këtij studimi është trajtuar fenomenologjia e krimit të organizuar (veçoritë, struktura, autorët) format e manifestimit të krimit të organizuar, dinamika, shtrirja territoriale, etiologjia e krimit të organizuar dhe disa nga masat për luftimin e tij. Në lidhje me studimin e dukurisë së krimit të organizuar transnacional është shfrytëzuar një metodologji ndërdisiplinare duke përdorur mjete e teknika të shumta hulumtuese. Nga pesë metodat që përdorin zakonisht hulumtuesit për studimin e krimit të organizuar, si: 1. metoda e studimit të rasteve individuale; 2. metoda klinike; 3. metoda e vrojtimit (observimit); 4. metoda e anketës dhe intervistës; dhe 5. metoda statistikore, gjatë punimit janë përdorur tri metoda: metoda e vrojtimit, metoda e anketës dhe intervistës; dhe metoda statistikore. Në lidhje me metodën e vrojtimit; është përdorur kryesisht vrojtimi indirekt, i cili është implementuar nëpërmjet bashkëpunimit me institucionet penitenciare në Shqipëri dhe në Kosovë. Përqëndrimi ka qënë i fokusuar tek analiza e të dhënave sipas formave të kriminalitetit dhe krimit të organizuar në lidhje me autorët e paraburgosur, të burgosur, të dënuar e të ekstraduar sipas veprave penale të kryera. Metoda e anketës dhe intervistës është aplikuar në këtë studim nëpërmjet pyetjeve të përcaktuara në intervistën për personalitete publike dhe ekspertë të sigurisë. Ndërsa, metoda e tretë e përdorur, është metoda statistikore. Kjo metodë merr një rëndësi të veçantë, sepse përmes kësaj metode janë përfshirë në studim të dhëna në lidhje me vëllimin, dinamikën, strukturën, ndryshimet nëpërmjet formave të veçanta të manifestimit të krimit të organizuar, veprave penale

konkrete, autorëve, të dënuarve, viktimave etj. Ndërkohë, si metoda statistikore më të shpeshta janë përdorur: metoda e “ligjit të numrave të mëdhenj”, ku janë analizuar raste të këtyre krimeve edhe në përputhshmëri me format e veprimtarive të veçanta të krimit të organizuar. Metoda e “modelit” është bazuar në paraqitjen për studim të mëtejshëm studimi i vetëm disa rasteve të krimit të organizuar të cilat përfaqësojnë rastet karakteristike. Metoda e “mesatares dhe e përqindjes” është shprehur nëpërmjet krahasimeve të bëra për këto veprimtari në Shqipëri dhe në Kosovë. Gjithashtu, është bërë krahasimi edhe nëpërmjet tyre, duke evidentuar veprimtaritë kriminale të organizuara më të përhapura dhe me përqindje më të lartë, kjo e krahasuar edhe me rajonin.

Nëpërmjet përdorimit të metodës statistikore është arritur që të pasqyrohen, të analizohen dhe të jepen shpjegime edhe lidhjet kauzale, shkaqet e kriminalitetit të organizuar dhe ndikimi i faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm. Këto janë ndërlidhur me problematikat me serioze të demokracisë, sfidat kryesore të sigurisë, veprimtaritë kriminale të organizuara më shumë të përhapura në Shqipëri dhe në Kosovë, si dhe janë bërë krahasime dhe janë evidentuar dallimet dhe ngjashmëritë midis tyre. Gjithashtu, të dhënat e grumbulluara janë verifikuar edhe përmes aplikimit të metodave të tjera. Kështu, evidencat statistikore, si p.sh. *evidencat kombëtare*, që përmbajnë informacionet për format e veprimtarive të krimit të organizuar i kemi siguruar nëpërmjet institucioneve të tilla: Drejtoria e Policisë së Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme, Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në Shqipëri dhe Kosovë.

Statistikat zyrtare të institucioneve të mësipërme, janë përfshirë në një program të veçantë. Të dhënat e grumbulluara janë përpunuar dhe mbi bazën e tyre janë bërë analiza krahasuese për veprimtari konkrete kriminale të organizuara, në lidhje me çështje penale, për referime, mosfillime, pezullime e procedime penale, çështje të dërguara në gjyq, autorë, viktima, të dëmtuar, masat e sigurimit, të ndaluar, të arrestuar, të dënuar, të pafajshëm etj.

Gjatë evidentimit dhe përpunimit të të dhënave zyrtare të evidencave statistikore të institucioneve të drejtësisë penale janë evidentuar edhe mospërputhje të ndryshme të të dhënave zyrtare midis institucioneve përkatëse. Duke marrë shkas nga këto mangësi, pas përpunimit të të dhënave janë konstatuar edhe disa problematika, në lidhje me shifrat e evidentimit, denoncimit, regjistrimit, zbulimit, dokumentimit dhe goditjes e luftimit kundër

krimit të organizuar. Kështu, studimi nxjerr në pah edhe shqetësimet që sjellin statistikat e kriminalitetit në mos njohjen e plotë të gjendjes dhe situatës konkrete në lidhje me shifrat “e numrit të errët”, “të numrit të përhimtë” dhe “të numrit të tepërt” të kriminalitetit. Gjithashtu, janë bërë shpjegime dhe komente për ndikimet e zhvillimit të demokracive, të institucioneve demokratike e të sigurisë, njohjes e zbatimit të shtetit ligjor dhe deri te shprehja e mungesës së besimit të qytetarëve që shprehet nëpërmjet shifrave të evidentuara, të përpunuara, të nxjerra dhe të publikuara në këtë studim.

1.3.1. Modeli i hulumtimit

Modeli i hulumtimit mbi të cilin mbështetet studimi është analiza krahasimore. duke u fokusuar në kontekstin lokal, ndërshtetëror dhe nënrajonar duke bërë krahasime me nivelin rajonal. Analiza krahasimore përfshin Shqipërinë, Kosovën dhe Shqipëri-Kosovë, duke evidentuar e mbledhur të dhëna të ndryshme nga pyetësorët, institucionet shtetërore, intervistat etj. Pra, kjo qasje është holistike, sepse hulumtuesi është i interesuar si për marrëdhëniet midis pjesëve përbërëse të rastit, ashtu edhe për rastin si një i tërë (Matthws & Ross, 2010). Ky studim është një zgjedhje e mirë, sepse ndihmon në identifikimin dhe analizimin e problematikave serioze të demokracisë, sfidave kryesore të sigurisë dhe veprimtaritë kriminale të organizuara më të përhapura, si dhe nivelin e bashkëpunimit në Shqipëri dhe në Kosovë.

1.3.2 Mbledhja dhe analizimi i të dhënave

Për vetë natyrën e studimit, skema për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave ka kaluar nëpërmjet disa fazave si: përcaktimi apo zgjedhja e modelit (zgjedhja e modelit ka lidhje me *vlerësimin e performancës* së modeleve të ndryshme); vlerësimi i modelit (bëhet pasi është zgjedhur modeli final ku është vlerëuar *aftësia përgjithësuese* e modelit të zgjedhur); vlefshmëria e modelit në mbledhjen e të dhënave; shpërndarja hapsinoro-kohore; menaxhimi i të dhënave; përshkrimi statistikor; analiza strukturore është mbështetur në, - analizën “e drejtuar nga modelet e zgjedhura”, dhe në analizën “e drejtuar nga të dhënat e grumbulluara”; tabelimi, grafikimi; vlerësimi i kryqëzuar; vizualizimi i të dhënave, konkluzione dhe rekomandime të rezultateve.

SKEMA PËR MBLEDHJEN, ANALIZIMIN DHE MODELIMIN E TË DHËNAVE



Figura 1 Skema për mbledhjen, analizimin dhe modelimin e të dhënave.

Të gjitha këto faza, metoda dhe procese pune kanë kaluar përmes një “laboratori analitik” dhe na kanë ndihmuar që të arrijmë në konkluzione me dobi për të dy vendet. Të dhënat dhe mënyrat e analizimit të tyre janë të lidhura me pyetjet kërkimore, hipotezat e studimit, modelin e hulumtimit dhe me strukturën e strategjinë e hulumtimit. Bazuar në elementët e mësipërm, studimi bazohet në analizën krahasuese, duke kombinuar qasjen cilësore me atë sasiore. Qasja sasiore lidhet me përdorimin e “të dhënave sasiore dytësore që janë në dispozicion për analizë të mëtejshme” (Mathws & Ross, 2010:147). Të dhënat kryesore sasiore mbi gjendjen e kriminalitetit të organizuar dhe krimit të organizuar transnacional mbështeten në burime të tilla, si: Ministria e Drejtësisë, Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, në Shqipëri dhe Kosovë, etj.

Për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave sasiore dhe cilësore, studimi bazohet edhe në disa pyetje:

- Cilat janë problemet më serioze të demokracisë në Shqipëri?
- Cilat janë problemet më serioze të demokracisë në Kosovë?
- Cilat janë problemet e përbashkëta midis Shqipërisë dhe Kosovës?

- Cilat janë problemet e veçanta dhe specifike të demokracisë në Shqipëri dhe në Kosovë?
- Cilat janë sfidat kryesore të sigurisë në Shqipëri?
- Cilat janë sfidat kryesore të sigurisë në Kosovë?
- Cili është ndikimi i faktorëve të jashtëm në veprimtaritë kriminale në Shqipëri dhe në Kosovë?
- Cilat janë veprimtaritë kriminale të organizuara më të përhapura në Shqipëri?
- Cilat janë veprimtaritë kriminale të organizuara më të përhapura në Kosovë?
- Cilat janë veprimtaritë e krimit të organizuar në fushën ekonomike-financiare, trafikimi i lëndëve narkotike, trafikimi i qenieve njerëzore, terrorizmi dhe korrupsioni në Shqipëri?
- Cili është niveli i krimit të organizuar transnacional dhe krimit të organizuar me bazë lokale e transnacionale Shqipëri-Kosovë?
- Cilat janë veprimtaritë kriminale të organizuara më të përhapura në nivel lokal, në nivel transnacional dhe që kanë bazë lokale e transnacionale në Shqipëri dhe në Kosovë?
- Cilat janë veprimtaritë kriminale më të përhapura në nivel rajonal dhe krahasimi me Shqipërinë dhe Kosovën?
- Cili është niveli i bashkëpunimit Shqipëri-Kosovë dhe ndikimi i tij në forcimin e shtetit ligjor kundër krimit të organizuar?
- Cili është niveli i bashkëpunimit rajonal e ndërkombëtar midis Shqipërisë dhe Kosovës dhe institucioneve ndërkombëtare në luftën kundër aktiviteteve të krimit të organizuar transnacional?

Për të realizuar këto objektiva, studimi është bazuar në të dhënat sasiore dhe cilësore. Instrumenta të tjerë të përdorur janë edhe 20 intervista të thelluara, si burime cilësore për provimin e hipotezës, si dhe analiza e thelluar edhe në dokumenta, tekste juridike, raporte strategjike, dokumenta ndërkombëtare, instrumenta dhe konventa juridike. Qasja cilësore lidhet me “mbledhjen e dokumenteve që lidhen me pyetjet e studimit dhe bërja e pyetjeve për këto dokumente” (Matthws & Ross, 2010:147). Dokumentet e botuara si: fjalime,

deklarata dhe intervista me politikanë të niveleve të larta shtetërorë dhe publike, shkencore e akademike, juristë, gjyqtarë, prokurorë, avokatë ekspertë të policisë, ekspertë të sigurisë, gazetarë, analistë, opinionistë etj. Duke qenë se sipas Atrkinson et. Al, “Dokumentat janë ‘fakte shoqërore’ në kuptimin se ato prodhohen, shkëmbehen dhe përdoren në mënyra të organizuara shoqërisht” (në Matthws & Ross, 2010:277), ato shërbejnë për mbledhjen e të dhënave, për analizimin e tyre dhe përdoren si të dhëna faktike. Disa nga dokumentet e rëndësishme në këtë studim janë:

- Konventa e Kombeve të Bashkuara kundra Krimit të Organizuar Transnacional, 2000,
- Rezoluta, konventa, raporte e deklarata të organizatave e institucioneve ndërkombëtare,
- Strategjia Kombëtare e Sigurisë e Republikës së Shqipërisë 2004, 2014,
- Ligji për themelimin e Këshillit të Sigurisë së Republikës së Kosovës, 2008,
- Raportvlerësimi i Kërcënimit të Krimit Serioz dhe Krimit të Organizuar, Kosovë, 2013,
- Dokumenti i Analizës së Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë së Republikës së Kosovës ,2014,
- Raporte vjetore dhe periodike të OKB^{-së}, të BE^{-së}, të NATO^{-s}, të INTERPOL^{-it}, të EUROPOL^{-it}, të FBI^{-së}, për demokracinë, shtetin ligjor, sigurinë e krimin e organizuar në Shqipëri e Kosovë.

Të dhënat përqendrohen në treguesit dhe statistikat zyrtare për demokracinë, institucionet demokratike, sfidat kryesore të sigurisë, krimin e organizuar transnacional dhe veprimtaritë kryesore kriminale të organizuara më të përhapura, dokumentet strategjike dhe diskutimi i aktorëve. Si përfundim, modelet e burimet e përzgjedhura me kujdes të veçantë dhe menaxhimi e analizimi i të dhënave, përbëjnë “shtyllën kurrizore” të burimeve zyrtare të përdorura, të burimeve të tjera, si të dhënave të grumbulluara nga përgjigjet e dy pyetësorëve me 767 anketues, si dhe përpunimet e tyre kanë prodhuar pamvarësisht vështirësive të ndeshura, të dhëna të reja që paraqesin rëndësi.

1.4 Kufizimet dhe risitë e studimit

Kufizimet e studimit burojnë nga kompleksiteti dhe dinamika e objektit të studimit, si dhe nga vetë kufizimet metodologjike dhe vështirësitë e aplikimit të instrumenteve të ndryshme në Shqipëri, në Kosovë dhe në analizën krahasuese Shqipëri-Kosovë dhe krahasimet edhe me rajonin. Një vështirësi është fakti që krimi i organizuar duke qënë shpesh, *së pari*, një veprimtari informale që i mundëson me vështirësi burimet zyrtare dhe, *së dyti*, krimi i organizuar drejtohet nga individë të dhunshëm, të mbështetur financiarisht, edhe me lidhjen apo mbështetjen e zyrtarëve të korruptuar të institucioneve shtetërore.

Gjithashtu, duke qënë se krimi i organizuar përfshin në vetvete dy nocione kundërthënëse *furnizimin me të mira dhe shërbime ilegale*, dhe *organizatën kriminale*, rezulton se çështjet e krimit të organizuar transnacional janë çështje shumë sensitive dhe me ndjeshmëri të lartë. Këto çështje kërkohet të trajtohen me shumë kujdes sepse ngjallin “frikë” prej grupeve kriminale dhe prej pushtetarëve të korruptuar që lidhen me to. Kjo është edhe një ndër arsyet që disa prej politikanëve, zyrtarëve të zbatimit të ligjit dhe ekspertëve që iu shpërnda pyetëtori nuk iu përgjigjën, ndërkohë që disa nga të intervistuarit nuk u ndjenë mirë dhe kërkuan që të mos publikohen të dhënat e intervistuarra prej tyre. Pra, këto çështje nxorën në pah vështirësitë metodologjike dhe sfidat që lidhen me studimin e kësaj dukurie kriminale apo fenomeni të “ndërkombëtarizuar”. Situata bëhet më e kur analizohet gjendja konkrete e kriminalitetit të organizuar në Shqipëri dhe në Kosovë gjatë viteve të fundit, 2008-2015.

Vështirësia në mbledhjen e të dhënave, komplikimet në ndjekjen në dinamikë të sfidave në dy shtetet dhe në rajon, si dhe pengesat e konsiderueshme për të siguruar te dhënat e duhura e kanë bërë mjaft sfiduese analizën në një kontekst të gjerë. Megjithatë, me qëllim që të minimizojmë sa më shumë kufizimet që rrjedhin nga objekti e koha e hulumtimit, bënë që studimi të tejkalojë këto kufizime nëpërmjet gërshetimit racional të metodave dhe instrumenteve në analizën e formave të shfaqjes, të përmasave e të ndikimit transnacional, në kushtëzimin e prirjeve kryesore të drejttimeve të sigurisë. Gjithashtu, për të minimizuar kufizimet, kemi bërë përzgjedhje të kujdesshme të burimeve sasiore dhe atyre cilësore si dhe të treguesve të tyre.

Kuadri kohor 2008-2015 në vetvete është sfidë për studimin për shkak të karakterit dinamik e të ndryshueshëm të statusit dhe fazave të shtetformimit e të konsolidimit të demokracisë, të ndryshueshmërisë të institucioneve të sigurisë dhe të vetë proceseve të integritit. Për ta argumentuar këtë vështirësi, ju referohemi studiuesve dr.Fabian Zhilla dhe dr.Besfort Lamallari në studimin e tyre me titull ”*Krimi i organizuar-vlerësimi i riskut në Shqipëri*”, në të cilin shprehen: “*Studimi e vuan mungesën e theksuar të studimeve apo artikujve shkencore të mëparshëm rreth krimit të organizuar në Shqipëri.*” (Fabian Zhilla & Besfort Lamallari, 2015:15). Edhe autori i këtij disertacioni vlerëson si kufizim thelbësor numrin e pakët të studimeve për krimin e organizuar në Shqipëri dhe në Kosovë, dhe veçanërisht mungesën e ndonjë analize krahasuese Shqipëri-Kosovë.

1.5 Risitë kryesore të studimit

Në tërësinë e vet studimi arrin të japë përgjigje pyetjeve kerkimore dhe hipotezave që e pasojnë atë duke sjellë një risi në studimet e sigurisë. Studimi përbën risi në hulumtimin e krimit të organizuar dhe krimit të organizuar transnacional në nivele lokale, shtetërore kombëtare, ndërnacionale dhe rajonale.

Një risi tjetër, me rëndësi është analiza krahasimore që krijon një tablo më të qartë të situatës së sigurisë të dy vendeve Shqipëri, Kosovë duke e krahasuar me rajonin. Bazuar në të dhënat sasiore, cilësore, në burime dhe instrumente të ndryshme studimi arrin në konkluzione me dobi për të sotmen dhe perspektivën e sigurisë, në drejtim të parandalimit dhe luftës ndaj krimit të organizuar. Gjithashtu, duke u mbështetur në situatat e sigurisë dhe të luftës kundër krimit të organizuar në Shqipëri, Kosovë dhe Shqipëri-Kosovë (analizë krahasuese), studimi jep një kontribut të veçantë me karakter përgjithësues, duke u ngritur mbi nivelin e botimeve dhe studimeve të derisotme, të cilat kanë qenë të kufizuara në nivel artikujsh, referatesh të pjesshme dhe të dhënave sasiore dytësore. Dhe *së fundi*, studimi me qasjen analitike krahasimore dhe qasjen kritike jep një kontribut të ri duke krijuar një vlerë të shtuar në studimet për parandalimin dhe luftën kundër krimit të organizuar transnacional.

Nëpërmjet këtij studimi është arritur që ndjeshmëria ndaj kësaj dukurie të rritet dhe të japin mendime e opinione të tyre 20 të intervistuar dhe 767 persona (65 personalitete politike e publike, zyrtarë të zbatimit të ligjit e ekspertë të sigurisë, etj, si dhe 702 studentë

të katër fakulteteve të Drejtësisë dhe të Studimeve të Sigurisë) që u janë përgjigjur pyetjeve të dy pyetësorëve për institucionet demokratike dhe krimin e organizuar në Shqipëri dhe Kosovë.

1.6 Struktura e studimit

Studimi është ndërtuar me një strukturë të tillë:

Teza që paraqesim në studim trajton aspektet themelore që kanë të bëjnë me krimin e organizuar transnacional Shqipëri, Kosovë, në kuadër të institucioneve demokratike, problematikave serioze të demokracisë dhe sfidave kryesore të sigurisë e lidhur edhe me integrimin europian dhe euroatlantik të të dy vendeve. Nëpërmjet këtij studimi janë bërë analiza të detajuara lokale dhe ndërshtetërore krahasuese, me synimin themelor të argumentimit të tezës që krimi i organizuar transnacional në kontekstin e sigurisë kombëtare, demokracisë dhe institucioneve demokratike, problemet lokale e ndërshtetërore të krahasuara me ato rajonale, janë çështje të rëndësishme dhe mjaft komplekse.

Studimi është ndërtuar në shtatë kapituj, nga hyrja e deri në konkluzione dhe rekomandime, kapituj të cilët janë pjesë përbërëse e studimit “*Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri, Kosovë, 2008-2015*”. Studimi përshkruhet nga një lidhje llogjike e organike nga fillimi deri në fund, ku analizat krahasuese janë pjesa më cilësore e këtij studimi me karakter të thellë analitik.

Në hyrje përfshihet qëllimi dhe objektivat e studimit, pyetjet kërkimore dhe hipotezat, metodologjia, modelin e hulumtimit, mbledhjen dhe analizimin e të dhënave, kufizimet dhe risitë e studimit, dhe strukturën e studimit.




Figura 1.1 Struktura e studimit.

Në kapitullin e dytë, studimi mbështetet në kornizën teorike të studimit, veçanërisht te shkolla e Kopenhagenit, si dhe kuptimi i krimit të organizuar dhe krimi i organizuar transnacional. Studimi trajton me vëmendje të posaçme vështrimin historik, përkufizimet dhe shpjegimet teorike mbi krimin e organizuar dhe atë transnacional.

Në kapitullin e tretë, hulumtohen marrëdhëniet, ndikimet dhe ndërveprimet e demokracisë dhe institucioneve të saj në Shqipëri dhe Kosovë. Problematikat e demokracisë në Shqipëri nën optikën e ekspertëve, problematikat e demokracisë në Kosovë, gjithashtu nën syrin e ekspertëve na shpjen në konkluzione shumë të rëndësishme. Këto konkluzione grupohen në dy aspekte: në problematikat e përbashkëta Shqipëri dhe Kosovë në mënyrë krahasuese, si dhe në problematikat specifike, të veçanta të Shqipërisë dhe të Kosovës veçmas, duke nxjerrë në dukje dallueshmëritë e demokracisë dhe të institucioneve demokratike në të dy vendet.

Në kapitullin e katërt, analiza e mësipërme e bën të domosdoshme përqëndrimin tonë në sfidat kryesore të sigurisë, kryesisht në Shqipëri dhe në Kosovë. Për të qenë sa më gjithëpërfshirës, jemi mbështetur në hulumtimet sasiore dhe cilësore. Intervistat e kryera me personalitete politike, publike, zyrtare të zbatimit të ligjit, ekspertë të njohur në Shqipëri, Kosovë dhe ekspertë ndërkombëtarë në mënyrë krahasuese, është një vlerë e shtuar në këtë studim. Ato na kanë ndihmuar për të hulumtuar në mënyrë të veçantë sfidat e sigurisë me bazë burimet e brendshme, si dhe sfidat e sigurisë me bazë ndikimin e faktorëve të jashtëm. Kjo ndarje metodologjike na ndihmon për të thelluar analizën tonë në kapitujt në vijim.

Një nga kapitujt më të rëndësishëm të hulumtimit tonë është kapitulli i pestë, i cili lidhet me veprimtaritë kriminale të organizuara, më të përhapura në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën e Kosovës. Për vetë historinë, gjeografinë, pozicionin gjeopolitik, popullsinë dhe faktorë të tjerë të përbashkët, veprimtaritë kriminale të organizuara në Shqipëri dhe në Kosovë mund të zbulohen, të parandalohen, të goditen e të luftohen në nivele lokale dhe ndërshtetërore midis dy vendeve. Nga hulumtimi mbi baza lokale dhe krahasuese rezulton se veprimtaritë kriminale të organizuara siç janë: trafikimi i drogës, trafikimi i qenieve njerëzore, kontrabandimi i emigrantëve, trafikimi i armëve, gjobëvënia, vrasjet me pagesë, krimi i organizuar kibernetik, pastrimi i parave, terrorizmi dhe korrupsioni kanë burime, elementë, rrezikshmëri dhe pasoja të mëdha. Por masat që nevojiten për parandalimin, goditjen dhe luftën kundër tyre, rezultojnë të kenë edhe karakteristika të veçanta. Kjo për faktin se pozicionet gjeografike dhe gjeopolitike të vendeve kanë mjaft dallueshmëri, duke marrë në konsideratë që Shqipëria është vend me dalje të konsiderueshme detare, në detin Adriatik, në detin Jon, në Mesdhe dhe në Evropë, ndërsa Kosova është me kufij tërësisht territorialë dhe me një situatë shumë specifike me kufijtë e veriut me Serbinë.

Aspekti më i ndërlikuar në studimin tonë, por edhe më i rëndësishmi njëkohësisht paraqitet në kapitullin e gjashtë, krimi i organizuar transnacional. Gjendja e kriminalitetit, format e veprimtarive kriminale të organizuara, veprimtaritë me kërcënuese në të dy vendet, si dhe sfidat e përbashkëta për adresimin e tyre, janë vënë në fokusin tonë të analizës krahasuese. Kjo për faktin se lëvizja e lirë e mallrave, e shërbimeve, e kapitaleve dhe e njerëzve na vendos në një situatë të vështirë. Nga njëra anë, kemi hapje dhe dinamikë

të natyrshme demokratike dhe integruese, nga ana tjetër, kemi përballje me kërcënime serioze të sigurisë transnacionale. Kjo sfidë ngelet e hapur, siç do të dalë edhe nga studimi.

Duke u bazuar në analiza lokale e ndërshtetërore, por edhe në krahasim me rajonin, studimi vjen në mënyrë të natyrshme te kapitulli i shtatë, niveli i bashkëpunimit Shqipëri - Kosovë dhe ndikimi që paraqet ky bashkëpunim për forcimin e shtetit ligjor kundër krimit të organizuar transnacional. Analiza që u kemi bërë historisë dhe situatës aktuale të bashkëpunimit, na ka shtyrë të hulumtojmë në mënyrë të veçantë bashkëpunimin në fushën e shkëmbimit të informacionit, të ndërmarrjes të analizave të përbashkëta me qëllim kryesor që të dy vendet të ndërmarrin strategji, masa dhe veprime konkrete në luftën kundër krimit të organizuar dhe menazhimin e zgjidhjen e problemeve të përbashkëta.

Studimi i bazuar në gjendjen aktuale dhe parashikimet e të dy vendeve, ka nxjerrë konkluzione në të cilat konkludohet dhe rekomandohet forcimi i shtetit ligjor kundër krimit të organizuar dhe krimit të organizuar transnacional që është themeli i përbashkët për të dy vendet për të adresuar me sukses këtë luftë. Mbyllja e studimit me konkluzione dhe rekomandime është rrjedhoja logjike e trajtimit, identifikimit, analizimit dhe e përmbajtjes së kapitujve të mësipërm duke argumentuar dhënien e përgjigjes për pyetjet kryesore dhe mbrojtjen e hipotezave fillestare.

KAPITULLI II:

SHKOLLAT E SIGURISË, TEORITË DHE KUPTIMI I KRIMIT TË ORGANIZUAR TRANSNACIONAL

2.1 Hyrje

Kapitulli i dytë ofron kornizën teorike të studimit tonë duke pasqyruar shkollën e Kopenhagenit, si dhe kuptimi i krimit të organizuar dhe krimi i organizuar transnacional. Studimi trajton vështrimin historik, përkufizimet dhe shpjegimet teorike mbi krimin e organizuar dhe atë transnacional. Gjithashtu, trajtohet edhe krimi i organizuar i tipit “mafioz” dhe “mafiet e reja”, duke përcaktuar karakteristikat e tyre në rrethanat konkrete, në vende të veçanta dhe në kontekstin rajonal e ndërkombëtar.

2.2. Shkolla e Kopenhagenit

Teoria e Përmbajtjes ose Shkolla e Kopenhagenit, lindi në Institutin për Kërkimet e Konflikteve dhe të Paqes, në Kopenhagë, si shkollë e re dhe më përparimtare në raport me teoritë më të vjetra tradicionale. (Alan Collins, 2010:479). Shkolla e Studimeve të Sigurisë e Kopenhagenit është një shkollë e mendimit akademik dhe origjinën e kanë librin e teorive të marrëdhënieve ndërkombëtare të autorit, Barry Busan, “*Njerëzit, shtetet dhe frika: problem i sigurisë kombëtare në marrëdhëniet ndërkombëtare*”, botuar në vitin 1983 (botimi i parë) dhe ribotuar në vitin 2003. Ajo përfaqësohet nga idetë e pikëpamjet e përfaqësuesve më të shquar Beri Busan (Barry Busan) dhe Ole Viver (Ole Waever), por edhe të Jep de Uald-it, të cilët botuan librin me titull: “*Siguria: një kuadër i ri analize*” (*Security: A New Framework for Analysis*) dhe kjo qasje u bë e njohur si Shkolla e Kopenhagenit (Bill Mc Sweeny:1996). Kjo shkollë ka të bëjë kryesisht me zgjerimin e kërcënimeve shoqërore dhe me një mbështetje më të madhe në nivelin rajonal në aspektin mbi sigurizimin, me qëllim analizimin e kërcënimeve materialiste të studimeve strategjike tradicionale. Shkolla e Kopenhagenit zhvilloi bazën e saj teorike të bazuar në tri ide themelore: 1-sektorët e sigurisë, 2-komplekset rajonale të sigurisë dhe 3. sigurizimi. Duke analizuar me kujdes këto teori dhe ide të kësaj shkolle, rezulton se është bërë zgjerimi dhe

thellimi i studimeve për sigurinë, edhe në problemet joushtarake, duke vërtetuar faktin që nuk është vetëm shteti ai që mund të jetë objekti kërcënimit të sigurisë, por edhe të tjerët. Koncepti i sektorëve të sigurisë trajtohet në librin “*Security, A New Framework for Analysis*”, dhe përqendrohet në pesë sektorët e sigurisë: në sigurinë ushtarake, sigurinë ekonomike, sigurinë politike, sigurinë shoqërore dhe në sigurinë e mjedisit jetësor. (Barry Busan, Ole Waever, Jaap de Wilde & Lynne Rienne:1998). Ndërkohë, në lidhje me komplekset rajonale të sigurisë, nivelet e kërcënimeve të sigurisë përveç shtetit, përfshijnë edhe shoqërinë dhe individët, -thekson Busan-ⁱ, duke i dhënë një trajtë të re analizës së sigurisë, nëpërmjet së cilës e zgjeron konceptin kompleks të sigurisë dhe i jep një rëndësi të veçantë nivelit rajonal.(Barry Busan: 2003). Katër prej pesë komponentëve të shkollës së Kopenhagenit u përkasin kërcënimeve jo ushtarake ndaj sigurisë. Kjo shkollë i përfshin studimet e sigurisë edhe te faktorët jo shtetërorë (shoqëritë dhe mjedisi). Ajo është konsideruar një qasje pozitiviste dhe tradicionale ndaj sigurisë dhe ishte pionieri lëvizjes për ndryshimin e qasjeve tradicionale të sigurisë. “*Të flasësh rreth sigurisë nuk do të thotë as gjë më tepër se kaq:të flasësh rreth sigurisë*” (Alan Collins, 2010:90). Sigurizimi është zhvilluar dhe mendohet se është koncepti më i shquar i shkollës së Kopenhagenit, sepse është argumentuar se siguria është një akt me pasoja të dallueshme në kontekstin e politikës ndërkombëtare (Ole Waever : 2001).

Në lidhje me konceptin e sigurizimit janë evidentuar disa autorë kritikë të sigurisë, si: Peter Hough, (Peter Hough :2004).Barry Busan, (Barry Busan: 2007), William Bain, (William Bain : 2006) të cilët pas ngjarjeve të 11 shtatorit 2001, kanë përdorur termin e ‘*letrave me vlerë*’, pa dhënë kredi për shkollën e Kopenhagenit. Fjala apo termi “*sigurizim*” do të thotë: kur një çështje paraqitet si kërcënim, ajo bëhet problem i sigurisë. Përfaqësuesit e shkollës së Kopenhagenit, ndryshe nga teoricienët e tjerë të sigurisë, e përcaktojnë sigurinë, në kuptimin e ngushtë, sigurinë si ekzistencë, duke përcaktuar dy entitete: 1. Sovranitetin që është parakusht i ekzistencës së shtetit, por edhe kriteri më i lartë i sigurisë së shtetit, çfarë do të thotë: nëse shteti humbet sovranitetin, nuk mund të ekzistojë si shtet, dhe 2.identitetin shoqëror i cili është kriteri më i lartë i sigurisë së shoqërisë ose sigurisë shoqërore, çka do të thotë se: shoqëria përcaktohet si grupi madh shoqëror në raport me dallimet që kanë me të tjerët. Gjithashtu, përfaqësuesit e shkollës së Kopenhagenit u japin rëndësi më të madhe disa koncepteve, si: konceptit të sigurisë në aspektin e rëndësisë së

madhe që ka dhe, nga ana tjetër, ata argumentojnë se në aspektin e qasjeve historike, shoqëritë nuk janë të njëjta, njëra me tjetrën, por përkundrazi ato dallojnë, sepse siguria nuk mund të studiohet dhe kuptohet nëse nuk e vlerëson sigurinë si produkt shoqëror, sepse *“krimi pret për gjatë vijave raciale, klasave, shtresave, shteteve e kontinenteve në tërë botën.*(Jani Papandile & Eugen Papandile, 2010:10).

Sipas shkollës së Kopenhagenit sugjerohet se dobësia e shtetit konfirmohet edhe me dallimet e mëdha ndërmjet interesave të vetë shtetit dhe grupeve etnike, politike ose shoqërore të tij. Prandaj, gjendja e qëndrueshme e sigurisë nënkupton gjendjen që minimizon dhe parandalon çdo lloj rreziku të integritetit territorial, konfliktet etnike, krimin e organizuar dhe korrupsionin. Sipas shkollës së Kopenhagenit çështjet joushtarake apo militare mund të jenë objekt i studimeve të sigurisë. Teoricienët e kësaj shkolle i qëndrojnë idesë se është vetëm shteti, aktori që mund të garantojë sigurinë, por argumentojnë edhe anën e kundërt. Kështu, sipas Buzanit: *“Shteti mund të jetë më shumë një burim kërcënimesh se sa mbrojtje për individët, por kjo vlen vetëm për një numër të kufizuar vendesh”.* (Mutimer, D: 2007).

Kjo shkollë ka të bëjë kryesisht me zgjerimin e kërcënimeve shoqërore dhe me një mbështetje më të madhe në nivelin rajonal në aspektin mbi sigurizimin, me qëllim analizimin e kërcënimeve materialiste të studimeve strategjike tradicionale.

2.3 Teoritë e sjelljes së krimit të organizuar

Teoritë që trajtojnë shkaqet e paraqitjes së krimit të organizuar janë: teoria e parandalimit të përgjithshëm;teoria e funksionalizmit; teoria organizative dhe krimi i organizuar; teoria e papërshtatmërisë; teoria e nën-kulturës dhe anti-kulturës dhe parandalimi i kriminalitetit; teoria e devijimit kulturor; teoria e grupit; teoria e ndërveprimit dhe etiketimit; teoria e lidhjes konspirative; teoria e ç’organizimit shoqëror; teoria e zgjedhjes racionale dhe teoria e anomisë.Në këtë studim vlerësuam vetëm t’i përmendim si teori dhe nuk do të trajtohen më gjërë.

2.4. Historia e krimit të organizuar, kuptimi, definicioni, dhe karakteristikat e tij

2.4.1. Historia e krimit të organizuar

Historia e krimit të organizuar daton prej shumë dekadash. Ndalimet e narkotikëve në nivelet komunale dhe shtetërore filloi në vitin 1878. Për opiumin dhe shitjet e morfinës kërkohej një recetë mjekësore për herë të parë në Amerikë në 1870 me vonë në Mexico City (Astorga 2005:19). Opiumi ishte importuar fillimisht nga Shtetet e Bashkuara, Evropë dhe Azi (Astorga 2005 : 22). Nga shekulli i 19-të rreth vitit 1920, opiumi, tretësira opiumit, dhe morfina janë konsumuar si ilaçe, megjithëse shtypi raportoi edhe vetëvrasje dhe vdekje si pasojë e përdorjes së morfinës -mbidozë. Në fillim të viteve 1900, heroina u ofrua si një komponent shurup kollë, ndërsa një ekstrakt i holluar perdorej i rekomanduar për zemër. Nga fillimi i viteve 1920, tonics coca u shpall për të luftuar aneminë, rakit-iket, dhe paralizën (Astorga 2005:25).

Historia e krimit të organizuar, e ka zanafillën rreth viteve 1800, daton në shekullin e 19-të pas vitit 1920-1930, ai ushtrohet më ndjeshëm dhe për të vijuar në vitet 1970-1980, dhe fiton “qytetarinë” mbarë botërore pas rënies së Murit të Berlinit dhe përfundimit të Luftës së Ftohtë. Shtrirja e tij u bë fillimisht në Itali dhe në Amerikë dhe më pas edhe në vende të tjera. Kjo shtrirje në disa vende bëri të mundur që shumë shpejt krimi i organizuar të shëndërrohej në një fenomen. Vitet 1990 e bëjnë krimin e organizuar prezent, kudo në botë. Pra, ai bëhet prezent dhe zhvillohet edhe në Ballkan dhe për rrjedhojë edhe në Shqipëri e Kosovë.

2.4.2 Kuptimi i krimit të organizuar

Që të flasësh për krimin e organizuar duhet që fillimisht ti referohesh përkufizimit të tij, ose konceptit dhe nocionit të saktë. Mirëpo, sipas Paoli dhe Vander Beken: “*të kuptuarit e krimit të organizuar ka filluar që nga viti 1920*”, por ai edhe sot e kësaj dite, ndoshta për shkak të “kakofonisë” ose më saktë për shkak të hartuesve të politikave të krimit të organizuar, apo zyrtarëve të zbatimit të ligjit, si dhe interesit të madh publik, nëpërmjet mediave dhe publikut të gjërë, vazhdon që përkufizimi, koncepti apo nocioni i krimit të organizuar “të mbetet një koncept *fuzzy*² dhe koncept i kontestuar ombrellë”. (Letizia Paoli, 2014 : 2).

²I turbullt, i paqartë, i mjegullt, i shpërqëndruar, i pasaktë, e vështirë për të perceptuar në mënyrë të qartë ose të kuptojnë dhe të shpjegojnë saktësisht

Termi i saktë i krimit të organizuar mendohet se është përdorur më parë në raportin vjetor të vitit 1896 për parandalimin e krimit nga Shoqëria e Nju Jorkut (New York Society), nëpunësit e të cilës i referohen operacioneve të kumbarit dhe prostitucionit që ishin të mbrojtura nga zyrtarët publik (Woodiwiss 2003 :5); shih von Lampe: 2001; Woodiwiss : 2001). Ndërsa, komentuesit dhe akademikët filluan të bëjnë përpjekje serioze për të përcaktuar dhe për të diskutuar krimin e organizuar në vitet 1920 dhe 1930, kur ndalohej në masë të madhe zgjerimi dhe zhvillimi i tregjeve të paligjshme të Amerikës së Veriut.

Ky koncept i krimit të organizuar ka qëndruar gjatë kësaj periudhe 95 vjeçare “në mes të dy nocioneve rivale: (a) një grup i organizatave të qëndrueshme e të paligjshme në vetvete ose anëtarët e të cilit sistematikisht angazhohen në krim; dhe (b) një vendosje e aktiviteteve të rënda penale, veçanërisht sigurimi i mallrave dhe shërbimeve të paligjshme, bëhet kryesisht për përfitime monetare” (Letizia Paoli, 2014:2).

Disa hartues të politikave dhe agjencive të zbatimit të ligjit, u shquan në mes dy nocioneve rivale, në përdorimin e termit "krimi i organizuar" në të dy shqisat brenda të njëjtit tekst jo në një qartësi të mirë. Ata i referohen organizatave kriminale, të tilla si mafias siçiliane dhe amerikane, Cosa Nostra, Yakuzat japoneze, kartelet kolumbiane dhe meksikane të drogës, si dhe grupet e tjera në shkallë të gjerë kriminale rreth botës, ku mendohet të ketë një strukturë hierarkike dhe të qëndrueshme. Nga ana tjetër, rindërtimi i trajktores historike për konceptin e krimit të organizuar ka filluar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ku ajo është përdorur pothuajse ekskluzivisht deri në vitet 1970 dhe pastaj vijon përhapjen e saj të shpejtë në Evropë që nga fundi i viteve 1980. Megjithatë, pavarësisht “pasigurive” rreth kohës, vendit e togfjalëshit të “sajuar” të saj, krimi i organizuar është origjinalisht një koncept Amerikan.

Politika, legjitimiteti dhe rëndësia e konceptit të krimit të organizuar kanë ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme me kalimin e kohës. Me përjashtim të Shteteve të Bashkuara dhe Italisë, më vende të tjera nuk e shohin krimin e organizuar si një problem serioz të brendshëm deri në fund të viteve 1980. Ndërsa, llogaritë e mediave të krimit të organizuar dhe mafia e kanë hipnotizuar gjithmonë publikun e gjërë. Shumica e studiuesve iu shmangën kësaj teme deri në fillim të viteve 1990. Vetëm pas viteve 1990 krimi i organizuar është bërë një politikë e pranuar dhe koncept shkencor praktikisht në të gjithë botën. Si rezultat i kësaj, krerët e Bashkimit Evropian morën hapat e parë drejt formulimit të një përgjigje të fuqishme për të gjitha vendet se: çfarë ishte konsideruar si një sfidë e

madhe për Bashkimin Evropian. Duke parë këtë zhvillim nga një perspektivë historike krahasuese, në 1992, menjëherë pas kolapsit të Bashkimit Sovjetik, Bashkimi Evropian u gjet vetë në një situatë të ngjashme me atë të Shteteve të Bashkuara në vitet 1920, në lidhje me rritjen e vazhdueshme të krimit të organizuar. Në këtë situatë, ishte e pamundur për të shmangur zhvillimin e një politike kombëtare koherente dhe efektive që synon kontrollin e krimit të organizuar.

Në këtë studim trajtohen disa terma dhe nocione në lidhje me nocionet krim “krim” dhe kriminalitet “criminality” dhe krimin e organizuar dhe kriminalitetin e organizuar. Për arsye të kuptimit dhe interpretimit më të mirë të këtyre termave po paraqesim shkurtimisht disa prej këtyre termave: “krimi i organizuar”, “krimi i organizuar nacional/kombëtar”, “krimi i organizuar ndërnacional”, “krimi i organizuar ndërkufitar”, “krimi i organizuar ndërshtetëror”, “krimi i organizuar transnacional” dhe “kriminaliteti i organizuar”.

Termi “krimi i organizuar” ka të bëjë me krimin e organizuar që kryhet në një vend dhe nuk kryhet në vende të tjera, apo nuk është i shtrirë me grupe e veprimtari kriminale që ushtrojnë aktivitetin në vende të ndryshme. Krimi i organizuar është një veprimtari më vete që klasifikohet si formë e manifestimit të krimit të organizuar, për shembull trafikimi i qenieve njerëzore, trafikimi i drogës etj. Termi “krimi i organizuar nacional/kombëtar”, ka të bëjë me krimin e organizuar që kryhet në një vend, komb, si përshembull në Shqipëri. Termi “krimi i organizuar ndërkufitar” është krimi i organizuar që kryhet dhe zhvillohet midis kufijve të dy vendeve të ndryshme për shembull krimi i organizuar midis Shqipërisë dhe Kosovës, por edhe midis kufijve të çdo shteti e vendi tjetër. Termi “krimi i organizuar ndërshtetëror”, domethënë ndër-shtetëror, është krimi i organizuar që kryhet nëpërmjet shteteve të ndryshme dhe bashkëpunimi për ta luftuar atë bëhet ndër shtetëror, pra nëpërmjet shteteve. Termi “krimi i organizuar transnacional / trans-nacional” është krimi i organizuar ndërkombëtar shumëkombësh “transnacional organized crime”, domethënë është krimi i organizuar që kryhet në dhe nga vende të ndryshme. Termi “krimi i organizuar ndërkombëtar”, “International organized crime” është krimi i organizuar që kryhet në kombe, vende e shtete të ndryshme. Termi “krimi i organizuar global” është krimi i organizuar shumëkombësh, që kryhet në shumë kombe në botë. Termi “kriminaliteti i organizuar”, (organized criminality) ka të bëjë me format apo veprimtaritë e kriminalitetit të

organizuar apo veprimtarive të organizuara kriminale. Në veprimtaritë e organizuara kriminale përfshihen veprimtaritë kriminale të organizuara si: terrorizmi, trafikimi i qenieve njerëzore, trafikimi i drogës, trafikimi i armëve, pastrimi i parave, korrupsioni, vrasjet me pagesë, gjobëvënia etj. Autorja Laura Z. Rodrigues shprehet se:

“Elementi themelor i kriminalitetit të organizuar është ekzistenca e një organizate kriminale. Shenja e tij përkufizuese nuk përcaktohet aq nga pjesëmarrja e një shume personash as nga veprat penale që këta kryejnë, por nga forma në të cilën personat në fjalë janë të strukturuar dhe nga fakti se si realizojnë veprimtarinë e dënueshme në fjalë” (Rodrigues,Z.L.2009:123-133).

Prandaj, nga pikëpamja metodologjike në kapituj dhe nënkapituj të veçantë brenda tekstit të studimit këto terma janë përdorur, trajtuar dhe pasqyrojnë kuptimin në kontekstin e duhur.

2.4.3 Veçoritë dhe karakteristikat e krimit të organizuar

Kriminaliteti në tërësi përmban disa karakteristika të sistemeve politike, ekonomike, juridike e shoqërore, nivelit të teknikave, mjeteve dhe instrumentave të kohës, zhvillimin e shoqërisë, dhe karakteristikën e veçantë siç është koha. Gjithashtu, karakteristika të tjera janë shtrirjet gjeografike të shteteve dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre si dhe niveli kulturor, arsimor dhe niveli psikologjik.

Krimi i organizuar është dukuri me rrezikshmeri shoqërore për; qytetarët, institucionet, sigurinë kombëtare, sigurinë rajonale, sigurinë ndërkombëtare dhe sigurinë globale. Nëpërmjet krimit të organizuar kërcënohet rendi publik, shoqëria dhe normaliteti social, pavarësia, integriteti dhe funksionimi i demokracisë, shtetit ligjor dhe siguria kombëtare e ndërkombëtare.

Krimi i organizuar është një ndër format e kriminalitetit në shoqëri që manifeston ngjashmëri me format tjera të kriminalitetit, por manifeston edhe disa veçori dalluese. Veçorite e krimit të organizuar janë të lidhura me format e organizimit të autorëve e grupeve, rrjeteve e bandave kriminale. Sipas autorëve Michael D.Lyjman dhe Garry W.Potter grupet e krimit të organizuar kanë këto veçori (karakteristika):

- 1. Janë jo ideologjike (nuk kanë qëllime politike, por thjesht qëllime të përfitimit material);*
- 2. Janë hierarkikë (kanë zinxhir të udhëheqjes). Janë struktura organizative/grupe me hierarki vertikale dhe me pushtet absolut të udhëheqësit/bosit të grupit-grup i strukturuar;*
- 3. Kanë anëtarësi të kufizuar dhe të veçantë (anëtarësimi është jo i lehtë, dhe kjo përkatësi bazohet në racë, etni, faretisni, shoqëri, familje, etj);*
- 4. Janë të përherëshme. Kjo do të thotë se ato zgjasin edhe pas vdekjes së anëtarit të grupit;*
- 5. Përdorin dhunën, kanosjen, miton dhe korrupsionin;*

6. *Demonstrojnë ndarjen specifike të punëve (planifikim në detaje);*
7. *Janë monopolistë. Ato krijojnë monopole psh, në bixhoz, prostitucion etj;*
8. *Janë të udhëhequra nga normat dhe rregullat e qarta që kanë të bëjnë me organizimin e brendshëm, sjelljen e anëtarëve etj;*
9. *Sekreti i aktivitetit dhe i veprimit të organizatës;*
10. *Mos tolerimi i tradhëtisë ndaj udhëheqësit dhe anëtarëve të organizatës;*
11. *Fushë veprimtaria kriminale e organizatës në përmasa ndërkombëtare.*

Disa autorë evidentojnë edhe disa veçori të tjera si; ekzistimin e lidhjeve ndërmjet organizatave kriminale me shtetin dhe organet e tij. Aktivitetet e grupeve kriminale të krimit të organizuar zakonisht ndërmerren me anë të dhunës fizike dhe psikike, kërcënimeve, shantazhit, dhënies së mitos, shfrytëzimit të lidhjeve me policinë, prokurorinë, gjykatat dhe organet tjera shtetërore. Krimi i organizuar është një problem juridik e ligjor, shoqëror e psikologjik, politik, ekonomik, kombëtar e ndërkombëtar.

Bashkimi European pasi filloi të merret me këtë çështje në fillim të viteve 1990, konkludoi që ishte e pamundur për të miratuar një përkufizim uniforme të krimit të organizuar, duke pasur parasysh divergjencat, vlerësimin e problemeve themelore dhe sistemeve të ndryshme ligjore të Evropës, shtetet anëtare (në atë kohë 12 shtete, tani 27; shih van der Heijden :1996). Si rezultat, BE-ja ka zhvilluar në vitin 1997 një rrjet të thjeshtë me 11 karakteristika. Prandaj, ata konfirmojnë se nuk është krim i organizuar në qoftë se grupet kriminale të përfshira, të kenë të paktën gjashtë nga karakteristikat e mëposhtme, nga të cilat 1, 3, 5, dhe 11 u konsideruan te detyrueshme:

1. bashkëpunimi i më shumë se dy njerëzve;
2. secili me detyrat e tyre të caktuara;
3. për një periudhë të zgjatur ose të pacaktuar kohe (ky kriter ka të bëjë me stabilitetin dhe (potenciali) qëndrueshmëri e grupit);
4. duke përdorur një formë të disiplinës dhe kontrollit;
5. dyshuar për kryerjen e veprave të rënda penale;
6. veprojnë në nivel ndërkombëtar;
7. duke përdorur dhunën apo veprime të tjera do të thotë të përshtatshme për frikësim të përshtatshëm;
8. përdorur struktura tregtare ose metodike;
9. angazhuar në pastrimin e parave;
10. ushtruar ndikim në politikë, media, administratën publike, autoritetet gjyqësore, ose ekonomi;
11. motivuar nga ndjekje të fitimit dhe/ose pushtet (Këshilli i Bashkimit Evropian, 1997b).

Përkundër paqartësisë së saj, përkufizimi i krimit të organizuar ka shërbyer si bazë për një stuhë të iniciativave të politikave të nivelit të lartë. Nevoja për të luftuar krimin e organizuar më efektivisht është prezantuar si një nga arsyt kryesore për avancimin e politikave mbi drejtësinë dhe punët e brendshme brenda BE^{së}. Për shkak të paqartësisë së saj, krimi i organizuar nuk është bërë një kategori e plotë ligjore. Megjithatë, BE-ja ka bërë në mënyrë të përsëritur përpjekje të "përafërt", për të harmonizuar përkufizimin ligjor të shteteve anëtare sipas veprave të anëtarësimit në një organizatë kriminale, e cila është kategoria më e afërt ligjore (shih Calderoni : 2012), si dhe për të rritur dhe avancuar me tej

kompetencat e policisë dhe prokurorisë në bashkëpunimin ndërkombëtar për zbatimin e ligjit. Ndërkohë, mund t'i referohemi edhe një date të saktë: viti 1997, vit i adoptimit të planit të veprimit kundër krimit të organizuar (akt i Këshillit të Evropës i datës 28 prill 1997). Krimi i organizuar *“udhëhiqet nga parimi i përfitimit dhe ky parim e dallon krimin e organizuar nga krimet ordinere e të rëndomta dhe nga krimet e ndryshme në administratë.”*³

2.4.4 Definicioni i krimit të organizuar

Sipas nenit 2 të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional, të nënshkruar në dhjetor 2000, si krim i organizuar kuptohet,

*“çdo grup i strukturuar i përbërë nga tre ose më shumë individë, i cili ekziston për një periudhë të caktuar kohore dhe vepron në përputhje me qëllimin e kryerjes së një ose më shumë krimeve ose shkeljeve....për të garantuar, në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë, një përfitim financiar, ose të një natyre tjetër materiale....”*⁴

Pra, ky krim udhëhiqet nga parimi i përfitimit dhe ky parim e dallon krimin e organizuar nga krimet ordinere e të rëndomta dhe nga krimet e ndryshme në administratë.

Ndërsa, shtete, organizata kombëtare e ndërkombëtare, politikanë, analistë, jurist, kriminalistë, ekspertë, studiues dhe autorë të ndryshëm, japin përkufizime të ndryshme. Kështu, agjencitë amerikane të zbatimit të ligjit, pranojnë si përkufizim të krimit të organizuar; *“Një aktivitet kriminal të dënueshëm, të vazhdueshëm e vetëveprues, duke patur një strukturë të organizuar, të ushqyer nga frika dhe korrupsioni dhe të motivuar nga etja për fitim.”*⁵ Termi i “organizuar” në togfjalëshin “krim i organizuar” është reflektuar në këtë përkufizim.

FBI^{ja} e përkufizon në këtë mënyrë krimin e organizuar: *“Një marrëveshje e fshehtë bashkëpunimi që vazhdon dhe përsëritet, që mbahet nga frika dhe korrupsioni dhe motivohet nga përfitimi ekonomik”*.

Organizata e Kombeve të Bashkuara ka përcaktuar se *krimi i organizuar është*

³Konventa e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar (Palermo 2000), neni 2, ratifikuar me ligjin nr. 8920 datë 11.07.2002 “Për ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar”

⁴ Po aty

⁵ “Kërcënimet e krimit të organizuar ndërkombëtar” Raporti i Këshillit të Sigurimit Kombëtar të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Uashington 2001, faqe 6

“Veprimtari kriminale me përmasa të mëdha e kryer nga grupe personash, të mirë organizuar apo pak të organizuar, për pasurimin e anëtarëve në dëm të komunitetit dhe qytetarëve. Në shumë raste realizohet nëpërmjet shkeljes flagrante të ligjit, përfshirë krime kundër personit dhe shpesh në bashkëpunim me korrupsion politik”. (United Nations, 1975: 8).

Sipas Këshillit të Evropës me krim të organizuar kuptojmë:

“Veprimtari të fshehta të bëra nga grupe të organizuar prej më shumë se tre apo më shumë personash, për një kohë të gjatë me synimin e kryerjes së krimeve të rënda nëpërmjet veprimit të përbashkët dhe duke përdorur frikësimin, dhunën, korrupsionin ose mjete të tjera për të siguruar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë për përfitim financiar ose të një lloji tjetër material”. (Council of Europe, 2002:6).

Sipas INTERPOL^{it} përkufizimi i krimit të organizuar përmban: *“Grupet që kanë një strukturë të përbashkët dhe të përbërë, objektivi parësor i të cilit është të sigurojë të ardhura nëpërmjet veprimtarive të fshehta, shpesh me anë të frikës dhe korrupsionit”. (Paul Nesbitt, 1993 : 319).*

Në vitin 1998 është krijuar një përkufizim zyrtar në një dokument që ka fuqinë e të drejtës ndërkombëtare dhe është përkufizimi i organizatës kriminale në veprimin e përbashkët të miratuar në nivelin e BE^{së}:

“Organizata kriminale nënkupton një shoqatë të strukturuar, të krijuar për një periudhë kohore, pjesëmarrjen e një, ose më shumë personave, që operojnë në mënyrë të bashkërenduar, me qëllim kryerjen e veprave penale të cilat ndëshkohen me heqje lirie, ose urdhër izolimi, për të paktën katër vjet, ose edhe me një dënim akoma më të rëndë, kur këto vepra përbëjnë qëllim në vetvete, ose mjet për arritjen e përfitimeve materiale, ose sipas rastit, për të influencuar në mënyrë të padrejtë, autoritetet publike operative.”⁶

Krimi i organizuar përfshin aktivitetet e paligjshme të cilat kryhen nga një grup, organizate kriminale grup i strukturuar kriminal apo bandë e armatosur për të siguruar përfitimet financiare e materiale. Krimi i organizuar është një sfidë e madhe e sigurisë. Krimi i organizuar nuk është i kufizuar vetëm në kufijtë kombëtar të shtetit, por ai vazhdimisht zgjerohet dhe nuk njihet kufij, racë, atdhe, kombësi dhe fe.

2.4.5 Krimi i organizuar transnacional

Përpjekja e parë e qeverisë amerikane për të studiuar krimin e organizuar është kryer në mes të viteve 1929 dhe 1931 nën kujdesin e Komisionit Kombëtar mbi ligjin vëzhgimin dhe zbatimin e kryesuar nga George Wickersham. Në raportin e tyre ndaj komisionit për kostot e krimit, dy prej konsulentëve të komisionit trajtuan gjerësisht dhe në

⁶ Veprimi i përbashkët 98/733/JHA (Justice and Home Affairs-Punët e Brendshme dhe Drejtësia), i datës 21 dhjetor 1998, miratuar nga Këshilli Evropian, mbi bazën e nenit K.3 të Traktatit për BE-në, që parashikonte penalizimin e pjesëmarrjes në një organizatë kriminale në Vendet Anëtare të Bashkimit Evropian

mënyrë më të organizuar për strukturimin e të dhënave të tyre "rreth kategorive bazuar në të drejtën penale, e jo kategorinë bazë të kriminelëve, që ishte më e rëndësishme" (Smith 1991:142). Kuptimi i krimit të organizuar si një grup i aktiviteteve kriminale sipërmarrëse me përfshirjen e shpeshtë e bizneseve ligjorë dhe përfaqësues të qeverisë ishte braktisur pas Luftës së Dytë Botërore. Nga 1940 e tutje, konceptualizimi i problemit u fokusua në kriminelët e karrierës dhe të huaj, të cilët gjoja përbënin mirë-strukturimin dhe organizata të fuqishme kriminale që përfaqësojnë një kërcënim për integritetin e shoqërisë amerikane dhe politikës.

Nga fillim të viteve 1990 e më pas, konsiderohet rritje e vëmendjes në natyrën transnacionale të krimit të organizuar, veçanërisht nga ana e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB). Krimi i organizuar vetëm pas viteve 1990, është bërë një politikë e pranuar dhe praktikisht një koncept shkencor në të gjithë botën.

Krimi i organizuar ndërkombëtar "transnacional" megjithëse është rreth 100 vjeçar dhe ka mbi njëqind (100) përkufizime e definicione të ndryshme, ai, edhe sot e kësaj dite vazhdon të përmbajë në vetvete shumë hapësira interpretimi, një pjesë e të cilave mund të ndikojnë negativisht. Termi krim i organizuar "*transnacional*" dhe termi "*internacional*" ndërkombëtar - është përdorur për herë të parë në vitin 1975 në Kongresin e Pestë të UN (Kombeve të Bashkuara) *Mbi Parandalimin e Krimit dhe Trajtimin e Ofezave - Krimi përtej kufijve ka ardhur duke u shtuar.*⁷ Ndërsa, Jeanne Giraldo dhe Harold Trikunas, theksojnë se: "*Dallga e tretë e demokracisë e cila filloi me revolucionin portugez në vitin 1974, ka prodhuar një zgjerim të paprecedent në lirinë njerëzore*". Ata argumentojnë se në shumë shtete sipërmarrjet kriminale transnacionale kanë përfituar nga destabiliteti që kanë shoqëruar këto tranzicione, kanë hedhur rrënjë të thella, duke përdorur korrupsionin, duke zgjeruar influencën e tyre në aparatet shtetërore, kanë dobësuar besimin publik dhe kanë nënshtruar imponimin e ligjit ndaj tyre. Në vitin 1994 në konferencën e organizuar në Uashington, Qendra për Studimet Strategjike dhe Ndërkombëtare e emërtoi krimin transnacional "*perandoria e së keqes.*"⁸ Sipas Raportit të Kombeve të Bashkuara të vitit 1996, krimi transnacional ishte bërë "*forma e re e gjeopolitikës.*"⁹ Krimi transnacional

⁷Konventa mbi Krimin Transnacional dhjetor 2000, neni 2

⁸Konferenca e organizuar nga Qendra për Studimet Strategjike dhe Ndërkombëtare në Uashington 1994

⁹Raporti i Kombeve të Bashkuara 1996

paraqitet: ”një fenomen si një kërcënim madhor i sigurisë kombëtare.”¹⁰ Ndërsa, në dhjetor 2000, është miratuar Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar transnacional.

Duke qenë se krimi i organizuar transnacional është bërë pothuajse sinonim i aktivitetit për ndërmarrje të paligjshme në ditët e sotme edhe përkufizimet për krimin e organizuar në konceptin ligjor lypet ti jepen më qartë në lidhje me të kuptuarit mafioz në qendër të krimit të organizuar (shih Hagan:1983), pasi edhe shtrirja territoriale e krimit të organizuar, ka ndryshuar. Ai fillimisht u barazua me shantazh, dhe ky ishte një tjetër nocion i paqartë në thelbin e të cilave ka zhvatje, një aktivitet i bazuar domosdoshmërisht territorialisht dhe që kryhen vetëm në baza lokale. Që nga viti 1990, në vend të kësaj shumë hulumtues (Williams & Florez 1994: 9-24). (Siegel, van de Bunt & Zaitch :2003) dhe një numër edhe më i madhi i agjencive qeveritare dhe organizatave ndërkombëtare, duke filluar nga Bashkimi Evropian, Kombet e Bashkuara (OKB 1994, Këshilli i Bashkimit Evropian 1997a;(Council of the European Union.1997a: 1-13), Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara 2000a; Shtëpia e Bardhë 2011), kanë theksuar natyrën transnacionale të krimit të organizuar. Pra, 15 vjet nga koha e trajtimit për herë të parë të termit krim i organizuar transnacional ose ndërkombëtar.

2.4.6 Definicioni i krimit të organizuar transnacional

Klaus von Lampe, një specialist në kërkimin e organizuar të krimit dhe vetë një studiues mbi krimin e organizuar, “ka hartuar mbi njëqind përkufizime të ndryshme të krimit të organizuar”. Por, sipas Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar transnacional (e datës 15 nëntor të vitit 2000), Neni 2¹¹ përcakton se:

(a) “Grup i organizuar kriminal” do të thotë një grup i përbërë nga tre apo më shumë persona që ekziston për një periudhë kohore dhe vepron bashkë, me qëllim të kryerjes së një a më shumë krimeve serioze apo kundravajtjeve të caktuara në parim me këtë Konventë, me qëllim që të arrij, në mënyrë direkte, apo indirekte, një përfitim financiar apo ndonjë përfitim tjetër material; (b) “Krim serioz” do të thotë kryerja e një kundravajtjeve të dënueshme me heqje

¹⁰ Strategjia Kombëtare e Sigurisë e Shteteve të Bashkuara, 1996

¹¹ Konventa e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar (Palermo 2000), ratifikuar me ligjin nr. 8920 datë 11.07.2002 “Për ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar”. Protokollin është pjesë e Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Krimit të Organizuar Nderkombëtar, të ratifikuar me ligjin nr. 8920, datë 11.07.2002 “Për ratifikimin e “Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Krimit të Organizuar Nderkombëtar” dhe dy protokolleve shtesë të saj”, të botuar në Fletoren Zyrtare nr. 41, dt. 25.7.2002, fq. 1195.

maksimale lirie së paku kater vitesh apo një dënim më serioz; (c) “Grup i strukturuar” do të thotë një grup që nuk është formuar rastësisht për kryerje të menjëhershme të një kundravajtjeje dhe se nuk ka nevojë të ketë role të definuara zyrtare për anëtarët e saj, vazhdimësinë e anëtarësisë apo një strukturë të zhvilluar;

Krimi i organizuar transnacional është i natyrës ndërkombëtare nëse: (a) Është kryer në më shumë se një shtet; (b) Është kryer në një shtet por një pjesë e konsiderueshme e përgatitjes, planit të drejtimit apo kontrollit të saj ndodh në ndonjë shtet tjetër; (c) Është kryer në një shtet por përfshin një grup të organizuar kriminal që merret me aktivitete kriminale në më shumë se një shtet; apo (d) Është kryer në një shtet por ka efekte të konsiderueshme në shtetin tjetër.

Baza juridike e konceptit të krimit të organizuar në format e tij në Shqipëri përcaktohen në nenin 28 të Kodit Penal,¹² i cili shprehet se:

“Organizata kriminale është forma më e lartë e bashkëpunimit në të cilën bëjnë pjesë tre ose më shumë persona dhe që dallohet nga shkalla e veçantë e organizimit, strukturimit, qëndrueshmërisë, kohëzgjatjes, si dhe nga qëllimi për kryerjen e një a më shumë veprave penale për të realizuar përfitime materiale dhe jo materiale. (Neni 28 i Kodit Penal, paragrafi 1). Ndërsa, përkufizimi i organizatës terroriste, (Neni 28 i Kodit Penal, paragrafi 1) i bandës së armatosur (Neni 28 i Kodit Penal, paragrafi 3) dhe i grupit të strukturuar kriminal. (Neni 28 i Kodit Penal, paragrafi 4). Krijimi dhe pjesëmarrja në to cilësohen si vepra penale dhe dënohen sipas parashikimeve në normat e pjesës së posaçme të Kodit Penal (nenet e veçanta 284/a e 333).

Nocioni i krimit të organizuar sipas legjislacionit penal të Republikës së Kosovës, shprehet se: Në Kosovën e pasluftës janë shënuar edhe risi në çështjet që lidhen edhe me krimin e organizuar. Në këtë drejtim, UNMIK-u fillimisht ka nxjerrë Rregulloren “Mbi masat kundër krimit të organizuar”. Sipas kësaj rregullore krimi i organizuar nënkupton kryerjen e një apo më shumë krimeve të rënda, nga një grup i organizuar me qëllim të përfitimit material apo financiar. Sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës:

“grup kriminal i organizuar” nënkupton bashkim i strukturuar, që ekziston për një kohë të caktuar, i tre apo më shumë personave për kryerjen e veprave të caktuara penale, që vepron në bashkëpunim me qëllim të kryerjes së një apo më shumë veprave të rënda penale për përfitim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dobisë financiare apo dobisë tjetër pasurore (Kodi Penal i Kosovës (2012), Neni 283).

Këto formulime në tërësi janë në harmoni me ato të Konventës së OKB-së kundër krimit të organizuar transnacional të vitit 2000 me përjashtim të disa dallimeve që përmban grupi i strukturuar kriminal.¹³”

¹²Ndryshuar me ligjin nr.9275 datë 16.09.2004, ndryshuar pika 2 dhe paragrafi 2 me ligjin nr.9686 datë 26.02.2007.

¹³Sipas Konventës do të kishim të bënim me grup të strukturuar, vetëm nëse ekzistojnë tiparet e mëposhtme: 1.Ekzistenca e një strukture organizative të përshtatshme për të realizuar një ose disa vepra penale; 2.Një bërthamë permanente pjesëmarrësish, me të paktën tre persona, që zakonisht shfaq tendencën për të zgjatur edhe përtej realizimit të veprimtarisë kriminale; 3. Një bërthamë pjesëmarrje, që ka si qëllim realizimin e një programi kriminal, i cili ka për objekt kryerjen e një kategorie të paracaktuar veprash penale (krime) që konsistojnë në shkelje të rënda; 4.

2.4.7 Tiparet themelore të krimit të organizuar transnacional

Në lidhje me tiparet, format dhe metodat e krimit të organizuar dhe krimit të organizuar transnacional, hartuesit e konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar transnacional kanë marrë në konsideratë pikëpamjet e analistëve, që kanë nxjerrë shpeshherë në pah tre tipare të tjera karakteristike të krimit të organizuar, vijojnë autorët Jeanne Giraldo dhe Harold Trikunas:

"1 - tendencën e përdorimit sistematik të korrupsionit dhe të dhunës; 2-marrjen parregullisht të niveleve të larta të të ardhurave, krahasuar me organizata të tjera kriminale; dhe 3-shkatërrimin e ekonomisë formale dhe depërtimin në të përmes riinvestimeve të përfitimeve të jashtëligjshme" (Alan Collins, 2010 : 438).

Pra, autorët evidentojnë krimin e organizuar si subjekt të një shqetësimi të veçantë ku pasuria dhe fuqia e tyre dëmton shoqërinë, ekonominë dhe qeverinë, ku objekti i luftës ndaj tyre mbetet imponimi i ligjit dhe ç'rrenjosja e organizatave kriminale të cilat kanë për objekt asetet kriminale. Prandaj mbetet detyrë sekuestrimi dhe konfiskimi asetëve kriminale të grupeve e organizatave kriminale e mafioze dhe kalimi i tyre, shtetit dhe shoqërisë.

2.4.8 Karakteristikat e krimit të organizuar transnacional

Karakteristika të krimit të organizuar transnacional janë: struktura hierarkike e grupit, pjekuria organizative, disiplina, diversiteti i krimit, organizimi, dhe besnikëria e anëtarëve të organizatës; shtyrja drejt korrupsionit të zyrtarëve dhe të qeveritarëve, me synimin në çdo rast të kërkimit të fitimit financiar. Ndërsa karakteristikat e veçoritë e grupeve shqiptare të krimit të organizuar janë:të organizuara mbi bazën e klaneve, fisit dhe qyteteve përkatëse kryesisht grupet që veprojnë jashtë vendit në Evropë dhe vendet e tjera; kanë strukturë horizontale dhe shpesh ndërrojnë padron; njihen dhe veprojnë me dhunë duke bërë presione nëpërmjet përdorimit të armëve; pëlqejnë qarkullimin e vlerave monetare “cash”; përdorin pseudonime dhe komunikimet telefonike i bëjnë përgjithësisht të hapura.

Elementë të cilet e tejkalojnë shprehjen e vullnetit dhe dashjes për të kryer vepra penale dhe është tregues i ndërgjegjësimit të anëtarëve të organizatës, për t'u grupuar së bashku me qëllim kryerjen e shumë krimeve.

Krimi transnacional kërcënon sigurinë kombëtare dhe sjell dëme e pasoja nga veprimtaria e grupeve kriminale transnacionale. Krimi transnacional cënon sigurinë e jetës, shëndetit dhe veprimtarisë jetësore njerëzore sepse ai dëmton individët si pjesa kryesore e shoqërisë për të vazhduar më tej, me dëmtimin që i shkakton shoqërisë, shtetit si dhe institucioneve të ndryshme. Sipas Jeanne Goraldo dhe Harold Trikunas, rezulton që: *“krimi i organizuar transnacional shkel dhe i dhunon të drejtat individuale si dhe të drejtat e njeriut.”* (Alan Collins, 2010; 434). Por, duhet theksuar se autorët e krimeve transnacionale, janë të pasur dhe të fuqishëm dhe si të tillë ata përbëjnë kërcënime reale për sigurinë kombëtare, ata arrijnë të dobësojnë shtetin, të sfumojnë demokracinë dhe ekonominë nëpërmjet korrupsionit. Sipërmarrjet e krimit transnacional, arrijnë të sfidojnë aftësinë e shteteve dhe institucioneve të tyre për të ushtruar funksionet e tyre bazë qeverisjen dhe drejtimin e duhur të institucioneve e të shtetit.

2.4.9 Kategoritë e krimit të organizuar transnacional dhe kategoritë e krimit të organizuar në Shqipëri

Në studimin e katërt të Kombeve të Bashkuara për tendencat e krimit dhe operacionet e sistemeve të të Drejtës Penale (1994) janë përcaktuar *“Kategoritë e krimit të organizuar transnacional”* (Alan Collins, 2010;438). *“Kategoritë e krimit të organizuar transnacional”* janë:

“Pastrimi i parave, trafikimi i jashtëligjshëm i drogës, korruptimi i zyrtarëve shtetërorë, depërtimi në biznese të ligjshme, pseudo-falimentimi, mashtrime me sigurimet, krimi elektronik, vjedhja e pasurisë intelektuale, trafiku i jashtëligjshëm i armëve, terrorizmi, pirateria e avionëve, pirateria në dete, pengmarrja në tokë, trafikimi i qënieve njerëzore, tregtia e pjesëve të trupit të njeriut, vjedhja e objekteve të artit e kulturës, krimi mjedisor dhe trafiqe të tjera të jashtëligjshme”. (Phil Williams & Dimitri Vlassis, (2001:14).

Pra, janë 18 kategori të krimit të organizuar transnacional.

Ndërsa në Vendimin e Këshillit të Ministrave i Republikës së Shqipërisë Nr.1140, datë 30.7.2008 *“Për miratimin e Strategjisë ndërsektoriale të luftës kundër krimit të organizuar, trafiqeve dhe terrorizmit”* konstatojmë se theksohet se:

“...si prioritete kryesore të Policisë së Shtetit në luftë kundër krimit të organizuar do të jenë: lufta kundër drogave; lufta kundër trafiqeve të paligjshme: lufta kundër trafikimit të qënieve njerëzore dhe kontrabandimit të njerëzve; lufta kundër trafikimit të armëve; lufta kundër

*trafikimit të makinave të vjedhura; lufta kundër trafikimit të veprave të artit; lufta kundër pastrimit të parave dhe korrupsionit; lufta kundër terrorizmit”.*¹⁴

Pra, janë tetë (8) kategori të krimit të organizuar. Ndërkohë nuk konstatohet në ligjet dhe dokumentat strategjike në Shqipëri që të trajtohen 18 kategoritë e krimit të organizuar transnacional në bazë dhe për zbatim të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar transnacional të vitit 2000 dhe në bazë të studimit të katërt të Kombeve të Bashkuara për tendencat e krimit dhe operacionet e sistemeve të të Drejtës Penale (1994).”

Duke analizuar e krahasuar përmbajtjen e tre dokumentave, 1-Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar transnacional të vitit 2000; 2-Studimin e katërt të Kombeve të Bashkuara për tendencat e krimit dhe operacionet e sistemeve të të Drejtës Penale (1994); dhe 3-“Strategjinë ndërsektoriale të luftës kundër krimit të organizuar, trafikeve dhe terrorizmit” të miratuar në Korrik 2008, nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, evidentohet se strategjia nënsektoriale nuk përmban të tetëmbëdhjetë (18) kategoritë e krimit të organizuar transnacional, por parashikon vetëm tetë (8) kategori të fushës së krimit të organizuar. Nga ky krahasim, dy janë konstatimet ose legjislacioni ka parashikuar vetëm tetë kategori të krimit të organizuar, duke parashikuar vetëm kategoritë e krimit të organizuar, ose ka parashikuar tetë kategoritë e krimit të organizuar duke “nënkuptuar” edhe kategoritë e krimit të organizuar transnacional, por që edhe në këtë nënkuptim nuk janë parashikuar tetëmbëdhjetë kategori, por vetëm tetë kategori. Pra, konstatohet se legjislacioni shqiptar në këtë përcaktim të konventës nuk përputhet me tetëmbëdhjetë (18) kategoritë e krimit të organizuar transnacional që kanë përcaktuar Kombet e Bashkuara”.

Përderisa nga njëra anë detyrimet e konventave ndërkombëtare janë të detyrueshme për tu zbatuar, dhe nga ana tjetër, “trumpetohet” me zë të lartë nga politika se fusha kryesore e veprimeve të institucioneve të shtetit në Shqipëri është lufta kundër krimit të organizuar, nevojitet një analizim më i thellë dhe më i plotë i figurave të krimit të organizuar dhe sidomos të krimit të organizuar transnacional, me qëllim që legjislacioni shqiptar në zbatim të konventave e marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara e

¹⁴Vendimi i Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë nr.1140, datë 30.7.2008 “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale të luftës kundër krimit të organizuar, trafikeve dhe terrorizmit”.

nënshkruara nga shteti shqiptar, lypet të gjejnë njohje e zbatim të plotë. Prandaj rekomandohet që institucionet e shtetit shqiptar duhet të parashikojnë dhe t'a aktualizojnë detyrimet ligjore të përcaktuara nga Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar transnacional edhe në ligjet e aktet normativë në Shqipëri. Gjithashtu, duhet të gjejnë pasqyrim edhe raportet e institucioneve e organizmave të tjerë ndërkombëtar që kanë studiuar, analizuar e raportuar me raporte të ndryshme periodike për “*kriminalitetin shqiptar, krimin e organizuar dhe mafien shqiptare në Shqipëri dhe në botë.*” Këto masa do të ndikojnë pozitivisht për përmirësimin e legjislacionit edhe me format e tjera të manifestimit të krimit të organizuar transnacional që rezultojnë në zbatim të detyrimeve të akteve ndërkombëtare, të njohura e të pranuar, të nënshkruara, apo edhe të akteve të tjera ndërkombëtare të panjohura e të pa nënshkruara akoma nga shteti shqiptar.

2.4.10 Ngjashmëritë dhe dallimet midis krimit të organizuar dhe krimit të organizuar transnacional

Në periudhën e sotme, koncepti i krimit të organizuar mund të themi se ka arritur tashmë kulmin e përhapjes të tij veçanërisht në Evropë, ku të dy palët, politikëbërësit dhe hulumtuesit kanë filluar për të zëvendësuar atë me koncepte alternative. Midis termave “krim i organizuar” dhe “krim i organizuar transnacional” ka ngjashmëri dhe dallime. Kështu, për dekada të tëra, ka patur debate në lidhje me domethënien e krimit të organizuar. Ka patur edhe mosmarrëveshje në këtë drejtim, por shumica e studiuesve kanë rënë dakort me faktin se, grupet kriminale dallojnë mes tyre për nga struktura, fuqia, përmasat, gama dhe shumëllojshmëria e aktiviteteve të cilat përfshihen. Në librin e autorit Alan Collins “*Studime Bashkëkohore të Sigurisë*”, autorët Jeanne Giraldo dhe Harold Trikonas shprehen se:

“Termet “krim i organizuar” dhe “krim i organizuar transnacional” përdoren disa herë duke këmbyer vendin me njëri-tjetrin, jo të gjitha krimet transnacionale kryhen prej grupeve të krimit të organizuar dhe jo të gjitha grupet e krimit të organizuar janë të përfshira në krimin transnacional. Pavarësisht këtij dallimi, shumica e analizave të krimit transnacional fokusohet sidomos në krime të kryera nga organizata që janë krijuar në mënyrë eksplicite për sigurimin e përfutimeve prej aktivitetit të jashtëligjshëm. Prej kësaj analize përjashtohen të ashtëquajturit “kriminel të rastësishëm” - pra, individë ose biznese të angazhuara në aktivitete tregtare legjitime të cilët mund të kryejnë krime transnacionale. Duke ndjekur këtë qasje, Konventa e Kombeve të Bashkuara i është adresuar kërcënimit nga krimi i organizuar transnacional. Përse duhet të fokusohemi në grupet e organizuara që kryejnë krime transnacionale, në vend të fokusimit në vetë aktivitetet kriminale?.” (Alan Collins, 2010 : 438).

2.4.11 Krimi i organizuar transnacional dhe globalizmi

Krimi i organizuar transnacional dhe globalizmi “bashkëjetojnë” me njëri-tjetrin. Krimi i organizuar transnacional është një sfidë kritike për qeverisjen demokratike dhe tranzicionin dhe modernizimin të proceseve në shumë pjesë të botës. Prandaj, kërkohet një strategji gjithëpërfshirëse që kombinon zbatimin e ligjit dhe analiza të zgjeruara të inteligjencës, shtet-ndërtimit, dhe bashkëpunimit ndër-shtetëror, duke përfshirë ndryshimin e qëndrimeve kulturore ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit në shoqërinë civile dhe sektorin privat.

Ndërsa, globalizmi “ndihmon” që krimi të përhapet me shpejtësi, por edhe të depërtojë me lehtë brenda institucioneve duke korrumpuar zyrtarë të zbatimit të ligjit. Prandaj, e ardhmja e krimit të organizuar transnacional lidhet me globalizmin. “Krimi i organizuar transnacional është “*ana e errët*” e globalizmit” dhe shfrytëzohet shumë nga krimi dhe kriminelët. Krimi i organizuar ekziston sot në vendet e origjinës, në vendet tranzit, dhe ai është në lëvizje të vazhdueshme si rrjedhojë e mundësive që i ka krijuar globalizmi, ose ndërkombëtarizimi. Krimi i organizuar ka tendencë për t’u zhvilluar e lulëzuar në vendet e përfshira në luftëra e konflikte, në vendet në tranzicion, në vendet e varfëra, të pazhvilluara dhe me kapacitete të ulëta, në vendet në të cilat qeveria është e dobët dhe e korrumpuar, pothuajse si një gjë e natyrshme dhe, për këtë arsye, bëhet pjesë e problemit në vend dhe jo pjesë e zgjidhjes. Dennis M.P. Mc Carthy përshkruan:

“Gjeografia punon në favor të krimit të organizuar.” Malet e thyera” dhe “një vijë bregdetare e gjatë” ndjell përshkrimin tonë për gadishullin Italian dhe Sicilinë. Vija bregdetare e Italisë është e pamatur, ne kemi tashmë në dukje, një ftesë për njerëzit dhe trafikimin kontrabandë; kjo nuk është për t’u habitur se një aktivitet i madh për krimin e organizuar shqiptar janë njerëzit kontrabandistë. Shqipëria, në fund të fundit, duket vetëm nëpërmjet detit Adriatik në Italinë juglindore, atdheu i Sacra Corona Unita.” (Dennis M.P. Mc Carthy, 1997:78-79).

“...Nuk duhet harruar që janë njerëz si ne, edhe ata që i përkasin krimit të organizuar, i cili si të gjitha gjërat njerëzore, mund të përballohet dhe fitohet.” (Giovanni Falcone & Marcelle Padovani :1991). Prandaj, është e domosdoshme të njihen dhe të dihet se shtetet e dobëta ose shtetet e dështuara, apo vendet që kanë institucione të brishta, politika të paqëndrueshme, shtete totalitare, demokraci të pazhvilluara, ekonomi të dobëta, varfëri e papunësi të madhe, mungesë investimesh, drejtues shteti dhe politikanë të lartë shtetërorë diktatorë, totalitaristë, dhe të korrumpuar. Vetëm në këtë mënyrë, lypet që në

fillim që të hartohen politika, strategji, programe e plane të veprimit të institucioneve për t'a luftuar në maksimum krimin e organizuar transnacional.

2.5 Mafia dhe krimi i organizuar

Kuptimi klasik i mafies së organizuar mbi baza familjesh, me organizime të vogla është rinovuar në ditët tona. Organizimi kriminal, si rrjedhojë e përshtatjes me kohën është i përhapur si një oktapod gjigand me kokën larg zonave të “veprimtarisë” së filialeve të tyre. Qarkullimi i parave të tyre të pista tashme bëhet duke i menaxhuar bizneset e veta me ane të menaxherëve të zonës. Në këtë aktivitet të administruar nga mafiozët, krijohet dhe sistemi i pushtetit, i cili perpiqet të konkurojë Shtetin në legjitimitetin ekskluziv, që i ka dhënë vota popullore për të ushtruar forcën, taksimin dhe zbatim e ligjeve. Konkurimi që mafiozët i bëjnë këtyre monopoleve të shtetit jep rrjedhojat e veta në krijimin e pasigurisë në vend dhe humbjen e paqes së popullit. Mafia duke qenë një veprimtari e organizuar kriminale përbën një kërcënim për Shtetin apo thënë ndryshe “Mafia është armik i Shtetit”. Prandaj, synimi i mafiozëve të sotëm është jo vetëm korruptimi i politikanëve, administratorëve publike, drejtuesve të policisë, prokurorëve apo gjykatësve për të bërë një sy qorr karshi biznesit të tyre mafioz. Por gjithashtu me fitimet e paligjshme të tyre, që janë shumë me të larta se çdo biznes i ligjshëm, kërkojnë ta përdorin administratën publike qendrore dhe lokale, që t'i lejojë të përdorin burimet kombëtare.

Mafia administron aktivitetin kriminal dhe krijon një pushtet të ngritur në sistem dhe ai synon të konkurojë Shtetin. Shtetin kërkon t'a imitojë në aspektin e legjitimitetit ekskluziv, dmth që ka marrë vota popullore sipas tyre për të përdorur forcë, për të vendosur taksa, apo taksimin dhe për të kërkuar zbatimin e ligjit. Si e zbatojnë ligjin mafiozët, natyrisht ata nuk zbatojnë ligjin e shtetit e së drejtës dhe liritë e të drejtat e njeriut, por e zbatojnë në aspektin e kundërt, ata e zbatojnë ligjin nga një pakicë ndaj shumicës pra, është antipodi i shtetit. Mafia konkuron monopolet e shtetit. Mafia krijon pasiguri në vend dhe ndikon në humbjen e paqes së popullit.

2.5.1 Mafia, krimi i organizuar i tipit mafioz dhe mafiet e “reja”

2.5.1.1 Mafia

Në historinë e hershme të mafies, organizatat kriminale në Itali; si Mafia Siçiliane- fjala mafia rrjedh nga një emërtim i një organizate italiane e krijuar më 1282 në Siçili për të kundërshtuar pushtimin Francez, që quhej Morte Alla Francia Italia Amella, pra, nga shkronjat e para të kësaj organizate ka rrjedh emri MAFIA. (Italian for 'Death To the French Is Italy's Cry').

Termi “mafia”(mafiusi), është përdorur për herë të parë dhe ka hyrë zyrtarisht në fjalorin e gjuhës italiane në vitin 1963, kur rregjisorët Giu Seppe Rizotto dhe Gaetano Mosca përgatitën dhe prezantuan një shfaqje teatrale të përkthyer në gjuhën italiane të cilët përdoren në skenë shprehjen:“*I mafiusi di la Vicaria*” dhe në këtë kohë, në këtë shfaqje teatrale paraqitej miti i mafias së “mirë”, domethënë mafia, mafozët apo “*të nderuarit*”, mbrojnë të dobëtit. “Mafia” për herë të parë si e strukturuar paraqitet në fillim të viteve 1970 në shtetet evropiane. “Mafia” është një strukturë sekrete dhe e organizuar që njeh aktivitetin e saj dhe të tjerëve. “Mafia”mbetet në thelb një bashkim vëllazërimi kriminal me shtrirje të gjërë.

Në Itali, krimi i organizuar i referohet kryesisht Mafias, si Cosa Nostra, Camorra Campagna, Ndragheta-kalabreze, Sacra Corona Unita-puljeze, organizata kriminale që Kodi penal Italian, duke filluar nga viti 1982, përcakton dhe sanksionon me nenin 416. Studimet e para në terren në Siçili në mes të viteve 1960 dhe fillim të viteve 1980. Shprehjet "krimi i organizuar" dhe "mafie", janë përdorur gjithnjë për t'iu referuar kriminelëve të huaj që veprojnë në Itali (p.sh., Ministero dell'Interno 2002). Në Kalabri, familjet biologjike në thelb të disa grupeve të mëdha 'Ndrageta ka pasur poste në pushtetin në qytetet e tyre dhe fshatra gjatë 100 viteve të fundit . Sipas Anxhelo Umilta në librin e tij “Camorra & Mafia”, botuar për herë të parë në vitin 1878 në Zvicër e përshkruan pak a shumë kështu lindjen e Mafies:

“... ecuria e ngadaltë dhe misterioze e shpërbërjes sociale... megjithatë kur shpërbëhen lidhjet morale që unifikojnë njerëz, lind domosdoshmërisht nevoja për të krijuar të tjera, jo më pak të forta. Kur solidariteti i të mirës, nuk ekziston më, një tjetër parim i afrimit, bën rrugë pak e nga pak.Dhe kuy është solidariteti i krimi, Gjithpka që nuk trajtohet nga ana e shoqërisë legale, trajtohte nga ana tjetër e shoqërisë, asaj jo legale, që kërkon të organizohet mbi baza të ndryshme nga ajo e moralit, e të drejtave dhe detyrave. Dhe linden grupime kriminale të tipit Mafie.”

Sipas tij, Mafi ka ligjet e saj, normat e saj, detyrimet për anëtarët e saj (Zamir Poda,1998:6). Pra, Mafia ka ligjet, normat, detyrime, organizimin, statute, rite, shenja të njohjes, asamble, këshill, organizim unik dhe strukturë vertikale.

2.5.1.2 Organizatat e mafias në Itali

Tri organizata apo grupe më të mirë të organizatave janë në ditët e sotme kryesisht referuar si mafias në Itali. Organizimi i parë, është mafia siciliane Cosa Nostra ("gjë jonë"), një konfederatë prej rreth 150 grupe, të vendosura kryesisht në pjesën perëndimore të Sicilisë, më shumë veçanërisht në provincat e Palermos. Organizimi i dytë, quhet 'Ndrageta dhe është gjithashtu një konfederatë e rreth 150 grupe. Këto të gjitha kanë origjinën nga pikën më jugore të gadishullit italian, Rajoni Kalabria, kryesisht nga krahinat e Reggio Calabria dhe Vibo Valentia. Në dialekt me origjinë greke që është ende i përhapur në Kalabri, fjala "Ndrageta" do të thotë "Shoqëria e burrave të nderit" dhe ende ka një konotacion pozitiv vendosur (Marinon, 1988 :16). Sipas studiuesit Zamir Poda:

"Ndrageta përfshin grupe të vendosura jashtë Rajoni i saj në shtëpi, në rajonet e Lombardia, Piemonte, dhe Liguria, si dhe në disa vende të huaja, më të dukshëm Gjermani, Kanada, dhe Australi. Numri i anëtarëve të paktën 10.000. Pesë njëqind prej tyre, ishin të organizuar në rreth 25 grupe, dhe janë aktive, ndërsa në mes të viteve 1990 numri i tyre shkoi në rreth 3.000. Mafia, në të gjithë sensin e saj, ka origjinë siciliane, ku ekziston si një organizim unik me strukturë vertikale, dominuar nga Cosa Nostra"(Zamir Poda,1998:12).

Cosa Nostra ka qenë tradicionalisht shumë më selektive në politikat e saj të rekrutimit se sa Ndrageta. Pas viteve '80 është zhvilluar lufta e dytë kundër mafiozeve e quajtur "goditja e Korlonezeve". Më i madhi dhe më i fuqishmi nga të gjithë ishte Tomaso Buscetta, që ishte kryetar i familjes Korleone dhe mbi quhej "bos i dy boteve". Goditja për Cosa Nostra, filloi në Palermo në 10 shkurt 1986 me 474 të pandehur dhe midis tyre kishte dhe eksponente politik, si kusherinjtë Nino dhe Vito Ciancimino. Ky proces mbaroi më 16 dhjetor 1987, me 19 burgime të përjetshme dhe me 2665 vjet burg, por mafia dha kundërpërgjigjen e saj duke e larë me një jetë njerëzore të magjistatit Antonio Scapelliti, i cili duhej të përfaqësonte akuzën përpara Gjykatës së Lartë, por kjo nuk ndodhi sepse ai u vra në 9 gusht 1991. Gjykata e Lartë lë në fuqi burgimet e përjetshme.



Foto 1.1 Giovanni Falcone & Paolo Borsellino¹⁵

Mafia gjendet përpara vështirësive. “Mafia” mbetet një “botë e mbyllur me ‘procedura fikse dhe rregulla të përsosura’ që përfshin në kodin e saj edhe armikun më të egër. “Mafia” ka qënë “vëllazëri kriminale” dhe më pas është konvertuar në “Shoqëri e Nderuar”. Mosfunksionimi i institucioneve dhe shtetit si rezultat i vakumit politik, shkaktoi luftën guerile të udhëhequr nga Garibaldi për “çlirimin” e Siçilisë nga Burbonët më 1860. Ata morën fuqi në vitin 1900 ku arritën të kontrollonin rreth një të tretën e ishullit të Siçilisë. Mafia siçiliane kontrollonte qeverisjen lokale në territorin e saj dhe e gjithë pasuria menaxhohej me forcë prej tyre. Askush nuk i shpëtonte influencës së mafies. “*Respektimi i ligjit të heshtjes*” kërkohet në forma ekstreme thotë Giovanni Falcone. (Zamir Poda, 1998:14).

2.5.1.3. “Mafiet e reja”

Lucio Di Pietro, në kursin e trajnimit me titull: “Instrumente ligjorë dhe teknika të luftës kundër krimit të organizuar transnacional përballje përvojash” Itali-Shqipëri, për gjyqtarë, prokurorë dhe oficerë të policisë gjyqësore shprehet me termin “Mafiet e reja.” (Lucio Di Pietro:2007). Ai bën një analizë zë përvojës gjyqësore italiane kur përdor termin : “Mafiet e reja” të cilat ai i quan struktura dhe format e shfaqjes së krimit të organizuar transnacional. Disa elementë për t’i veçuar janë njohja dhe emërtimi nga strukturat shtetërore italiane përshembull Drejtorisë Kombëtare të Antimafias. Pra, kjo tregon se e kanë njohur dhe e kanë parashikuar fjalën mafie dhe antimafia, jo thjeshtë në zhargonin e përditshëm, por në legjislacionin e tyre dhe në strukturat përkatëse.

¹⁵Falkone dhe Borselino të lindur në Sicili, gjyqtar, miq e kolegë me njëri tjetrin dhe heronj pas vdekjes. Martirë të Drejtësisë Italiane. Falkone u ekzekutua nga mafia me 23 maj 1992, dhe 56 ditë pas vrasjes së Falkones më datën 19 korrik 1992 në Palermo ekzekutohet me autobombë edhe gjykatësi Paolo Borsellino. Me 15 maj 1993, pesë muaj më pas rinisin hetimet dhe arrestimet e drejtuesve dhe anëtarëve të familjeve mafioze në Itali.

Dukuria “mafia” ka fituar të drejtën e qytetarisë në vendet e Ballkanit, dhe për të luftuar dukurine “mafia”, si thelb i krimit të organizuar, është i nevojshëm hartimi i një pakete ligjore antimafia.” (Xhavit Shala, 2003: 25-26).

Në Shqipëri dhe Kosovë nuk ekziston fjala “*mafie*” e shkruar në ligj, ndërkohë që ligji për luftën për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar quhet ligji “*antimafia*” nga nivelet më të larta shtetërore, politike, nga drejtues policie, prokurorë, gjyqtarë, opinionalistë, analistë gazetarë media, etj. Lind pyetja, derisa nuk ka ligj për mafian, pse përdoret termi ligji “Antimafia”.

Roli i Drejtorisë Kombëtare të Antimafias në luftën ndaj “formave të reja të Mafias”, ka filluar në vitin 1994, dhe i ka kushtuar një rëndësi të veçantë studimit dhe analizës së realiteteve kriminale të huaja që veprojnë në Itali të ngjashme me të ashtuquajturat mafie tradicionale (*Cosa Nostra, Camorra*, etj.). (Giovanni Falcone & Marcelle Padovani: 1991). Pra, realitete që bëjnë pjesë (apo mund të bëjnë pjesë) në format e parashikuara nga neni 416/bis i k.p. Drejtoria Kombëtare e Antimafias e ka përqëndruar vëmendjen e saj kryesisht mbi realitete të huaja të organizatave kriminale. Realitetet kriminale të huaja që veprojnë në Itali organizata të huaja, ndërkombëtare dhe/ose transnacionale, janë quajtur ndryshe “*mafie të tjera*” dhe, më pas, “*mafie të reja*” si: Mafia shqiptare; rumune; bullgare; afrikano-veriore, veçanërisht ajo nigeriane dhe magrebine; amerikano-jugore, sidomos ajo kolumbiane; ruse; kineze.

2.5.1.4 Krimi i organizuar i tipit mafioz

Gjykatësi Xhovani Falkone është shprehur se: “*Realiteti kriminal mafioz, është tepër i rëndë, por nuk duhet harruar që janë njerëz si ne, edhe ata që i përkasin krimit të organizuar, i cili si të gjitha gjërat njerëzore, mund të përballohet dhe fitohet*”. (Giovanni Falcone & Marcelle Padovani: 1991).

“Në vitin 2013 në vlerësimin e kërcënimit të krimit të organizuar dhe serioz, EUROPOLI, Agjencia e Inteligjencës së Policisë së Bashkimit Evropian, (the European Union’s police intelligence agency), shprehet për rrezikshmërinë e madhe që kanë të dyja "grupet e krimit të organizuar" dhe "zonat e aktiviteteve të krimit të organizuar dhe serioz " (Europol, *SOCTA* 2013: 42), & (Letizia Paoli, 2014:2).

“Mafia” e “mafiozët” sot kanë qëllim dhe objektiv të korruptojnë politikanët, zyrtarët, administratorët publikë, zyrtarët e zbatimit të ligjit, Polici, prokurori, gjykata, dogana, tatime, etj. Mafiozet sigurojnë fitime të paligjshme dhe me një pjesë të tyre “blejnë” pushtetin, shtetin, zyrtarët, përdorin administratën shtetërore nëpërmjet “agjentëve” të tyre dmth, agjentët mafiozë që kanë korruptuar, shërbejnë si “karremi” që dobësojnë strukturat, marrin informacione, nxjerrin sekrete, përgatisin akte normative, specifikime në tendera, etj, për të ndihmuar veten të fitojnë para që mafia i ka blerë, korruptuar dhe që i përdor si thotë ajo. Ndërmarrjet kriminale të krimit të organizuar kërkojnë të kontrollojnë zona të caktuara që t’i vihen përballë shtetit.

2.6. Përmbledhje

Ky kapitull përmbledh kornizën teorike të studimit, shkollën e Kopenhagenit. Gjithashtu, trajtoi konceptet bazë, kuptimin, përkufizimet, veçoritë, karakteristikat, tiparet themelore të krimit të organizuar dhe krimit të organizuar transnacional. Krimi i organizuar i tipit “mafioz” dhe “mafiet e reja”. Përveç aspekteve teorike janë pasqyruar edhe karakteristikat e tyre, dhe janë shpjeguar çështje ligjore të dokumentave kryesorë strategjikë që kanë të bëjnë me çështjet që lidhen me kapitujt e tjerë të studimit në lidhje me demokracinë, institucionet demokratike, sigurinë kombëtare dhe parandalimin e luftimit e krimit të organizuar transnacional në Shqipëri dhe Kosovë.

Një interes në rritje, në kërkime teorike rezulton në një mori materialesh të publikuara. Librat që japin një panoramë me të zgjeruar janë: Hagan (1983); Smith (1991); Giovanni Falcone & Marcelle Padovani (1991); Paul Nesbitt (1993); Williams & Florez (1994); Bill Mc Sweeny (1996); Dennis Carthy (1997); Barry Busan, Ole Waever, Jaap de Wilde & Lynne Rienne (1998); Zamir Poda (1998); Phil Williams & Dimitri Vlassis (2001); Ole Waever (2001); Woodiwiss (2003); Xhavit Shala (2003); Siegel, van de Bunt & Zaitch (2003); Barry Busan (2003 & 2007); Peter Hough (2004); Astorga (2005); William Bain (2006); Mutimer & Lucio Di Pietro (2007); Rodrigues (2009); Alan Collins (2010); Jani Papandile & Eugen Papandile (2010); Calderoni (2012); Letizia Paoli (2014). Me interes janë edhe konventat ndërkombëtare të OKB^{së}, Këshillit të Europës, Këshillit të Bashkimit Evropian, Interpol^{it}, Europol^{it} dhe Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të

organizuar transnacional, etj.Kapitulli që vijon, paraqet punën e bërë në lidhje me demokracinë dhe institucionet demokratike në Shqipëri, Kosovë–analizë krahasuese.

KAPITULLI III:

DEMOKRACIA DHE INSTITUCIONET DEMOKRATIKE NË SHQIPËRI, KOSOVË – ANALIZË KRAHASUESE

3.1 Hyrje

Në këtë kapitull hulumtohen marrëdhëniet dhe ndikimet e demokracisë dhe të institucioneve demokratike Shqipëri, Kosovë dhe të krahasuara Shqipëri-Kosovë, në kontekstin e krimit të organizuar transnacional. Gjithashtu, trajtohen çështjet problemore të demokracisë në Shqipëri dhe në Kosovë nën optikën e ekspertëve, dhe të 702 studentëve të anketuar, problematikat e përbashkëta Shqipëri dhe Kosovë, problematikat specifike, të veçanta të Shqipërisë dhe të Kosovës dhe dallueshmëritë e demokracisë dhe të institucioneve demokratike në të dy vendet.

Një nga pyetjet kërkimore bazë që studimi ngre ka të bëjë me problemet më serioze të demokracisë në Shqipëri dhe Kosovë, problemet e përbashkëta dhe të veçanta e specifike, pyetje këto në kontekstin e objektit të studimit. Synimi është për të provuar lidhjen dhe ndikimin që mbartin në vetvete, demokracia dhe institucionet demokratike me krimin e organizuar transnacional Shqipëri- Kosovë. Kjo pyetje kërkimore për secilin nivel të analizës lidhet edhe me hipotezën e studimit “Siguria kombëtare dhe funksionaliteti i institucioneve demokratike të Shqipërisë dhe Kosovës mbetet e kushtëzuar nga parandalimi, goditja dhe lufta e krimit të organizuar trans-nacional”.

3.2 Analizë krahasuese e statusit të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës

Studimi me temë “Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri, Kosovë, 2008-2015”, ka marrë në analizë krahasuese dy shtete, Republikën e Shqipërisë dhe Republikën e Kosovës. Në këtë kontekst, në kapitullin vijues bëjmë një analizë krahasuese midis statusit të dy shteteve, Shqipërisë dhe Kosovës.

Republika e Shqipërisë dhe Republika e Kosovës, kanë staturë të ndryshme. Republika e Shqipërisë është një shtet mbi 100 vjeçar, i konsoliduar dhe vend anëtar i NATO-s. Republika e Kosovës është shteti i ri. Republika e Kosovës në vitin 1999 u

pushtua nga Serbia, e cila kreu krimet më të rënda të gjenocidit mbi popullsinë shqiptare në Kosovë. U desh ndërhyrja e NATO-s, me bombardime me forca ajrore e tokësore për 78 ditë rresht, deri në çlirimin e Kosovës nga ushtria serbe.

Krimi i organizuar transnacional, trajtohet në lidhje të ngushtë me mënyrën e funksionimit të demokracisë, të institucioneve shtetërore dhe të sigurisë kombëtare të dy shteteve, në kushtet specifike të secilit shtet. Republika e Shqipërisë që nga viti 1992 ka lënë pas sistemin totalitar dhe komunizmin dhe ka hyrë në rrugën e pluralizmit politik dhe të ndërtimit të demokracisë. Republika e Kosovës, deri në vitin 1999, ka qenë pjesë e shtetit komunist jugosllav, më i liberalizuar në krahasim me Shqipërinë. Gjatë viteve 1998-1999 është pushtuar nga ushtria serbe, ku janë kryer gjenocid dhe krime shumë të rënda, si: vrasje masive, dhunime, keqtrajtime dhe largim masiv të popullsisë të rreth 500 mijë shqiptarëve nga trojet e tyre në drejtimin e Shqipërisë dhe të Maqedonisë.

Megjithatë, midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës, ekzistojnë edhe disa aspekte të përbashkëta si: Shqipëria dhe Kosova janë dy shtete pjesë e një kombi; janë pjesë e Ballkanit Perëndimor; janë fqinjë me kufij të përbashkët tokësor; janë dy shtete që vijnë nga i njëjti sistem, sistemi komunist.

Përveç ngjashmërive ka dhe dallueshmëri, si: në Shqipëri sistemi komunist ka qenë ndër më të ashprit në botë ku izolimi, lufta e klasave, shtetëzimi i pronës private, heqja e besimit fetar, burgosjet, internimet dhe vrasjet e kundërshtarëve politikë kanë qenë dominuese. Ndërsa sistemi komunist i ish-Jugosllavisë ka qenë ndër sistemet komuniste më liberale në botë, e karakterizuar nga politika e "mosangazhimit" dhe e neutralitetit ndaj blloqeve të tjera. Gjithashtu, nuk pati ashpërsinë dhe izolimin e sistemit komunist në Shqipëri, por përkundrazi ishte një komunizëm "liberal". Besimi fetar vazhdoi të kishte lirinë dhe prona private u zhvillua ndjeshëm edhe nëpërmjet kredimarrjeve lehtësuese. Por, Kosovës nuk iu lejuan liritë politike dhe të drejtat që kishin republikat dhe krahinat e tjera; u la në varfëri, ndërkohë që reprezaljet, burgosjet dhe sulmet politike kanë qenë të vazhdueshme.

Dallueshmëritë janë edhe në këto drejtime: në Republikën e Shqipërisë, në vitin 1990, lindi pluralizmi dhe demokracia. Në Kosovë në vitin 1990 filloi lufta e ish-Jugosllavisë ndaj republikave të tjera dhe krahinave autonome. Jugosllavia u shpërbë në vitin 1991, Sllovenia, Kroacia dhe Maqedonia u shpallen shtete të pavarura. Bosnjë-

Hercegovina, pas luftës së përgjakshme u shpall me status e monitorim ndërkombëtar nga OKB-ja, në bazë të Marrëveshjes së Dayton-it, ndërsa Kosova në vitin 1998-1999 u pushtua nga forcat ushtarako-policore serbe, por që u çlirua si rezultat dhe i ndërhyrjes së NATO-s. Kosova nga 10 qershori i vitit 1999 deri me 17 shkurt 2008 ishte nën drejtimin e misionit ndërkombëtar UNMIK, ndërsa nga 17 shkurti 2008 e aktualisht vazhdon të jetë shtet i lirë, i pavarur dhe sovran. Republika e Shqipërisë ka kërcënime potenciale/permanente sigurinë energjetike, terrorizmin, krimin e organizuar dhe fatkeqësitë natyrore. Kosova, veç sa më sipër, ka kërcënime potenciale dhe ruajtjen e territorit të vendit veçanërisht në Mitrovicën e Veriut dhe komunat me shumicë serbe. Ndërsa, kërcënimet kalimtare lidhen me format e manifestimit të kriminalitetit të organizuar, si: trafikimi i emigrantëve apo trafikimet e tjera në kufi me shtetet e tjera fqinjë.

3.3 Problematikat e demokracisë në Shqipëri

Demokracia është shumë e rëndësishme dhe si e tillë ajo në Shqipëri ka rilindur vetëm në vitin 1990 me lëvizjen politike të studentëve dhe me krijimin e partisë së parë politike opozitare, Partisë Demokratike. Shqiptarët e nisën demokracinë pa traditë, pa pronë, pa ekonomi të qëndrueshme, pa kulturë demokratike, pa institucione të së drejtës dhe pa një elitë të ndërgjegjshme dhe të aftë të marrë përgjegjësitë e kalimit nga diktatura staliniste në një demokraci të modelit perëndimor. Mungesa e elitës politike e bëri edhe më të vështirë tranzicionin dhe të pamundur forcimin e shpejtë demokratik të shoqërisë. Kalimi nga një shoqëri e mbyllur, në të cilën partia-shtet ka kontroll absolut mbi pronën dhe individin, në një shoqëri të hapur, të bazuar në konkurrencën e lirë dhe në shtetin e së drejtës, ishte sfida më e madhe e shqiptarëve që nga krijimi i shtetit shqiptar më 1912. Për të gjitha këto arsye, nuk mund të quhen të ekzagjeruara vlerësimet se në fillim të viteve '90-të çdo vendim, veprim dhe apo hap në drejtim të reformave demokratike mund të konsiderohet i jashtëzakonshëm” (Afrim Krasniqi, 2006: 202).

Për të evidentuar problematikat më serioze të demokracisë në Shqipëri, përdorëm dy burime parësore. Burimi i parë parësor janë 40 intervista me politikanë, zyrtarë publikë dhe ekspertë të sigurisë në Shqipëri, Kosovë dhe ekspertë ndërkombëtarë. Burimi i dytë parësor janë rezultatet e dy pyetësorëve: Pyetësori nr. 1. “*Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri-Kosovë, 2008-2015*” iu dërgua 120 personave politikë,

publikë, shkencorë, akademikë, ekspertëve të sigurisë e të drejtësisë etj., nga të cilët janë përgjigjur 65 politikanë, ministra, deputetë, pedagogë, studiues, gazetarë, analistë dhe ekspertë në Shqipëri, Kosovë, por dhe ekspertë ndërkombëtarë. Pyetësi nr. 2. “*Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri-Kosovë, 2008-2015*” (dërguar studentëve të fakulteteve të Drejtësisë dhe të Sigurisë në Prishtinë dhe Tiranë) me synim zgjerimin e kampionimit të anketimit me 702 studentë nga katër universitete në Shqipëri dhe në Kosovë.

Në tabelën 3.1 paraqiten problematikat më serioze të demokracisë në Shqipëri. Sipas të dhënave tabelare rezulton se për periudhën 2008-2015, janë evidentuar gjithsej 25 problematika më serioze të demokracisë në Shqipëri, të cilat paraqiten më poshtë:

1. *Mungesa e shtetit ligjor* me 14% të përgjigjeve. 26.7% janë përgjigjur ekspertët ndërkombëtarë, 21.8% ekspertët në Kosovë dhe 8.6% ekspertët në Shqipëri;

2. *Korrupsioni* me 10.8% të përgjigjeve. 13.3% janë përgjigjur ekspertët ndërkombëtarë, 12.1% ekspertët në Shqipëri dhe 7.3% ekspertët në Kosovë;

3. *Kapacitete të ulëta, keqfunksionimi dhe politizimi i administratës* me 8.1% të përgjigjeve. 10.3% janë përgjigjur ekspertët në Shqipëri dhe 5.5% ekspertët në Kosovë;

4. *Problematika të sistemit zgjedhor*, me 7% të përgjigjeve. 10.3% janë përgjigjur ekspertët në Shqipëri dhe 1.8% ekspertët në Kosovë;

5. *Krimi i organizuar dhe veprimtaritë e tij*, me 5.9% të përgjigjeve. 13.3% janë përgjigjur ekspertët ndërkombëtar, 12.1% ekspertët në Shqipëri dhe 5.5% ekspertët në Kosovë;

6. *Legjitimiteti i demokracisë dhe sovraniteti popullor*, me 5.9% të përgjigjeve, nga të cilat 14.5% janë përgjigjur ekspertët në Kosovë, 6.7% ekspertët ndërkombëtar dhe 1.7% ekspertët në Shqipëri;

7. *Mosfunksionimi i sistemit të drejtësisë dhe ndërmarrja e reformës*, me 5.4% të përgjigjeve. 6.7% janë përgjigjur ekspertët ndërkombëtar, 5.5% ekspertët në Kosovë dhe 5.2% ekspertët në Shqipëri;

8. *Problematikat sociale*, me 5.4% të përgjigjeve. 6% përgjigjet e ekspertëve në Shqipëri dhe 5.5% ekspertët në Kosovë;

9. *Problematikat ekonomike*, me 4.3% të përgjigjeve. 5.2% janë përgjigjur ekspertët në Shqipëri dhe 3.6% ekspertët në Kosovë;

10. *Kequshtrimi dhe privatizimi i pushtetit*, me 4.3% të përgjigjeve. 5.2% janë përgjigjur ekspertët në Shqipëri dhe 3.6% ekspertët në Kosovë;

11. *Kapja e shtetit*, me 3.8% të përgjigjeve. 4.3% janë përgjigjur ekspertët në Shqipëri dhe 3.6% ekspertët në Kosovë;


12. *Mungesë e transparencës dhe llogaridhënies*, me 3.2 % të përgjigjeve. 6.7% janë përgjigjur ekspertët ndërkombëtarë, 3.6% ekspertët në Kosovë dhe 2.6% ekspertët në Shqipëri;

13. *Mbivendosje dhe mosbalancim të pushteteve*, me 3.2% të përgjigjeve. 7.3% janë përgjigjur ekspertët në Kosovë dhe 1.7% janë përgjigjur ekspertët në Shqipëri;

14. *Mungesa e besimit të popullit në demokraci dhe drejtësi*, me 3.2% të përgjigjeve. 13.3% janë përgjigjur ekspertët ndërkombëtarë, 2.6% ekspertët në Shqipëri dhe 1.8% ekspertët në Kosovë.

Në shifra më të ulëta vijojnë problematikat e tjera, si: *konfliktet politike dhe ashpërsia shoqëri civile apatike parti politike jodemokratike, inkriminimi i politikës, media jo e lirë dhe rregjimi i pronës, mosrespektimi i ligjit nga qeveritë, kultura e pandëshkueshmërisë, mungesa e kulturës politike, mungesa e kontrollit të territorit dhe përafrimi i legjislacionit me BE^{në}.*

Pra, nga përgjigjet e mësipërme rezulton se për personalitetet politike dhe publike dhe ekspertët në Shqipëri, problematikat më serioze të demokracisë në Shqipëri janë: korrupsioni me 12.1% të përgjigjeve, problematika të sistemit zgjedhor dhe kapacitete të ulëta, keqfunksionimi dhe politizimi i administratës me 10.3%, mungesa e shtetit ligjor me 8.6%, problemet sociale 6%, krimi i organizuar dhe veprimtaritë e tij, mosfunksionimi i sistemit të drejtësisë dhe ndërmarrja e reformës, dhe kequshtrimi dhe "privatizimi" i pushtetit 5.2%, dhe kapja e shtetit e konfliktet politike dhe ashpërsia 4.3%. Në figurën nr. 3.1 paraqiten në një pamje më të qartë problematikat më serioze të demokracisë në Shqipëri.



Burimi: Pyetësori 1. “Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri-Kosovë, 2008-2015”, plotësuar nga personalitete publike dhe ekspertë të sigurisë e drejtësisë në Shqipëri, Kosovë dhe ekspertë ndërkombëtarë. Përpunim i autorit, 2016

Figura 3.1. Problematikat më serioze të demokracisë në Shqipëri


Më poshtë, paraqesim problematikat më serioze të demokracisë në Shqipëri, sipas anketimit me 702 studentë.

Sipas të dhënave të tabelës 3.2. dhe figurës 3.2 rezulton se, për periudhën 2008-2015, në perceptimin e studentëve, janë evidentuar gjithsej 14 problematika më serioze të demokracisë në Shqipëri, të cilat paraqiten, si më poshtë:

1. Korrupsioni me 465 përgjigje ose 66%;
2. Krimi i organizuar e veprimtaritë e tij me 328 përgjigje ose 47 %;
3. Problematika ekonomike me 227 përgjigje ose 32 %;
4. Mosfeksionimi i sistemit të drejtësisë dhe ndërmarrja e reformës me 202 përgjigje ose 29%;
5. Problematika të sistemit zgjedhor me 194 përgjigje ose 28%;
6. Mos respektimi i ligjit nga qeveritë me 118 përgjigje ose 18%;
7. Mungesa e shtetit ligjor me 112 përgjigje ose 16%;
8. Problemet sociale me 110 përgjigje ose 16%;

9. Kultura e pandëshkueshmërisë me 97 përgjigje ose 14%;
10. Konfliktet politike dhe ashpërsia me 94 përgjigje ose 13%;
11. Kapacitete të ulëta, keqfunksionimi dhe politizimi i administratës me 81 përgjigje ose 12%;
12. Shoqëria civile apatike me 37 përgjigje ose 5%;
13. Partitë politike jodemokratike me 30 përgjigje ose 4%;
14. Media jo e lirë me 19 përgjigje ose 3%.

Nga krahasimi i përgjigjeve të pyetësorëve, të plotësuar nga politikanët dhe ekspertët e sigurisë, rezulton se nga të parët janë evidentuar tri probleme: mungesa e shtetit ligjor, korrupsioni, kapacitete të ulëta, keqfunksionimi dhe politizimi i administratës.



Burimi; Pyetësori 2 “Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri-Kosovë, 2008-2015”, plotësuar nga studentët e fakulteteve të Drejtësisë dhe të Sigurisë në Prishtinë dhe në Tiranë. Përpunim i autorit, 2016.

Figura 3.2 Problematikat më serioze të demokracisë në Shqipëri (anketimi i studentëve)¹⁶

¹⁶Theksojmë se të anketuarit kanë pasur të drejtën e më shumë se një përgjigjeje (deri në 3 alternativa/përzgjedhje për secilën pyetje).

Ndërsa, anketimi i studentëve sipas figurës 3.2 nga përgjigjet e anketimit të studentëve rezulton se, janë evidentuar si problematika më kryesore, korrupsioni, krimi i organizuar e veprimtaritë e tij dhe problematika ekonomike.

Pra, nga të dy grupet e kampionimit persona publikë e ekspertë të sigurisë, si dhe studentët evidentojnë se problematikat më kryesore në Shqipëri rezultojnë të jenë: korrupsioni, krimi i organizuar e veprimtaritë e tij, mungesa e shtetit ligjor, kapacitete të ulëta, keqfunksionimi dhe politizimi i administratës dhe problematikat ekonomike.

Me qëllim, verifikimin e pyetjes kërkimore dhe hipotezave fillestare, u referohemi intervistave të thelluara të marra nga autori.

Nga intervistat e thelluara me personalitete të ndryshme rezulton, si më poshtë:

Sipas PhD Walter Schwimmer, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës (1999-2004), problemet më serioze të demokracisë në Shqipëri janë:

“Mungesa e respektit për ligjin nga ana e institucioneve demokratike dhe ligjzbatuese. Me këtë dua të them se, ndërsa legjislativi është në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe është miratuar nga kuvendi, përsëri rezulton se, as nga qeveria apo agjencitë që veprojnë në emër të shtetit nuk veprojnë, në përputhje me këto ligje. Pra, as legjislativi ose as vendimet e gjykatës nuk u përshatën dëshirave të tyre.”¹⁷

Prof. dr.Fatmir Sejdiu, Presidenti i Republikës së Kosovës (2006-2010) shprehet:

“E mirë e madhe është që Shqipërinë nuk e gjejmë në atë stadin e viteve të '90. Por është një Shqipëri tjetër, e anëtarësuar në NATO, me mekanizma të rëndësishëm ndërkombëtarë dhe që, deshëm apo nuk deshëm ne apo dikush tjetër, është një shtet që ka rëndësi të veçantë dhe është një faktor i rëndësishëm për paqen, sigurinë dhe stabilitetin në Ballkan. Prandaj, mendoj se Shqipëria ka nevojë për një koherencë të mirë të veprimeve institucionale, por edhe për një politikë edukative tek të gjithë qytetarë..... Shqipëria e dalë nga një periudhë moniste e qeverisjes së fundviteve '90^{te} është ndeshur natyrisht me pjesën e sfidave të reja që kërkon një përmbushje të idealeve të të gjithë atyre njerëzve që kanë dashur të përmbysin një periudhë që ka qënë e rëndë për ta dhe të hyjë me hapa të shpejtuar në drejtim të pranimit nga familja e vendeve të lira dhe demokratike.... Tranzicioni në Shqipëri dhe në Kosovë kanë nevojë për përmirësim të garniturës politike.”¹⁸

Politikani, ministri, eksperti e analisti i njohur i çështjeve ekonomike, dr. Zef Preçi mendon se, ndër problemet më të mëdha të demokracisë në Shqipëri janë:

“1. Thyerja që ka pësuar entuziazmi i fillim-viteve '90^{te} me realitetin përherë e më të hidhur që është servirur gjatë 25 viteve. Domethënë qytetarët nuk janë më aq besues ndaj demokracisë dhe njëkohësisht nuk janë më aq aktiv në pjesëmarrje në të; 2. Duhet të pranojmë se vetëm një palë zgjedhje kanë qënë demokratikisht të pakontestuar, kam parasysh zgjedhjet e vitit 1992, që kanë qënë një lloj plebishiti për ndryshimin e sistemit. Pastaj kanë qënë zgjedhje që gjithnjë kanë pasur kontestime: - janë përdorur hile dhe në thelb nuk kanë shprehur gjithmonë ndjeshmërinë publike. Ai vijon më tej se: “problemet e mëdha janë: 1. Mungesa e pjesëmarrjes së qytetarëve në qeverisje; 2. Mungesa e legjitimitetit të institucioneve përfaqësuese në nivel

¹⁷ Intervista është marrë nga autori, datë 27.11.2015.

¹⁸ Intervista është marrë nga autori në Prishtinë, datë 11.12.2015.

*politik qendror dhe vendor; 3. Kequshtrimi i pushtetit pra, mosrespektimi i rregullave të lojës demokratike në vend.*¹⁹”

Dr. Bajram Rexhepi, Kryeministri i Republikës së Kosovës (2002-2004) dhe Ministër i Brendshëm (2009-2014), shprehet se: *”Shqipëria është një shtet me një traditë të gjatë gati një shekullore, megjithatë demokracia në Shqipëri është relativisht e re dhe që të implementohen principet e mirëfillta demokratike kërkon dhe duhet kohë.*²⁰”

Juristi dhe politikani i njohur, Ylli Manjani argumenton se shtatë janë problemet më serioze për demokracinë në Shqipëri:

*“1. Shoqëria e mbyllur shqiptare. Korrupsioni, informaliteti, ligjet paralele me ligjet e shtetit janë ende pjesë e realitetit; 2. Partitë politike për të marrë vota përpiqen më shumë t’i afrohen sëmundjeve të shoqërisë se sa t’i kurojnë ato. Për pasojë, përfaqësimi politik, nuk ka sesi të jetë i ndryshëm nga sa është shoqëria; 3. Funksionimi normal i shtetit dhe sundimi i ligjit janë në konkurrencë të përhershme me korrupsionin dhe anti rregullin. Kjo konkurrence shpesh çon në përplasje të dhunshme; 4. Mendimi ndryshe nuk arrin të bëhet alternativë. Kjo i deformon njerëzit që mendojnë sepse duhet të sigurojnë jetesën; 5. Elitat e shoqërisë nuk arrijnë të ndikojnë ende në jetën publike dhe nuk japin ende modelin e respektit dhe të etikës; 6. Themeli i demokracisë, vota nuk është ende e lirë dhe e ndershme. Pronari i votës, populli, e shet atë. Këtu fillon zinxhiri i demokracisë së deformuar; dhe 7. Koha ende e shkurtër e ndarjes nga komunizmi.”*²¹

Shyqyri Dekavelli, Drejtor i Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (2002-2014), shprehet:

*”Sistemi i tanishëm ka gjasa të pranohet nga shqiptarët si caku përfundimtar i demokracisë. Shqiptarët do t’i duhet një korrigjim themelor i politikbërjes për t’u bërë demokraci plotësisht e konsoliduar. Shqipëria ka nevojë për udhëheqës të aftë dhe me vizion për ta çuar vendin përpara.*²²”

Deputeti, ministri dhe politikani Aldo Bumçi, shprehet se *“nga faktorët më të rëndësishëm që kanë ndikuar janë mungesa e konsensusit për shtetformim, mospërfshirja e opozitës në proceset vendimarrëse mbi një bazë të gjerë demokratike.*²³” Peter Linden Jones shprehet se: *“problem kryesor mbetet mungesa e respektit për ligjin dhe zbatimin e tij nga institucionet shtetërore.*²⁴”

¹⁹Dr. Zef Preçi Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i Albanian Center for Economic Research (ACER), Ministër i Ekonomisë (1999-2000). (Intervista është marrë nga autori në Tiranë, datë 03.11.2015).

²⁰ Intervista është marrë nga autori në Mitrovicën e Veriut në Kosovë, datë 23.01.2016.

²¹Ylli Manjani, Ministër i Drejtësisë (2015-vazhdim). (Intervista është marrë nga autori në Tiranë, datë 7.10.2015).

²² Intervista është marrë nga autori në Tiranë, datë 8.10.2015.

²³Aldo Bumçi, Ministër i Drejtësisë (2005-2007), Ministër i Punëve të Jashtme (2013-2014). (Intervista është marrë nga autori në Tiranë me datën 16.2.2016).

²⁴Peter Linden Jones, drejtues i strukturave policore dhe të sigurisë në Mbretërinë e Bashkuar, ekspert i Misionit PAMECA, Misionit Policor të Bashkimit Evropian në Shqipëri, këshilltar i Ministrisë së Brendshme dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, misioni PAMECA, (2004-2007), Tiranë. (Intervista është marrë nga autori, datë 17.12. 2015).

Dr. Alfred Moisiu, Presidenti i Republikës së Shqipërisë (2002-2007) shprehet se, problemet më të mëdha të demokracisë në Shqipëri janë:

“Forcimi i shtetit ligjor, reforma e drejtësisë, zgjidhja e problemeve të pronës, realizimi i zgjedhjeve të lira, të ndershme, pa abuzime e shitblerjen e votës, zhvillimi i ekonomisë me ritme të larta duke synuar turizmin dhe bujqësinë dhe interesimi për emigrantët që ndodhen jashtë vendit, ku 1/3 e shqiptarëve ndodhën jashtë Shqipërisë.”²⁵

Për Kozara Kati, presidente e Qendrës Shqiptare të të Drejtave të Njeriut dhe aktiviste e shoqërisë civile shqiptare janë: *”mungesa e kulturës demokratike, e shtetformimit e qeverisjes së mirë, e lirisë dhe të drejtve të njeriut dhe kriminalizimi i politikës.”²⁶*

Duke analizuar me vëmendje përgjigjet e mësipërme konstatojmë se politikanët dhe zyrtarët e lartë shtetërorë e publikë në Shqipëri dhe Kosovë rendisin problematikën e parë me serioze mungesën e shtetit ligjor. Ndërkohë, sipas përgjigjeve të mësipërme rezulton se pasojat si korrupsioni dhe krimi i organizuar vijnë nga shkaqet kryesore që sjellin këto pasoja të rënda (siç janë shprehur ekspertët në Shqipëri për korrupsionin) për Shqipërinë si; mungesa e demokracisë së të zhvilluar, institucione jo demokratike dhe mos funksionim të shtetit ligjor. Nëse nuk do të ishin këto shkaqe edhe pasojat e saj si korrupsioni, krimi i organizuar etj., do të ishin minimale dhe jo probleme shqetësuese. Ndërkohë, që është për t’u nënvizuar se ekspertët ndërkombëtarë vijnë me problematikën e dytë, me korrupsionin, krimi i organizuar dhe veprimtaritë e tij, mosrespektimi i ligjit nga qeveritë dhe mungesa e besimit të popullit në demokraci dhe drejtësi, për të vijuar me problematikën e tretë mungesa e transparencës dhe llogaridhënies, mosfunksionimi i sistemit të drejtësisë dhe ndërmarrja e reformës dhe legjitimiteti i demokracisë dhe sovraniteti popullor. Pra, ata i grupojnë përgjigjet që kanë në lidhje me njëra-tjetrën në mënyrë strukturaliste, ndërkohë që korrupsioni renditet i pari nga ekspertët në Shqipëri për të vijuar me problematika të sistemit zgjedhor dhe kapacitete të ulëta, keqfunksionimi dhe politizimi i administratës, mungesa e shtetit ligjor, problemet sociale, krimi i organizuar dhe veprimtaritë e tij, mosfunksionimi i sistemit të drejtësisë dhe ndërmarrja e reformës, dhe kequshtrimi dhe privatizimi i pushtetit. Pra, nëpërmjet këtyre përgjigjeve arrijmë në përfundimin se shqiptarët në Shqipëri janë lodhur shumë gjatë këtij tranzicioni dhe viteve objekt të këtij studimi, prandaj rendisin të parën pasojën që po i rëndon ndoshta më shumë

²⁵Dr. Alfred Moisiu, Presidenti i Republikës së Shqipërisë (2002-2007). (Intervista është marrë nga autori në Tiranë, datë 18.12.2015).

²⁶Kozara Kati, presidente e Qendrës Shqiptare të të Drejtave të Njeriut, aktiviste e mirënjohur e shoqërisë civile shqiptare, 1992-2016.

se çdo gjë tjetër në këto vite. Nëse krahasojmë përgjigjet e ekspertëve ndërkombëtarë ata përgjigjet e tyre si problematikat më serioze i kanë dhënë për shkakun e krijimit të gjendjes aktuale të demokracisë dhe institucioneve demokratike dhe ky shkak është mungesa e shtetit ligjor.

Si përfundim, konkludohet se këto problematika të evidentuara përputhen edhe me parashikimet e dokumentit strategjik të sigurisë kombëtare, i cili trajtohet në kapitullin në vijim.

3.3.1 Problematikat e demokracisë në Shqipëri, nën optikën e ekspertëve

Problemet e demokracisë në Shqipëri, analizohen nën optikën e ekspertëve, duke i analizuar më vete mendimet dhe opinionet e tyre. Mbi bazën e përgjigjeve të pyetjeve të pyetësorit nr. 1., në tabelën 3.3 paraqiten problematikat më serioze të demokracisë në Shqipëri sipas ekspertëve në Shqipëri dhe ekspertëve në Kosovë. Mbi këtë bazë është bërë përpunimi dhe krahasimi i përgjigjeve të tyre dhe rezulton se janë evidentuar gjithsej 25 problematika më serioze të demokracisë në Shqipëri, të cilat janë: 1. *korupsioni* 12.1%; 2. *problematika të sistemit zgjedhor* 10.3%; 3. *kapacitete të ulëta, keqfunksionimi dhe politizimi i administratës* 10.3%; 4. *mungesa e shtetit ligjor* 8.6%; 5. *problemet sociale* 6%; 6. *krimi i organizuar dhe veprimtaritë e tij* 5.2%; 7. *mosfunksionimi i sistemit të drejtësisë dhe ndër marrja e reformës* 5.2%; 8. *kequshtrimi dhe privatizimi i pushtetit* 5.2%, 9. *problematikat ekonomike* 5.2%, 10. *kapja e shtetit* 4.3%, 11. *konfliktet politike dhe ashpërsia* 4.3%, 12. *shoqëri civile apatike* 3.4%, 13. *mungesë e transparencës dhe llogaridhënies* 2.6%, 14. *mungesa e besimit të popullit në demokraci dhe drejtësi* 2.6%, 15. *inkriminim i politikës* 2.6%, 16. *parti politike jodemokratike* 2.6%, 17. *media jo e lirë* 2.6%, 18. *legjitimiteti i demokracisë dhe sovraniteti popullor* 1.7%, 19. *mbivendosje dhe mos balancim i pushteteve* 1.7%, 20. *regjimi i pronës* 1.7%, dhe 21. *kultura e pandëshkueshmërisë* 1.7%. Pra, sipas përgjigjeve nga politikanet dhe ekspertët në Shqipëri janë pasqyruar 21 problematika më serioze për demokracinë në Shqipëri, nga 25 problematika që janë evidentuar në tërësi nga të gjithë ekspertët.

Ndërkohë që perceptimi i studentëve të anketuar, sipas tabelës 3.2 “Problematikat më serioze të demokracisë në Shqipëri” (anketimi i studentëve), rezulton se nga 14 problematikat

më serioze të demokracisë në Shqipëri, që kanë përcaktuar ekspertët janë evidentuar: korrupsioni, krimi i organizuar e veprimtaritë e tij, problematika ekonomike, mosfunksionimi i sistemit të drejtësisë dhe ndërmarrja e reformës, problematika të sistemit zgjedhor, mosrespektimi i ligjit nga qeveritë, mungesa e shtetit ligjor, problemet sociale, kultura e pandëshkueshmërisë, konfliktet politike dhe ashpërsia, kapacitete të ulëta, keqfunksionimi dhe politizimi i administratës, shoqëria civile apatike, partitë politike jo demokratike dhe media jo e lirë. Konkluzion. nga 767 të anketuarit- përsnat publikë, politikë, ekspertët e sigurisë si dhe studentët e anketuar, kanë arritur në përfundimin se problematika e parë serioze për demokracinë në Shqipëri është korrupsioni. Ky përfundim përputhet edhe me dokumentin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Shqipërisë të viti 2014.

Në lidhje me problematikën e sistemit zgjedhor ekzistojnë mendime të ndryshme. Kështu, për juristin dhe politikanin e njohur Ylli Manjani

“partitë politike për të marrë vota përpigën më shumë t’u afrohen sëmundjeve të shoqërisë sesa t’i kurojnë ato. Përfaqësimi politik, për pasojë nuk ka sesi të jetë i ndryshëm nga sa është shoqëria. Themeli i demokracisë, vota nuk është ende e lirë dhe e ndershme. Pronari i votës populli e shet atë. Këtu fillon zinxhiri i demokracisë së deformuar.”²⁷

Për dr. Alfred Moisiu, është shumë e rëndësishme realizimi i zgjedhjeve të lira, të ndershme, pa abuzime e shitblerjen e votës.²⁸ Për profesor Neritan Ceka ministër i Brendshëm (1997-1998), kryetar i Komisionit Parlamentar për Sigurinë Kombëtare (1998-2005):

“Problemi kryesor mbetet ushtrimi i votës së lirë dhe të ndershme, mbi të cilën pastaj ndërtohen edhe institucionet demokratike. Fakti që manipulimi dhe blerja e votave është bërë kronike, ndryshe nga vende të tjera që kanë dalë nga diktaturat lindore, dëshmon për një defekt që është rrënjësor në praktikën e partive politike, por edhe në mentalitetin e zgjedhësve. Mendoj se eliminimi i këtyre praktikave do të kërkojë disa dekada.”²⁹

Ndërsa, dr. Zef Preçi shprehet se: “...zgjedhjet gjithmonë kanë pasur kontestime, janë përdorur hile dhe në thelb nuk kanë shprehur gjithmonë ndjeshmërinë publike.”³⁰ Prof. Sajmira Pino shprehet: “Korrupsionit në Shqipëri i është dhënë besueshmëri shtetërore. Ai

²⁷Intervista është marrë nga autori, datë 7.10.2015.

²⁸ Intervista është marrë nga autori në Tiranë, datë 18.12.2015.

²⁹Profesor Neritan Ceka, Ministër i Brendshëm (1997-1998), kryetar i Komisionit Parlamentar për Sigurinë Kombëtare (1998-2005), nënkryetar i Kuvendit të Shqipërisë (2008), këshilltar i Kryeministrit të Shqipërisë (2005-2009). (Intervista është marrë nga autori në Tiranë, datë 08.03.2016).

³⁰Intervista është marrë nga autori në Tiranë, datë 03.11.2015.

*e gërryen atë që ndërtohet, e infekton shoqërinë në mënyrë të pandalshme, duke kaluar nga një shtresë në tjetrën, dhe patjetër që e minon edhe sigurinë e vendit.*³¹”

Për dr. Mentor Nazarkon, analist i njohur i shtypit periodik dhe i mediave,

*"problemi më serioz janë zgjedhjet. Zgjedhjet qoftë në partitë politike, qoftë në zgjedhjet lokale e zgjedhjet e përgjithshme, ku nuk ka mekanizma korrektues të deformimeve të votës. Ka kontroll të procesit zgjedhor nga aktorët më të fuqishëm nga të zgjedhurit e mëparshëm etj. Ky është problemi kryesor."*³²

Për politikanin dhe pedagogun dr. Marko Bello, problemi më serioz është:

*“mosfunjionimi i shtetit ligjor, institucionet e dobëta, korrupsioni, abuzimi me pushtetin, trafiku i influencës, rekrutimi në administratën publike i militantëve partiake në dëm të profesionistëve, ku preferohet shteti partiak, ku politika kontrollon gjithçka, duke nëpërkëmbur ligjin.*³³”

Sipas PhD Andreas Berg-u për t’i mposhtur këto problematika ka nevojë për institucione të forta demokratike.³⁴ Për deputetin Asllan Dogjani

*“Është shkelur e drejta themelore e drejta e votës e zgjedhjes në mënyrë të lirë dhe të pavarur. Ka tendenca për të ndikuar deri në ndërgjegjen e qytetarëve për të kontrolluar votën. Në momentin që qytetarët nuk janë të lirë të votojnë dhe të zgjedhin me vullnetin e tyre të pandikuar nga qeveria, atëherë nuk mund të flasim për demokraci të konsoliduar.*³⁵”

Ndërsa, sipas gazetarit dhe aktivistit të shoqërisë civile, Erion Kristo

*“Demokracia ndërtohet nga vota dhe vota në Shqipëri nuk ka vlerë. Ajo shitet dhe rrëmbehet dhe keqlexohet në mënyrë masive, përtej marzhit të pranuar, aq sa kompromenton vetë zgjedhjet. Klasa politike shqiptare ka mundur një sistem ku nuk ka vlerë të vendosësh me votë, sepse vota tjetërsohet. Sistemi gjyqësor nuk është garant, por një bandë. Media është bashkëaksionere e politikës. Shoqëria civile nuk ka këllqe dhe mbështetje, as nga ndërkombëtarët as nga publiku. Pra, të gjitha hallkat vuajnë seriozisht.*³⁶”

³¹Dr.Saemira Pino, dekane e Fakultetit të Shkencave Sociale në Shkollën e Lartë Universitare “Marin Barleti”, zëvendësministre e Shëndetësisë, kryetare e Forumit të Grave të Partisë Socialiste, aktiviste shoqërore e mirënjohur, studiuese, profesore në Universitetin Shtetëror, në Fakultetin e Shkencave Sociale.

³²Dr. Mentor Nazarko, analist i shtypit periodik dhe i mediave, këshilltar i Presidentit të Republikës (1997-2002), (Intervista është marrë nga autori në Tiranë, datë 11.09.2015).

³³Dr. Marko Bello, Ministër i Mbrojtjes, deputet i Kuvendit të Shqipërisë, ambasador i Shqipërisë, zëvendërministër i Mbrojtjes, profesor, gazetar, studiues.

³⁴Andreas Berg, këshilltar, zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës (këshillues suedez). (Intervista është marrë nga autori, datë 17.12.2015).

³⁵Asllan Dogjani, deputet i Kuvendit të Shqipërisë, deputet, anëtar i Komisionit Parlamentar të Sigurisë Kombëtare, drejtues i strukturave drejtuese të Policisë. (Intervista është marrë nga autori në Tiranë, datë 8.10.2015.)


³⁶Erion Kristo, drejtues i emisionit “Bardhazi” në Scan TV për gazetarinë televizive, dhe dekan i Studenteve në universitetin "Marin Barleti". (Intervista është marrë nga autori në Tiranë, datë 15.11.2015.)

Sipas këshilltarit të Presidentit të Republikës për çështje të sigurinë kombëtare, Gjergj Lezhja: *“Problemi kryesor ende i pazgjidhur është bërja e zgjedhjeve të lira, të ndershme dhe me standarde demokratike.”*³⁷”

Ndërsa, sipas përgjigjeve të ekspertëve në Kosovë përgjigjet për problemet më serioze të demokracisë në Shqipëri janë: 1. mungesa e shtetit ligjor 21.8%; 2. legjitimiteti i demokracisë dhe sovraniteti popullor 14.5%; 3. korrupsioni 7.3%; 4. mbivendosje dhe mosbalancim i pushteteve 7.3%; 5. krimi i organizuar dhe veprimtaritë e tij 5.5%; 6. kapacitete të ulëta, keqfunksionimi dhe politizimi i administratës 5.5%; 7. Problemet sociale 5.5%; 8. mosfunksionimi i sistemit të drejtësisë dhe ndërmarra e reformës 5.5%; 9. kequshtrimi dhe privatizimi i pushtetit 3.6%; 10. kapja e shtetit 3.6%; 11. mungesë e transparencës dhe llogaridhënies 3.6%; 12. mungesë e kulturës politike 3.6%; 13. problematika të sistemit zgjedhor 1.8%; 14. mungesa e besimit të popullit në demokraci dhe në drejtësi 1.8%; 15. regjimi i pronës 1.8%; 16. mungesë e kulturës politike 1.8%; 17. përafrimi i legjislacionit me BE-në 1.8%.

Pra, sipas përgjigjeve nga ekspertët në Kosovë janë pasqyruar 17 problematika më serioze për demokracinë në Shqipëri, nga 25 problematika që janë evidentuar në tërësi nga të gjithë ekspertët. Të bën përshtypje fakti që në përgjigjet e ekspertëve në Kosovë nuk janë evidentuar si problematika; konfliktet politike dhe ashpërsia, shoqëri civile apatike, inkriminimi i politikës, parti politike jodemokratike, media jo e lirë, kultura e pandëshkueshmërisë dhe mosrespektimi i ligjit nga qeveritë, ndërkohë që nga ekspertët e tjerë, përgjithësisht, janë trajtuar edhe këto problematika për demokracinë në Shqipëri.

³⁷Gjergj Lezhja, këshilltar i Presidentit të Republikës për çështje të sigurinë kombëtare, (2013-2016), Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, (2007-2013), zëvendësministër i Brendshëm (2005-2007).(Intervista është marrë nga autori në Tiranë, datë 10.11.2015).




Burimi: Pyetësori 1 “Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri-Kosovë, 2008-2015”, plotësuar nga personalitete publike dhe ekspertë të sigurisë e drejtësisë në Shqipëri, Kosovë dhe ekspertë ndërkombëtarë. Përpunim i autorit, 2016.

Grafiku 3.1. Problematikat më serioze të demokracisë në Shqipëri sipas optikës së ekspertëve në Shqipëri dhe në Kosovë

Sipas grafikut nr. 3.1 paraqiten problematikat më serioze të demokracisë në Shqipëri sipas optikës së ekspertëve në Shqipëri dhe në Kosovë, rezulton se shtatë problemet më serioze të demokracisë në Shqipëri janë: 1. mungesa e shtetit ligjor; 2. legjitimiteti i demokracisë dhe sovraniteti popullor; 3. korrupsioni; 4. mbivendosja dhe mosbalancimi i pushteteve; 5. krimi i organizuar dhe veprimtaria e tij; 6. kequshtrimi dhe privatizimi i pushtetit; 7. problemet sociale. Ndërsa sipas ekspertëve në Shqipëri rezulton se shtatë problemet më serioze të demokracisë në Shqipëri janë; 1.korrupsioni; 2. problematika të sistemit zgjedhor; 3. kapacitete të ulëta, keqfunksionim dhe politizim të administratës; 4. mungesa e shtetit ligjor; 5. problemet sociale; dhe 6. problemet sociale.

Më poshtë, paraqesim figurën 3.3, ku jepet krahasimi i qëndrimeve të të intervistuarve mbi problematikat kryesore të ngritura nga ndërkombëtarët.



Burimi; Pyetësori 1 “Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri-Kosovë, 2008-2015”, plotësuar nga personalitete publike dhe ekspertë të sigurisë e drejtësisë në Shqipëri, Kosovë dhe ekspertë ndërkombëtarë. Përpunim i autorit, 2016.

Figura 3.3 Krahasimi i qëndrimeve të të intervistuarve mbi problematika kryesore të ngritura nga ndërkombëtarët (për Shqipërinë)

Sipas të dhënave tabelare rezultojnë se për periudhën 2008-2015, problemet më serioze të demokracisë në Shqipëri nga krahasimi i qëndrimeve të të intervistuarve ndërkombëtarë janë evidentuar: 1. mungesa e shtetit ligjor me 26.7 % të përgjigjeve; 2. korrupsioni me 13.3%; 3. mosrespektimi i ligjit nga qeveritë 13.3%; 4. mungesa e besimit të popullit në demokraci dhe në drejtësi 13.3%, 5. legjitimiteti i demokracisë dhe sovraniteti popullor me 6.7%. 6. mosfunksionimi i sistemit të drejtësisë dhe ndërmarrja e reformës, me 6.7% dhe 7. mungesa e transparencës dhe llogaridhënies 6.7%.

Sipas të dhënave tabelare, tabela 3.4, pesha e nënfaktorëve në përgjigjet e të intervistuarve për faktorin *problematika të sistemit zgjedhor*, nënfaktori *procesë zgjedhore të manipuluar dhe jo të lira*, rezultojnë me 5.9% të përgjigjeve në total, nga të cilat 8.6% janë përgjigjur ekspertët në Shqipëri. Ky është një konkluzion që arrihet pasi ekspertët në Shqipëri mendohet se e kanë njohur dhe kanë “vuajtur” nga kjo problematikë serioze e cila është baza dhe “guri i themelit” për ndërtimin e demokracisë, pasi pa zgjedhje të lira dhe demokratike nuk mund të ndërtohet demokracinë, institucionet demokratike dhe shtetin ligjor. Ndërsa, faktorin *korupsioni* e kanë vlerësuar nëpërmjet përgjigjeve në një shkallë më të lartë ekspertët ndërkombëtarë me 13.3% nga 12.1% që e kanë vlerësuar ekspertët në Shqipëri dhe 7.3% ekspertët në Kosovë.

Faktori *mungesa e shtetit ligjor*, përbëhet nga tre nënfaktorë, *sundimi i rendit dhe ligjit*, me 4.3%, *mungesa apo forcimi i shtetit ligjor*, me 9.1% dhe *mungesë kontrolli nga strukturat e gjyqësorit dhe të ekzekutivit* me 0.5% e përgjigjeve.

Faktori *mosfunksionimi i sistemit të drejtësisë dhe ndërmarrja e reformës*, përbëhet nga nënfaktori *reforma në drejtësi*, me 0.5% dhe *mosfunksionimi i sistemit të drejtësisë*, me 4.8%.

Faktori *kequshtrimi dhe privatizimi i pushtetit*, përbëhet nga nënfaktori *sulme politike ndaj medias dhe bizneseve*, me 1.1%, kequshtrimi i pushtetit, me 1.1%, trafiku i influencës, 0.5%, nepotizmi, 0.5%, abuzimi me pushtetin, 1.1%.

Faktori *kapacitete të ulëta, keqfunksionim dhe politizim i administratës*, përbëhet nga nënfaktori nivel profesional dhe moral i ulët në administratë, 1.1%, nënpunësit civil pre e politikave partiake, 0.5%, mungesa e kordinimit të institucioneve, 1.1%, funksionimi fragmentar, administratë e dobët, militante, e paqëndrueshme dhe klienteliste, 2.7%, mungesa e demokracisë dhe autonomisë politike të institucioneve, 2.7%.

Faktori *legjitimiteti i demokracisë dhe sovraniteti popullor*, përbëhet nga nënfaktori *legjitimiteti i organeve shtetërore*, 1.1%, *mungesa e pjesëmarrjes së qytetarëve në qeverisje*, 1.1%, mungesë e sovranitetit popullor, 1.1%, zhvillimi i demokracisë, 2.7 %.

Faktori *problematikat ekonomike*, përbëhet nga nënfaktori ekonomi e dobët, 1.1%, varfëria, 0.5%, papunësia, 1.1% dhe zhvillimi ekonomik 1.6%.

Faktori *problematikat sociale*, përbëhet nga nënfaktorët *gjakmarrje*, 0.5%, *arsim jociësor*, *mungesa e edukimit dhe përgatitjes*, 1.6%, *interesi për emigrantët shqiptarë jashtë vendit*, 0.5%, *ksenomamia*, 0.5%, *tranzicioni*, 0.5%, *mentaliteti i popullsisë*, 0.5%, *pasojat e komunizmit (ende të pranishme)*, dhe *mungesa e tolerancës*, 0.5%. Ekspertët në Shqipëri janë përgjigjur me 0.9% të pyetjeve për këto dy nënfaktorë, ndërkohë që ekspertët në Kosovë dhe ekspertët ndërkombëtarë nuk janë përgjigjur për këto dy nënfaktorë. Kjo tregon se ekspertët në Shqipëri i njohin më mirë këto dy nënfaktorë që vazhdojnë të jenë prezentë dhe shqetësues akoma në Shqipëri.

Si përfundim, problematikat më kryesore për demokracinë në Shqipëri të cilat janë pasqyruar në përgjigjet e pyetësorëve nga personalitetet politike dhe publike, ekspertët e sigurisë, si dhe nga perceptimi i studentëve rezultojnë se, këto problematika serioze përputhem edhe me problematikat kryesore që janë përcaktuar në dokumentin “Strategjia e

sigurisë kombëtare e Republikës së Shqipërisë” të vitit 2014, siç do ta shohim më konkretisht edhe në kapitullin në vijim. Ndërkohë që çështjet e krimit të organizuar dhe të korrupsionit etj., po verifikojnë e testojnë hipotezën dhe pyetjet kërkimore, nëpërmjet edhe këtij kapitulli, duke evidentuar se krimi i organizuar transnacional, ka një ndikim të rëndësishëm për demokracinë dhe institucionet demokratike. Nga njëra anë, mosfunksionimi i duhur i demokracisë dhe institucioneve demokratike i krijon “terrenin “ e përshtatshëm, krimit të organizuar për veprimtari aktive të tij, dhe, nga ana tjetër, ai ndikon ndjeshëm në dobësimin e demokracisë dhe të mirëfunksionimit të institucioneve demokratike.

3.4. Problematikat e demokracisë në Kosovë

Demokracia në Kosovë është demokraci e re. Ajo ka hedhur shtat dhe po rritet e zhvillohet së bashku me krijimin e institucioneve shtetërore shqiptare në Kosovë. Demokracia lindi me lindjen e shtetit të ri të pavarur të Kosovës. Si e tillë, demokracia dhe institucionet demokratike janë të ndërthurura me njëra-tjetrën dhe e gjejnë vetveten brenda njëra-tjetrës. Dy ngjarjet më madhore për Kosovën për vitin 2008³⁸ ishin Shpallja e Pavarësisë me 17 Shkurt 2008 nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe miratimi nga Kuvendi dhe hyrja në fuqi më 15 qershor 2008 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Kushtetuta e Kosovës është një dokument bashkëkohor, që plotëson parametrat e një shteti demokratik të së drejtës, të bazuar ‘në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes së mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut’(neni 7) (Luan Omari, 2008:63).

Statusi i ardhshëm i Kosovës u përcaktua në bazë të dokumentit të hartuar nga Ahtisaari,-ish-presidenti i Finlandës, i ngarkuar nga OKB-ja për të formuluar një opsion të hollësishëm dhe të argumentuar, që do të shërbente për të përcaktuar statusin përfundimtar të Kosovës. Kushtetuta parashikon që:

³⁸Kjo është arsyeja që punimin tonë “Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri, Kosovë” kemi vendosur edhe periudhën e studimit 2008-2015, periudhë kur Kosova u shpall e pavarur dhe filloi ndërtimin e shtetit të ri.

“Republika e Kosovës mund të marrë pjesë në sistemet e sigurisë ndërkombëtare me qëllim ruajtjen e paqes dhe mbrojtjen e interesave shtetërore (neni 2/3), por edhe parashikon që marrëveshjet ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Kosovës, bëhen pjesë e sistemit të brendshëm juridik dhe zbatohen në mënyrë të drejtëpërdrejtë, me përjashtim të rasteve kur nuk janë të vetëzbatueshme, çka do të kërkonte nxjerrjen e një ligji. Këto marrëveshje ndërkombëtare dhe normat juridikisht të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare kanë epërsi ndaj ligjeve të Republikës së Kosovës (neni 19, paragrafët 1 dhe 2)”. (Luan Omari, 2008:65).

Ndërsa, në nenin 20, parashikohet bartja ose transferimi i sovranitetit, sepse *“Republika e Kosovës, në bazë të marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare, për çështje të caktuara, mund t’u kalojë kompetenca shtetërore organizatave ndërkombëtare”*. Profesor Luan Omari shprehet:

“...pranohet parimi se dispozitat e marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara kanë epërsi mbi ligjet dhe aktet e tjera të Kosovës (por jo mbi Kushtetutën), në Nenin 143, përkundrazi, sanksionohet epërsia e dispozitave të propozimit gjithëpërfshirës edhe mbi vetë kushtetutën”. (Luan Omari, 2008:67).

Dr. Mentor Nazarko shprehet: *“Ligji ndërkombëtar, marrëveshjet ndërkombëtare të analizuara janë për nga fuqia mbi dokumentet ligjore të brendshme. Ato janë mbi kushtetutat e këtyre vendeve”*. (Mentor Nazarko, 2006 :75). Sipas dr. Bajram Rexhepit,

“ne kemi shumë ngjashmëri, por kemi edhe dallime, natyrisht që ne përse i përket shtetësisë ne jemi shtet shumë i ri. Ne kemi traditë si shtet socialist në ish -Jugosllavinë si një krahinë autonome, ndërsa si shtet e pavarur jemi nga viti 2008, pra jemi 7-8 vite, pra nuk është një kohë e gjatë”.³⁹

Profesor Fatmir Sejdiu shprehet se, *Kosova ka kaluar pjesën përgatitore të qeverisjes vendore dhe pjesën e dytë që ka të bëjë me ngritjen e administratës shtetërore*.⁴⁰

Në tabelën 3.5 problematikat më serioze të demokracisë në Kosovë, në mënyrë tabelare paraqiten përgjigjet e personaliteteve të intervistuar, ekspertë në Shqipëri, në Kosovë dhe të ekspertëve ndërkombëtarë, të cilët u janë përgjigjur pyetjeve të pyetësorit nr.1. *Për problematikat më serioze të demokracisë në Kosovë*. Sipas të dhënave tabelare, rezulton se për periudhën 2008-2015, problemet më serioze të demokracisë në Kosovë janë evidentuar gjithsej 22 problematika, nga 25 problematika që ishin evidentuar në Shqipëri që po i paraqesim më poshtë, si:

1. *Kultura institucionale, keqfunksionimi dhe politizimi i administratës*, me 13.2% të përgjigjeve nga të cilat 20.4% janë përgjigjur ekspertët ndërkombëtarë, 14.3% ekspertët në Kosovë dhe 8.3% ekspertët në Shqipëri;

³⁹Intervista është marrë nga autori në Mitrovicën e Veriut në Kosovë, datë 23.01.2016.

⁴⁰Intervista është marrë nga autori në Prishtinë, datë 11.12.2015.

2. *Shtetformimi demokratik dhe pjekuria e klasës politike*, me 12.5% të përgjigjeve, nga të cilët 20.4% janë përgjigjur ekspertët në Kosovë dhe 9.5% ekspertët në Shqipëri.

3. *Korrupsioni*, me 11.8% të përgjigjeve, nga të cilët 21.4% janë përgjigjur ekspertët ndërkombëtarë, 15.5% ekspertët në Shqipëri dhe 3.7% ekspertët në Kosovë;

4. *Paqëndrueshmëria politike*, me 11.2% të përgjigjeve, nga të cilët 21.4% janë përgjigjur ekspertët ndërkombëtarë dhe 16.7% ekspertët në Shqipëri;

5. *Mungesa e shtetit ligjor*, me 8.6% të përgjigjeve, nga të cilët 18.5% janë përgjigjur ekspertët në Kosovë dhe 3.6% ekspertët në Shqipëri;

6. *Problematika ekonomike* me 5.9%, nga të cilat 7.4% janë përgjigjur ekspertët në Kosovë dhe 6% ekspertët në Shqipëri.

7. *Demokracia e brendshme e partive politike*, me 5.9% të përgjigjeve, nga të cilat me nga 7.1% janë përgjigjur ekspertët ndërkombëtarë dhe ekspertët në Shqipëri dhe 3.7% ekspertët në Kosovë.

8. *Krimi i organizuar dhe veprimtaritë e tij*, me 4.6% të përgjigjeve, nga të cilat 7.1% janë përgjigjur ekspertët ndërkombëtarë, 6% ekspertët në Shqipëri dhe 1.9% ekspertët në Kosovë.

9. *Prania e faktorit ndërkombëtar*, me 3.9% të përgjigjeve, nga të cilat 6% janë përgjigjur ekspertët në Shqipëri, dhe 1.9% ekspertët në Kosovë.

10. *Mungesa e transparencës dhe llogaridhënies*, me 3.9% të përgjigjeve, nga të cilat 14.3% janë përgjigjur ekspertët ndërkombëtarë, dhe 4.8% ekspertët në Shqipëri.

11. *Influenca e politikave serbe dhe e krimit të organizuar serb*, me 3.3% të përgjigjeve, nga të cilat 6% janë përgjigjur ekspertët në Shqipëri, ndërsa ekspertët në Kosovë dhe ekspertët ndërkombëtarë nuk kanë dhënë përgjigje për këtë problematikë.

12. *Kapja e shtetit*, me 3.3% të përgjigjeve, nga të cilët 7.1% janë përgjigjur ekspertët ndërkombëtarë, 5.6% ekspertët në Kosovë dhe 1.2% ekspertët në Shqipëri.

13. *Problematikat sociale*, me 2% të përgjigjeve nga të cilat 3.7% janë përgjigjur ekspertët në Kosovë dhe 1.2% ekspertët në Shqipëri.

14. *Mbivendosja e pushteteve*, me 1.3% të përgjigjeve, nga të cilët 3.7% janë përgjigjur ekspertët në Kosovë.

15. *Mungesa e njohjes së Kosovës në botë*, me 1.3% të përgjigjeve, nga të cilët 2.4% janë përgjigjur ekspertët në Kosovë.

16. *Mungesa e aktivizimit qytetar*, me 1.3% të përgjigjeve, nga të cilët 3.7% janë përgjigjur ekspertët në Kosovë.

17. *Mungesa e besueshmërisë së institucioneve*, me 1.3% të përgjigjeve, nga të cilët 7.1% janë përgjigjur ekspertët ndërkombëtar dhe 1.2% ekspertët në Shqipëri.

18. *Inkriminimi i politikës*, me 1.3% të përgjigjeve, nga të cilët 2.4% janë përgjigjur ekspertët në Shqipëri.

19. *Problematika e sistemit zgjedhor*, me 1.3% të përgjigjeve, nga të cilët 1.9% janë përgjigjur ekspertët në Shqipëri dhe 1.2% ekspertët në Kosovë.

20. *Liberalizmi i vizave dhe anëtarësimi në BE* me 0.7% të përgjigjeve, nga të cilët 1.9% janë përgjigjur ekspertët në Kosovë.


21. *Problematika e sistemit të drejtësisë*, me 0.7% të përgjigjeve, nga të cilët 1.9% janë përgjigjur ekspertët në Kosovë.

22. *Media jo e lirë*, me 0.7% të përgjigjeve, nga të cilët 1.2% janë përgjigjur ekspertët në Shqipëri.

Pra, nga përgjigjet e mësipërme rezulton se tri problematikat me serioze të demokracisë në Kosovë janë: 1. kultura institucionale, keqfunksionimi dhe politizimi i administratës; 2. shtetformimi demokratik dhe pjekuria e klasës politike, dhe 3. korrupsioni.

Në figurën 3.3 paraqiten në pamje grafike problematikat më serioze të demokracisë në Kosovë, sipas së cilës rezulton se, nga 22 problematika të evidentuara, 10 problematika janë më seriozet, si: *kultura institucionale, keqfunksionimi dhe politizimi i administratës, shtetformimi demokratik dhe pjekuria e klasës politike, korrupsioni, paqëndrueshmëria politike, mungesa e shtetit ligjor, problematika ekonomike, demokracia e brendshme e partive politike, krimi i organizuar dhe veprimtaritë e tij, prania e faktorit ndërkombëtar dhe mungesa e transparencës dhe llogaridhënies.*

Problemet kryesore të demokracisë në Kosovë



Burimi: Pyetësi 2 “*Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri-Kosovë, 2008-2015*”, plotësuar nga studentët e fakulteteve të Drejtësisë dhe të Sigurisë në Prishtinë dhe Tiranë. Përpunim i autorit, 2016.

Grafiku 3.2 Problematikat më serioze të demokracisë në Kosovë (Anketimi i studentëve).⁴¹

Sipas të dhënave tabelare të tabelës 3.6 dhe grafikut 3.2 rezulton se për periudhën 2008-2015, janë evidentuar gjithsej 14 problematika më serioze të demokracisë në Shqipëri, të cilat paraqiten më poshtë:

1. *Korrupsioni* me 481 përgjigje ose 69%;
2. *Krimi i organizuar, droga e trafikimi* me 288 përgjigje, ose 41 %;
3. *Problematika ekonomike* me 178 përgjigje ose 25 %;
4. *Problematika te sistemit të drejtësisë* me 164 përgjigje ose 23%;
5. *Mungesa e shtetit ligjor* me 146 përgjigje ose 21%;
6. *Kapja e shtetit* me 127 përgjigje ose 18%;
6. *Shteti demokratik dhe pjekuria e klasës politike* me 123 përgjigje ose 18%;
7. *Kultura institucionale, keqfunksionimi dhe politizimi i administratës* me 119 përgjigje ose 17%;
8. *Prania e faktorit ndërkombëtar* me 74 përgjigje ose 11%.
9. *Problemet sociale* me 70 përgjigje ose 10%;
10. *Demokracia e brendshme e partive politike* me 64 përgjigje ose 9%;
11. *Mungesa e aktivizimit qytetar* me 50 përgjigje ose 7%;
12. *Problematika të sistemit zgjedhor* me 49 përgjigje ose 7%;
13. *Mbivendosja e pushteteve* me 40 përgjigje ose 6%;
14. *Nuk e di përgjigjen* me 36 përgjigje ose 5%.

⁴¹Theksojmë se të anketuarit kanë pasur të drejtën e më shumë se një përgjigjeje (deri në 3 alternativa/përzgjedhje për secilën pyetje).

Nga krahasimi i përgjigjeve të pyetësorëve të plotësuar nga politikanët dhe ekspertët e sigurisë, si dhe nga përgjigjet e anketimit të studentëve për problematikat më serioze të demokracisë në Kosovë, rezulton se, në rastin e parë janë evidentuar tri problematika: 1. kultura institucionale, keqfunksionimi dhe politizimi i administratës; 2. shtetformimi demokratik dhe pjekuria e klasës politike, dhe 3. korrupsioni. Ndërsa, anketimi i studentëve ka evidentuar të parën problematikë *korruptionin, krimin e organizuar e veprimtaritë e tij, droga, trafikimi dhe problematika ekonomike*. Pra, *korruptioni* është evidentuar si problematikë kryesore.


Cilësia e qeverisjes dhe mjedisi investues, sipas Ernst Florian Winter, lënë për të dëshiruar. Kështu shprehet ai:

“Kosova ka kaluar një rrugë të vështirë dhe specifike në ndërtimin e administratës publike dhe institucioneve. Por mbetet shumë për t’u bërë për të ngritur cilësinë e qeverisjes. Është ndërtuar në aparat i madh burokratik, ndërsa përzgjedhja nuk bëhet gjithmonë bazuar në kritere objektive të aftësive. Ka mbizotëruar ndikimi i faktorëve politikë (partive) në zgjedhjen dhe emërimin e funksionarëve në pozitat më me përgjegjësi, ndaj, domosdo, aftësitë profesionale dhe referencat duhet të jenë kriteri i zbatuar. Kontrolli i sferave të caktuara të interesave dhe shpërblimi për aktivizim partiak ka qënë faktor kyç, dhe kjo ka shumë pak të përbashkët me qeverisjen moderne të zhvillimit ekonomiko-social dhe praktikatat europiane e euroatlantike. Kjo duhet të kuptohet nga aktorët tanë politikë, sa më shpejt e në dobi të ndërtimit të qëndrueshmërisë ekonomike të Kosovës” (Ernst Florian Winter, 2007:112).

Për të përmirësuar cilësinë e qeverisjes, kërkohet një seriozitet dhe investim më i madh moral, ligjor dhe politik nga klasa politike në Kosovë.

3.4.1. Problematikat e demokracisë në Kosovë, nën optikën e ekspertëve.

Mbi bazën e pyetësorit dhe të intervistave të zhvilluara në tabelën 3.7 dhe në grafikun 3.3 pasqyrohen problematikat më serioze të demokracisë në Kosovë nën optikën e ekspertëve në Shqipëri dhe në Kosovë.



Burimi: Pyetësori 1 “Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri-Kosovë, 2008-2015”, plotësuar nga personalitete publike dhe ekspertë të sigurisë e drejtësisë në Shqipëri, Kosovë dhe ekspertë ndërkombëtarë. Përpunim i autorit, 2016.

Grafiku 3.3 Problematikat më serioze të demokracisë në Kosovë nën optikën e ekspertëve në Shqipëri dhe në Kosovë.

Sipas politikanëve dhe ekspertëve në Shqipëri, *paqëndrueshmëria politike* renditet problematika e parë me 16.7% të përgjigjeve, *korrupsioni* renditet problematika e dytë me 15.5% të përgjigjeve, *shtetformimi demokratik dhe pjekuria e klasës politike* renditet e treta me 9.5% të përgjigjeve, *kultura institucionale, keqfunksionimi dhe politizimi i administratës*, renditet e katërta me 8.3%, *demokracia e brendshme e partive politike*, renditet problematika e pestë me 7.1%, për të vijuar më tej, *me influenca e politikave serbe dhe e krimit të organizuar serb, problematika ekonomike, krimi i organizuar, droga, trafikimi, prania e faktorit ndërkombëtar* me 6%, *mungesa e transparencës dhe llogaridhënies* me 4.8%, *mungesa e shtetit ligjor* me 3.6%, *mungesa e njohjes së Kosovës në botë dhe inkriminimi i politikës* me 2.4%, për të përfunduar me, *media jo e lirë, mungesa e besueshmërisë së institucioneve, kapja e shtetit, problematika e sistemit zgjedhor dhe problematika sociale* me 1.2% të përgjigjeve.

Sipas politikanëve dhe ekspertëve në Kosovë, *shtetformimi demokratik dhe pjekuria e klasës politike dhe kultura institucionale, keqfunksionimi dhe politizimi i administratës* renditet problematika e parë dhe e dytë me 20.4% të përgjigjeve, *mungesa e shtetit ligjor*, renditet e treta me 18.5%, *problematika ekonomike*, renditet problematika e katërt me 7.4%, *kapja e shtetit*, renditet e pesta me 5.6%, për të vijuar me *korrupsionin, demokracia e brendshme e partive politike, problematika sociale, mbivendosja e pushteteve dhe mungesa*

e aktivizimit qytetar me 3.7%, si dhe krimi i organizuar, droga, trafikimi, prania e faktorit ndërkombëtar, problematika e sistemit zgjedhor, liberalizimi i vizave dhe anëtarësimi në BE dhe problematika e sistemit të drejtësisë me 1.9% të përgjigjeve.

Nga analiza krahasuese e përgjigjeve të dhëna nga ekspertët në Shqipëri dhe në Kosovë vihen re ndryshime në përgjigje. Për shembull ekspertët në Kosovë eidentojnë pesë problematika më serioze: *shtetformimi demokratik dhe pjekuria e klasës politike, kultura institucionale, keqfunksionimi dhe politizimi i administratës, mungesa e shtetit ligjor, problematika ekonomike dhe kapja e shtetit.* Ndërkohë që ekspertët në Shqipëri rendisin pesë problematika të tjera serioze si: *paqëndrueshmëria politike, korrupsioni, shtetformimi demokratik dhe pjekuria e klasës politike, kultura institucionale, keqfunksionimi dhe politizimi i administratës dhe demokracia e brendshme e partive politike.* Theksojmë se paqëndrueshmërinë politike ekspertët në Shqipëri e kanë eidentuar si problemin e parë serioz për demokracinë në Kosovë. Mendoj se kjo problematikë e shprehur për Kosovën nga ekspertët në Shqipëri, ka të bëjë me gjendjen faktike të problematikës së gjatë të “posttranzicionit” 26-vjeçar shqiptar, dhe jo “të demokracisë”, të cilën mesa duket ekspertët në Shqipëri e rendisin si një ndër shkaqet kryesore që kanë ndikuar edhe në problematika dhe në faktorë të tjerë që bëhen pasoja të kësaj problematike. Ndoshta, ekspertët në Shqipëri, nëpërmjet kësaj përgjigjeje, kanë dashur të sugjerojnë për Kosovën të mësuarit nga “gabimet” e Shqipërisë dhe të mos e marrin si model imitues, pra, të krijojnë qëndrueshmërinë politike në Kosovë dhe të mbështeten jo në eksperiencat “negative” të Shqipërisë.

Një veçori tjetër, rezulton të jetë se ekspertët në Shqipëri kanë vlerësuar si problematika edhe *mungesën e njohjes së Kosovës në botë, inkriminimin e politikës, media jo e lirë dhe mungesa e besueshmërisë së institucioneve,* të cilat nga ekspertët në Kosovë nuk janë eidentuar si të tilla. Pra, edhe këto faktorë janë shumë të rëndësishëm dhe lidhen me eksperiencën shtetformuese që kanë ekspertët në Shqipëri në krahasim me eksperiencën e re shtetformuese të ekspertëve në Kosovë dhe problemeve në dukje akoma të shfaqura deri tani në Kosovë, por që nga eksperiencia e Shqipërisë, këto problematika janë “*pas derës*” dhe do të “*trokasin*” shumë shpejt në qeverisjen dhe shtetformimin e Kosovës në të ardhmen. Të bën përshtypje fakti se ekspertët në Kosovë janë shprehur në përgjigjet e tyre për problematikën *mungesa e aktivizimit qytetar me 3.7% të përgjigjeve,* ndërkohë që


ekspertët në Shqipëri nuk janë përgjigjur fare për të në lidhje me për Kosovën, ndërkohë, që ekspertët në Shqipëri për këtë problematikë për Shqipërinë nuk e kanë përmendur si problematikë fare, por duke u shprehur për problematikën *shoqëri civile apatike* për Shqipërinë me 3.4% të përgjigjeve.

Në Kosovë problematika *mungesa e aktivizimit qytetar* për ekspertët në Kosovë është e ulët, ndërkohë për ata të Shqipërisë nuk është përmendur fare. Në Kosovë lëvizja qytetare civile “Vetëvendosja” ka qënë shumë aktive. Ajo u shëndrrua në parti politike dhe vazhdon edhe aktualisht të bëjë “opozitën” e shoqërisë civile në parlament dhe në rrugë. Në Shqipëri, shoqëria civile është e “kapur” pas pushtetit dhe është vënë në “shërbim” të “partive-shtet” në shtet dhe në opozitë. Gjithashtu, “shteti partiak” në pushtet, por edhe në “opozitën-shtet” është treguar “i zgjuar” për interesat e tij të ngushta që nga vitet 1991-1992, duke politizuar sindikatat sipas dy partive kryesore politike, Partisë Socialiste dhe Partisë Demokratike. Elementët “*eminentë*” të shoqërisë civile këto parti politike i “kanë përthithur” dhe “*joshur*” duke i përfshirë në politikë dhe duke i bërë pjesë të tyre. Zëvendës-presidenti Amerikan Xhon Kerri, gjatë vizitës që bëri në Tiranë, zhvilloi takim me përfaqësues të shoqërisë civile, ashtu siç shihet gjatë dy viteve të fundit ambasadori amerikan, Donald Lu, që u bën thirrje të drejtpërdrejtë qytetarëve dhe shoqërisë civile në Shqipëri që të mbrojnë interesat e tyre qytetare pasi politika e “*kriminalizuar*”,⁴² dhe krimi i organizuar e “*kanë kapur*”⁴³ shtetin dhe institucionet dhe nuk përfaqësojnë dhe mbrojnë interesat e qytetarëve.

Në figurën nr. 3.4 trajtohet problematika në mënyrë përfaqësuese duke përfshirë dhe problematikat e ngritura nga ekspertët ndërkombëtarë.

⁴²1.6% e përgjigjeve në total të ekspertëve theksojnë inkriminimin e politikës. Ekspertët në Shqipëri 2.6%.

⁴³3.3% e përgjigjeve në total të ekspertëve theksojnë kapjen e shtetit. Ekspertët ndërkombëtarë 7.1%.



Burimi: Pyetësori 1 “Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri-Kosovë, 2008-2015”, plotësuar nga personalitete publike dhe ekspertë të sigurisë e drejtësisë në Shqipëri, Kosovë dhe ekspertë ndërkombëtarë. Përpunim i autorit, 2016.

Figura 3.4 Krahasimi i qëndrimeve të intervistuarve mbi problematikat kryesore të ngritura nga ndërkombëtarët.

Nga paraqitja grafike rezulton se në total problematika që renditet e para është *kultura institucionale, keqfunksionimi dhe politizimi i administratës* me 13.2% të përgjigjeve; vijon me *korruptionin*, me 11.8% dhe me *paqëndrueshmërinë politike*, me 11.2% të përgjigjeve. Ndërkohë, që përgjigjet e ekspertëve ndërkombëtarë rendisin këto problematika për demokracinë në Kosovë: 1. korruptioni 21.4%; 2. paqëndrueshmëria politike 21.4%; 3. kultura institucionale, keqfunksionimi dhe politizimi i administratës 14.3%; 4. mungesa e transparencës dhe llogaridhënies, 14.3%; 5. krimi i organizuar, droga, trafikimi 7.1%; 6. kapja e shtetit, 7.1%; 7. mungesa e besueshmërisë së institucioneve 7.1%; 8. demokracia e brendshme e partive politike 7.1% të përgjigjeve.

Pra, ekspertët ndërkombëtarë në mënyrë të dallueshme nga ekspertët në Shqipëri dhe ata të Kosovës rendisin pesë problemet më serioze: *korruptioni, paqëndrueshmëria politike, mungesa e transparencës dhe e llogaridhënies, kultura institucionale, keqfunksionimi dhe politizimi i administratës dhe krimi i organizuar, droga, trafikimi*.

PhD Walter Schwimmer, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës (1999-2004), në lidhje me pyetjen për problemet më serioze të demokracisë në Kosovë shprehet:

“Partitë politike siç është për shembull “Vetëvendosja”, kërkojnë të imponojnë vullnetin e tyre pavarësisht faktit që nuk kanë një mandat politik për ta bërë këtë dhe nuk kanë fituar vota të

mjaftueshme në zgjedhjet e përgjithshme për të krijuar një qeveri, që të përpiqet me anë të dhunës apo me anë të mënyrave të tjera të bllokojnë punën e mazhorancës të zgjedhur, nuk është demokraci.⁴⁴”

Edhe Peter Linden Jones është shprehur: *“Partitë opozitare si “Vetëvendosja” duke kërkuar për të imponuar vullnetin e tyre edhe pse nuk kanë mandat politik për ta bërë këtë, përdorin dhunën për të bllokuar punën e shumicës të zgjedhur duke e dëmtuar demokracinë në Kosovë.⁴⁵”* Ndërsa Isuf Çelaj është shprehur se *pamundësia e krijimit të një poli të tretë të politikës, nuk ka bërë të mundur akoma, bindjen dhe përfaqësimin e duhur qytetar për të frenuar veprimet arbitrare të dy partive të mëdha.⁴⁶*

Në mënyrë tabelare pesha e nënfaktorëve në përgjigjet e të intervistuarve, paraqitet në tabelën nr. 3.8. Gjithashtu, paraqitet edhe pesha e nënfaktorëve brenda faktorëve në përgjigjet e të intervistuarve, sipas së cilës rezulton se: nga 22 faktorë, janë evidentuar 42 nënfaktorë. Pesha e nënfaktorëve në përgjigjet e të intervistuarve për faktorin *kultura institucionale, keqfunksionimi dhe politizimi i administratës*, përbëhet nga 6 nënfaktorë nga të cilët, *mungesa e kulturës insitucionale dhe institucione jodemokratike* në total 6.6%, nga të cilët ekspertët në Kosovë 13% dhe ekspertët në Shqipëri 3.6%, *përgatitja e institucioneve të qeverisjes vendore dhe mbivendosja e kompetencave të institucioneve* 0.7%, *niveli profesional dhe morali i ulët në administratë dhe mungesa e kordinimit të institucioneve* 1.3% si dhe *mungesa e autonomisë politike të institucioneve* 2.6%. Ekspertët ndërkombëtarë janë shprehur me 7.1% për nënfaktorët *mungesa e autonomisë politike të institucioneve dhe mungesa e kordinimit të institucioneve*. Ndërkohë që ekspertët në Kosovë, u kanë dhënë peshë më të madhe *mungesës së kulturës institucionale dhe institucione jodemokratike* me 13% dhe *mungesës së autonomisë politike të institucioneve* me 3.7%, ndërsa, ekspertët në Shqipëri peshën më të madhe ua kanë dhënë *mungesës së kulturës institucionale dhe institucione jodemokratike* me 3.6% dhe *nivelit profesional dhe moral i ulët në administratë* me 2.4%.

Në faktorin *shtetformimi demokratik dhe pjekuria e klasës politike*, janë evidentuar katër nënfaktorë dhe konkretisht: *mungesa e një gjyqësori të pavarur, integriteti dhe legjitimiteti i institucioneve dhe i përfaqësimit*, me 1.3%, *mungesë demokracie në ushtrimin*

⁴⁴ Intervista është marrë nga autori, datë 27.11.2015.

⁴⁵ Peter Linden Jones, autor i cituar.

⁴⁶ Isuf Celaj, drejtor i Shërbimeve të Përgjithshme në Ministrinë e Brendshme (2005-2013).

e pushtetit, me 0.7% dhe papjekuria dhe paaftësia e klasës politike, 3.9%, shtetformimi demokratik 6.6%. Ekspertët në Kosovë shtetformimit demokratik i kanë dhënë peshën më të madhe me 11.1%, papjekurisë dhe paaftësisë së klasës politike 5.6% dhe integritetit dhe legjitimitetit të institucioneve dhe të përfaqësimit 3.7%. Ndërsa, ekspertët në Shqipëri, shtetformimit demokratik 4.8%, papjekurisë dhe paaftësisë së klasës politike 3.6% dhe mungesës demokracie në ushtrimin e pushtetit me 1.2%.

Në faktorin *problematika ekonomike*, janë evidentuar tre nënfaktorë dhe konkretisht: *zhvillimi ekonomik* me 1.3%, *varfëria, ekonomi e dobët, zhvillim i ulët ekonomik* 3.9% dhe *zotërimi efektiv i teknologjisë* 0.7%. Ekspertët në Kosovë janë përgjigjur për *zhvillimin ekonomik* me 3.7% dhe *varfëria, ekonomi e dobët, zhvillim i ulët ekonomik* dhe *zotërimi efektiv i teknologjisë* me 1.9%. Ndërsa, ekspertët në Shqipëri për nënfaktorin *varfëria, ekonomi e dobët, zhvillim i ulët ekonomik* janë përgjigjur me 6%.

Në faktorin *paqëndrueshmëria politike*, janë evidentuar pesë nënfaktorë dhe konkretisht: *karakteri politik* me 2%, *paqëndrueshmëria politike* 2.6%, *karakteri i dobët i shtetit* 2.6% përpjekjet e opozitës për të imponuar vullnetin e tyre, kur nuk janë zgjedhur nga populli 1.3% dhe *mungesa e konsensusit politik* 2.6%. Ekspertët në Shqipëri për nënfaktorin *karakteri i dobët i shtetit dhe mungesë e konsensusit politik* 4.8%, *paqëndrueshmëria politike dhe konflikti politik* ndërsa, ekspertët ndërkombëtar për nënfaktorin *paqëndrueshmëria politike* 7.1%.

Në faktorin *demokracia e brendshme e partive politike* janë evidentuar dy nënfaktorë dhe konkretisht: *parti politike jo demokratike* 5.3% dhe *pushteti i një partie prej vitesh* 0.7%. Ekspertët ndërkombëtarë për nënfaktorin *parti politike jodemokratike* përgjigjen 7.1%, ndërkohë që ekspertët në Shqipëri përgjigjen 6% dhe ekspertët në Kosovë 3.7%. Ndërsa, për nënfaktorin *pushteti i një partie prej vitesh*, ekspertët në Shqipëri përgjigjen 1.2%.


Në faktorin *problematika sociale*, janë evidentuar tre nënfaktorë. *Cilësia e edukimit dhe arsimimit, gjakmarrje dhe papunësia* me 0.7%, nga të cilët ekspertët në Kosovë për *cilësinë e edukimit dhe arsimimit dhe papunësinë* përgjigjen 1.9%, ndërsa ekspertët në Shqipëri për *gjakmarrjen* përgjigjen 1.2%.

3.4.2. Demokracia dhe problematikat e përbashkëta në Shqipëri dhe në Kosovë-analizë krahasuese.

Duke qenë se, nga njëra anë, jemi dy shtete, pjesë të një kombi, dhe, nga ana tjetër, kemi pasur shtetformime, qeverisje dhe zhvillime të ndryshme, veçanërisht pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore dhe pas viteve '90, trajtimi i gjendjes së demokracisë dhe të problematikave të përbashkëta në Shqipëri dhe në Kosovë paraqet interes të veçantë në trajtimin dhe zgjidhjen e tyre. Kështu, në tabelën nr. 3.9 paraqiten të përbashkëtat midis Shqipërisë dhe Kosovës në problematikat e demokracisë.

Nëpërmjet të dhënave të paraqitura në mënyrë tabelare kemi bërë edhe një analizë për 25 problematika kryesore të demokracisë në Shqipëri dhe 22 problematika kryesore të demokracisë në Kosovë. Problematika e parë është *mungesa e shtetit ligjor* në Shqipëri, 14% dhe në Kosovë 8.6%; *korrupsioni*, 10.8% me 11.8%; *kapacitete të ulëta, keqfunksionimi dhe politizimi i administratës*, 8.1% me 13.2%; *problematika të sistemit zgjedhor* 7% me 1.3%; *krimi i organizuar dhe veprimtaritë e tij*, 5.9% me 4.6%; *problematika të lidhura me demokracinë*, 5.9% me 12.5%; *problematikat sociale*, 5.4% me 2%; *problematika të sistemit të drejtësisë* 5.4% me 0.7%; *problematikat ekonomike* 4.3% me 5.9%; *kapja e shtetit* 3.8% me 3.3%; *mbivendosje dhe mosbalancim i pushteteve* 3.2% me 1.3%; *mungesa e besimit të popullit në demokraci, në institucione dhe në drejtësi* 3.2% me 1.3%; *mungesë e transparencës dhe e llogaridhënies* 3.2% me 3.9%; *inkriminim i politikës* 1.6% me 1.35; *media jo e lirë* 1.6% me 0.7% dhe *demokracia e brendshme e partive politike* 1.6% me 5.9%.

Në mënyrë grafike në figurën nr. 3.5 paraqiten të përbashkëtat midis Shqipërisë dhe Kosovës në *problematikat e demokracisë*. Mbi bazën e përgjigjeve të pyetjeve të pyetësorit nga ekspertët në Shqipëri dhe në Kosovë, janë përpunuar të dhënat dhe janë nxjerrë të përbashkëtat.



Burimi: Pyetësori 1 “Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri-Kosovë, 2008-2015”, plotësuar nga personalitete publike dhe ekspertë të sigurisë e drejtësisë në Shqipëri, Kosovë dhe ekspertë ndërkombëtarë. Përpunim i autorit. 2016.

Figura 3.5 Të përbashkëta midis Shqipërisë dhe Kosovës në problematikat e demokracisë.

Siç shihet nga paraqitja grafike, *mungesa e shtetit ligjor, korrupsioni, kapacitete të ulëta, keqfunksionimi dhe politizimi i administratës, problematika të sistemit zgjedhor, krimi i organizuar dhe veprimtaritë e tij dhe problematika të lidhura me demokracinë, problematikat sociale, problematika të sistemit të drejtësisë e problematikat ekonomike e deri te kapja e shtetit,*⁴⁷ *mbivendosje dhe mosbalancim i pushteteve, inkriminimi i politikës,*⁴⁸ *e media jo e lirë* bashkëshoqërojnë sipas ekspertëve në Shqipëri dhe në Kosovë, shtetin, shoqërinë, demokracinë, zhvillimin dhe problemet me krimin e organizuar, korrupsionin etj.

Nga analizimi i përgjigjeve të personaliteteve publike e politike dhe ekspertëve të sigurisë, evidentohet se nga 25 problematika kryesore të demokracisë në Shqipëri dhe 22 problematika kryesore të demokracisë në Kosovë, dhe nga analiza krahasuese rezulton se janë 16 problematika të përbashkëta midis Shqipërisë dhe Kosovës ose, ndryshe, 64% e problematikave kryesore të demokracisë në Shqipëri dhe 72.7% e problematikave kryesore të demokracisë në Kosovë, janë të përbashkëta. Duke u referuar përfundimeve të mësipërme, konkludohen eksperiencat pozitive, modelet e mira dhe shembuj konkret pozitivë që duhet të ndiqen nga qeverisja e politikëbërja e dy shteteve Shqipërisë dhe Kosovës. Ndërsa, eksperiencat, shembujt dhe modelet negative, jo vetëm që nuk duhen

⁴⁷3.8% e përgjigjeve për shtetin në Shqipëri dhe 3.3% për shtetin në Kosovë ekspertët janë përgjigjur për rubrikën “Kapja e shtetit”.

⁴⁸1.6% e përgjigjeve janë evidentuar për inkriminimin e Politikës në Shqipëri dhe 1.3% për inkriminimin e politikës në Kosovë.

ndjekur, kopjuar e imituar, por nevojitet të nxirren konkluzione të qarta për ndërtimin e konsolidimin e demokracive, mirëfunksionimin e institucioneve, ndarjen e pushteteve, depolitizimin e “çmilitarizimin” partiak të administratës, luftë pa kompromis kundër krimit të organizuar dhe veprimtarive të tij, korrupsionit, dhe si dhe vënien e qeverive e të lidërshiptit politik e partiak në shërbim të qytetarëve dhe taksapaguesve që u kanë besuar dhe zgjedhur për t’i drejtuar.

Ndërkohë që statusi dhe përvoja e ndryshme shtetformuese, eksperiencia e institucioneve demokratike dhe të sigurisë, veçanërisht në Shqipëri në krahasim me Kosovën si shtet i ri dhe në formim e konsolidim e sipër, tregon se shteti shqiptar, qeveria dhe institucionet e sigurisë lypet të punojnë më shumë në të ardhmen për konsolidimin e demokracisë dhe të shtetit ligjor. Sipas dr. Bekim Podrimcakut,


“Shqipëria dhe Kosova kanë një sistem “vetëvrasës”, nga njëra anë, qëndron pozita e opozita e cila shpesh qëndron në rrugë. Nuk kemi demokraci. Ne kemi të bëjmë me autokraci. Ne jemi individ (shqiptarët e Shqipërisë dhe të Kosovës). Çdo gjë ne e sjellim rreth vetes, por jo rreth shtetit, siç veprojnë politikanët dhe zyrtarët dhe qytetarët në vendet perëndimore si në Gjermani apo Slloveni etj. Këto shtete kanë parim vlerësimi, që shteti është gjithçka, dhe jo individ, vetvetja. Ne shqiptarët shtetin e kemi menduar “vegël” dhe kemi luajtur me të, ndërsa shtetet e tjera të zhvilluara nuk e kanë menduar dhe nuk e mendojnë të tillë, por thonë që shteti është gjithçka.”⁴⁹ Ndërsa, dr. Bajram Rexhepi shprehet se dhe në procesin demokratik duhet të mënjanohet dukuria e anarkisë, si në Shqipëri ashtu edhe në Kosovë.⁵⁰

3.4.3 Problematika specifike të demokracisë në Shqipëri dhe Kosovë.

Përveç të përbashkëtave midis Shqipërisë dhe Kosovës në problematikat e demokracisë, kemi evidentuar edhe problematikat e veçanta dhe specifike në secilin shtet. Në figurën nr. 3.6 pasqyrohen përgjigjet e pyetjeve dhe analizimi i tyre, në lidhje me problematikat e demokracisë, të pranishme në Shqipëri.

⁴⁹Dr. Bekim Podrimcaku, autor i cituar.

⁵⁰ Intervista është marrë nga autori në Mitrovicën e Veriut në Kosovë, datë 23.01.2016.




Burimi: Pyetësori 1. “Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri-Kosovë, 2008-2015”, plotësuar nga personalitete publike dhe ekspertë të sigurisë e drejtësisë në Shqipëri, Kosovë dhe ekspertë ndërkombëtarë. Përpunim i autorit, 2016.

Figura 3.6 Problematika të demokracisë të pranishme vetëm në Shqipëri.

Këto problematika janë: *kequshtrimi dhe privatizimi i pushtetit; shoqëri civile apatike; rregjimi i pronës; kultura e pandëshkueshmërisë; mosrespektimi i ligjit nga qeveritë; mungesa e kontrollit të territorit dhe përafrimi i legjislacionit me BE^{në}.*

Në figurën nr. 3.7 pasqyrohen përgjigjet e pyetjeve dhe analizimi i tyre lidhur me problematika të demokracisë, të pranishme vetëm në Kosovë.



Burimi: Pyetësori 1 “Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri-Kosovë, 2008-2015”, plotësuar nga personalitete publike dhe ekspertë të sigurisë e drejtësisë në Shqipëri, Kosovë dhe ekspertë ndërkombëtarë). Përpunim i autorit, 2016.

Figura 3.7 Problematika të demokracisë, të pranishme vetëm në Kosovë.

Këto problematika janë: *shtetformimi demokratik dhe pjekuria e klasës politike; paqëndrueshmëria politike; prania e faktorit ndërkombëtar; influenca e politikave serbe dhe e krimit të organizuar serb; mungesa e aktivizimit qytetar; liberalizimi i vizave dhe anëtarësimi në BE.*

3.4.4. Dallueshmeritë e demokracisë në Kosovë.

Shtetformimi dhe demokracia në Kosovë është shumë e re dhe për rrjedhojë sfidat e saj janë të mëdha. Siç rezulton edhe nga figura 3.5 evidentohen tri problematika të demokracisë me karakter të brendshëm dhe konkretisht: *shtetformimi demokratik dhe pjekuria e klasës politike* 38%, *paqëndrueshmëria politike* 34% dhe *mungesa e aktivizimit qytetar* 4%, të cilat përbëjnë 76%. Ndërsa, tri problematika të demokracisë me karakter të jashtëm, por edhe me ndikim të brendshëm janë: *prania e faktorit ndërkombëtar* 12%, *influenca e politikave serbe dhe e krimit të organizuar serb* 10%, dhe *liberalizimi i vizave dhe anëtarësimi në BE* 2%, të cilat bëjnë 24%. Pra, problematikat me karakter të brendshëm janë problematikat kryesore, të cilat shteti dhe qeveria e Kosovës duhet t'u kushtojnë vëmendje dhe rëndësi të veçantë në të ardhmen.

3.5 Përmbledhje.

Në këtë kapitull u trajtuan problematikat kryesore të demokracisë dhe të institucioneve demokratike në Shqipëri, Kosovë - analizë krahasuese. Fillimisht, u trajtua një përshkrim analitik i statusit të Republikës së Shqipërisë dhe i Republikës së Kosovës dhe të problematikave që mbartin në vetvete këto dy shtete, pjesë përbërëse e një kombi, nga historia e para dhe pas viteve '90, dhe pas vitit 2008 kur Kosova shpalli Pavarësinë. Në vijim, u trajtuan problematikat kryesore të demokracisë në Shqipëri dhe në Kosovë, nën optikën e personaliteteve politike, publike dhe të ekspertëve të sigurisë në Shqipëri, Kosovë dhe të ekspertëve ndërkombëtarë. Gjithashtu, u bënë analiza krahasuese dhe u evidentuan problematika të përbashkëta, problematika të veçanta dhe dallueshmëria e demokracisë në Kosovë si shtet i ri dhe në konsolidim. Çështjet e krimit të organizuar, po verifikojnë e testojnë hipotezën dhe pyetjet kërkimore, nëpërmjet edhe këtij kapitulli, duke evidentuar se krimi i organizuar transnacional, ka një ndikim të rëndësishëm për demokracinë dhe institucionet demokratike. Nga njëra anë, mosfunksionimi i duhur i demokracisë dhe institucioneve demokratike i krijon “terrenin “ e përshtatshëm, krimit të organizuar për

veprimtari aktive të tij, dhe, nga ana tjetër, ai ndikon ndjeshëm në dobësimin e demokracisë dhe mirëfunksionimit të institucioneve demokratike.

Pyetja kërkimore bazë që studimi ngre në lidhje me problemet më serioze të demokracisë në Shqipëri dhe Kosovë, problemet e përbashkëta dhe të veçanta e specifike dhe provohet lidhja e ngushtë dhe ndikimi i madh që mbartin në vetvete, demokracia dhe institucionet demokratike në raport me krimin e organizuar transnacional Shqipëri- Kosovë. Gjithashtu, përgjigjet e provuara të këtyre pyetjeve kërkimore e provojnë hipotezën e studimit se: Siguria kombëtare dhe funksionaliteti i institucioneve demokratike të Shqipërisë dhe Kosovës mbeten të kushtëzuara nga parandalimi, goditja dhe lufta kundër krimit të organizuar trans-nacional dhe anasjelltas niveli i krimit të organizuar është në përpjestim të drejtë me shkallën e brishtësisë së institucioneve demokratike dhe të sigurisë. Kapitulli që vijon, paraqet veprimtaritë kriminale të organizuara më të përhapura, në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën e Kosovës.

KAPITULLI IV:

SFIDAT KRYESORE TË SIGURISË NË SHQIPËRI DHE NË KOSOVË

4.1 Hyrje.

Një nga pyetjet kërkimore bazë që studimi ngre ka të bëjë me problemet më serioze dhe sfidat kryesore të sigurisë në Shqipëri dhe Kosovë, pyetje këto në kontekstin e objektit të studimit. Synimi është për të provuar lidhjen dhe ndikimin që mbartin në vetvete, siguria kombëtare dhe sfidat e saj në raport me krimin e organizuar transnacional Shqipëri-Kosovë. Kjo pyetje kërkimore për secilin nivel të analizës krahasimore lidhet edhe me hipotezën e studimit “Siguria kombëtare dhe funksionaliteti i institucioneve demokratike të Shqipërisë dhe Kosovës mbetet e kushtëzuar nga parandalimi, goditja dhe lufta e krimit të organizuar trans-nacional”. Prandaj, ky kapitull synon të trajtojë disa aspekte si: dokumentat e strategjisë së sigurisë kombëtare Shqipëri, Kosovë dhe dokumenta të tjerë të rëndësishëm; sfidat dhe specifikat e sigurisë për secilin vend; analizë-krahasuese mbi bazën e përgjigjeve të pyetësorëve me politikanë, e ekspertë të sigurisë, drejtësisë dhe të studentëve të anketuar; dhe sfidat e sigurisë me bazë burimet e brendshme, dhe ndikimin e faktorëve të jashtëm.

4.2 Dokumenti Strategjia e Sigurisë Kombëtare e Republikës së Shqipërisë, 2014, në kontekstin e funksionimit të institucioneve demokratike, të sigurisë kombëtare dhe krimit të organizuar transnacional në Shqipëri.

Sipas dokumentit Strategjia e Sigurisë Kombëtare e Republikës së Shqipërisë të vitit 2014,⁵¹ klasifikimi i rreziqeve është bërë duke shqyrtuar dy parametra kryesorë: gjasat e shfaqjes së rrezikut dhe pasojat që mund të shkaktojnë për sigurinë kombëtare. Në bazë të kombinimit të këtyre dy parametrave rreziqet janë klasifikuar në tre nivele. Në nivelin e parë janë grupuar rreziqet që kanë gjasa të larta shfaqjeje dhe pasoja të larta në rast se

⁵¹ Dokumenti Strategjia e Sigurisë Kombëtare e Republikës së Shqipërisë u miratua nga Kuvendi i Shqipërisë në Tiranë, në qershor 2014.

materializohen. Në nivelin e dytë janë grupuar rreziqet të cilat ndërthurin gjasa të ulëta dhe pasoja të larta. Në nivelin e tretë janë grupuar rreziqet që kanë gjasa të ulëta shfaqjeje dhe pasoja më të kufizuara. Këto përfundime janë arritur duke analizuar edhe dobësitë strukturore dhe institucionale që ndikojnë më së shumti në aftësinë tonë për tu përballur me këto rreziqe. Rreziqet e nivelit të parë kanë prioritetin më të lartë për sigurinë e Republikës së Shqipërisë. Gjasat e shfaqjes dhe pasojat e tyre për sigurinë kombëtare vlerësohen të larta. Rreziqet e nivelit të parë janë: • Korrupsioni dhe krimi i organizuar; • Kriza energjetike, që kërcënon sigurinë e furnizimit të RSH-së dhe cenon rritjen ekonomike; • Mangësitë në kontrollin dhe administrimin e territorit, që kërcënojnë sigurinë individuale dhe favorizojnë trafiket e ndryshme; • Sulmet kibernetike nga aktorë shtetërorë ose jo shtetërorë; • Degradimi mjedisor dhe fatkeqësitë natyrore; shkatërrimi i mjedisit, shpyllëzimi, ndotja e lumenjve dhe fatkeqësitë natyrore industriale apo të shkaktuara nga ndikimi i njeriut.

Pra, korrupsioni dhe krimi i organizuar janë klasifikuar rreziku i parë në Rreziqet e nivelit të parë, dhe Rreziqet e nivelit të parë sipas këtij dokumenti kanë prioritetin më të lartë për sigurinë e Republikës së Shqipërisë.

4.3 Sfidat kryesore të sigurisë në Shqipëri.

Siguria është çështje e të gjithë qytetarëve, shteteve dhe institucioneve ndërkombëtare. Siguria merr një rëndësi të veçantë dhe shumë të rëndësishme për Shqipërinë aktualisht edhe si vend anëtar i NATO-s. Dr. Alfred Moisiu, Presidenti i Republikës së Shqipërisë (2002-2007) shprehet se sfidat kryesore të Sigurisë në Shqipëri janë gjashtë:

“1. zgjidhja e problemeve me Greqinë; 2. çështja e kufirit detar, heqja e ligjit të luftës; 3. zgjidhja e problemit të Çamërisë; 4. lufta kundër krimit të organizuar; 5. rritja e nivelit të standarteve evropiane të Policisë së Shtetit e institucioneve të tjera ligjbatuese; dhe 6. problemi i gjakmarrjes, vrasjeve dhe grumbullimit të armatimit.”⁵²

Ndërsa, juristi dhe politikani Ylli Manjani shprehet se:

“Ekonomia e dobët sjell vasalitet ndaj cilitdo që paguan. Pozita e një shteti ekonomikisht të dobët është shumë e dobët si ndaj shteteve më të forta, ashtu edhe ndaj grupeve kriminale;

⁵² Intervista është marrë nga autori në Tiranë me datën 18.12.2015.

varfëria e lartë rrit ekspozimin ndaj çdo rrisht që përdor paranë për të vepruar; korrupsioni masiv, endemik, bën të shitshëm çdo gjë publike; dhe niveli shumë i ulët i strukturave të sigurisë kombëtare, dhe keqpërdorimi i tyre për interes politik. psh ushtria ende përdoret për të mbledhur mbetjet urbane....⁵³

Ministri i Drejtësisë (2005-2007), dr.Aldo Bumçi shprehet se krimi i organizuar dhe terrorizmi janë dukuritë më shqetësuese në planin e krimit transnacional. Gjithashtu, ekstremizmi fetar dhe fundamentalizmi është një fenomen problematik.⁵⁴ Ndërsa, dr.Illir Panda Ministri i Drejtësisë (1999-2000) dhe Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (2003-2007), shprehet se: *“Shqipëria ka një sfidë. Sfidat është fundamentalizmi dhe bllokimi i elementëve terroriste dhe nxitjes së fundamentalizmit me kahje nga terrorizmi.”*⁵⁵ Dr. Ilir Kulla shprehet se: *”Ekonomia, varfëria, krimi, droga, korrupsioni, ekstremizmi politiko-fetar.”*⁵⁶ Sipas gazetarit të njohur Ferdinand Dervishi *”krimi i organizuar dhe trafiku i drogave janë operacione politike të simuluar me qëllim marrjen e pushtetit pa shkuar në kutitë e votimit....”*⁵⁷. Sipas dr. Florian Qehaja, Drejtor i Qendrës për Studime të Sigurisë (QKSS) Kosovë

*“Në pesë vitet e ardhshme ekzistojnë tre sfida kryesore për Republikën e Shqipërisë:1. Jostabiliteti politik; këtu mendoj në përplasjet e vazhdueshme ndër-politike si dhe implikimet në jetën shoqërore, institucionale si dhe në integrimet evropiane;2. Krimi i organizuar; këtu mendoj në forma të ndryshme të krimit të organizuar të cilat janë të ndërlidhura me politikën dhe individë të fuqishëm. Krimi i organizuar ndërlidhet edhe me korrupsionin endemik i cili vazhdon të përbëjë sfidë për Shqipërinë; 3. Dallimet sociale e ekonomike: këtu mendoj në rritjen e hendekut mes të varfërve dhe të pasurve si dhe mundësia e mobilizimit shoqëror në formë të pakënaqësive të ndryshme, dhe si rrjedhojë e këtyre dallimeve.”*⁵⁸

PhD Walter Schwimmer, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës (1999-2004), në lidhje me pyetjen cilat janë sfidat kryesore që kërcënojnë Sigurinë kombëtare të Republikës së Shqipërisë, shprehet se: *“Do ti referohem sërish përgjigjes së parë. Në qoftë se qeveria përceptohet nga popullsia se nuk ka respektuar ligjin, sidomos në qoftë se kjo*

⁵³ Intervistë e marrë nga autori me datën 7.10.2015.

⁵⁴ Intervista është marrë nga autori në Tiranë me datën 16.2.2016.

⁵⁵ Intervista është marrë nga autori në Tiranë me datën 26.11.2015.

⁵⁶ Dr.Illir Kulla, Ekspert dhe Analist i çështjeve të sigurisë kombëtare dhe rajonale. Intervista është marrë nga autori në Tiranë me datën 25.11.2015.

⁵⁷ Ferdinand Dervishi, Gazetar i mirënjohur, analist, botues, kryeredaktor TV ABC NEWS. Intervista është marrë nga autori në Tiranë me datën 22.11.2015.

⁵⁸ Intervista është marrë nga autori në Prishtinë me datën 15.11.2015.

mungesë e respektit ndikon individët, atëherë as individi nuk do t'a respektojë ligjin. Kjo është rruga për në anarki. ⁵⁹”

Mbi bazën e përgjigjeve të pyetjeve të pyetësorit për sfidat kryesore të Sigurisë në Shqipëri në tabelën 4.1 në mënyrë tabelare rezulton se, në total të pyeturit janë përgjigjur për 15 sfida kryesore të sigurisë në Shqipëri dhe konkretisht; sfida të krimit të organizuar dhe veprimtarive kriminale 19.5% ; terrorizmi ndërkombëtar, ekstremizmi politik dhe fetar 16.7%; korrupsioni dhe sfida të zhvillimit ekonomik 11.5%; situata gjeopolitike në Ballkanin Jug-Perëndimor 6.9%; sfida të zhvillimit të shtetit ligjor, destabiliteti dhe konfliktualiteti politik në vend dhe sfida sociale 4.6%; kapje e pushtetit, përmirësimi i strukturave, politikave dhe edukimit policor dhe ushtarak 3.4%; migrimi 2.3%; sfida të integritit dhe mosfunksionimi i institucioneve të ekonomisë në vend/nivel profesional dhe moral i ulët në administratë 1.7%,; informaliteti 1.1%, dhe të tjera 6.3%.


Përsnat publikë dhe politikë dhe ekspertët në Shqipëri përgjigjen se, sfida të krimit të organizuar dhe veprimtarive kriminale dhe terrorizmi ndërkombëtar, ekstremizmi politik dhe fetar 18.3%, korrupsioni 12.8%, sfida të zhvillimit ekonomik 10.1%, situata gjeopolitike në Ballkanin Jug-Perëndimor 7.3%, destabiliteti dhe konfliktualiteti politik në vend, përmirësimi i strukturave, politikave dhe edukimit policor dhe ushtarak dhe sfida sociale 4.6%, sfida të zhvillimit të shtetit ligjor, kapje e pushtetit, dhe sfida të integritit 2.8%.

Përsnat publikë dhe politikë dhe ekspertët në Kosovë përgjigjen se, sfida të krimit të organizuar dhe veprimtarive kriminale 21.2%, sfida të zhvillimit ekonomik 17.3%, terrorizmi ndërkombëtar, ekstremizmi politik dhe fetar 13.5%, situata gjeopolitike në Ballkanin Jug-Perëndimor 7.7%, korrupsioni, sfida të zhvillimit të shtetit ligjor, destabiliteti dhe konfliktualiteti politik në vend, kapje e pushtetit, migrimi dhe sfidat sociale 5.8%.

Ekspertët ndërkombëtarë përgjigjen se: sfida të krimit të organizuar dhe veprimtarive kriminale 19.5%, terrorizmi ndërkombëtar, ekstremizmi politik dhe fetar 16.7%, korrupsioni dhe sfida të zhvillimit ekonomik 11.5%, situata gjeopolitike në Ballkanin Jug-Perëndimor 6.9%, sfida të zhvillimit të shtetit ligjor, destabiliteti dhe

⁵⁹ Intervista është marrë nga autori me datën 27.11.2015.


konfliktualiteti politik në vend, dhe sfida sociale 4.6%, kapje e pushtetit, përmirësimi i strukturave, politikave dhe edukimit policor dhe ushtarak 3.4%.



Burimi: Pyetësi 1 “Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri-Kosovë, 2008-2015” (plotësuar nga personalitete publike dhe ekspertë të sigurisë e drejtësisë në Shqipëri, Kosovë dhe ekspertë ndërkombëtarë).Përpunim i Autorit (2016).

Figura 4.1 Sfidat kryesore të sigurisë në Shqipëri.

Pra, nga 15 sfida kryesore të sigurisë në Shqipëri, sfidat më kryesore janë: 1. Sfida të krimit të organizuar dhe veprimtarive kriminale 19.5%; 2. terrorizmi ndërkombëtar, ekstremizmi politik dhe fetar 16.7%; 3. Korrupsioni 11.5%; 4. sfida të zhvillimit ekonomik 11.5%; 5. situata gjeopolitike në Ballkanin Jug Perëndimor 6.9%; 6. sfida të zhvillimit të shtetit ligjor 4.6%; 7. Destabiliteti dhe konfliktualiteti politik në vend 4.6%.



Burimi: Përgjigjet e pyetësorit 2 “*Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri-Kosovë, 2008-2015*”. (plotësuar nga studentët e fakulteteve të Drejtësisë dhe të Sigurisë në Prishtinë dhe Tiranë). Përpunim i Autorit (2016).

Figura 4.2 Sfidat kryesore që çënojnë sigurinë kombëtare në Republikën e Shqipërisë (Anketimi i studentëve).⁶⁰

Sipas të dhënave të tabelës 4.3 dhe figurës 4.2 rezultojnë se për periudhën 2008-2015, janë evidentuar sfidat kryesore të sigurisë në Shqipëri, të cilat paraqiten më poshtë: 1. Sfida të krimit të organizuar dhe veprimtarive kriminale me 535 përgjigje ose 76%; 2. korrupsioni me 455 përgjigje ose 65%; 3. sfida të zhvillimit ekonomik me 206 përgjigje ose 29%; 4. destabiliteti dhe konfliktualiteti politik në vend me 189 përgjigje ose 27%; 5. sfida të zhvillimit të shtetit ligjor me 151 përgjigje ose 22%; 6. terrorizmi ndërkombëtar, ekstremizmi politik dhe fetar me 146 përgjigje ose 21%; 7. sfidat e integritetit me 83 përgjigje ose 12%.

Nga krahasimi i përgjigjeve të pyetësorëve të plotësuar nga politikanët dhe ekspertët e sigurisë, si dhe nga përgjigjet e anketimit të studentëve për sfidat kryesore të sigurisë kombëtare në Shqipëri, rezultojnë se, në rastin e parë janë evidentuar tre sfida; 1. Sfida të krimit të organizuar dhe veprimtarive kriminale; 2. terrorizmi ndërkombëtar, ekstremizmi politik dhe fetar; 3. Korrupsioni; 4. sfida të zhvillimit ekonomik; 5. situata gjeopolitike në Ballkanin Jug Perëndimor; 6. sfida të zhvillimit të shtetit ligjor; 7.

⁶⁰ Theksojmë se të anketuarit kanë patur të drejtën e më shumë se një përgjigje (deri në 3 mundësi përzgjedhje për secilën pyetje).

Destabiliteti dhe konfliktualiteti politik në vend. Ndërsa, anketimi i studentëve ka evidentuar këto shtatë sfida. 1. Sfida të krimit të organizuar dhe veprimtarive kriminale; 2. Korrupsioni; 3. sfida të zhvillimit ekonomik; 4. destabiliteti dhe konfliktualiteti politik në vend; 5. sfida të zhvillimit të shtetit ligjor; 6. terrorizmi ndërkombëtar, ekstremizmi politik dhe fetar; 7. sfidat e integritetit.

Pra, sfidat e sigurisë në Shqipëri që janë evidentuar nga 767 të anketuarit rezultojnë se janë: 1. Sfida të krimit të organizuar dhe veprimtarive kriminale; 2. terrorizmi ndërkombëtar, ekstremizmi politik dhe fetar; 3. korrupsioni; dhe 4. sfida të zhvillimit ekonomik.

4. 3.1 Gjykimi i ekspertëve në Shqipëri dhe Kosovë mbi sfidat kryesore të sigurisë-analizë krahasuese.

Në mënyrë tabelare mbi bazën e përgjigjeve të të pyeturve sipas pyetësorit 1, sfidat kryesore të sigurisë kombëtare në Shqipëri nga gjykimet e ekspertëve në Shqipëri dhe në Kosovë, si dhe ekspertët ndërkombëtarë, nga 15 sfida apo faktorë kryesorë të sigurisë në Shqipëri, rezultojnë se pesë janë sfidat apo faktorët kryesorë të sigurisë në Shqipëri. 1. sfida të krimit të organizuar dhe veprimtarive kriminale, sipas ekspertëve në Shqipëri me 18.3% dhe sipas ekspertëve në Kosovë me 21.2%, 2. terrorizmi ndërkombëtar, ekstremizmi politik dhe fetar me 18.3% dhe 13.5%, 3. korrupsioni me 12.8% dhe 5.8%, 4. sfida të zhvillimit ekonomik 10.1% dhe 17.3%, dhe 5. situata gjeopolitike në Ballkanin Jug -Perëndimor 7.3%, dhe 7.7%.

Dr. Bekim Podrimcaku shprehet se:


“Siguria ka të bëjë me edukimin, me arsimin e popullsisë. Edukimi, arsimimi është “power” fuqi. Arsimi është ABC⁶¹. Duhet të kenë zhvillim më të madh shkencat ekzakte. Duhet parë se nga çfarë burimesh vjen siguria, në Shqipëri dhe në Kosovë, përshembull nga energjëtika dhe duhen parashikuar prioritetet dhe masa të veçanta.”⁶¹”

⁶¹Dr. Bekim Podrimcaku, autor i cituar.

Ndërsa, Arne Stivs shprehet: “Korrupsioni dhe krimi i organizuar janë një faktor destabilizuar dhe një bllok pengues për t’u futur Shqipëria në Bashkimin Evropian.”⁶²”

Për ekspertin e sigurisë Shkelzen Rexhepi janë: “Sistemi i pakonsoliduar ekonomiko-shoqëror, aktiviteti i dendur i shërbimeve sekrete të shteteve të interesuara direkt për destabilitet dhe mungesa e kontrollit të territorit dhe depërtimi në nivele shqetësuese i organizatave kriminale terroriste dhe korrupsioni.”⁶³ Eksperti i sigurisë Fredi Agastra shprehet: “Krimi i organizuar, trafiket e paligjshme, droga, korrupsioni, kryesisht i sistemit të drejtësisë dhe administratës së lartë shtetërore dhe terrorizmi ndërkombëtar...”⁶⁴»

Në mënyrë grafike në grafikun 4.1 paraqiten sfidat kryesore të sigurisë në Shqipëri dhe krahasimi i gjykimeve të ekspertëve në Shqipëri dhe Kosovë.



Grafiku 4.1 Sfidat kryesore të Sigurisë në Shqipëri dhe krahasimi i gjykimeve të ekspertëve në Shqipëri dhe Kosovë.

Gjykimet e ekspertëve janë të përafërta në përcaktimin e 15 sfidave kryesore të Sigurisë në Shqipëri. Nga analiza krahasuese e përgjigjeve të dhëna rezultojnë se, pesë sfidat kryesore të sigurisë në Shqipëri janë: 1. sfida të krimit të organizuar dhe veprimtarive

⁶²Arne Stivs, ekspert i sigurisë ndërkombëtare, përgjegjës i këshillimit në Minisionin Policor të Bashkimit Evropian, MAPE, në Shqipëri, (1997-2001).


⁶³Drejtes Shkelzen Rexhepi, Oficer i Kontaktit i Policisë Shqiptare në Kosovë (2004-2008), Drejtues i Strukturave të Policisë së Shtetit, ekspert i sigurisë.

⁶⁴ Drejtues Fredi Agastra, ekspert i Sigurisë, Drejtues i strukturave qendrore në Policinë e Shtetit

kriminale; 2. terrorizmi ndërkombëtar, ekstremizmi politik dhe fetar; 3. Korrupsioni; 4. sfida të zhvillimit ekonomik dhe 5. situata gjeopolitike në Ballkanin Jug-Perëndimor. Për PhD Florian Qehaja në pesë vitet e ardhshme ekzistojnë tre sfida kryesore për Republikën e Shqipërisë:

“1. Jostabiliteti politik si rezultat i përplasjeve ndër-politike e implikimet në jetën shoqërore dhe institucionale; 2. Krimi i organizuar i ndërlidhur me politikën, individë të fuqishëm dhe korrupsionin endemik; 3. Dallimet sociale e ekonomike nëpërmjet rritjes së hendekut midis të varfërve dhe të pasurve paknaqësive dhe dallimeve sociale.”⁶⁵

Në mënyrë grafike në figurën 4.4 paraqitet krahasimi i qëndrimeve të të intervistuarve mbi problematikat kryesore të ngritura nga ndërkombëtarët.



Burimi: Pyetësori 1 “Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri-Kosovë, 2008-2015” (plotësuar nga personalitete publike dhe ekspertë të sigurisë e drejtësisë në Shqipëri, Kosovë dhe ekspertë ndërkombëtarë).Përpunim i Autorit (2016).

Figura 4.4 Krahasimi i qëndrimeve të të intervistuarve mbi problematikat kryesore të ngritura nga ndërkombëtarët.

Ekspertët ndërkombëtarë rendisin pesë problematikat kryesore: 1. sfida të krimit të organizuar dhe veprimtarive kriminale, me 23.1%, 2. korrupsioni me 23.1%, 3. terrorizmi ndërkombëtar, ekstremizmi politik dhe fetar, me 15.4%, 4. sfida të zhvillimit të shtetit ligjor 15.4% dhe migrimi 7.7%. Nga analiza krahasuese e përgjigjeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar, ekspertët në Shqipëri dhe në Kosovë rezulton se nga përgjigjet e dhëna nga ndërkombëtarët ka peshë më të madhe në përgjigjet e tyre për sfida të zhvillimit të shtetit ligjor dhe migrimin, ku përgjigjet e ekspertëve në Shqipëri kanë një peshë të ulët respektivisht 2.8% dhe 0% dhe nga ekspertët në Kosovë nga 5.8%.

⁶⁵ PhD Florian Qehaja, autor i cituar.

Në tabelën 4.4 pesha e nën faktorëve në përgjigjet e të intervistuarve për problematikat kryesore për institucionet demokratike dhe krimin e organizuar transnacional Shqipëri-Kosovë, 2008-2015, nga ekspertët në Shqipëri, Kosovë dhe ekspertët ndërkombëtarë, pasqyrohet se, nga 15 faktorë janë evidentuar 47 nënfaktorë të cilët evidentojnë një peshë të konsiderueshme të nënfaktorëve në përgjigjet e të intervistuarve.

Në faktorin *sfida të krimit të organizuar dhe veprimtarive kriminale*, janë evidentuar tre nënfaktorë dhe konkretisht: krimi i organizuar, me 13.8%, nga të cilët ekspertët në Kosovë dhe ekspertët ndërkombëtarë janë përgjigjur me 15.4% dhe ekspertët në Shqipëri me 12.8%, përhapja e krimit, rritja e trafikimit të njerëzve, emigrantëve, drogës, me 5.2%, nga të cilët ekspertët ndërkombëtarë janë përgjigjur me 7.7%, ekspertët në Kosovë me 5.8% dhe ekspertët në Shqipëri me 4.6%. Ndërsa, sulmet kibernetike, me 0.6% nga të cilët ekspertët në Shqipëri me 0.9%.

Në faktorin *terrorizmi ndërkombëtar, ekstremizmi politik dhe fetar*, janë evidentuar dy nënfaktorë dhe konkretisht terrorizmi ndërkombëtar, me 8.6%, nga të cilët ekspertët në Kosovë 9.6%, ekspertët në Shqipëri 8.3% dhe ekspertët ndërkombëtar 7.7%, përhapja dhe veprimtaria e ideologjive radikale fetare dhe politike (fondamentalizmit), me 8%, nga të cilët ekspertët në Shqipëri me 10.1%, ekspertët ndërkombëtar me 7.7% dhe ekspertët në Kosovë 3.8%.

Në faktorin *situata gjeopolitike në Ballkanin Jug-Perëndimor*, janë evidentuar katër nënfaktorë dhe konkretisht: situata gjeopolitike në Ballkanin Jug Perëndimor, me 2.9%, nga të cilët ekspertët në Kosovë 3.8% dhe ekspertët në Shqipëri 2.8%, zgjidhja e çështjeve me Greqinë (Çamëria, kufijtë detar, ligji i luftës) me 1.7%, nga të cilët ekspertët në Kosovë 3.8% dhe ekspertët Shqiptarë me 0.9%, politikat dhe interesat jomiqësore të vendeve fqinjë, me 1.1%, cënimi i integritetit territorial, me 1.1%.

Në faktorin *sfida të zhvillimit të shtetit ligjor*, janë evidentuar katër nënfaktorë dhe konkretisht; shteti ligjor, me 1.7%, mungesa e ndarjes së pushteteve, me 0.6%, mosrespektimi i ligjit nga qeveria, me 1.1%, ndikimi i politikës në rend dhe ligj, me 1.1%.

Në faktorin *sfida të zhvillimit ekonomik*, janë evidentuar gjashtë nënfaktor dhe konkretisht papunësia, me 1.7%, varfëria e popullsisë, me 3.4%, ekonomia e dobët e vendit,

me 3.4%, zhvillimi i ulët ekonomik i viteve të fundit, 1.7%, përmirësimi i klimës së biznesit, me 0.6%, paaftësia konkurruese e vendit, me 0.6%.

Në faktorin *destabiliteti dhe konfliktualiteti politik në vend*, janë evidentuar tre nënfaktorë. Destabiliteti dhe mungesa e konsensusit politik, me 2.9%, mungesa e bashkëveprimit të palëve, me 1.1%, sistem i pakonsoliduar politik-ekonomik, me 0.6%.

Në faktorin *përmirësimi i strukturave, politikave dhe edukimit policor dhe ushtarak*, janë evidentuar katër nënfaktorë dhe konkretisht nivele të ulëta të strukturës së Sigurimit Kombëtar, me 1.1%, rritja e nivelit të standarteve evropiane të Policisë së Shtetit, me 0.6%, mungesa e përgatitjes ushtarake të popullsisë dhe e politikave ushtarake të vendit, me 1.1%, mungesa e hartimit dhe zbatimit të politikave të sigurisë, me 0.6%.

Në faktorin *sfida sociale*, janë evidentuar katër nënfaktorë dhe konkretisht konfliktet sociale dhe mungesa e barazisë, me 1.7%, përmirësimi i sektorëve të arsimit dhe shëndetësisë, me 1.1%, mungesë e politikave shëndetësore dhe arsimore cilësore, me 0.6%, gjakmarrja, me 1.1%.

Në faktorin *mos funksionimi i institucioneve të ekonomisë në vend në nivel profesional dhe moral i ulët në administratë*, janë evidentuar dy nënfaktorë; mosfunksionimi i institucioneve të ekonomisë në vend, me 0.6%, niveli profesional dhe moral i ulët në administratë, me 1.1%.

Në faktorin *të tjera*, janë evidentuar nëntë nënfaktorë dhe; sistemi energjitik dhe varësia nga tregjet ndërkombëtare, mediat sociale si rrisht i shpërndarjes së informacionit, degradimi i mjedisit dhe ndotja, siguria ushqimore, rreziqet me origjinë natyrore, procese zgjedhore të manipuluar, sfidat ushtarake, me 0.6%, si dhe rregjimi i pronës, dhe revoltat qytetare, me 1.1%.

4.4 Sfidat specifike të sigurisë në Kosovë.

Duke qënë se Kosova është shtet i ri i sapo dalë nga lufta, i qeverisur nga UNMIK-^u nga qershori i vitit 1999, dhe pas fillim ndërtimit të shtetit të pavarur pas shpalljes së Pavarësisë me 17 Shkurt 2008, manifeston mjaft probleme që lidhen me sigurinë dhe sfidat kryesore që rrjedhin prej saj. Disa prej të cilave janë:

1. Sfida e marrëdhënieve me shtetin Serb dhe impakti në vend;
2. Sovraniteti territorial i vendit;
3. Sfida e konsolidimit të demokracisë dhe shtetformimit;
4. Sfida e krimit të organizuar dhe veprimtarive kriminale;
5. Sfida të zhvillimit ekonomik e social;
6. Shtetformimi demokratik dhe pjekuria e klases politike;
7. Destabiliteti dhe konfliktualiteti politik në vend, etj.

4.4.1 Dokumenti Strategjia e Sigurisë Kombëtare e Republikës së Kosovës, 2014, në kontekstin e funksionimit të institucioneve demokratike, të sigurisë kombëtare dhe luftës ndaj krimit të organizuar transnacional në Kosovë.

Sipas dokumentit të Analizës së Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë së Republikës së Kosovës, mars 2014,⁶⁶ midis të tjerave trajtohet mjedisi global i sigurisë (seksioni 4.2), mjedisi rajonal i sigurisë (seksioni 4.3) dhe mjedisi i brendshëm i sigurisë (seksioni 4.4) ku trajtohet rreziku i krimit të organizuar (pika 4.4.5), korrupsionit (pika 4.4.6), kërcënimet jo-konvencionale (seksioni 4.5), armët e shkatërrimit në masë (pika 4.5.1), terrorizmi (pika 4.5.2), krime kibernetike (4.5.3), armët e dëmtimit në masë (pika 4.5.3) shpërndarja e armëve të vogla (pika 4.4.4), ekstremizmi (pika 4.4.3).

Në dokumentin e Analizës së Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë së Republikës së Kosovës, 2014, në pikën 4.4.5- krimi i organizuar shkruhet se: *“Një rrezik tjetër mund të jetë krimi i organizuar, i cili nuk është i kufizuar vetëm brenda territorit të Kosovës por është një problem transnacional/ndërshtetëror. Si i tillë kërcënon dhe dëmton sundimin e ligjit dhe perspektivën e zhvillimit ekonomik në Kosovë”*. Ndërsa në pikën 4.4.6 Korrupsioni, shprehet se: *“Një rrezik tjetër është korrupsioni. Korrupsioni minon besimin*

⁶⁶Regullore (QRK) nr.42/2013 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Sekretariatit dhe Qendrën e Situatave të Këshillit të Sigurisë të Kosovës, është miratuar në mbledhjen e 162 të Qeverisë Republikës së Kosovës me vendimin nr.15/162 me datë 27.12.2013.

në institucionet publike dhe ndikon negativisht zhvillimin ekonomik dhe integrimin Euro-Atlantik”. Ndërsa në pikën 4.5.2. Terrorizmi shprehet se:

“Pozita gjeografike dhe aspiratat Euro-Atlantike dhe bashkëpunimi i ngushtë me vendet që janë pjesë të organizatave Euro-Atlantike e bënë Kosovën të cënueshme ndaj terrorizmit. Kosova konsideron terrorizmin dhe aktet e terrorizmit jo vetëm si një rrezik dhe kërcënim ndaj vetvetes por edhe ndaj miqve dhe aleatëve të saj. Republika e Kosovës është e gatshme dhe bënë përpjekje të bashkëpunoj me të gjitha vendet për të parandaluar dhe zvogëluar terrorizmin ndërkombëtar dhe aktivitetet terroriste”.

Kosova manifeston probleme dhe kërcënime që lidhen me sigurinë dhe sfidat kryesore që rrjedhin prej saj. Kërcënimet dhe rreziqet në Kosovë janë të shumëllojshme. Kështu, sipas QKSS:

“Cënimi i integritetit territorial të Republikës së Kosovës paraqet një ndër rrezikshmëritë të nivelit të lartë. Aktiviteti i strukturave paralele serbe në veri të lumit Ibër si dhe mungesa e qasjes së institucioneve të Kosovës në 18% të territorit shtrun nevojën e analizimit të situatës në baza periodike. Kjo sidomos kur merret parasysh fakti i kontrabandës së gjerë në këtë pjesë të territorit e që po dëmton buxhetin e Kosovës.”⁶⁷

Ernst Florian Winter shprehet se:

“Kosova është pjesë e zonës Jugore të Europës Qendrore. Ballkani Perëndimor është një emërtim i gabuar. Mjedisi gjeopolitik i Europës qendrore është lënë pas dore, si nga Kombet e Bashkuara, ashtu edhe nga Bashkimi Europian. Parakushti i sigurisë së qytetarëve dhe përfaqësimit të interesave të tyre është që një shtet, të jetë shtet sovran, por edhe funksional.” (Ernst Florian Winter, 2007: 25).

Nga intervista me Dr. Bajram Rexhepi, në lidhje me pyetjen: ”Si mendoni në lidhje me ndikimin më pozitiv të institucioneve shtetërore, për zbatimin e ligjit dhe luftën ndaj krimit të organizuar e trafiqeve ndërkufitare në pjesën veriore të Mitrovicës”? Ai shprehet që *de jure* Veriu i përket Kosovës, por *de facto* është i lidhur me Serbinë, gjë që i ka hapur rrugë krimit të organizuar nacional dhe krimit të organizuar transnacional.⁶⁸

Sfidat kryesore të sigurisë në Kosovë për doktorant Rrahman Sulejmani janë: *”Ekstremizmi Islam, mos shtrirja e sovranitetit në tërë territorin e Republikës së Kosovës, mungesa e sundimit të ligjit, papunësia dhe korrupsioni në institucione të larta të shtetit”*⁶⁹

Për Kujtim Bytyqin, janë: *“korrupsioni, krimi i organizuar; trafikimi i narkotikëve dhe*

⁶⁷Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) Kosovë “Vlerësim i rëndësisë së Këshillit të Sigurisë së Kosovës në sektorin e Sigurisë” Prishtinë, Dhjetor 2008, faqe 6.


Web-faqja: www.qkss.org

⁶⁸Intervista është marrë nga autori në Mitrovicën e Veriut në Kosovë me datën 23.01.2016 .

⁶⁹ PhD Kandidat, Kolonel Rrahman Sulejmani, Drejtor i Departamentit për Polici Kriminale në Policinë e Kosovës (2005- 2009), ekspert i sigurisë .

terrorizmi”.⁷⁰ Ndërsa, Besnik Gjaka shprehet se:”sfidat kryesore të sigurisë Kombëtare në Kosovë, janë; “Mungesa e institucioneve të konsoliduara, fragmentarizimi politik dhe përbërja multietnike e popullatës me armiqtë të zhvilluar historike.”⁷¹ Për Gjeneral Reshat Maliqin sfidat specifike të sigurisë në Kosovë janë: “Migrimi, terrorizmi, krimi i organizuar, korrupsioni dhe ndikimi i politikës në rend dhe ligj.”⁷²”

Më poshtë, paraqitet tabela 4.5 sfidat kryesore specifike të Sigurisë në Kosovë.



Burimi: Pyetësi 1 *Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri-Kosovë, 2008-2015* (plotësuar nga personalitete publike dhe ekspertë të sigurisë e drejtësisë në Shqipëri, Kosovë dhe ekspertë ndërkombëtarë). Përpunim i Autorit (2016).

Figura 4.5 Sfidat kryesore specifike të sigurisë në Kosovë.

⁷⁰Doktorant Kujtim Bytyçi, analist për Politikën e Sigurisë në Republikën e Kosovës, ekspert i sigurisë në Kosovë.

⁷¹ Besnik Gjaka, hulumtues në fushën e krimit të organizuar në Prishtinë.

⁷²PhD Kandidat, Gjeneral Reshat Maliqi Drejtor i Pergjithshëm i Policisë Kosovë 2010-2011, Drejtor i Analizës së Planifikimit Strategjik e Juridik në Drejtorinë e Policisë Kosovë, Profesor i lëndës kriminalistike në Kolegjin Gjilan.

Sipas të dhënave të paraqitura nga ekspertët në Shqipëri, ekspertët në Kosovë dhe ekspertët ndërkombëtarë, rezulton se janë evidentuar 17 sfida apo faktorë kryesorë të sigurisë në Kosovë.

Sfida e parë, është *ekstremizmi fetar dhe politik*, me 14.4%, nga të cilët ekspertët ndërkombëtarë 16.7%, ekspertët në Shqipëri 15.9% dhe ekspertët në Kosovë 11.5%.

Sfida e dytë, është *sfida e marrëdhënieve me shtetin serb dhe impakti në vend*, me 13.8%, nga të cilët ekspertët në Shqipëri 13.8%, ekspertët ndërkombëtarë 11.1% dhe ekspertët në Kosovë 9.8%.

Sfida e tretë, është *korupsioni*, 11.4%, nga të cilët ekspertët ndërkombëtarë 22.2%, ekspertët në Shqipëri 10.2% dhe ekspertët në Kosovë 9.8%.

Sfida e katërt, është *sfida të zhvillimit ekonomik*, 9.6%, nga të cilët ekspertët në Kosovë 11.5%, ekspertët në Shqipëri 9.1% dhe ekspertët ndërkombëtarë 5.6%.

Sfida e pestë, është *terrorizmi ndërkombëtar*, 9%, nga të cilët ekspertët në Shqipëri 10.2%, ekspertët në Kosovë 8.2% dhe ekspertët ndërkombëtarë 5.6%.

Sfida e gjashtë, është *sfida të krimit të organizuar dhe veprimtarive kriminale*, 8.4%, nga të cilët ekspertët në Shqipëri 10.2% dhe ekspertët në Kosovë 8.2%.

Sfida e shtatë, është *sovrانيتi territorial i vendit*, 8.4%, nga të cilët ekspertët në Kosovë 14.8% dhe ekspertët në Shqipëri 5.7%.” Bazuar në të dhënat në dispozicion të Policisë së Kosovës që nga viti 1999 e deri tani, vetëm në veri të Kosovës janë vrarë 32 persona, ka pasur rreth 150 raste të sulmeve me mjete shpërthyes dhe armë të zjarrit, rreth 751 vetë të plagosur, është bërë shkatërrimi i pikave të kalimit kufitar Jarinjë dhe Bërnjak, sulme ndaj objekteve të gjykatave në veri të Mitrovicës, sulme ndaj objekteve të stacioneve policore, vrasje e një anëtari të njësisë speciale të UNMIK-ut, vrasje e oficerit të Policisë së Kosovës, sulme mbi KFOR-in, sa për të përmendur disa.⁷³”


Ndërsa, edhe figura 4.5 paraqet sfidat kryesore specifike të sigurisë në Kosovë, dhe rezulton se, janë evidentuar shtatë sfida apo faktorë kryesorë të Sigurisë në Kosovë. Sfida e

⁷³Policia e Kosovës Raport Vlerësimi i Kërcënimit të Krimit Serioz dhe Krimit të Organizuar 2013, faqe 21.

parë, është ekstremizmi fetar dhe politik, me 14.4%. Sfida e dytë, është sfida e marrëdhënieve me shtetin serb dhe impakti në vend. Sfida e tretë, është korrupsioni. Sfida e katërt, sfida të zhvillimit ekonomik. Sfida e pestë, është “terrorizmi ndërkombëtar”. Sfida e gjashtë, është sfida të krimit të organizuar dhe veprimtarive kriminale, dhe sfida e shtatë, “sovrانيتeti territorial i vendit. Mirëpo, koncepti i sigurisë bazohet prej rrezikimit nga armiku, është një strategji e vjetër sa vetë njerëzimi dhe është një mjet që vazhdon të jetë në shërbim të pushtetit. (Bekim Baliqi, 2010: 24).

“Në aspektin e sigurisë vlen parimi, sipas të cilit nëse arrini që të keni një komunikim të shëndoshë dhe mirëkuptim shkalla e sigurisë do të jetë shumë më e lartë, pasi me këtë krijohen më shumë miq në vend të armiqve. Prandaj, marrëdhëniet me njerëzit, marrëdhëniet me publikun, sjelljet njerëzore nuk janë një rrugë njëdrejtimëshe, por e dyanshme ku kërkohet dialogu në vend të monologut”. (Bekim Baliqi, 2010: 46).

Identifikimi dhe analizimi i sfidave kryesore të sigurisë në Kosovë nëpërmjet përgjigjeve të pyetjeve pyetësorit 1 dhe intervistave të thelluara të personave publikë, politikë dhe ekspertëve të sigurisë në Shqipëri në Kosovë dhe ekspertëve ndërkombëtarë është paraqitur një panoramë e qartë e këtyre sfidave të sigurisë në Kosovë.



Burimi: Pyetësori 2 *Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri- Kosovë, 2008-2015*”. (plotësuar nga studentët e fakulteteve të Drejtësisë dhe të Sigurisë në Prishtinë dhe Tiranë). Përpunim i Autorit (2016).

Figura 4.6 Sfidat kryesore që çënojnë sigurinë kombëtare në Republikën e Kosovës (anketimi i studentëve).⁷⁴

⁷⁴ Theksojmë se të anketuarit kanë patur të drejtën e më shumë se një përgjigje (deri në 3 mundësi përzgjedhje për secilën pyetje).

Sipas të dhënave të tabelës 4.6 dhe figurës 4.6 rezulton se për periudhën 2008-2015, janë evidentuar këto sfidat kryesore të sigurisë kombëtare në Kosovë: 1. Sfida e marrëdhënieve me shtetin Serb dhe impakti në vend me 493 përgjigje ose 70%; 2. Sovraniteti territorial i vendit me 254 përgjigje ose 36%; 3. Korrupsioni me 217 përgjigje ose 31%; 4. Ekstremizmi fetar dhe politik me 191 përgjigje ose 27%; 5. sfida të krimit të organizuar dhe veprimtarive kriminale me 175 përgjigje ose 25%; 6. sfida të zhvillimit ekonomik me 161 përgjigje ose 23%; 7. destabiliteti dhe konfliktualiteti politik në vend me 105 përgjigje ose 15%; 8. Sfida të kequshtrimit të pushtetit me 92 përgjigje ose 13%; 9. sfida të konsolidimit të demokracisë dhe shtetformimit me 89 përgjigje ose 13%, etj.

Nga krahasimi i përgjigjeve të pyetësorëve të plotësuar nga politikanët dhe ekspertët e sigurisë, si dhe nga përgjigjet e anketimit të studentëve për problematikat më serioze të demokracisë në Shqipëri, rezulton se, në rastin e parë janë evidentuar, sfidat kryesore të sigurisë: 1. ekstremizmi fetar dhe politik, 2. sfida e marrëdhënieve me shtetin serb dhe impakti në vend, 3. korrupsioni, 4. sfida të zhvillimit ekonomik, 5. terrorizmi ndërkombëtarë, 6. sfida të krimit të organizuar dhe veprimtarive kriminale, 7. sovraniteti territorial i vendit. Ndërsa, anketimi i studentëve ka evidentuar këto sfida: 1. Sfida e marrëdhënieve me shtetin Serb dhe impakti në vend; 2. Sovraniteti territorial i vendit; 3. Korrupsioni; 4. Ekstremizmi fetar dhe politik; 5. sfida të krimit të organizuar dhe veprimtarive kriminale; 6. sfida të zhvillimit ekonomik ; 7. destabiliteti dhe konfliktualiteti politik në vend.

Pra, sfidat e sigurisë kombëtare në Kosovë që janë evidentuar nga 767 të anketuarit rezulton se janë: 1. Sfida e marrëdhënieve me shtetin serb dhe impakti në vend; 2. Sovraniteti territorial i vendit; 3. ekstremizmi fetar dhe politik, 4. korrupsioni, 5. sfida të krimit të organizuar dhe veprimtarive kriminale; 6. sfida të zhvillimit ekonomik.

Nga analiza krahasuese e disa përgjigjeve të dhëna për disa sfida, evidentohet se, përceptimi i studentëve të anketuar ka përcaktuar sfidën e parë -sfida e marrëdhënieve me shtetin Serb dhe impakti në vend me 70%; 2. Sovraniteti territorial i vendit me 36%; ndërkohë që politikanët dhe ekspertët e rendisin sfidën e dytë me 13.8%, ekspertët në Shqipëri 13.6%, ndërkombëtarët 11.1% dhe ekspertët në Kosovë 9.8%. Ndërsa, sovraniteti territorial i vendit vlerësohet sfida e shtatë me 8.4%, nga të cilët ekspertët në Kosovë 14.8%

dhe ekspertët në Shqipëri 5.7%. Ndërkohë, studentët ekstremizmi fetar dhe politik e rendisin sfidën e katërt, ndërsa politikanët dhe ekspertët e rendisin sfidën e parë.

Nga analiza krahasuese e sfidave kryesore të sigurisë në Shqipëri me sfidat kryesore të sigurisë në Kosovë, rezulton se në Shqipëri që nga 767 të anketuarit janë evidentuar : 1. Sfida të krimit të organizuar dhe veprimtarive kriminale; 2. terrorizmi ndërkombëtar, ekstremizmi politik dhe fetar; 3. korrupsioni; dhe 4. sfida të zhvillimit ekonomik.

4.4.2 Gjykimi i politikanëve dhe ekspertëve në të dy vendet mbi sfidat specifike të sigurisë në Kosovë -analizë krahasuese.

Sfidat kryesore të sigurisë në Kosovë dhe gjykimi i ekspertëve në të dy vendet mbi sfidat specifike të sigurisë në Kosovë -analizë krahasuese, paraqitet në tabelën 4.7, dhe në grafikun 4.2.

Në mënyrë tabelare dhe grafike nga analiza krahasuese e gjykit të ekspertëve në Shqipëri dhe në Kosovë rezulton se janë evidentuar 17 sfida kryesore. Sfida kryesore për ekspertët në Shqipëri për gjendjen e Sigurisë në Kosovë janë: 1.Sfida e parë, është “sfidat e marrëdhënieve me shtetin serb dhe impaktit në vend” me 17%; 2. Sfida e dytë, është ekstremizmi fetar dhe politik, me 15.9%; 3. Sfida e tretë, është sfida të krimit të organizuar dhe veprimtarive kriminale,10.2%. 4. Sfida e katërt, është terrorizmi ndërkombëtar, me 10.2%; 5. Sfida e pestë, është korrupsioni, me 10.2%; 6. Sfida e gjashtë, është sfida të zhvillimit ekonomik, me 9.1%; dhe 7. Sfida e shtatë, është sfida të konsolidimit të demokracisë dhe të shtetformimit, me 8%. Ndërsa, sfida kryesore për ekspertët në Kosovë për gjendjen e sigurisë në Kosovë janë:1. sovraniteti territorial i vendit, 14.8%; 2. ekstremizmi fetar dhe politik,11.5%; 3.Sfidat e zhvillimit ekonomik 11.5%; 4. Sfidat e marrëdhënieve me shtetin serb dhe impaktit në vend, 9.8%; 5. korrupsioni, 9.8%;6. terrorizmi ndërkombëtar, 8.2%; dhe 7. sfida të krimit të organizuar dhe veprimtarive kriminale, me 8.2%.

Nga krahasimi i gjykimeve të politikanëve dhe ekspertëve nga të dy vendet, të bie në sy fakti se sfidat e marrëdhënieve me shtetin serb dhe impaktit në vend, për ekspertët në Shqipëri është sfida e parë, ndërkohë që për ekspertët në Kosovë, kjo është sfida e katërt, por ndërkohë ekspertët në Kosovë kanë përcaktuar sfida të parë, sovraniteti territorial i

vendit, sfidë të cilën ekspertët në Shqipëri e kanë përcaktuar sfidën e tetë. Kjo sfidë lidhet me marrëdhëniet me shtetin serb dhe ka të bëjë me çështjen e Mitrovicës dhe është dhe mbetet shumë e rëndësishme për të ardhmen. Në lidhje me ekstremizmin fetar dhe politik ekspertët e dy shteteve e kanë përcaktuar si sfidën e dytë dhe këtu ata dakortësohen. Ekspertët dakortësohen edhe për sfidën e pestë, korrupsioni. Ekspertët në Kosovë, sfidat e zhvillimit ekonomik i konsiderojnë sfidën e tretë dhe më pas konsiderojnë sfida terrorizmin ndërkombëtar, krimi i organizuar dhe veprimtaritë kriminale, ndryshe nga ekspertët në Shqipëri që konsiderojnë sfidën e tretë sfida të krimit të organizuar dhe veprimtarive kriminale dhe terrorizmin ndërkombëtar. Gjithashtu, ekspertët në Shqipëri sfida të konsolidimit të demokracisë dhe të shtetformimit e shohin si sfidën e shtatë, ndërkohë që ekspertët në Kosovë e konsiderojnë sfidën e nëntë.

Profesor Fatmir Sejdiu shprehet që një pjesë serioze e krimit lidhet me investimet që bën Serbia për ta mbajtur Kosovën të destabilizuar për një periudhë të caktuar.⁷⁵ Ndërsa, sipas dr. Alfred Moisiu, sfidat kryesore që kërcënojnë Sigurinë Kombëtare të Republikës së Kosovës, janë tre: *“Së pari, zgjidhja e problemeve me Serbinë. Së dyti, përfshirja e Mitrovicës së Veriut në juridiksion e administrim të Kosovës, dhe së treti, forcimi luftës kundër krimit të organizuar e terrorizmit.”*⁷⁶. Sipas QKSS,

*“Cënimi i integritetit territorial të Republikës së Kosovës paraqet një ndër rrezikshmëritë të nivelit të lartë. Aktiviteti i strukturave paralele serbe në veri të lumit Ibër si dhe mungesa e qasjes së institucioneve të Kosovës në 18% të territorit shtron nevojën e analizimit të situatës në baza periodike. Kjo sidomos kur merret parasysh fakti i kontrabandës së gjerë në këtë pjesë të territorit e që po dëmton buxhetin e Kosovës.”*⁷⁷

Dr. Zef Preçi shprehet se: “Në Kosovë është herët për të folur për një sistem sigurie shtetëror, përse kohë nuk kemi sovranitet të plotë shtetëror.”⁷⁸ Ndërsa, Dr. Mentor Nazarko

⁷⁵ Intervista është marrë në Prishtinë me datën 11.12.2015.

⁷⁶ Intervista është marrë nga autori në Tiranë me datën 18.12.2015.

⁷⁷ Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) Kosovë “Vlerësim i rëndësisë së Këshillit të Sigurisë së Kosovës në sektorin e Sigurisë” Prishtinë, Dhjetor 2008, faqe 6.

Web-faqja: www.qkss.org

⁷⁸ Dr. Zef Preçi, autor i cituar.

mendon se kërcënimi kryesor vjen nga Serbia.⁷⁹ Nga intervista me Dr. Bajram Rexhepi, në lidhje me pyetjen:”Si mendoni në lidhje me ndikimin më pozitiv të institucioneve shtetërore, për zbatimin e ligjit dhe luftën ndaj krimit të organizuar e trafikeve ndërkufitare në pjesën veriore të Mitrovicës”? Ai shprehet që *de jure* Veriu i përket Kosovës, por *de facto* është i lidhur me Serbinë, gjë që i ka hapur rrugë krimit të organizuar nacional dhe krimit të organizuar transnacional.⁸⁰ Sipas studjueses Prof. asoc. Dr. Iva Zajmi tensionet në Kosovë janë rezultat i pakicave serbe, korrupsionit dhe ekstremizmit politik dhe fetar.⁸¹ Ndërsa, Dr. Aldo Bumçi i shton edhe problemet e ekstremizmit fetar në Kosovë, Maqedoni dhe Shqipëri.⁸² Dr. Ilir Panda, është i mendimit se sfida e fundamentalizmit ka të bëjë me bllokimin e elementëve terroristë dhe fundamentalistë në Kosovë, të cilët janë dyfishi i Shqipërisë.⁸³ Ndërsa, Juristi i njohur Prof. Dr. Ermir Dobjani, është i mendimit se terrorizmi islamik në Kosovë është përhapur për shkak të sektit vehabist.⁸⁴ PhD Abit Hoxha, ekspert i Sigurisë në Kosovë shprehet se:”*Veriu dhe strukturat e serbisë që funksionojnë në veri, radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm dhe mos-kontrollimi i kufirit.*⁸⁵”

Ernst Florian Winter shprehet se:”*Kosova është pjesë e zonës Jugore të Europës Qendrore. Ballkani Perëndimor është një emërtim i gabuar. Mjedisi gjeopolitik i Europës qendrore është lënë pas dore, si nga Kombet e Bashkuara, ashtu edhe nga Bashkimi Europian*”. (Ernst Florian Winter, 2007:25). “Parakusht i sigurisë së qytetarëve dhe përfaqësimit të interesave të tyre janë që një shtet të jetë shtet sovran, por edhe funksional” (Bekim Baliqi, 2010:23).

Statusi i ardhshëm i Kosovës u përcaktua në bazë të dokumentit të hartuar nga Ahtisaari, ish presidenti i Finlandës, i ngarkuar nga OKB-ja për të formuluar një opion të

⁷⁹Dr. Mentor Nazarko, autor i cituar.

⁸⁰ Intervista është marrë nga autori në Mitrovicën e Veriut në Kosovë me datën 23.01.2016.

⁸¹ Intervista është marrë nga autori në Tiranë me datën 22.12.2015.

⁸² Intervista është marrë nga autori në Tiranë me datën 16.2.2016.

⁸³ Intervista është marrë nga autori në Tiranë me datën 26.11.2015.

⁸⁴Prof. Dr. Ermir Dobjani, Avokat i Popullit 2000-2010 (dy mandate), Jurist i mirënjohur, pedagog në Universitetin Shtetëror dhe Universitete Private). Intervista është marrë nga autori në Tiranë me datën 10.11.2015.

⁸⁵ PhD Abit Hoxha, ekspert i sigurisë në Prishtinë.

hollësishëm dhe të argumentuar, që do të shërbente për të përcaktuar statusin përfundimtar të Kosovës. Kushtetuta parashikon që:


“Republika e Kosovës mund të marrë pjesë në sistemet e sigurisë ndërkombëtare me qëllim ruajtjen e paqes dhe mbrojtjen e interesave shtetërore (neni 2/3), por edhe parashikon që marrëveshjet ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Kosovës, bëhen pjesë e sistemit të brendshëm juridik dhe zbatohen në mënyrë të drejtëpërdrejtë, me përjashtim të rasteve kur nuk janë të vetëzbatueshme, çka do të kërkonte nxjerrjen e një ligji. Këto marrëveshje ndërkombëtare dhe normat juridikisht të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare kanë epërsi ndaj ligjeve të Republikës së Kosovës (neni 19, paragrafët 1 dhe 2).” (Luan Omari, 2008 :65).

Ndërsa, në nenin 20, parashikohet bartja ose transferimi i sovranitetit, sepse:

“Republika e Kosovës, në bazë të marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare, për çështje të caktuara, mund t’u kalojë kompetenca shtetërore organizatave ndërkombëtare”. “...pranohet parimi se dispozitat e marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara kanë epërsi mbi ligjet dhe aktet e tjera të Kosovës (por jo mbi Kushtetutën), në Nenin 143, përkundrazi, sanksionohet epërsia e dispozitave të propozimit gjithëpërfshirës edhe mbi vetë kushtetutën. (Luan Omari, 2008 : 65).

Ligji ndërkombëtar, marrëveshjet ndërkombëtare të analizuar janë për nga fuqia mbi dokumentet ligjore të brendshme. Ato janë mbi kushtetutat e këtyre vendeve.” (Mentor Nazarko, 2006:75).

Sfidat kryesore të sigurisë në Kosovë dhe krahasimi i gjykimeve të ekspertëve në Shqipëri dhe Kosovë, paraqiten në figurën 4.7.



Burimi: Pyetësori 1 “Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri-Kosovë, 2008-2015” (plotësuar nga personalitete publike dhe ekspertë të sigurisë e drejtësisë në Shqipëri, Kosovë dhe ekspertë ndërkombëtarë). Përpunim i Autorit (2016)

Figura 4.7 Krahasimi i qëndrimeve të të intervistuarve mbi problematikat kryesore të ngritura nga Ndërkombëtarët.

Nga krahasimi i gjykimeve të ekspertëve në Shqipëri dhe Kosovë vihet re dakortësimi për disa sfida si për shembull, sfida e dytë ekstremizmi fetar dhe politik dhe

sfida e pestë, korrupsioni. Ndërkohë, sfidat e tjera ekspertët shqiptarë në Shqipëri dhe Kosovë i shohin nga këndvështrime të ndryshme si: Sfidat e marrëdhënieve me shtetin serb dhe impaktit në vend. Ekspertët në Shqipëri e shohin sfidën e parë, por konsiderojnë sfidën e tetë sovraniteti territorial i vendit, ndërkohë që ekspertët në Kosovë e kanë konsideruar sfidën e parë.

Pra, këndvështrimet që kanë ekspertët në Kosovë janë më aktuale dhe të gjalla, për shkak të njohjes mirë të gjendjes se jetuar atje, ndërkohë që ekspertët në Shqipëri kanë një këndvështrim tjetër, ata mendojnë me *“fohtë”* dhe shprehen se sfidat e marrëdhënieve me shtetin serb dhe impaktit në vend, është sfida e parë dhe mesa duket nëpërmjet *“zgjidhjes”* së kësaj sfide zgjidhet edhe sovraniteti territorial i vendit. Mendohet se, nga njëra anë, prekja çdo ditë e problematikave me shtetin serb dhe pakicat serbe në Kosovë, dhe nga ana tjetër, *“plagët e rënda”* të luftës, gjenocidit dhe terrori serb mbi popullsinë shqiptare në Kosovë, ndonëse kanë kaluan 16 vjet nga çlirimi i Kosovës⁸⁶ nga NATO prej pushtuesve gjenocistë serbë, dhe 8 vjet nga krijimi i shtetit të pavarur të Kosovës,⁸⁷ përsëri për ekspertët në Kosovë kjo sfidë është sa e rëndësishme, aq edhe e vështirë për t’u zgjidhur pamvarësisht përpjekjeve të BE-së dhe SHBA-së. Arsyeja është e thjeshtë, ata i njohin serbët më mirë se shqiptarët në Shqipëri e trojet e tjera, si dhe më mirë se sa të huajt.

Ndërkohë, nga analizimi me vëmendje i të dhënave të grumbulluara nga përgjigjet e ekspertëve ndërkombëtarë të bie në sy evidentimi i 10 sfidave kryesore, nga të cilat ata rendisin sfidën e parë korrupsionin me 22.2%, sfidën e dytë, ekstremizmin fetar dhe politik, me 16.7%, për të vijuar me sfidat e marrëdhënieve me shtetin serb dhe impaktin në vend, destabiliteti dhe konfliktualiteti politik dhe prania e faktorit ndërkombëtar me 11.1% dhe për të vazhduar me sfidat e zhvillimit ekonomik, terrorizmi ndërkombëtar, sfidat e zhvillimit social, emigracioni dhe procesi i liberalizimit të vizave dhe integritimit në BE me 5.6%.

PhD Walter Schwimmer, në lidhje me pyetjen cilat janë sfidat kryesore që kërcënojnë sigurinë kombëtare të Republikës së Kosovës, shprehet se:

⁸⁶Republika e Kosovës u çlirua me datën 10 qershor 1999 nga ndërhyrja ushtarake dhe bombardimet për 78 ditë të forcave të NATO-s kundër pushtuesve serbë.

⁸⁷Me 17 Shkurt 2008 Kuvendi i Republikës së Kosovës, shpalli unanimitisht Pavarësinë e Republikës së Kosovës.

“Përderisa Bashkimi Evropian po lehtëson një dialog midis Kosovës dhe Serbisë nuk duket të jetë i angazhuar në ndonjë formë të monitorimit të veprimit për të siguruar që marrëveshjet e arritura janë kryer nga secila parti. Formalisht OKB^{ja} dhe tani BE^{ja} kanë dështuar dhe vazhdojnë të dështojnë për të shkëputur në punët e brendshme të shtetit. Kjo është e përbërë nga korrupsioni që përceptohet brenda këtyre institucioneve.”⁸⁸”

Ndërkohë, të bën përshtypje fakti i përgjigjeve të ekspertëve në Kosovë për praninë e faktorit ndërkombëtar dhe procesi i liberalizimit të vizave dhe integritit në BE, si dhe përgjigjeve të ekspertëve në Shqipëri për emigracionin dhe praninë e faktorit ndërkombëtarë që janë shprehur me përgjigjet 0%. Nga këto përgjigje, kuptohet këndvështrimi i jashtëm i ndërkombëtarëve, por konstatohet edhe këndvështrimi i brendshëm i ekspertëve në Kosovë dhe në Shqipëri të cilët mesa duket janë lodhur nga pritja e gjatë, pritshmëritë dhe qëndrimet hera herës të strukturave të BE^{së} në qëndrimet ndaj Serbisë. Dr. Alfred Moisiu, në konferencën ndërkombëtare për sigurinë dhe paqen në Ballkan” të zhvilluar në Tiranë, me 22 nëntor 2015” u shpreh se: *“BE^{ja} po ndjek një politikë favorizuese ndaj Serbisë.”⁸⁹*

Në tabelën 4.8 paraqitet krahasimi i qëndrimeve të të intervistuarve mbi problematikat kryesore të ngritura nga ndërkombëtarët. Nga paraqitja në mënyrë tabelare rezulton se nga 17 faktorë janë evidentuar 35 nënfaktorë të cilët evidentojnë një peshë të konsiderueshme të nënfaktorëve në përgjigjet e të intervistuarve.

Në faktorin *sfidat e marrëdhënive me shtetin serb dhe impaktin në vend*, janë evidentuar katër nënfaktorë: pengesat politike dhe çështjet e lidhura me Serbinë, me 10.8%, nga të cilët ekspertët në Shqipëri 14.8% dhe ekspertët në Kosovë 8.2%; situata gjeopolitike në Ballkanin Perëndimor, monitorimi i dialogut Kosovë-Serbi dhe marrëdhëniet ndëretnike.

Në faktorin *sfida të krimit të organizuar dhe veprimtarive kriminale*, janë evidentuar tre nënfaktorë: krimi i organizuar; kontrabandimi; dhe krimi ekonomik. Në faktorin sovraniteti territorial i vendit janë evidentuar dy nënfaktorë: integriteti dhe sovraniteti shtetëror në gjithë territorin dhe çështjet e lidhura me administrimin e Mitrovicës.

⁸⁸ Intervista është marrë nga autori me datën 27.11.2015.

⁸⁹ Dr. Alfred Moisiu, President i Republikës së Shqipërisë (2002-2007), Fjala e mbajtur në Konferencën ndërkombëtare për sigurinë dhe paqen në Ballkan, të organizuar nga Federata e Paqes Universale në Europë në bashkëpunim me Federatën e Paqes Univerasale në Shqipëri, Tiranë, 22 nëntor 2015.

Në faktorin *sfida të konsolidimit të demokracisë dhe të shtetformimit*, janë evidentuar tre nënfaktorë: procesi i pakonsoliduar i shtetformimit demokratik, me 3.6%, nga të cilët ekspertët në Shqipëri 5.7% dhe ekspertët në Kosovë 1.6%; të qëniet ende një shtet i dobët, 0.6%, nga të cilët ekspertët në Shqipëri 1.1%; njohja e shtetit të Kosovës në botë, 1.2%, nga të cilët ekspertët në Kosovë 1.6% dhe ekspertët në Shqipëri 1.1%.

Në faktorin *sfida të zhvillimit ekonomik* janë evidentuar katër nënfaktorë: zhvillimi i ekonomisë; kushtet e vështira ekonomike; papunësia; dhe informaliteti.

Në faktorin *proçesi i liberalizimit të vizave dhe integrimi në BE*, janë evidentuar dy nënfaktorë: integrimi në BE dhe liberalizimi i vizave.

Në faktorin *përmirësimi i strukturave, politikave dhe edukimit policor e ushtarak* janë evidentuar dy nënfaktorë: mungesa e ushtrisë së përgatitur dhe e politikave të mbrojtjes dhe forcimi i institucioneve të sigurisë kombëtare.

Në faktorin *sfidat e kequshtrimit të pushtetit* janë evidentuar dy nënfaktorë: përdorimi i dhunës shtetërore dhe ndikimi i politikës në rend dhe ligj.

Në faktorin, *sfida të zhvillimit social*, janë evidentuar pesë nënfaktorë: shëndetësia jocijësores; edukimi jocijësor; patriotizmi i njerëzve të fuqishëm; menaxhimi i medias sociale; dhe mungesa e perspektivës së të rinjëve.

Nga analizmi me vëmendje i krahasimit të qëndrimeve të të intervistuarve mbi problematikat kryesore të ngritura nga ndërkombëtarët për faktorin sfidat e marrëdhënieve me shtetin serb dhe impaktin në vend, ekspertët ndërkombëtarë për nënfaktorin monitorimi i dialogut Kosovë-Serbi, janë përgjigjur 11.1%, pra, ata e konsiderojnë shumë të rëndësishme zhvillimin e këtij dialogu dhe monitorimin e tij, ndërkohë që edhe për liberalizimin e vizave, ekspertët ndërkombëtarë shprehën me 5.6%.

Pra, këto përgjigje nga njëra anë, shprehin edhe një herë rëndësinë dhe peshën e zhvillimit të mëtejshëm të këtyre nënfaktorëve, dhe nga ana tjetër, kuptohet domosdoshmëria e ecjes me ritme më të shpejta dhe të sigurta në këtë drejtim në të ardhmen. Por ekspertët ndërkombëtarë nëpërmjet përgjigjeve me 5.6% të menaxhimit të medias sociale, vihet re se ata tërheqin vëmendjen se media sociale duhet menaxhuar më

mirë sepse për shoqërinë në Kosovë merr një rëndësi të veçantë. Ndërkohë, çështjet e lidhura me administrimin e Mitrovicës nëpërmjet përgjigjeve të ekspertëve në Kosovë 4.9%, tregojnë edhe një herë për rëndësinë që ka zgjidhja e kësaj çështje kryesore në marrëdhëniet midis Kosovës dhe Serbisë. Zgjidhja e kësaj çështje “të vështirë” mesa duket do të mbetet parakusht edhe i zgjidhjes së problemeve që kanë të bëjnë me sfidat e marrëdhënieve me shtetin serb dhe impaktin në vend si dhe me sovranitetin territorial të vendit, sfida të cilat për ekspertët në Kosovë dhe në Shqipëri janë renditur në problematikat e para të vlerësuara respektivisht nga ekspertët shqiptarë të Shqipërisë dhe të Kosovës. Siç e trajtuam edhe më sipër edhe nga anketimi i 702 studentëve këto probleme janë sfidat e para që lidhen me sigurinë kombëtare në Kosovë.

4.5 Ndikimi i faktorëve të jashtëm në veprimtaritë kriminale në Shqipëri dhe në Kosovë.


Në analizën krahasuese të përgjigjeve të pyetësorëve, faktorët e jashtëm luajnë një rol të konsiderueshëm ndikues në veprimtarinë kriminale në Shqipëri dhe në Kosovë. Pasqyra përmbledhëse e faktorëve të jashtëm ndikues në veprimtaritë kriminale në Shqipëri dhe Kosovë, pasqyrohet në tabelën 4.9 e cila evidenton peshën e 14 faktorëve në totalin e përgjigjeve.

Faktorët kriminaliteti i organizuar dhe veprimtaritë e grupeve kriminale shqiptare në botë së bashku me faktorin pozicioni gjeografik i Shqipërisë dhe Kosovës, vlerësohen me peshën më të madhe me nga 13% duke evidentuar se rëndësia e faktorëve të jashtëm është tepër e rëndësishme. Mosfunksionimi i demokracisë dhe shtetit ligjor, 11%, shumë e rëndësishme; rrjetet ndërkombëtare kriminale dhe linjat ndërkombëtare të trafikimit, 10%, shumë e rëndësishme; vështirësitë ekonomike dhe mungesa e zhvillimit, 9% të rëndësishëm; konfliktet ushtarake dhe vatrat e ekstremizmit, 8% të rëndësishme; emigracioni, 7% të rëndësishme; kërkesa për lëndë narkotike në BE, 4% pak të rëndësishëm; lëvizja e lirë Shqipëri - Kosovë dhe e Shqipërisë në Evropë, 4% pak të rëndësishëm; mungesa e bashkëveprimit policor transnacional dhe me strukturat ndërkombëtare hetimore, 3%, pak të rëndësishëm; korrupsioni 3%, pak të rëndësishëm; destabiliteti politik, 2%, më pak të rëndësishëm; globalizmi, 2%, më pak të rëndësishëm; dhe të tjera, 8%, më pak të rëndësishëm.

PhD Walter Schwimmer, pyetjes në lidhje me “faktorët e jashtëm ndikues në veprimtaritë kriminale në Shqipëri dhe Kosovë”, shprehet se:

*“Presionet politike nga të dyja vendet/shtetet individuale të tilla si Italia, Komisioni Evropian vepron në emër të vendeve anëtare apo Shtetet e Bashkuara në qeveritë e Shqipërisë dhe të Kosovës se një aktivitet i veçantë i ndërmarrë nga krimi i organizuar është i papranueshëm. Këto rezultate presioni qoftë nga qeveria e drejtpërdrejtë e veprimit përshembull ligji në lidhje me madhësinë e motorit të anijeve të vogla duke u ndjekur me pas nga transportet e njerëzve në Itali, ose presioni nga ana e qeverive mbi agjencitë e zbatimit të ligjit për të zbatuar ligjet”.*⁹⁰

Pesha e faktorëve në totalin e përgjigjeve të të intervistuarve, paraqitet në figurën 4.8.



Burimi: Pyetëtori 1 “Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri-Kosovë, 2008-2015” (plotësuar nga personalitete publike dhe ekspertë të sigurisë e drejtësisë në Shqipëri, Kosovë dhe ekspertë ndërkombëtarë). Përpunim i Autorit (2016).

Figura 4.8 Pesha e faktorëve në totalin e përgjigjeve të të intervistuarve.

Ndërsa, shpjegimi i shkallës së vlerësimit të faktorëve të jashtëm që ndikojnë në veprimtaritë kriminale të organizuara në nivelet lokale dhe transnacionale Shqipëri-Kosovë paraqitet në tabelën 4.10.

Tabela 4.11 paraqet të dhënat përmblledhëse të nënfaktorëve të jashtëm që ndikojnë në veprimtaritë kriminale të organizuara në nivelet lokale Shqipëri - Kosovë. Në mënyrë tabelare rezulton se faktorët kriminaliteti i organizuar dhe veprimtaritë e grupeve kriminale shqiptare në botë, dhe pozicioni gjeografik i Shqipërisë dhe Kosovës, vlerësohen me peshën

⁹⁰ Intervista është marrë nga autori me datën 27.11.2015.

më të madhe me nga 13%, dhe më pas vijojnë; mosfunksionimi i demokracisë dhe shtetit ligjor; rrjetet ndërkombëtare kriminale dhe linjat ndërkombëtare të trafikimit; vështirësitë ekonomike dhe mungesa e zhvillimit; konfliktet ushtarake dhe vatrat e ekstremizmit; emigracioni; kërkesa për lëndë narkotike në BE; lëvizja e lirë Shqipëri - Kosovë dhe e Shqipërisë në Evropë; mungesa e bashkëveprimit policor transnacional dhe me strukturat ndërkombëtare hetimore; korrupsioni; destabiliteti politik; globalizmi; dhe të tjera.

Nga analizën krahasuese e ndikimit të faktorëve të jashtëm në veprimtaritë kriminale në Shqipëri dhe në Kosovë rezulton se: *Së pari*, faktorët e jashtëm ndikues në veprimtarinë kriminale janë me ndikim të veçantë dhe mjaft specifik për problematikën e krimit të organizuar dhe veprimtarive kriminale. *Së dyti*, kriminaliteti i organizuar dhe veprimtaritë e grupeve kriminale shqiptare në botë, të ndikuar nga pozicioni gjeografik i Shqipërisë dhe Kosovës në rajon zënë peshën më të madhe në totalin e përgjigjeve të të intervistuarve, politikanë dhe ekspertë në Shqipëri, Kosovë dhe ekspertë ndërkombëtarë. *Së treti*, mosfunksionimi i demokracisë dhe shtetit ligjor, ka krijuar “kushtet e përshtatshme” që krimi i organizuar transnacional, rajonal, global e shumëkombësh dhe rrjetet ndërkombëtare kriminale dhe linjat ndërkombëtare të trafikimit, të ushtrojnë aktivitetin dhe veprimtaritë e tyre kriminale në mënyrë të drejtëpërdrejtë dhe veçanërisht nëpërmjet kriminalitetit të organizuar dhe veprimtaritë e grupeve kriminale shqiptare në botë. *Së katërti*, vështirësitë ekonomike dhe mungesa e zhvillimit në Shqipëri dhe në Kosovë, nga njëra anë, kanë nxitur emigracionin në vendet e tjera në BE^{së}, dhe nga ana tjetër, kanë joshur grupet kriminale transnacionale për ti përfshirë e përdorur në veprimtaritë e krimit të organizuar shtresat me të pamundura për jetesë, punësim dhe zhvillim. *Së pesti*, faktorët e brendshëm si: mosfunksionimi i demokracisë dhe shtetit ligjor; vështirësitë ekonomike dhe mungesa e zhvillimit; mungesa e bashkëveprimit policor transnacional dhe me strukturat ndërkombëtare hetimore, korrupsioni dhe destabiliteti politik kanë hapur “portat” nëpërmjet globalizmit, emigracionit dhe lëvizjes së lirë Kosovë-Shqipëri, Shqipëri – Kosovë dhe në drejtim të Evropës dhe vendeve të tjera. Këto kanë ndikuar ndjeshëm që faktorët e jashtëm të gjejnë kushte të përshtatshme nëpërmjet faktorëve të brendshëm dhe krimi i organizuar transnacional, grupet kriminale shqiptare në botë dhe linjat ndërkombëtare kriminale dhe linjat ndërkombëtare të trafikimit të zhvillojnë aktivitetin e tyre kriminal në Shqipëri, Kosovë dhe në rajon.

Përmbledhja e faktorëve/indikatorëve dhe nënfaktorëve të jashtëm që ndikojnë në veprimtaritë kriminale të organizuara në nivelet lokale Shqipëri - Kosovë pasqyrohet në tabelën 4.11. Sipas kësaj tablele rezulton se 14 faktorë apo indikatorë të përgjithshëm përbëhen nga 37 nënfaktorë apo nën indikatorë.

Faktori *kriminaliteti i organizuar dhe veprimtaritë e grupeve kriminale shqiptare në botë* përbëhet nga katër nënfaktorë: krimi i organizuar, grupet kriminale shqiptare në botë, trafiku i drogës dhe pastrimi i parave dhe kthimi i të dënuarve në Shqipëri dhe Kosovë.

Faktori *mosfunksionimi i demokracisë dhe shtetit ligjor*, përbëhet nga shtatë nënfaktorë; mosfunksionimi i shtetit ligjor, kapja e shtetit, demokraci e dobët, problematikat e brendshme vendore, shtete të dobëta, institucione në Kosovë ende të pakonsoliduara, dobësia dhe moskordinimi i institucioneve ligjzbatuese.

Faktori *rrjetet ndërkombëtare kriminale dhe linjat ndërkombëtare të trafikimit*, përbëhen nga tre nënfaktorë; ndikimi, lidhjet dhe shembujt e organizatave të huaja kriminale, rrjetet e drogës me origjinë Afganistan, Iran, Turqi dhe Ballkan dhe linjat ndërkombëtare të trafikimit.

Faktori *vështirësitë ekonomike dhe mungesa e zhvillimit*, përbëhen nga dy nënfaktorë; varfëria dhe rënia ekonomike, dhe papunësia e lartë në të dy vendet.

Faktori *konfliktet ushtarake dhe vatrat e ekstremizmit*, përbëhen nga tre nën faktorë; vatrat e konflikteve dhe tensionet politike në Siri dhe Ukrainë, konfliktet rajonale, dhe emigracioni.

Faktori *lëvizja e lirë Kosovë-Shqipëri dhe e Shqipërisë në Europë*, përbëhet nga dy nënfaktorë; lehtësia në komunikim dhe lëvizje Shqipëri - Kosovë dhe lëvizja e lirë e shqiptarëve në Evropë.

Faktori *mungesa e bashkëveprimit policor transnacional dhe me strukturat ndërkombëtare hetimore*, përbëhet nga tre nënfaktorë; mungesa e inteligjencës së kontrollit të pikave kufitare, mungesa e bashkëveprimit ndërpolicor, mos anëtarësimi i Kosovës në strukturat ndërkombëtare policore.

Faktori *të tjera*, përbëhet nga shtatë nënfaktorë; vonesa në procesin e integritit, ndikimet e ndryshme shoqërore dhe ndryshimi i mentalitetit, nepotizmi, presioni politik ndërkombëtar, lidhja etnike e të dy vendeve, mungesa e lëvizjes së lirë të Kosovës dhe tranzicioni i zgjatur.

4.6 Përmbledhje.

Në këtë kapitull u trajtuan sfidat kryesore të sigurisë kombëtare në Shqipëri dhe në Kosovë.

Nga analiza analitike dhe krahasimore rezulton se, politikanët, ekspertët e sigurisë dhe studentet në përgjigjet dhe intervistat e tyre konkludojnë se sfidat kryesore të sigurisë janë të lidhura ndushtësisht me demokracinë dhe institucionet demokratike siç u provua në kapitullin e mëparshëm, dhe të sigurisë dhe me krimin e organizuar transnacional Shqipëri-Kosovë. Kjo përputhshmëri arrihet edhe me dokumentin Strategjia e Sigurisë Kombëtare e Republikës së Shqipërisë, 2014, e cila përcakton se: korrupsioni dhe krimi i organizuar janë klasifikuar rreziku i parë në Rreziqet e nivelit të parë, dhe për rrjedhojë Rreziqet e nivelit të parë sipas këtij dokumenti kanë prioritetin më të lartë për sigurinë e Republikës së Shqipërisë. Ndërsa nga studimi i dokumentit të Analizës së Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë së Republikës së Kosovës, 2014, konstatohet se në pikën 4.4.5-krimi i organizuar dhe në pikën 4.4.6 -korrupsioni *përcaktohen rreziqe brenda territorit të Kosovës por është një problem transnacional/ndërshtetëror, sepse kërcënojnë e dëmtojnë sundimin e ligjit dhe ndikojnë negativisht në zhvillimin ekonomik dhe integrimin Euro-Atlantik*?. Pra, kjo është një edhe me përgjigjet e ekspertëve, intervistat e thelluara dhe përceptimet e studentëve, prandaj kërkohet vëmendje dhe vendosmëri në luftimin e këtij fenomeni.

Në analizën krahasuese u evidentua se faktorët e jashtëm luajnë një rol të konsiderueshëm ndikues në veprimtarinë kriminale në Shqipëri dhe në Kosovë.

Nga shqyrtimet dhe analizimet e mësipërme, arrijmë në përfundimin se: Pyetja kërkimore bazë që studimi ngre në lidhje me sfidat kryesore të sigurisë kombëtare në Shqipëri dhe Kosovë, e provojnë lidhjen e ngushtë dhe ndikimin e madh që mbartin në vetvete, siguria kombëtare, institucionet e sigurisë dhe sfidat e saj në raport me krimin e organizuar transnacional Shqipëri- Kosovë. Përgjigjet e provuara të këtyre pyetjeve

kërkimore e provojnë hipotezën e studimit se “Siguria kombëtare dhe funksionaliteti i institucioneve demokratike të Shqipërisë dhe Kosovës mbetet e kushtëzuar nga parandalimi, goditja dhe lufta e krimit të organizuar trans-nacional”. Kapitulli që vijon, paraqet veprimtaritë kriminale të organizuara më të përhapura në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën e Kosovës.

KAPITULL V:

VEPRIMTARITË KRIMINALE TË ORGANIZUARA MË TË PËRHAPURA NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË DHE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS


5.1. Hyrje.

Në këtë kapitull hulumtohen veprimtaritë kriminale të organizuara më të përhapura në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën e Kosovës. Një nga pyetjet kërkimore bazë që studimi ngre, ka të bëjë me veprimtaritë kriminale të organizuara më të përhapura në Shqipëri dhe në Kosovë, dhe me veprimtaritë e krimit të organizuar në fushën ekonomike-financiare, trafikimi i lëndëve narkotike, trafikimi i qenieve njerëzore, terrorizmi dhe korrupsioni. Këto veprimtari do të trajtohen dhe analizohen mbi baza lokale dhe krahasuese me qëllim identifikimin e veprimtarive më të përhapura dhe orientimin e sugjerimin e masave përkatëse për parandalimin dhe luftimin e tyre.

5.2 Veprimtaritë kriminale të organizuara më të përhapura në Republikën e Shqipërisë.

Kampioni i zgjedhur me kujdes me 65 politikanë të niveleve të larta, persona publikë, drejtues të institucioneve ligjzbatuese, studiues, pedagogë, juristë dhe ekspertë të sistemit të drejtësisë, ekspertë të sigurisë, në Shqipëri, Kosovë si dhe ekspertë ndërkombëtarë, si dhe zhvillimi i 20 intervistave të thelluara dhe baza e të dhënave nga institucionet ligjzbatuese.


Mbi bazën e pyetësorit nr.1 janë përgjigjur të intervistuarit, në lidhje me veprimtaritë kriminale të organizuara, më të përhapura në Republikën e Shqipërisë.



Burimi: Pyetësi nr. 1 “Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri-Kosovë, 2008-2015”, plotësuar nga personalitete publike dhe ekspertë të sigurisë e të drejtësisë në Shqipëri, në Kosovë dhe nga ekspertë ndërkombëtarë. Përpunim i autorit (2016).

Figura 5.1 Veprimtaritë kriminale të organizuara, më të përhapura në Shqipëri.

Figura 5.1 pasqyron veprimtaritë kriminale të organizuara, më të përhapura në Shqipëri, gjatë viteve, sipas së cilës janë: trafiku i drogës 28.47%, korrupsioni 27.1%, pastrimi i parave 14.6%, vrasjet me pagesë 7.3% dhe trafiku i qenieve njerëzore 6.57%.




Burimi: Pyetësi nr. 1 “Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri-Kosovë, 2008-2015”, plotësuar nga personalitete publike dhe ekspertë të sigurisë e të drejtësisë në Shqipëri, në Kosovë dhe nga ekspertë ndërkombëtarë. Përpunim i autorit (2016).

Figura 5.2 Veprimtaritë kriminale të organizuara, më pak të përhapura në Shqipëri.

Figura 5.2 pasqyron veprimtaritë kriminale të organizuara, më pak të përhapura në Shqipëri, 2008-2015, sipas së cilës janë: gjorbëvënia 3.65%, trafikimi i armëve dhe terrorizmi, dhe kontrabandimi i emigrantëve nga 2.92%, krimi i organizuar kibernetik dhe

krimi ushqimor 1.46% dhe kontrabanda e mallrave 0.73%. Ndërsa, tabela 5.1 pasqyron shpjegimin të dhënave të veprimtarive kriminale të organizuara.



Burimi: Përgjigjet e pyetësorit nr. 2 “Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri-Kosovë, 2008-2015”, plotësuar nga studentët e fakulteteve të Drejtësisë dhe të Sigurisë në Prishtinë dhe në Tiranë. Përpunim i autorit (2016).

Figura 5.3 Veprimtaritë kriminale të organizuara, më të përhapura në Republikën e Shqipërisë (Anketimi i studentëve).⁹¹


Sipas të dhënave të tabelës 5.1 dhe figurës 5.3 rezulton se i janë përgjigjur pyetësorit nr. 2, 702 studentë për veprimtaritë kriminale të organizuara më të përhapura në Republikën e Shqipërisë për periudhën 2008-2015, të cilat paraqiten:1.Trafikimi i drogës 78%; korrupsioni 9%; pastrimi i parave 7%; trafikimi i qenieve njerëzore 3%; kontrabandimi i emigrantëve e trafikimi i armëve 2% dhe gjobëvenia e vrasjet me pagesë 1%.

Nga krahasimi i përgjigjeve të pyetësorëve të plotësuar nga politikanët dhe ekspertët e sigurisë, si dhe nga përgjigjet e anketimit të studentëve për veprimtaritë kriminale të organizuara, më të përhapura në Republikën e Shqipërisë, rezulton se, në rastin

⁹¹ Theksojmë se të anketuarit kanë pasur të drejtën e dhënies vetëm të një përgjigjeje (vetëm një mundësi përzgjedhjeje).

e parë janë evidentuar trafikimi i drogës, korrupsioni, pastrimi i parave, vrasjet me pagesë dhe trafikimi i qenieve njerëzore. Ndërsa, anketimi i studentëve ka evidentuar: trafikimi i drogës, korrupsioni, pastrimi i parave, trafikimi i qenieve njerëzore, kontrabandimi i emigrantëve, trafikimi i armëve, gjobëvënia dhe vrasjet me pagesë.

Pra, nga analizimi i përgjigjeve të pyetësorëve të 767 të anketuarve rezulton se tri veprimtaritë kriminale të organizuara, më të përhapura në Shqipëri janë: 1. trafikimi i drogës; 2. korrupsioni; 3. pastrimi i parave.



Burimi: Përgjigjet e pyetësorit nr. 2 “Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri- Kosovë, 2008-2015”, plotësuar nga studentët e fakulteteve të Drejtësisë dhe të Sigurisë në Prishtinë dhe në Tiranë. Përpunim i autorit (2016).

Figura 5.4 Veprimtaritë kriminale të organizuara, më të përhapura në Republikën e Shqipërisë (Anketimi i studentëve).⁹²

Sipas gjyqtarit dhe studiuesit të njohur në fushën e krimit të organizuar, dr. Zamir Poda :

⁹²Theksojmë se të anketuarit kanë pasur të drejtën e dhënies vetëm të një përgjigjeje (vetëm një mundësi përzgjedhjeje).

*“Rruga e drogës që përdor krimi i organizuar transnacional dhe pozicioni i Shqipërisë në raport me Europën, drogën dhe armët janë instrumente të tjera të destabilizimit dhe kërcënimeve për sigurimin. Erozioni i mirëqënies sociale, shkaktuar nga zgjerimi i përdorimit të substancave narkotike dhe zhvillimi i mundshëm i terrorizmit, paraqesin dy momente frike ekstremisht të forta dhe të prekshme nga shoqëria perëndimore. Afrika e Veriut, Lindja e Mesme dhe juglindja e Mesdheut (Ballkani në sensin e pastër), mund të jenë prodhues të drogës ose rrugë të thjeshta të kalimit të drogës, eksportues të egërsisë fundamentaliste, si dhe të arsenaleve të armëve me kosto të ulët”.*⁹³

PhD Walter Schwimmer, në lidhje me pyetjen: Cilat janë aktivitetet më të përhapura të krimit të organizuar në Republikën e Shqipërisë?, shprehet për korrupsionin duke sqaruar:

*“Korrupsioni minon besimin në atë të qeverisë, të institucioneve të qeverisë dhe është një kancer që shkatërron shtetin. Nëse popullsia nuk i beson shtetit ata do të kërkojnë ta lënë atë. Ata që do ta ketë të lehtë të largohen janë të arsimuar të cilët kanë aftësitë që janë të tregtueshme në shtetet e tjera. Si rezultat ata që kanë më shumë për të ofruar largohen dhe zhvillimi i shtetit vuan si rezultat i kësaj”.*⁹⁴

Dr. Zef Preçi në intervistën e dhënë, në lidhje me korrupsionin dhe me demokracinë është shprehur:

*“Mendoj që në stadin e sotëm të zhvillimit të vendit, korrupsioni ka marrë përmasa shqetësuese. Korrupsioni në fillimet e tranzicionit zhvillohej nëpërmjet shkëmbimit të favoreve, ndërsa pas viteve 1990, korrupsioni u bë dhe u transformua për shkak të interesave ekonomike. Në qoftë se para viteve 1990, paratë ishin në banka, pastaj kaloi korrupsioni në privatizimet. Sot është forma më e lartë, sot korrupsioni ka shkuar, është ngritur dhe është futur brenda parlamentit. Kemi kaluar nga **faza e parë** që është faza e korrupsionit të vogël (rrushfetit, pagimit të parave në dorë, edhe kur emërohen në detyra, (pety corruption), (korrupsioni i vogël). **Faza e dytë**, është faza e kapjes së shtetit, kur bizneset tentojnë të bashkëpunojnë e të shfrytëzojnë lidhjet me politikën, dhe interesat e politikës për para. Më shpejt se sa në politikë, nuk pasurohesh me asgjë në Shqipëri. **Faza e tretë**, është faza “dështimit të shtetit të së drejtës”, kur përfaqësuesit e biznesit të dyshimtë, arrijnë jo vetëm të çojnë përfaqësuesit e tyre në administratë, por shkojnë edhe vetë në parlament.*

- Pasoja është deformimi i demokracisë. Deformimi i sigurisë i konkurrencës me ne në tregje.
- Shtimi i përpjekjeve për të marrë në kontroll të lobeve (Bizneset me lidhje politike të gjithçkaje që është publike).
- Deformimi i sigurisë, i konkurrencës.

Domethënë për pasuri natyrore, fonde publike, ne prokurorimet, për shembull, iniciohen, privatët. Por që emërtohen si koncesione që nuk ekzistojnë në asnjë vend të botës. Kryhen intervistime publike te panevojshme, për shembull investimi në IT., në zona që nuk ka banim, etj. Kemi të bëjmë me një nivel të lartë të korrupsionit i cili në thelb mund të klasifikohet si “grand corruption”, pra, korrupsioni i madh ku përpjekjet bëhen për të ndërvepruar klasa politike me

⁹³Dr. Zamir Poda hetues, prokuror, gjyqtar, avokat, profesor i të Drejtës Procedurale Penale në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës, anëtar i Gjykatës së Lartë, studiues i njohur dhe autor e bashkëautor i disa librave në fushën e luftës kundër krimit të organizuar dhe mafias. Intervista është marrë nga autori, datë 23.12.2015.

⁹⁴ Intervista është marrë nga autori, datë 27.11.2015.

klasën e biznesit dhe për të zgjedhur prej saj, për t'u pasuruar për një kohë të shkurtër shohim që vetëm kompanitë që kanë lidhje me pushtetin. Kontratat koncensionare aplikohen në vende që kanë sistem ligjor funksional. Në rastin tonë krijohen posaçërisht kompanitë anonime për t'i dhënë lekët atyre që ata duan. Për të marrë qindra milionë dhe, për fat të keq jo vetëm buxhetit të vitit, por edhe buxhetit të shumë viteve, por edhe të periudhave që vijnë për 10, 20 apo 30 vitet e ardhshme. Synohet të përdoren dhe të shfrytëzohen kontrata publike që nuk kanë funksionuar askund në botë dhe nuk janë koncensionare. Në rastin tonë krijohen shërbime publike që u jepen kompanive anonime që krijohen për të marrë fitime të madhe të biznesit. Për të mos thënë se është vështirë të evidentosh kompani serioze, por vetëm kompani formale. Është vështirë që në nivelin e biznesit të gesh kompani serioze, por vijnë "kompani" me duar ne xhepa, krijojnë lidhje politike, kudo që shkojnë. Në asnjë vend të botës nuk ekziston shërbimi "Check up", por Shqipëria harxhon 10 deri në 12 milion euro në vit, nga një kompani që ishte krijuar vetëm 3 javë para kryerjes së tenderit. Prandaj, viktima e radhës është qytetari, është biznesi, është biznesi i huaj. Së fundi, është deklarata e ambasadorit gjerman ku ka deklaruar se asnjë biznesmen gjerman gjatë 25 viteve të fundit nuk ka fituar asnjë tender në këto vite të tranzicionit në Shqipëri. Përgjithësisht kemi të bëjmë me një fazë ku shteti ka dështuar si i tillë, që të jetë një përfaqësues i mbrojtjes si interesave të publikut të gjerë të qytetarëve, i vlerave të qytetarëve dhe është një instrument në dorën e oligarkisë të konfirmuar qartë edhe me mbipërfaqësimin e vet në parlament.

Dhe me pasuritë kryesore të vendit që janë baza e mbajtjes në këmbë të çdo shteti demokratik në botë, siç është nafta, shteti shqiptar fiton më pak sesa të kishte qenë i pushtuar pasi lobet e biznesit dhe të lidhura me qeveritë dhe me lidhje politike vendase apo të huaja për shkak të trafikut të influencave e kanë vënë nën kontroll. Tezat e mëparshme që vidhet Shqipëria, vidhet vota, vidhet vota dhe vidhet Shqipëria detyrimisht tani janë evidente dhe nuk kanë ndryshuar asgjë. Edhe pse ndryshon mazhoranca politike, qeverisja, pushteti, administrata publike, shqetësimi tjetër është se, lobet e biznesit vazhdojnë të jenë persona të specializuar dhe vazhdojnë të jenë po aq prezentë edhe në administratën e re.

Fenomeni i korrupsionit vazhdon të jetë më agresiv, vazhdon të jetë përherë dhe më shumë i sofistikuar, tani kemi të bëjmë me një shtrirje të kufijve midis politikës, mediave dhe biznesit dhe për rrjedhojë edhe hapësira demokratike për këto zvogëlohet, klima që krijohet është klimë mbytëse, ku oligarkë të njohur për mungesën e besimit publik, politikanë të njohur e të përfolur dhe të stimagtizuar në opinionin publik dhe emblemantikë në aspektin e abuzimit me detyrën, marrin poste të larta, vendi është i veshur me një demagoxhi dhe tautologji antikorrupsion.


Pra, panorama nuk është aspak optimiste. Pas 25 vitesh shqiptarët kanë humbur shpresën dhe njëkohësisht duhet të pranojmë, përderisa e kanë mbyllur ciklin dy partitë e mëdha dhe sistemi është e mbyllur, sepse është pushteti i listës, kemi që nga 2008 që nuk zgjidhen dhe nuk funksionojë demokratikisht partitë politike, por funksionon vetëm pushteti i listës. Kemi që nga viti 2008 që asgjë nuk zgjidhet, por gjithçka emërohet, duke ndjekur listën e lobeve në historinë e biznesit, ato janë shëndërruar në zgjatime të lobeve të biznesit. Marrja nën kontroll e një ministrie, e një drejtorie e shërbimeve publike në thelb nuk është gjë tjetër, veçse marrja e tyre për përfitime dhe kalimi i këtyre përfitimeve shkon në favor të përfituesve privatë. Persona të stigmatizuar për pasoja tragjike për vendin vazhdojnë të jenë po aq aktiv në jetën e vendit dhe të abuzojnë dhe, për rrjedhojë krimi i organizuar ndjehet komod në këto kushte për të mos thënë se në situata të caktuara edhe mund të jetë përdorur edhe kundër gjyqtarëve, zyrtarëve që bëhen pengesë në këtë luftë kundër krimin të organizuar.⁹⁵

⁹⁵ Intervista është marrë nga autori në Tiranë, në lidhje me korrupsionin dhe demokracinë, datë 03.11.2015.

5.3 Veprimtaritë kriminale të organizuara në nivelet lokale në Republikën e Shqipërisë-analizë krahasuese.

Lufta kundër kriminalitetit të organizuar nacional, ndërnacional, transnacional, ndërkombëtar, rajonal, global dhe shumëkombësh është detyrë e tri pushteteve në Shqipëri, e pushtetit legjislativ që miraton ligjet dhe që ka për detyrë të ushtrojë kontroll mbi qeverinë dhe institucionet e tjera për zbatimin e ligjeve. Është detyrë e pushtetit ekzekutiv, pra e qeverisë dhe e institucioneve të saj ligjzbatuese, si: Policia e Shtetit, dogana, tatimet, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave etj. Është detyrë e prokurorisë, e cila ka për detyrë të përfaqësojë dhe të mbrojë akuzën në emër të shtetit dhe pushtetit gjyqësor, sepse ai ka për detyrë dhënien e drejtësisë penale, pra, ka për detyrë edhe hetimin e gjykimin e çështjeve penale, të autorëve të veprave penale. Secili institucion shtetëror ka detyrat dhe kompetencat e tij, por një ndër detyrat e tyre të rëndësishme është koordinimi dhe bashkërendimi e bashkëpunimi i këtyre institucioneve me njëri-tjetrin.

Statistikat e Policisë së Shtetit për veprat penale në fushën e krimit të organizuar, të evidentuar e zbuluar, gjatë viteve gjejnë pasqyrim në tabelën 5.2, tabelën 5.3, ndërsa në grafikun 5.5.



Burimi: Shkresa nr. B-11/1, datë 04.03.2016 e Drejtorisë së Policisë së Shtetit, lënda, “Përgjigje Tuajës nr.B-11 Prot. datë 10.02.2016, “Informacion mbi statistikat për veprat penale të krimit të organizuar, terrorizmit dhe korrupsionit në vitet 2008-2015”, drejtuar Bajram Ibraj. *Përpunim i autorit (2016)*.

Figura 5.5 Veprat penale në fushën e krimit të organizuar, të zbuluara në % sipas Policisë së Shtetit, 2008-2015.

Në mënyrë tabelare evidentohet në total se krime në fushën e akteve terroriste janë evidentuar 123 vepra penale dhe janë zbuluar 80 vepra penale ose 65.04%.Pra, 43 vepra

penale ose 34.6% janë krime të pazbuluara ose “shifra të përhimtë”⁹⁶ (Dritan Shala, 2013:6) të kriminalitetit. Krime në fushën e trafikëve të paligjshme janë evidentuar 3.611 vepra penale dhe janë zbuluar 3.468 vepra penale ose 96.03%. Pra, 143 vepra penale ose 3.97% janë krime të pazbuluara ose “shifra të përhimtë” të kriminalitetit. Krime në fushën e drogës janë evidentuar 6.799 vepra penale dhe janë zbuluar 5.963 vepra penale ose 87.70%. Pra, 836 vepra penale ose 22.30% janë krime të pazbuluara ose “shifra të përhimtë” të kriminalitetit. Krime në fushën ekonomike-financiare janë evidentuar 14.602 vepra penale dhe janë zbuluar 14.158 vepra penale ose 96.95%. Pra, 444 vepra penale ose 3.05% janë krime të pazbuluara ose “shifra të përhimtë” të kriminalitetit. Krime kundër korrupsionit janë evidentuar 3.953 vepra penale dhe janë zbuluar 3.862 vepra penale ose 97.69%. Pra, 91 vepra penale ose 2.31% janë krime të pazbuluara ose “shifra të përhimtë” të kriminalitetit. Krime kundër pastrimit të parave janë evidentuar 1.406 vepra penale dhe janë zbuluar 1.380 vepra penale ose 98.15%. Pra, 26 vepra penale ose 1.85% janë krime të pazbuluara ose “shifra të përhimtë” të kriminalitetit.


Ajo që na bën përshtypje është fakti që në vitet 2010, 2011, 2012, 2013 dhe 2014 evidentimi dhe zbulimi i veprave penale është i barabartë në masën 100%. Lind pyetja: Këto shifra a mund të konsiderohen shifra të sakta të kriminalitetit, kur për pesë vite radhazi krimet kundër pastrimit të parave janë zbuluar në masën 100%? Mendojmë që kjo nuk është gjendja reale dhe e vërtetë, dhe këto shifra të kriminalitetit i krijojnë vështirësi çdo studiuesi të nxjerrë përfundime e konkluzione dhe të japë rekomandime. Krime kompjuterike janë evidentuar 598 vepra penale dhe janë zbuluar 307 vepra penale ose 51.33%. Pra, 291 vepra penale ose 48.67% janë krime të pazbuluara ose “shifra të përhimtë” të kriminalitetit.

Në total, për shtatë fushat e veprimtarisë kriminale të organizuar janë evidentuar 31.092 vepra penale dhe janë zbuluar 29.398 vepra penale ose 94.55%. Pra, 1694 vepra penale ose 5.45% janë krime të pazbuluara ose “shifra të përhimtë” të kriminalitetit për shtatë veprimtaritë e krimit të organizuar në Shqipëri për periudhën 2008-2015. Në tabelën 5.5 pasqyrohen veprat penale në fushën e krimit të organizuar, autorët dhe masat e sigurimit sipas Policisë së Shtetit për vitin 2015. Në mënyrë tabelare rezulton: *në vepra penale për*

⁹⁶Me “numër të përhimtë” të kriminalitetit kuptohen rastet kur nuk janë zbuluar, zbardhur, ndriçuar, dokumentuar ligjërisht me prova deri në fund nga organet kompetente.


qëllime terroriste, nga të cilat evidentuar 12, zbuluar 5 ose 41.70% me 15 autorë gjithsej, ku rezulton 1 arrestuar, 4 ndaluar, 8 në gjendje të lirë dhe 2 autorë të larguar; *krime në fushën e trafiqeve të paligjshme*, nga të cilat evidentuar 432, zbuluar 364 ose 84.30% me 500 autorë gjithsej, nga të cilët 125 arrestuar, 38 ndaluar, 284 në gjendje të lirë dhe 51 autorë të larguar; *krime në fushën e drogës*, nga të cilat evidentuar 1021, zbuluar 975 ose 95.50% me 1529 autorë gjithsej, nga të cilët 931 arrestuar, 92 ndaluar, 413 në gjendje të lirë dhe 91 autorë të larguar; *krime ekonomiko-financiare*, nga të cilat evidentuar 2436, zbuluar 2326 ose 95.50% me 2636 autorë gjithsej, nga ku 406 arrestuar, 110 ndaluar, 1985 në gjendje të lirë dhe 133 autorë të larguar; *krime në fushën e korrupsionit*, nga të cilat evidentuar 907, zbuluar 877 ose 96.70% me 1335 autorë gjithsej, nga të cilët 221 arrestuar, 166 ndaluar, 929 në gjendje të lirë dhe 172 autorë të larguar; *krime në fushën e pastrimit të parave*, ku janë evidentuar 355, zbuluar 344 ose 96.90% me 464 autorë gjithsej, nga të cilët 35 arrestuar, 14 ndaluar, 409 në gjendje të lirë dhe 5 autorë të larguar dhe *krimet kompjuterike*, ku janë evidentuar 122, zbuluar 33 ose 27.00% me 49 autorë gjithsej, nga të cilët 5 arrestuar, 10 ndaluar, 31 në gjendje të lirë dhe 3 autorë të larguar.

Tabela 5.6 dhe 5.7 pasqyron ecurinë e formave të krimit të organizuar të lidhura me trafikimin dhe prostitucionin, 2008-2015 e shprehur në shifra, përqindje në formë tabelare dhe grafike. Në mënyrë tabelare kjo ecuri rezulton se në total, *për trafikimin e mjeteve motorike* janë evidentuar 2056 raste, *prostitucioni* 591 raste, *ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit* 283, *trafikimi i personave* 138, *trafikimi i armëve dhe municioneve* 116, *trafikimi i femrave* e raste të tjera në fushën e trafiqeve të paligjshme 35, *trafikimi i të miturve* 30 dhe *mbajtja e lokaleve për prostitucion* 23 raste. Ecuria e formave të krimit të organizuar, të lidhura me trafikimin dhe prostitucionin, 2008-2015 e shprehur në përqindje, gjen pasqyrim në figurën 5.7 ku rezulton se: *trafikimi i mjeteve motorike* në vitin 2008 janë evidentuar 74.81%, 2009, 74.77%, 2010, 55.14%, 2011, 70.54%, 2012, 66.50%, 2013, 58.91%, 2014, 47.97% dhe viti 2015, 39.65%. Ndërsa, *trafikimi i personave* në vitin 2014, 11.04% dhe në vitin 2015, 15.71%, *trafikimi i femrave* ka qenë në nivele më të larta në vitin 2010, 7.22% dhe në vitin 2013, 7.75%. *Prostitucioni* në vitin 2008 21.08%, 2009, 24.01%, 2010, 17.72%, 2011, 17.63%, 2012, 13.95%, 2013, 11.37%, 2014, 15.99% dhe 2015, 20.20%. Ndërsa, në mënyrë grafike paraqitet në figurën 5.6 dhe grafikun 5.2.



Burimi: Shkresa Nr. B-11/1, datë 04.03.2016 e Drejtorisë së Policisë së Shtetit, lënda: “Përgjigje Tuajës Nr.B-11 Prot. datë 10.02.2016, “Informacion mbi statistikat për veprat penale të krimit të organizuar, terrorizmit dhe korrupsionit në vitet 2008-2015”, drejtuar Bajram Ibraj. *Përpunim i autorit (2016)*.

Figura 5.6 Ecuria e e formave të krimit të organizuar, të lidhura me trafikimin dhe prostitucionin, 2008-2015 e shprehur në përqindje.



Burimi: Shkresa Nr. B-11/1, datë 04.03.2016 e Drejtorisë së Policisë së Shtetit, lënda: “Përgjigje Tuajës Nr.B-11 Prot. datë 10.02.2016, “Informacion mbi statistikat për veprat penale të krimit të organizuar, terrorizmit dhe korrupsionit në vitet 2008-2015”, drejtuar Bajram Ibraj. *Përpunim i autorit (2016)*.


Grafiku 5.2 Ecuria e krimit të organizuar të lidhura me trafikimin dhe prostitucionin, 2008-2015.

Nga paraqitja grafike rezulton se *trafikimi i mjeteve motorike* nga 2008 në vitin 2015, ka pësuar rënie, *prostitucioni* ka qëndruar në të njëjtin nivel. *Trafikimi i personave* ka pësuar rënie në vitet 2009-2012 dhe ka pësuar rritje në vitet 2013, 2014 dhe në vitin 2015 me rritjen më të madhe me 15.71%. Trafikimi i mjeteve motorike, trafikimi i personave, trafikimi i armëve dhe municioneve dhe prostitucioni, 2008-2015, pasqyrohet në tabelën 5.8. Në mënyrë tabelare evidentohen këto katër vepra penale, ku në nivelin më të lartë shfaqet *trafikimi i mjeteve motorike* në vitin 2008 me 74.81% dhe *prostitucioni* në vitin 2009 me 24.01%.

Ecuria e veprave penale të korrupsionit dhe të abuzimeve me pushtetin, 2008-2015 e shprehur në shifra, pasqyrohet në tabelën 5.9, ndërsa ecuria e veprave penale të korrupsionit dhe të abuzimeve me pushtetin, 2008-2015 e shprehur në përqindje, pasqyrohet në tabelën 5.10.

Në mënyrë tabelare dhe grafike në shifra dhe në përqindje evidentohen se *korruptsioni* në nivelet më të ulëta ka qenë në vitet 2009 me 52 ose 14.70 %, 2008 me 69 ose 18.80%, viti 2011 me 64 ose 18.10%, viti 2010 me 79 ose 20.60% dhe viti 2012 me 99 raste ose 22.90%. Ndërsa, në nivele më të larta janë evidentuar në vitin 2014 me 151 raste ose 28.40% dhe në vitin 2015 me 258 raste ose 58.5%. Në total, për vitet 2008-2015 janë evidentuar 885 vepra penale të korrupsionit. Ndërsa, *veprat penale të kryera nga punonjësit shtetërorë publikë*, evidentohen në vitin 2008, 299 vepra penale ose 81.30%, në vitet 2009 e 2010 me 302 vepra penale ose 85.30%, viti 2011 me 289 vepra penale ose 81.60%, 2012 me 329 ose 76.20%, 2013 me 338 ose 73.80%, 2014 me 537 ose 69.80%, 2015 me 633 ose 69.80%.


Grafiku 5.3 pasqyron ecurinë e veprave penale të korrupsionit dhe të abuzimeve me pushtetin, 2008-2015.



Burimi: Shkresa Nr. B-11/1, datë 04.03.2016 e Drejtorisë së Policisë së Shtetit, lënda: “Përgjigje Tuajës Nr.B-11 Prot. datë 10.02.2016, “Informacion mbi statistikën për veprat penale të krimit të organizuar, terrorizmit dhe korrupsionit në vitet 2008-2015”, drejtuar Bajram Ibraj. *Përpunim i autorit (2016)*.

Grafiku 5.3 Ecuria e veprave penale të korrupsionit dhe abuzimeve me pushtetin, 2008-2015.


Sipas grafikut rezulton se korrupsioni nga viti 2008 në vitin 2015 ka pësuar rritje, ndërsa, veprat penale të kryera nga punonjësit shtetërorë publikë nga viti 2008 në vitin 2015 ka pësuar ulje. Tabela 5.11 dhe 5.12 pasqyrojnë veprat penale kundër narkotikëve, të shprehura në shifra dhe në përqindje, 2008-2015. Ecuria e veprave penale të narkotikëve në vitet 2008-2015, si dhe në vitet 2008, 2011 dhe 2015, pasqyrohet në figurën 5.7



Burimi: Shkresa Nr. B-11/1, datë 04.03.2016 e Drejtorisë së Policisë së Shtetit, lënda: “Përgjigje Tuajës Nr.B-11 Prot. datë 10.02.2016, “Informacion mbi statistikat për veprat penale të krimit të organizuar, terrorizmit dhe korrupsionit në vitet 2008-2015”, drejtuar Bajram Ibraj. *Përpunim i autorit (2016).*

Figura 5.7 Ecuria e veprave penale të narkotikëve.

Sipas pamjeve grafike të mësipërme evidentohet se *kultivimi i bimëve narkotike* në një analizë krahasimore, 2008-2015 evidentohet se në vitin 2008 kultivimi ka qenë në 50.20%, në vitin 2011- 0.50% dhe në vitin 2015- 1.30%. *Trafikimi i narkotikëve* ka qëndruar në të njëjtat nivele, ndërsa, *shitja e shpërndarja e narkotikëve* në vitin 2008 me 45.20%, 2011 me 89.50% dhe në vitin 2015 me 91.90 %. Pavarësisht shifrave të paraqitura nga Policia e Shtetit, na bën përshtypje fakti që kultivimi i bimëve narkotike në vitin 2011 është 0.50% dhe në vitin 2015 është 1.30%, në një kohë që nga akuzat e bëra nga opozita shqiptare, por edhe nga raportet e ndërkombëtarëve, si dhe nga monitorimi me helikopter rezulton se, pas goditjes së grupeve kriminale në fshatin Lazarat, tashmë mbjedhja e kultivimi i bimëve narkotike është shëndrruar pothuajse në të gjithë territorin e vendit.




Burimi: Shkresa Nr. B-11/1, datë 04.03.2016 e Drejtorisë së Policisë së Shtetit, lënda: “Përgjigje Tuajës Nr.B-11 Prot. datë 10.02.2016, “Informacion mbi statistikat për veprat penale të krimit të organizuar, terrorizmit dhe korrupsionit në vitet 2008-2015”, drejtuar Bajram Ibraj. *Përpunim i autorit (2016).*

Grafiku 5.4 Ecuria e veprave penale të narkotikëve në vitet 2008, 2011 dhe 2015.

Ndërsa, sipas grafikut 5.4 ecuria e veprave penale të narkotikëve në vitet 2008, 2011 dhe 2015, rezulton se *shitja e shpërndarja e narkotikëve* në 2008 ka qenë 45.20%, 2011- 89.50% dhe në 2015 -91.90%. *Trafikimi i narkotikëve* në 2008- 4.60%, 2011-10.00% dhe në 2015-6.90%. Ndërsa, *kultivimi i bimëve narkotike* në 2008 ka qenë 50.20%, 2011-0.50% dhe në 2015-1.30%.

Tabela dhe grafiku ecuria e veprave penale të financimit të terrorizmit dhe pastrimi i produkteve, 2008-2015, pasqyrohen në tabelat 5.14 e 5.15 dhe grafiku 5.5.



Burimi: Shkresa Nr. B-11/1, datë 04.03.2016 e Drejtorisë së Policisë së Shtetit, lënda: “Përgjigje Tuajës Nr.B-11 Prot. datë 10.02.2016, “Informacion mbi statistikat për veprat penale të krimit të organizuar, terrorizmit dhe korrupsionit në vitet 2008-2015”, drejtuar Bajram Ibraj. *Përpunim i autorit (2016)*.

Grafiku 5.5 Ecuria e veprave penale të financimit të terrorizmit dhe pastrimi i produkteve, 2008-2015.


Në mënyrë tabelare për vitet 2008-2015 *veprat penale për financimin e terrorizmit* janë në shifrat zero, ndërsa *pastrimi i produkteve* është në total 893, nga të cilat në vitin 2008 -183, në vitin 2009 -159, në vitin 2010 -56, në vitin 2011 -86, në vitin 2012 -116, në vitin 2013 -87, në vitin 2014 -206 dhe në vitin 2015 zero.

5.4 Veprimtaritë e krimit të organizuar në fushën ekonomike-financiare në Shqipëri -analizë krahasuese.

Veprimtaritë e manifestimit të krimit të organizuar në fushën ekonomike dhe financiare në Shqipëri janë evidente. Këtë e ka evidentuar në konstatimet e tij edhe Këshilli i Evropës për Shqipërinë, në kuadër të projektit “Për forcimin e kapaciteteve në luftë kundër krimit të organizuar në Evropën Juglindore”, ku Lucio di Pietro, këshilltar,

Zëvendësprokuror Kombëtar Antimafie, në Drejtorinë Kombëtare Antimafie, në konferencën e mbajtur në Tiranë me titull “Tipare strukturore dhe forma të shfaqjes së krimit të organizuar transnacional” u shpreh se *kërcënimet kryesore për Shqipërinë janë krimi i organizuar që ka lidhje me drogën, trafikimin e qenieve njerëzore, krimin ekonomik dhe korrupsionin.* (Lucio di Pietro: 2007).

Analiza krahasimore e krimit të organizuar në fushën ekonomike dhe financiare në Shqipëri për periudhën 2008-2015, gjen pasqyrim në figurën 5.8, tabelat 5.16 dhe 5.17.



Burimi: Shkresa Nr. B-11/1, datë 04.03.2016 e Drejtorisë së Policisë së Shtetit, lënda: “Përgjigje Tuajës Nr.B-11 Prot. datë 10.02.2016, “Informacion mbi statistikën për veprat penale të krimit të organizuar, terrorizmit dhe korrupsionit në vitet 2008-2015”, drejtuar Bajram Ibraj. *Përpunim i autorit (2016).*

Figura 5.8 Analizë krahasimore e krimit të organizuar në fushën ekonomike dhe financiare në Shqipëri, 2008-2015.


Sipas të dhënave tabelare, rezulton se për periudhën 2008-2015 në krimet ekonomike dhe financiare, në rubrikën “*Krime në fushën e doganave*” rezultojnë se ato zënë respektivisht në vitin 2008, 10.9%, në vitin 2009, 15.1%, në vitin 2010, 14.2%, në vitin 2011, 12.1%, në vitin 2012, 10.9%, në vitin 2013, 6.1%, në vitin 2014, 7.7% dhe në vitin 2015, 9.4%. Në rubrikën “*Falsifikime*” rezultojnë se ato zënë respektivisht në vitin 2008, 58.8 %, në vitin 2009, 52.3 %, në vitin 2010, 35.7 %, në vitin 2011, 45.7 %, në vitin 2012, 37.9 %, në vitin 2013, 23 %, në vitin 2014, 27.9 % dhe në vitin 2015, 26.4 %. Në rubrikën “*Mashtrime*” rezultojnë se ato zënë respektivisht në vitin 2008, 26.9 %, në vitin 2009, 28.6

%, në vitin 2010, 26.1 %, në vitin 2011, 21.9 %, në vitin 2012, 25.8 %, në vitin 2013, 24.3 %, në vitin 2014, 27.6 % dhe në vitin 2015, 16.1 %.

Të dhënat e mësipërme shprehin një paraqitje të zhvillimit të krimeve ekonomike financiare në Shqipëri, 2008-2015. Në tërësi vihet re qartë një rënie e dukurisë së falsifikimit dhe një rritje e madhe e veprave penale në fushën e tatim-taksave. Përgjatë viteve të ndryshme *shfaqja e krimit ekonomik dhe financiar* ka pësuar ndryshime në shifra. Kështu, në vitin 2008 ndër krimet më të përhapura të kësaj kategorie kanë qënë *mashttrimet* dhe *falsifikimet*, duke lënë të fundit në renditje *krimet doganore*. Më tej, në vitin 2009, *mashttrimet* dhe *shkelja e së drejtës së pronësisë industriale* kanë pësuar një rritje të lehtë, por megjithatë *falsifikimet* kanë vazhduar të jenë të parat në renditje në këtë kategori krimesh.

Fenomeni *i mashttimeve* në fushën ekonomike dhe financiare ka pasur një ecuri të njëjtë ndër vite, me përjashtim të vitit të fundit 2015, ku shihet një rënie nga viti i mëparshëm me rreth 10%. Kategoritë e krimeve që kanë pësuar më tepër ndryshime në shifra janë: ai *i falsifikimit*, i cili ka kaluar nga 939 krime në vit (2008) në 643 krime në vitin 2015. Një tjetër dukuri që vihet re është shtimi i veprave penale në fushën e tatim taksave, i cili ka pësuar një dhjetëfishim të peshës në totalin e krimeve ekonomike dhe financiare nga viti 2008 në 2015. Veçanërisht në sy bie një rritje e lartë e grupit të krimeve të tjera ekonomike dhe financiare në vitin 2013 në dallim nga të gjithë vitet e tjera.

Në mënyrë tabelore në tabelën 5.18 dhe në mënyrë grafike në grafikun pasqyrohet trendi i krimeve kryesore në fushën ekonomike dhe financiare në Shqipëri në vitet 2008, 2012 dhe 2015.



Burimi: Shkresa Nr. B-11/1, datë 04.03.2016 e Drejtorisë së Policisë së Shtetit, lënda: “Përgjigje Tuajës Nr.B-11 Prot. datë 10.02.2016, “Informacion mbi statistikën për veprat penale të krimit të organizuar, terrorizmit dhe korrupsionit në vitet 2008-2015”, drejtuar Bajram Ibraj. *Përpunim i autorit (2016)*.

Grafiku 5.6 Veprat penale kryesore në fushën ekonomike dhe financiare në Shqipëri në vitet 2008, 2012 dhe 2015.

Sipas tyre rezulton se *veprat penale në fushën e tatim-taksave* dhe *të vepra penale të tjera ekonomiko-financiare*, nga viti 2008 në vitin 2015 janë rritur në masën 30%, ndërkohë që *veprat penale falsifikime* nga vitin 2008 në vitin 2015 kanë pësuar rënie në masën 30%, *veprat penale në fushën e mashtrimeve* për të njëjtën periudhë të krahasuar kanë pësuar rënie në masën 25%, ndërkohë që *veprat penale në fushën e doganave* për periudhën 2008-2015 kanë qëndruar në të njëjtin nivel. *Veprat penale në fushën e tatim-taksave* dhe *vepra penale të tjera ekonomiko-financiare*, argumentohet se kanë pasur një rritje të konsiderueshme pas vitit 2008, por veçanërisht në vitet 2014-2015, argumentohet edhe nga shifrat e operacioneve, dhe të arrestimeve që janë bërë nga Policia e Shtetit për goditjen e fenomenit të informalitetit. Sipas Ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri, viti 2015 ishte “*viti më i suksesshëm, duke shënuar rezultate historike në luftën kundër krimit, kontrollin e territorit dhe garantimin e rendit e të sigurisë publike, si dhe një progres të dukshëm në zhvillimin e organizatës, përmes një procesi reformues shumëdimensional.*”⁹⁷”

Goditja dhe lufta e paligjshmërisë dhe e informalitetit, “ishte në qendër të veprimeve dhe masave të strukturave policore gjatë gjithë vitit 2015, duke e vlerësuar si një domosdoshmëri për vendosjen e sundimit të ligjit dhe rregullit.”⁹⁸” Strukturat e Policisë së Shtetit së bashku me OSHEE-në zhvilluan operacione të suksesshme për identifikimin e personave që vjedhin energjinë elektrike, duke evidentuar 1914 raste të vjedhjeve të energjisë dhe proceduar penalisht 1917 autorë. Gjithashtu, operacion i suksesshëm u zhvillua nga Policia e Shtetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, ku u evidentuan rreth 824 vepra penale në kuadër të luftës ndaj informalitetit në ekonomi.”⁹⁹”

Sipas raportit vjetor të veprimtarisë së Drejtorisë së Policisë së Shtetit rezulton se janë goditur 252 grupe kriminale me mbi 1600 autorë, janë evidentuar 54 vrasje, nga të cilat, 5 vrasje të pazbuluara, ndërkohë që gjatë vitit 2014, janë evidentuar 22 vrasje të pazbuluara dhe gjatë vitit 2013, 23 vrasje të pazbuluara.¹⁰⁰ Pra, për vitet 2013-2015, janë

⁹⁷Analiza vjetore e Policisë së Shtetit 2015. Fjala e Ministrit të Punëve të Brendshme, Saimir Tahiri, në seancën parlamentare, gjatë diskutimit të projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për kontrollin e lëndëve narkotike dhe zbatimin e ligjit”. Web: www.punetebrendshme.gov.al

Linku i dokumentarit: Policia e Shtetit në 2015 - Vit i rezultateve historike (dokumentar).

⁹⁸Analiza vjetore e Policisë së Shtetit 2015.

⁹⁹Po aty. Web: www.punetebrendshme.gov.al. Linku i dokumentarit: Policia e Shtetit në 2015-Vit i rezultateve historike (dokumentar).

¹⁰⁰Analiza vjetore e Policisë së Shtetit 2015.

evidentuar 50 vrasje të pazbuluara.¹⁰¹ Ndërsa, nga viti 1990-2015 janë vrarë në Shqipëri 6.310 persona. Ndërkohë gjatë këtij viti “fuqia zbuluese ka arritur shifrën 85%. Kjo shifër zbulueshmërie nuk është arritur asnjëherë, që prej vitit 1990.¹⁰² Gjatë këtij viti janë zhvilluar 70 operacione policore të sukseshme në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë, si dhe janë evidentuar 50 grupe kriminale të goditura me aktivitet në fushën e shitjes dhe trafikimit të narkotikëve, 240 operacioneve u zhvilluan për identifikimin dhe asgjësimin e bimëve narkotike. Ndërsa, operacioni më i suksesshëm është operacioni i koduar “Xibraka”, ku u sekuestrua 19 kg heroinë me 31 milionë euro që është vlera e asetëve të sekuestruara për pastrim të produkteve të veprës penale nga strukturat e Policisë së Shtetit.” Ndërkohë, në kuadër të ligjit “Antimafia”, sekuestrimet kapin vlerën e 19.4 milionë lekëve, rreth 3,4 milionë euro, mbi 4 milionë dollarë.¹⁰³ ”

Pavarësisht rezultateve të trajtuara, është me rëndësi t’u referohemi edhe studiuesve të fushës së krimit të organizuar. Dr. Fabian Zhilla, studiues i fushës së kriminologjisë dhe i studimeve të bëra për krimin e organizuar në Shqipëri, më datën 5 shtator 2015 ka botuar shkrimin “Lazaratizimi” i Shqipërisë, ku shprehet se *rishpërndarja e fenomenit të kultivimit të kanabisit po ndodh sot vetëm një vit pas mega-operacioneve të Lazaratit dhe Dukagjinit.*¹⁰⁴ Ai vijon, duke u shprehur për konfigurimin e ri të “hartës” së rritjes së kanabisit të shtetit shqiptar dhe fenomeni i “kombëtarizimit” të mbjelljes së kanabisit është diçka shumë serioze dhe si e tillë duhet trajtuar.¹⁰⁵

5.5. Kriminaliteti i organizuar, trafiku i qenieve njerëzore, terrorizmi dhe korrupsioni në Shqipëri, 2008-2015 - analizë krahasuese.

Me qëllim njohjen e së vërtetës, lidhur me saktësinë e statistikave zyrtare të institucioneve ligjzbatuese për gjendjen reale të kriminalitetit të organizuar në Shqipëri, 2008-2015, bëmë dy analiza krahasuese të statistikave zyrtare të Policisë së Shtetit, të Prokurorisë së Përgjithshme dhe të Ministrisë së Drejtësisë, në lidhje me të dhënat për

¹⁰¹ 50 vrasje të pazbuluara në vitet 2013-2015 konsiderohen “Grey figure” “shifra të përhimë” të kriminalitetit”, çka do të thotë që nuk janë zbuluar, dokumentuar e goditur autorët e këtyre vrasjeve (Dritan Shala, 2013:6).

¹⁰² Analiza vjetore e Policisë së Shtetit 2015.

¹⁰³ Po aty.


¹⁰⁴ <http://www.postbllok.com/lazaratizimi-i-shqiperise/>

¹⁰⁵ Po aty.

krimin e organizuar, trafikun e qenieve njerëzore, veprat penale me qëllime terrorizmi dhe për korrupsionin, si dhe analiza të veçanta mbi bazën e statistikave të institucioneve të Policisë së Shtetit, të Prokurorisë së Përgjithshme dhe të Ministrisë së Drejtësisë.

Tabela 5.19 paraqet krahasimin e statistikave zyrtare për veprat penale e çështjet e krimit të organizuar për periudhën 2008-2015. Sipas kësaj table rezultojnë që nga krahasimi i statistikave zyrtare për referimet nga Policia e Shtetit, hetimet në proces nga Prokuroria e Përgjithshme dhe vendimet e gjykatës (dënuar *me gjobë plus burg*), për veprat penale *krimi i organizuar*, sipas tabelës 5.19, rezultojnë mospërputhje dhe, konkretisht: referimet e Policisë së Shtetit për periudhën 2008-2015 në total janë evidentuar 25, hetime në proces 102 dhe vendime të gjykatës (dënuar *me gjobë plus burg*) 86.


Duke u referuar statistikave të Prokurorisë së Përgjithshme kemi bërë një analizë krahasuese në tabelën nr. 63 lidhur me referimet, procedimet dhe ndjekjen e çështjeve penale të krimit të organizuar, 2008-2015. Sipas statistikave zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme rezultojnë se janë evidentuar: 25 referime të Policisë së Shtetit, 1 mosfillim, 56 rregjistrime procedime penale, 102 në hetim, 22 procedime të pushuara, 8 procedime të pezulluara, 22 procedime ose çështje të dërguar në gjyq, 105 të pandehur të dërguar në gjyq dhe 96 vendime të gjykatës (dënuar *me gjobë plus burg*). Tabela 5.21 paraqet *veprat penale të krimit të organizuar, çështje penale, të dënuar, 2008-2014 sipas vjetarit të Ministrisë së Drejtësisë*. Në mënyrë tabelare të dhënat nga vjetarët e Ministrisë së Drejtësisë për figurat e veprave penale të krimit të organizuar, çështje penale, të dënuar për periudhën 2008-2014, rezultojnë se në rubrikën *dhënie ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit* janë evidentuar 219 çështje me 548 persona të dënuar, *marshtrimet dhe krimet ekonomike* 213 çështje me 251 të dënuar, *kontrabanda* 738 çështje me 777 të dënuar, *korupsioni* 200 çështje me 430 të dënuar, *prodhim, lehtësim dhe trafikim narkotikësh* 2668 çështje me 3.354 të dënuar, *trafikim të qenieve njerëzore dhe prostitucion* 344 çështje me 484 të dënuar, *krim i organizuar* 8 çështje me 32 të dënuar, dhe *trafikimi i armëve* 60 çështje me 59 të dënuar. Prodhim, lehtësim dhe trafikim narkotikësh ka numrin më të madh të çështjeve 2668, me 3.354 të dënuar. Gjithashtu, figura 5.9 paraqet statistika të Ministrisë së Drejtësisë në Shqipëri për figurat e veprave penale të krimit të organizuar, çështje penale, të dënuar, 2008-2014.



Burimi: Statistikat e vjetarëve të Ministrisë së Drejtësisë në Tiranë, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2013, 2014. Përpunim i Autorit (2016).

Figura 5.9 Veprat penale të krimit të organizuar, çështje penale, të dënuar, 2008-2014 sipas vjetarit të Ministrisë së Drejtësisë.

Ndërsa, tabela 5.22 dhe grafiku 5.7 evidentojnë numrin e çështjeve të gjykuara për veprat penale të krimit të organizuar dhe veprimtari të tjera kriminale, sipas vjetarëve të Ministrisë së Drejtësisë në Shqipëri, 2008-2014.



Burimi: Statistikat e vjetarëve të Ministrisë së Drejtësisë në Tiranë, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2013, 2014. Përpunim i autorit (2016).

Grafiku 5.7 Numri i çështjeve të gjykuara për veprat penale të krimit të organizuar sipas vjetarëve të Ministrisë së Drejtësisë në Shqipëri, 2008-2014.

Në mënyrë tabelore evidentohet se *veprat penale të prodhimit, të lehtësimit dhe të trafikimit të narkotikëve* për periudhën 2008-2015 në total janë 2.668, *kontrabanda* 738 çështje, *dhënie ndihme për kalim të paligjshëm të kufirit* 419, *trafikimi i qenieve njerëzore dhe prostitucion* 344, *mashtimet dhe krimet ekonomike* 213, *korupsioni* 200, *trafikimi i armëve* 60 dhe *grupe kriminale të krimit të organizuar* 8, në vetëm 7 vjet, ndërkohë që

paraqitja grafike evidenton që *veprat penale për prodhim, lehtësim dhe trafikim narkotikësh* kanë arritur nivelin më të lartë në vitin 2014 në krahasim me vitet e tjera.

Tabela 5.23 paraqet analizë krahasuese të statistikave zyrtare për veprën penale të trafikimit të qenieve njerëzore, midis Policisë së Shtetit dhe Ministrisë së Drejtësisë, 2008-2015. Sipas kësaj tablele, rezulton se sipas Policisë së Shtetit në vitin 2008, janë evidentuar 389 vepra penale, ndërsa Ministria e Drejtësisë ka evidentuar 64 çështje dhe 68 të dënuar. Në vitin 2009, 329 vepra penale me 69 çështje dhe 89 të dënuar, në vitin 2010 janë evidentuar 457 vepra penale kundrejt 46 çështjeve dhe 78 të dënuarve. Në vitin 2011 evidentohen 465 me 57 çështje dhe 83 të dënuar. Në vitin 2012, janë evidentuar 509 vepra penale me 40 çështje dhe 59 të dënuar. Në vitin 2013, janë evidentuar 387 vepra penale, kundrejt 30 çështjeve dhe 44 të dënuar. Në vitin 2014, janë evidentuar 444 vepra penale kundrejt 38 çështjeve dhe 63 të dënuarve. Gjatë vitit 2015 janë evidentuar në Shqipëri 401 vepra penale. Nga të dhënat e mësipërme rezulton se shifrat zyrtare nuk kanë përputhje të përafërt, por përkundrazi ato, sipas viteve dhe të dhënave të sipërpërmenduar, kanë diferencë të mëdha.

Tabela 5.24 paraqet krahasimin e statistikave zyrtare për veprat penale e çështjet me qëllime terroriste, 2008-2015. Nga krahasimi i statistikave zyrtare për referimet e Policisë së Shtetit nga Policia e Shtetit, hetimet në proces nga Prokuroria e Përgjithshme dhe vendimet e gjykatës (dënuar *me gjobë plus burg*), për veprat penale me qëllime terroriste sipas tabelës 5.25 rezultojnë se për periudhën 2008-2015, në total janë evidentuar referimet e Policisë së Shtetit 32, hetime në proces 59 dhe vendime të gjykatës (dënuar *me gjobë plus burg*) 7. Pra, ka mospërputhje të shifrave zyrtare midis këtyre institucioneve shtetërore. Gjithsesi, mbi bazën e të dhënave të mësipërme, nxirren konkluzione dhe përfundime për luftën kundër krimit të organizuar dhe rritjen e efektivitetit të punës së strukturave të Policisë së Shtetit e të policisë gjyqësore, si dhe të prokurorisë dhe të gjykatës.

Tabela 5.26 paraqet krahasimin e statistikave zyrtare për veprat penale e çështjet e korrupsionit për periudhën 2008-2015. Sipas kësaj tablele rezulton se nga krahasimi i statistikave zyrtare për referimet e Policisë së Shtetit nga Policia e Shtetit, hetimet në proces nga Prokuroria e Përgjithshme dhe vendimet e gjykatës (dënuar *me gjobë plus burg*), për veprat penale korrupsioni rezultojnë se në referimet e Policisë së Shtetit për periudhën

2008-2015 në total janë evidentuar 694, hetime në proces 1.031 ose 347 më shumë dhe vendime të gjykatës (dënuar *me gjobë plus burgim*).

Nga argumentet e mësipërme, arrihet në përfundimin se shifrat zyrtare të kriminalitetit midis institucioneve, si: Policia e Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme dhe Gjykatat kanë mospërputhje të dallueshme jashtë normales dhe, për rrjedhojë, përfundimet që nxirren mbi bazën e këtyre statistikave është vështirë për të qenë ekzaktësisht të sakta. Nëse diferencave në mospërputhjet e statistikave zyrtare ju shtojmë edhe “*shifrat errëta*” të kriminalitetit, “*shifrat e përhimtë*” të kriminalitetit dhe “*shifrat e tepërta*” të kriminalitetit, konkludohet se pavarësisht përpjekjeve shumë pozitive përfundimet mund të mos jenë të sakta. Prandaj, kërkohet të bëhet unifikimi i statistikave zyrtare të institucioneve shtetërore e të drejtësisë penale, si dhe të vlerësohen dhe të merren në konsideratë përveç statistikave zyrtare edhe “*shifrat e errëta*” të kriminalitetit, “*shifrat e përhimtë*” të kriminalitetit dhe “*shifrat e tepërta*” të kriminalitetit, sepse ato janë pjesë e gjendjes reale dhe praktike të kriminalitetit të organizuar dhe kriminalitetit në tërësi.

Sipas tabelës 5.27, nga të dhënat e Prokurorisë së Përgjithshme për referimet, procedimet dhe ndjekjen e çështjeve penale për korrupsionin, 2008-2015 rezultojnë se referimet e Policisë së Shtetit për vitet 2008-2015 janë 694, referime për kallëzime të tjera. Policia e Shtetit 224, mosfillime 111, rregjistrime procedime 884, gjithsej në hetim në procedime 1031, pushuar procedime 408, dërguar në gjygj procedime ose çështje 332, dërguar në gjygj të pandehur 595, vendime të gjykatës (dënuar *me gjobë plus burg*) 417, pafajësi 39, pushim akuze, pushim çështje 14.

Në total, nga analiza krahasimore e statistikave zyrtare të Drejtorisë së Policisë së Shtetit, Prokurorisë së Përgjithshme dhe të Ministrisë së Drejtësisë për veprën penale të *korrupsionit* për periudhën 2008-2015, rezulton se në vitin 2008, vepra penale, sipas Policisë së Shtetit, janë evidentuar 389, Prokuroria e Përgjithshme ka evidentuar 330, ndërsa Ministria e Drejtësisë 64 çështje dhe 68 të dënuar. Në vitin 2009 janë evidentuar nga Policia e Shtetit, 329 vepra penale, Prokuroria e Përgjithshme 327, Ministria e Drejtësisë me 69 çështje dhe 89 të dënuar. Në vitin 2010 janë evidentuar nga Policia e Shtetit 457 vepra penale, Prokuroria e Përgjithshme 658, Ministria e Drejtësisë kundrejt 46 çështjeve dhe 78 të dënuarve. Në vitin 2011 evidentohen nga Policia e Shtetit 465, Prokuroria e Përgjithshme 436, Ministria e Drejtësisë me 57 çështje dhe 83 të dënuar. Në vitin 2012 janë

evidentuar 509 vepra penale, Prokuroria e Përgjithshme 337, Ministria e Drejtësisë me 40 çështje dhe 59 të dënuar. Në vitin 2013 janë evidentuar 387 vepra penale, Prokuroria e Përgjithshme 590, Ministria e Drejtësisë kundrejt 30 çështjeve dhe 44 të dënuar. Në vitin 2014 janë evidentuar 444 vepra penale, Prokuroria e Përgjithshme 761, Ministria e Drejtësisë 38 çështje dhe 63 të dënuar. Në vitin 2015 në Shqipëri janë evidentuar nga Policia e Shtetit 401 vepra penale dhe 1180 çështje nga Prokuroria e Përgjithshme. Nga të dhënat e mësipërme rezulton se shifrat zyrtare nuk kanë përputhje të përafërt, por përkundrazi ato, sipas viteve dhe të dhënave të sipërpërmenduara, kanë diferenca të mëdha.

5.6. Masat e sigurisë dhe zgjidhja e tyre, 2008-2015.

Masat e sigurisë dhe zgjidhja e tyre për periudhën 2008-2015 paraqitet ne formë tabelare në tabelën 5.28.

Nga paraqitja grafike evidentohet se për periudhën 2008-2015 janë paraqitur 34.584 kërkesa për vendime arresti nga prokuroria dhe nga gjykata janë marrë 31.900 vendime arresti, ndërkohë që në total zgjidhja e çështjeve, sipas tabelës së mësipërme, është 4.974. Ndërsa, tabela 5.29 paraqet numrin e shtetasve nga Shqipëria, të paraburgosur dhe të dënuar/burgosur në Shqipëri, për periudhën 2008-2015. Në mënyrë tabelare të dhënat sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për numrin e personave të paraburgosur dhe të dënuar në Shqipëri për periudhën 2008-2015 rezultojnë se janë të paraburgosur gjithsej 2.574, të dënuar 2.881 dhe 5.455 gjithsej. Në rubrikën “Organizata kriminale” evidentohen 7 të paraburgosur dhe 14 të dënuar ose 21 gjithsej. Në rubrikën “Drogë” evidentohen 634 të paraburgosur dhe 498 të dënuar ose 1.132 gjithsej. Në rubrikën “Shfrytëzim prostitucioni” 48 të paraburgosur dhe 29 të dënuar ose 77 gjithsej.

5.7. Veprimtaritë kriminale të organizuara më të përhapura në Republikën e Kosovës.

Ashtu siç e theksuam edhe në kapituj të tjerë, demokracia dhe funksionaliteti i shtetit në Kosovë dhe institucioneve të saj datojnë pas 17 Shkurtit 2008. Një ndër institucionet më kryesore për luftën kundër veprimtarive kriminale të organizuara dhe për sigurimin e jetës, rendit, sigurisë së qytetarëve në Kosovë është Policia e Kosovës. Policia e

Republikës së Kosovës u formua me 6 shtator 1999 nën mandatin e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Sipas Rezolutës fillimisht është vendosur policia civile ndërkombëtare e Kombeve të Bashkuara, e pastaj është krijuar Policia e Republikës së Kosovës, theksohet në Raportin Vjetor 2009 të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë Kosovë. Në këtë raport theksohet: “Në raport me popullatën ne kemi rreth 357 zyrtarë policorë për 100.000 banorë, ndërkohë që mesatarja e disa shteteve të Bashkimit Evropian është 352 policë për 100.000 banorë. Përfaqësimi etnik i gjitha grupeve etnike në brendinë e Policisë së Republikës së Kosovës përfshinë 11 grupe etnike. Përfaqësimi gjinor (femëror) është 13.59% e numrit të përgjithshëm në policinë e Republikës së Kosovës dhe 8.8% në pozita udhëheqëse. Raporti vjetor i policisë së Kosovës për vitin 2008, për aktivitetin e këtij institucioni është raporti i parë pas Shpalljes së Pavarësisë të Vendit.”¹⁰⁶ Në vitin 2008 Policia e Kosovës numëronte rreth 8700 punonjës, prej tyre rreth 7000 zyrtarë policorë (të trajnuar brenda tridhjetë e pesë gjenerata (rreth 570 oficerë të divizionit të sigurimit ka filluar ndryshimi i statusit të tyre në zyrtarë policorë, si dhe janë 1131 punonjës të angazhuar në pozita mbështetëse dhe administrative. Në vitin 2009 janë hartuar nga grupet e punës dhe janë miratuar nga qeveria e Kosovës “Strategjia shtetërore kundër krimit të organizuar dhe planit të veprimit”, “Strategjia kundër trafikimit të qenieve njerëzore”, “strategjia kundër drogave”, si dhe janë marrë masa për zbatimin e tyre.

Me qëllim njohjen e gjendjes së kriminalitetit të organizuar dhe problematikave gjatë vitit të parë të shpalljes së pavarësisë, i referohemi vitit 2008, lidhur me veprën penale *krimi i organizuar*, neni 274, prokuroritë e Kosovës gjatë vitit raportues kanë pranuar në punë 14 kallëzime penale me 80 persona. Gjatë vitit 2008 prokuroritë kanë zgjedhur rastet e 53 ose të 42,0% të personave, ndërsa në fund të periudhës raportuese kanë mbetur të pazgjidhura 11 kallëzime penale me 73 persona. Nga rastet e zgjidhura 50 ose 94,3 % e paraqitjeve penale kanë përfunduar me ngritje të akuzës pas procedurës hetimore. Në vitin raportues, krahasuar me vitin paraprak, numri i fletëparaqitjeve për veprat penale *krimi i organizuar* është rritur për 77 fletëparaqitje penale.¹⁰⁷ Raporti vijon se koeficienti i zgjidhshmërisë së rasteve për veprat penale - *krimi i organizuar* është 42 %, krahasuar me

¹⁰⁶Deklaratë e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës, Gjeneral Sheremet Ahmeti, Raporti vjetor 2008 i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë Kosovë.

¹⁰⁷ http://www.psh-ks.net/repository/docs/Raporti_Vjetor_2008-Prokurori_i_Shtetit1.pdf

koeficientin e zgjidhshmërisë së rasteve në përgjithësi 80,7%, del se koeficienti i zgjidhshmërisë për rastet e krimit të organizuar në veçanti është shumë më i ulët për 38,8%.

Prokuroria Speciale e Kosovës (PSK) kanë pranuar 4 kallëzime penale me 7 persona, për veprën penale *shpërlarja e parave* (Rregullore 2004/2). Ajo ka zgjidhur 8 raste ose 44,4% të personave, kanë mbetur të pazgjidhura 6 kallëzime penale me 10 ose 55,6% të personave, ndërkohë që shkalla e zgjidhshmërisë së çështjeve është e ulët, duke e krahasuar, me shkallën e zgjidhshmërisë në përgjithësi (80,8%). Gjithashtu, janë zbuluar 181 raste ose 1,4 % të autorëve të panjohur, ndërsa 1307 ose 10,1 % të kallëzimeve janë hedhur poshtë nga prokurorët për shkak të parashkrimit. Pra, evidentohet se shkalla e zbulueshmërisë nga ana e Policisë së Kosovës është shumë e vogël vetëm 1,4%, dhe kjo shifër është shqetësuese. Ndërkohë, që është e pakuptimtë dhe e padrejtë që të jesh i ngarkuar me 0,1% të kallëzimeve penale e t'i kesh 10,9 % të kuadrove, siç i ka Prokuroria Speciale e Kosovës ose PSK u përkasin 81,7% të kallëzimeve – lëndëve kurse 50,8% të stafit civil.¹⁰⁸ Administrata e prokurorive nuk ka kushte normale për kryerjen e punëve administrative, nga 5 persona punojnë në një zyrë. Ndërkohë, problem serioz për çështjen e hapësirave paraqet Prokuroria Publike e Mitrovicës, e cila më shumë se një vit është përzënë nga ndërtesa e prokurorive në veri të Mitrovicës. Në fakt këto prokurori po kryejnë vetëm çështjet emergjente dhe për këtë arsye këto prokurori nuk kanë dërguar raport për vitin 2008.

Gjatë vitit 2009, nga Policia e Kosovës dhe nga prokuroritë, janë pranuar në punë 278 kallëzime penale me 340 persona, por duke shtuar edhe 320 personave, të cilat kanë mbetur të pazgjidhura nga viti 2008, janë pranuar kallëzimet për 660 persona. Ndërkohë, janë zgjidhur rastet e 373 personave, dhe në fund të vitit kanë mbetur të pazgjidhura 287 raste ose 43,5% personave me 135 kallëzime penale ose lëndë penale. Gjendja për këto vepra penale, në vitin raportues është përkeqësuar nga se PSRK-u nën mandatin e UNMIK-ut, në vitin 2008 kishte raportuar, që nuk ka as një paraqitje penale të këtij lloji të pazgjidhur. Në raportin e viti 2009, PSRK-u nën mandatin e EULEX-it ka raportuar se nga viti 2008, janë trashëguar rastet e 102 personave si të pazgjidhura, prandaj për këtë në fund

¹⁰⁸Raport për punën e Prokurorive Publike të Republikës së Kosovës për vitin 2008.
http://www.psh-ks.net/repository/docs/Raporti_Vjetor_2008-Prokurori_i_Shtetit1.pdf

të vitit raportues është zmadhuar numri i paraqitjeve të pazgjidhura.¹⁰⁹ Nga kallëzimet penale të pranura apo të rregjistruara në punë gjatë vitit raportues (131), 78 ose 59,6% të kallëzimeve janë parashtruar nga policia e Kosovës, 42 ose 32,1% janë parashtruar nga Prokurori Publik drejtpërsëdrejti, 2 ose 1,5% nga Agjencioni Kosovar kundër Korrupsionit, 4 ose 3,0 % janë parashtruar nga qytetari i dëmtuar, 2 ose 1,5% të kallëzimeve janë parashtruar nga Qendra e Informacionit Financiar dhe 3 ose 2,3% të kallëzimeve janë parashtruar nga të tjerët.

PSK-u i ka pasur në punë rastet e 1574 personave dhe i ka pranuar në punë gjatë vitit 2009: 10 ose 2,7% të personave të dyshuar për veprat penale të terrorizmit (neni 110, 111, 112 dhe 113 KPK); 152 ose 40,6% të personave janë të dyshuar për veprat penale të krimeve kundër të drejtës ndërkombëtare (neni 117, 118, 119, 120 dhe 121 KPK); 96 ose 25,7% të personave janë të dyshuar për veprat penale të krimit të organizuar (neni 274 KPK); 38 ose 10,1 % të personave janë të dyshuar për veprat penale shpërlarja e parave (Rregullore 2004/2).


Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare në vitin raportues ka pësuar rënie, krahasuar me vitin paraprak për 48 ose 38,4 % të paraqitjeve. 285 ose 1,2% të paraqitjeve penale i përkasin kapitullit XIV (veprat penale kundër të drejtës ndërkombëtare). Numri më i madh i veprave penale që i përket veprës penale nga neni 120 - *krime të luftës për shkelje të rëndë*- të nenit 3 të Konventës së Gjenevës me 126 ose 44,2%, veprat penale nga neni 137, 138, 139 dhe neni 140, të ashtuquajturat *veprat penale të trafikimit me qenie njerëzore*, marrin pjesë me 122 ose 42,8% të paraqitjeve penale. Ndërsa, veprat penale nga neni 137 *vendosja e skllavërisë*, në vitin raportues është zvogëluar për 39 raste, ndërsa veprat penale nga neni 138 *kontrabandimi me emigrant* është zmadhuar për 31 persona, gjithashtu, dhe veprat penale nga neni 139 *trafikimi me njerëz* është zmadhuar për 13 persona. Lidhur me veprën penale *krimi i organizuar*, Prokuroritë e Kosovës gjatë vitit raportues kanë pranuar 20 kallëzime penale me 118 persona, plus edhe rastet e 102 personave kanë mbetur të pazgjidhura nga periudha paraprake. Koeficienti i zgjedhshmërisë së rasteve për veprat penale, i organizuar është 32,7%, krahasuar me koeficientin e zgjedhshmërisë së rasteve në përgjithësi 74,2%, rezulton se koeficienti i zgjedhshmërisë për rastet e krimit të organizuar

¹⁰⁹ Raport për punën e Prokurorive Publike të Republikës së Kosovës për vitin 2008.
http://www.psh-ks.net/repository/docs/Raporti_Vjetor_2008-Prokurori_i_Shtetit1.pdf

në veçanti është shumë më i ulët. Gjatë vitit 2009, institucionet relevante kanë rregjistruar 222 kallëzime penale me 437 persona plus edhe rastet e 303 personave të cilët kanë mbetur të pazgjdhura nga viti 2008, atëherë rezulton se gjithsej çështje penale të rregjistruara apo të pranura evidentohet se kanë qenë rastet e 740 personave që kanë të bëjnë me veprat penale të korrupsionit. Ndërsa, për veprat penale të shpërlarjes së parave, janë rregjistruar apo ka pranuar në punë Prokuroria Speciale, 10 kallëzime penale me 38 persona, ka zgjidhur rastet 5 ose 11,6% të personave. Për veprat penale krimi i drogës janë rregjistruar 17 ose 100% të fletëparaqitjeve penale. Rënia e numrit të veprave penale përkatësisht me drogën nuk është reale ose sipas kësaj rezulton se, trafikimi dhe përdorimi i drogës është i legalizuar. Ndërsa, gjatë vitit 2009, janë paraqitur 13355 kallëzime, duke rritur për 30% kriminalitetin e organizuar.

Mbi bazën e pyetësorit të përgatitur në lidhje me veprimtaritë kriminale të organizuara më të përhapura në Republikën e Kosovës janë përgjigjur të intervistuarit me qëllim marrjen e opinioneve të tyre nga eksperiencia dhe përvoja e ekspertëve në Shqipëri, në Kosovë dhe ekspertëve ndërkombëtarë dhe arritjen e konkluzioneve dhe dhënies së sugjerimeve për zhvillimin e një lufte më të ashpër ndaj tyre.

Në figurën 5.10 paraqesim veprimtaritë kriminale të organizuara, më të përhapura në Kosovë.



Burimi: Pyetësi nr.1 “Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri-Kosovë, 2008-2015”, plotësuar nga personalitete publike dhe ekspertë të sigurisë e të drejtësisë në Shqipëri, në Kosovë dhe ekspertë ndërkombëtarë. Përpunim i autorit (2016).

Figura 5.10 Veprimtaritë kriminale të organizuara, më të përhapura në Kosovë.

Sipas këtij grafiku, nga pyetjet e të intervistuarve rezultojnë se veprimtaritë kriminale të organizuara, më të përhapura në Kosovë për periudhën 2008 -2015 janë: korrupsioni, trafiku i drogës dhe pastrimi i parave.

PhD Walter Schwimmer, në lidhje me pyetjen: Cilat janë aktivitetet më të përhapura të krimit të organizuar në Republikën e Kosovës?, shprehet për *korruptionin*, njësoj si në Shqipëri:

”Korrupsioni minon besimin në atë të qeverisë, të institucioneve të qeverisë dhe është një kancer që shkatërron shtetin. Nëse popullsia nuk i beson shtetit ata do të kërkojnë ta lënë atë. Ata që do ta ketë të lehtë të largohen janë të arsimuarit, të cilët kanë aftësinë që janë të tregtueshëm në shtetet e tjera. Si rezultat ata që kanë më shumë për të ofruar largohen dhe zhvillimi i shtetit vuan si rezultat i kësaj.”¹¹⁰ ”

Në figurën 5.11 paraqesim veprimtaritë kriminale të organizuara, më pak të përhapura në Kosovë.




Burimi: Pyetësi I “Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri-Kosovë, 2008-2015”, plotësuar nga personalitete publike dhe ekspertë të sigurisë e të drejtësisë në Shqipëri, në Kosovë dhe ekspertë ndërkombëtarë. Përpunim i autorit (2016).

Figura 5.11 Veprimtaritë kriminale të organizuara, më pak të përhapura në Kosovë.

Sipas grafikut, rezultojnë se veprimtaritë kriminale të organizuara, më pak të përhapura në Kosovë për periudhën 2008-2015 janë: *trafikimi i armëve* 0.09%, *kontrabandimi i emigrantëve* 0.08%, *trafikimi i qenieve njerëzore* 0.07%, *terrorizmi* 0.06%, *krimi i organizuar kibernetik*, *gjobëvënia* dhe *vrastet me pagesë* 0.02%. Në tabelën 5.30 bëhet një shpjegim i grafikëve sipas formave të manifestimit të krimit të organizuar.

¹¹⁰ Intervista është marrë nga autori me datën 27.11.2015.



Burimi: Pyetësi 2 “Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri- Kosovë, 2008-2015”, plotësuar nga studentët e fakulteteve të Drejtësisë dhe të Sigurisë në Prishtinë dhe në Tiranë). Përpunim i autorit (2016).

Figura 5.12 Veprimtaritë kriminale të organizuara më të përhapura në Republikën e Kosovës (Anketimi i studentëve).¹¹¹

Sipas të dhënave të tabelës 5.31 dhe figurës 5.12 rezulton se 702 studentë i janë përgjigjur kështu pyetësit nr. 2. Këto veprimtari janë:

1. trafikimi i drogës 78%;
2. korrupsioni 9%;
3. pastrimi i parave 7%;
4. trafikimi i qenieve njerëzore 3%;
5. kontrabandimi i emigrantëve 2%;
6. trafikimi i armëve 2%;
7. gjobëvënia 1%;
8. vrasjet me pagesë 1%;
9. nuk e di/pa përgjigje 1%.

Nga krahasimi i përgjigjeve të pyetësorëve, të plotësuar nga politikanët dhe ekspertët e sigurisë, si dhe nga përgjigjet e anketimit të studentëve për veprimtaritë kriminale të organizuara më të përhapura në Republikën e Kosovës rezulton se në rastin e parë janë evidentuar: 1. trafikimi i drogës; 2. korrupsioni; 3. pastrimi i parave; 4. trafiku i armëve 5. kontrabandimi i emigrantëve; 6. trafikimi i qenieve njerëzore; 7. terrorizmi; 8. krimi i organizuar kibernetik; 9. gjobëvënia dhe 10. vrasjet me pagesë. Ndërsa, anketimi i

¹¹¹ Theksojmë se të anketuarit kanë pasur të drejtën e dhënies vetëm të një përgjigjeje (vetëm një mundësi përzgjedhjeje).

studentëve ka evidentuar: trafikimin e drogës; korrupsionin; pastrimin e parave; trafikimin e qnieve njerëzore; kontrabandimin e emigrantëve; trafikimin e armëve; gjobëvënien; dhe vrasjet me pagesë. Pra, nga analizimi i përgjigjeve të pyetësorëve të 767 të anketuarve rezulton se tri veprimtaritë kriminale të organizuara, më të përhapura në Shqipëri janë: 1.korrupsioni; 2. trafikimi i drogës; 3. pastrimi i parave.

Nga analiza krahasimore e veprimtarive kriminale më të organizuara në Shqipëri, dhe në Kosovë rezulton se në Shqipëri veprimtaria e parë është *trafikimi i drogës*, veprimtaria e dytë *korupsioni* dhe veprimtaria e tretë është pastrimi i parave, ndërkohë që në Kosovë veprimtari e parë është *korupsioni*, pastaj *trafikimi i drogës* dhe *pastrimi i parave*. Analisti Ferdinand Dervishi shprehet: “Problemi më kryesor mbetet korrupsioni i përhapur në të gjithë sferat e jetës dhe veprimtarisë së shoqërisë. Aktualisht marrja me politikë apo politika si profesion konceptohet si mënyra më e mirë, me e shpejtë dhe më e rehatshme për të arritur në një kohë të shkurtër ato që një qytetar duhet të arrijë duke punuar gjithë jetën. Për fat të keq, deri tani asnjë forcë politike nuk premtion të shërojë këtë plagë të shoqërisë sonë.¹¹²”

Tabela 5.32 paraqet statistikën e krimit të organizuar, sipas Policisë në Kosovë për periudhën 2008-2013¹¹³ sipas së cilës evidentohen disa nga format e manifestimit të krimit të organizuar më të dhëna konkrete. Tabela 3.33 paraqet viktimat e trafikimit të identifikuar në Kosovë, 2008-2013.¹¹⁴ Në mënyrë tabelare *viktimat e trafikimit të identifikuar*, sipas origjinës në Kosovë për periudhën 2008-2013 rezulton se janë gjithsej 249 viktima/të dëmtuar, nga të cilët 117 shtetas nga Kosova, 22 shtetas nga Shqipëria, 36 nga Moldavia, 9 shtetas serbë, 2 bullgarë, 1 polakë dhe 2 shtetas të tjerë. Numrin më të lartë të viktimave rezultojnë ta kenë vitet 2012 me 54 viktima dhe viti 2013 me 52 viktima.

Tabelat 5.34 dhe 5.35 paraqesin *sasitë e drogave të sekuestruara* në Kosovë, 2008-2012.¹¹⁵ Në mënyrë tabelare sasitë e drogave të sekuestruara në Kosovë për periudhën 2008-2012, janë: heroina 290832.68, marihuana 1875055.35, hashashi 550.8, kokainë 13951.26, bimë të kanabisit 66658, ekstazy 3220 dhe droga të tjera 10059.17. Në mënyrë

¹¹² Ferdinand Dervishi, autor i cituar.

¹¹³ http://www.pk-ks.net/repository/docs/Raporti_Vjetor_2008,2009,2010,2011,2012,2013-Policia_e_Kosoves.pdf

¹¹⁴ http://www.pk-ks.net/repository/docs/Raporti_Vjetor_2008,2009,2010,2011,2012,2013-Policia_e_Kosoves.pdf

¹¹⁵ http://www.pk-ks.net/repository/docs/Raporti_Vjetor_2008,2009,2010,2011,2012-Policia_e_Kosoves.pdf

tabelare sasitë e drogave të sekuestruara në Kosovë për periudhën 2008-2012, janë raste 1.722, kultivimi 212, posedimi 979, trafikimi 587, të dyshimtë 2578. Tabela 5.36 paraqet të dhënat për autorët e krimeve të organizuara në Kosovë, 2008-2012.¹¹⁶ Në mënyrë tabelare të dhënat për autorët e krimeve të organizuara në Kosovë për periudhën 2008-2012 janë: meshkuj 2484, femra 94, shtetas shqiptarë të Kosovës 2384, serbë 68 dhe 126 të tjerë. Tabela 5.37 paraqet konfiskimet e drogave dhe mjeteve të tjera në Kosovë në vitet 2011 e 2012 dhe ndryshimi i tyre në përqindje.¹¹⁷

Ndërsa, tabela 5.38 paraqet personat e arrestuar dhe të ndaluar për vitet 2011 e 2012 në Kosovë dhe ndryshimi e përqindja e tyre.¹¹⁸ Tabela 5.39 paraqet operacionet policore për vitet 2011 e 2012 në Kosovë si dhe ndryshimi e përqindja e tyre,¹¹⁹ sipas së cilës rezulton se në vitin 2011, janë organizuar 186 operacione ndërsa, në vitin 2012, 162 operacione. Rëndësia e operacioneve policore dhe hetimore të përbashkëta merr një rëndësi të madhe dhe është vendimtare për të luftuar me sukses krimin e organizuar “kombëtar” apo “nacional”, “ndërshtetëror” apo transnacional. Operacione të përbashkëta si operacioni “tranziti” i cili godet grupin kriminal për ‘posedim, shpërndarje të paautorizuar të substancave narkotike’ në Prishtinë me 6 Shtator 2013. Ky operacion i drejtuar nga PSK-u në marrëveshje e bashkëpunim me Policinë e shtetit shqiptar, Guardia Di Financa të Italisë dhe Policisë Zvicerane, Policia e Kosovës ka kryer me sukses operacionin e përbashkët, të koduar “Tranzit-billy 2”, ku u arrestuan 4 persona të dyshuar dhe u sekuestruan 102,5 kg. lëndë narkotike.¹²⁰ Ndërsa, me 21 dhe 22 tetor 2013 Policia e Kosovës, e mbështetur nga NJHKO-u e EULEX-i, i ka zhvilluar tri operacione të kontrollit të banesës dhe ambjenteve të tjera/bastisjes në Kosovë, ku u konfiskuan një numër i armëve, operacion i cili u zhvillua në kuadër të një operacioni të madh për trafikimin e drogës që u zhvillua në Itali kishin të bënin me trafikimin e drogës. Policia italiane ndërmori veprime për zbatimin e 71 urdhër-arresteve dhe kryerjen e 117 kontrolleve apo bastisjeve me bashkëpunimin e agjencive për zbatimin e ligjit të Shqipërisë, të Kosovës, të Bosnjë Hercegovinës, Kroacisë, Sllovenisë dhe të Austrisë. Mbi 700 kilogramë drogë u konfiskuan pas zbulimit të një rrjeti

¹¹⁶ http://www.pk-ks.net/repository/docs/Raporti_Vjetor_2008,2009,2010,2011,2012-Policia_e_Kosoves.pdf

¹¹⁷ http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr_529_2015-Raporti_Vjetor_2011,2012-Prokurori_i_Shtetit1.pdf

¹¹⁸ http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr_529_2015-Raporti_Vjetor_2011,2012-Prokurori_i_Shtetit1.pdf

¹¹⁹ http://www.pk-ks.net/repository/docs/Raporti_Vjetor_2011,2012-Policia_e_Kosoves.pdf

¹²⁰ Njoftim për shtyp i Policisë së Kosovës datë 22 tetor 2013.

¹²⁰ Njoftim për shtyp i Policisë së Kosovës datë 6 Shtator 2013.

ndërkombëtar që importonte drogë në Itali përmes Ballkanit.¹²¹ Në një konferencë ndërkombëtare për shtyp e cila u mbajt në L'Aquila, Itali, Shefi i Njësisë Hetimore të Krimit të Organizuar, Alan Edwards, u shpreh: *“Operacioni, i cili është kryer në mbarë Evropën, tregon se si bashkëpunimi dhe bashkërendimi i agjencive për zbatimin e ligjit mund ta luftojë krimin në mënyrë të suksesshme dhe ta bëjë Evropën një vend më të sigurt për komunitetin e saj.* (Alan Edwards :2013). Ndërsa zyrtari i Policisë së Kosovës, theksoi se Policia e Kosovës është e gatshme të përfshihet dhe të bashkëpunojë ngushtë me Policinë e EULEX-it për t'i luftuar grupet transnacionale të krimit të organizuar. Këto operacione policore dhe hetimore të përbashkëta tregojnë rëndësinë e madhe që ka bashkëpunimi midis agjencive të zbatimit të ligjit në Kosovë dhe bashkëpunimit të tyre të ngushtë me agjencitë ligjzbatuese të Shqipërisë dhe të vendeve të tjera të rajonit e më gjërë si dhe me organizatat ndërkombëtare relevante.

Megjithatë, përveç shifrave zyrtare të evidentuara në raportet vjetore të institucioneve shtetërore ekzistojnë edhe shifrat e *“numrit të errët”*, *“numrit të përhimtë”* dhe *“numrit të tepërt”* të kriminalitetit. Në rastin konkret i referohemi *“numrit të përhimtë”* (Dritan Shala, 2013 : 6) të kriminalitetit, *“Grey figure”* (rastet e njohura, të denoncuar e të rregjistruara të kriminalitetit të cilat nuk janë zbuluar, zbardhur, ndriçuar e dokumentuar ligjërisht deri në fund nga organet kompetente). Kështu, *“numri i kryesve të panjohur të veprave penale për rrethanat në të cilat gjendet shteti i Kosovës është i madh (31,2%), mirëpo krahasuar me numrin e kryesve të panjohur që i kishte Republika e Kroacisë në vitin 2007 (42.4%), atëherë del se numri i kryesve të panjohur në Republikën e Kosovës është për 11,2% më i vogël së në Kroaci.*¹²²

Në këtë kapitull, është me interes të theksojmë se dimensionin fenomenologjik i kriminalitetit ka të bëjë me përfshirjen, shpjegimin dhe përmbajtjen nga fusha e fenomenologjisë kriminale,¹²³ e statistikave e dinamikës së kriminalitetit, si dhe tipologjia e kriminalitetit e të dhënave krahasuese mbi kriminalitetin. Në këtë kuadër marrin vlerë të veçantë statistikat e fenomenit kriminal, domethënë të kriminalitetit. Është me rëndësi të ndërjegjësohemi të pranojmë dhe pastaj të nxjerrim detyra për të ardhmen se kemi disa

¹²¹Njoftim për shtyp i Policisë së Kosovës, datë 22 tetor 2013.

¹²²Raporti i punës së Prokurorive Publike të Republikës së Kosovës për vitin 2008.

http://www.psh-ks.net/repository/docs/Raporti_Vjetor_2008,-Prokurori_i_Shtetit1.pdf.

¹²³Përbën një sferë të posaçme të kriminologjisë e cila studion format e kriminalitetit, strukturën e tij, strukturën e ndryshimit të kriminalitetit dhe dinamikën e kriminalitetit.

lloje të grupeve të të dhënave kriminale. *Së pari*, grupi i të dhënave apo informacioneve zyrtare,¹²⁴ i cili ende nuk ka një statistikë të unifikuar midis institucioneve të drejtësisë penale, duke përfshirë edhe Policinë e Shtetit, sepse ne konstatuam mospërputhje, mosrakordim në disa drejtime të statistikave zyrtare të disa institucioneve ligjzbatuese. *Së dyti*, grupi i të dhënave apo informacioneve jozyrtare. Ky grup i të dhënave klasifikohet në tri nëngrupe;

1. Shifrat e “*numrit të errët*” (Dritan Shala, 2013:6) apo “*të pandriçuara*”, “*të padenoncuar*” të kriminalitetit. Këto janë rastet e kriminalitetit të cilat nuk janë denoncuar dhe nuk njihen nga organet kompetente, pra, nuk dihen dhe kjo shifër mbetet e errët.

2. Shifrat e “*numrit të përhimtë*” (*Grey figure*) (Shala, 2013:6) të kriminalitetit. Këto janë rastet e njohura, të denoncuar e të rregjistruara të kriminalitetit të cilat nuk janë zbuluar, zbardhur, ndriçuar e dokumentuar ligjërisht deri në fund nga organet kompetente.

3. Shifrat e “*numrit të tepërt*” (Shala, 2013:6) “*errësim të gjendjes*”, shifra të ekzagjeruara të kriminalitetit. Këto janë rastet e evidencimit të kriminalitetit të bëra publike, të mediatizuara, dhe akuza të përgjithshme të individëve dhe palëve politike në kuvend e media, apo raporte të OJQ-^{ve} të ndryshme me shifra të ekzagjeruara të numrit të autorëve e viktimave të trafikuar, prostitucionit, trafikimit të fëmijëve, etj. Këto shifra të ekzagjeruara i përdorin për qëllime të përfitimeve të projekteve. Ndërsa, akuzat e opozitave politike shpesh bëhen me shifra të ekzagjeruara të kriminalitetit, të autorësisë, viktimave, korrupsionit etj. për të akuzuar e zbehur punën e mazhorancave politike në pushtet, dhe për përfitime e kapital politik të votuesit. Pra, këto akuza e publikime mediatike, por jo vetëm, bëhen për krime që nuk kanë ndodhur, por që propagandohen se kanë ndodhur.

Informacionet apo të dhënat zyrtare evidentohen në formë të regjistruar, domethënë të evidentuara nga Policia e Shtetit apo policitë e tjera të krijuara me ligj të veçantë, (statistika policore), informacionet, apo të dhënat mbi të akuzuarit (statistika e prokurorisë), të dhënat mbi të gjykuarit (statistika të gjykatave), dhe të dhënat mbi sanksionet e ekzekutuara penale (statistika të institucioneve për ekzekutimin e sanksioneve penale, dënimi i të dënuarve, sekuestrimet e konfiskimet e pasurive etj).

¹²⁴Shënim i autorit: Shifrat zyrtare bazohen në të dhënat zyrtare të institucioneve të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës.

Shqipëria dhe Kosova lypet të trajtojnë më me seriozitet çështjet e evidentimit, rregjistrimit, zbulimit të autorëve të veprave penale, dokumentimit ligjor dhe goditjes e luftimit të grupeve kriminale të organizuara. Siç doli edhe nga studimi, përvoja e këtyre viteve ka evidentuar edhe shifra të “*numrit të errët*” të “*numrit të përhimtë*” dhe të “*numrit të tepërt*” të kriminalitetit. Lypet të bëhen hulumtime dhe studime në të ardhmen me qëllim marrjen seriozisht me këto shqetësime të komunitetit për gjendjen reale dhe të vërtetë të kriminalitetit të grupeve kriminale të organizuara në Shqipëri dhe në Kosovë.

5.8 Përmbledhje.

Ky ishte ndër kapitujt më të rëndësishëm të hulumtimit, sepse trajtoi veprimtaritë kriminale të organizuara, më të përhapura në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën e Kosovës. Hulumtimi u realizua mbi baza lokale dhe krahasuese për veprimtaritë kriminale të organizuara si: trafikimi i drogës, trafikimi i qenieve njerëzore, kontrabandimi i emigrantëve, trafikimi i armëve, gjobëvënia, vrasjet me pagesë, krimi i organizuar kibernetik, pastrimi i parave, terrorizmi dhe korrupsioni.

Nga analiza krahasimore e veprimtarive kriminale më të organizuara në Shqipëri, dhe në Kosovë rezulton se në Shqipëri veprimtaria e parë është *trafikimi i drogës*, veprimtaria e dytë është *korupsioni* dhe veprimtaria e tretë është *pastrimi i parave*, ndërkohë që në Kosovë veprimtari e parë është *korupsioni*, pastaj *trafikimi i drogës* dhe *pastrimi i parave*. Gjithashtu, në këtë kapitull trajtohet edhe konstatimi i disa mospërputhjeve të shifrave zyrtare të veprimtarive kriminale të organizuara midis këtyre institucioneve. Përveç diferencave në mospërputhjet e statistikave zyrtare ekzistojnë edhe “*shifrat errëta*”, “*shifrat e përhimtë*” dhe “*shifrat e tepërta*” të kriminalitetit, të cilat ndikojnë në mosnjohjen e gjendjes reale të kriminalitetit. Prandaj, kërkohet të bëhet unifikimi i statistikave zyrtare të institucioneve shtetërore e të drejtësisë penale, dhe të merren në konsideratë edhe keto shifra të “*pa njohura*” të kriminalitetit. Pyetjet kërkimore bazë që studimi ngre, nëpërmjet këtij kapitulli, u verifikuan dhe u testuan, por edhe për çështjet që do të trajtohen në kapitullin në vijim, përbëjnë “bërthamën” e trajtimit të detajuar të krimit të organizuar dhe krimit të organizuar transnacional. Kapitulli që vijon, trajton krimin e organizuar transnacional Shqipëri, Kosovë, Rajon- analizë krahasuese.

KAPITULLI VI: KRIMI I ORGANIZUAR TRANSNACIONAL SHQIPËRI-KOSOVË-RAJON-ANALIZË KRAHASUESE.

6.1. Hyrje.

Në këtë kapitull paraqitet hulumtimi i krimit të organizuar transnacional Shqipëri-Kosovë-rajon, analizë krahasuese. Ky kapitull shumë i rëndësishëm trajton disa nga pyetjet kërkimore bazë që studimi ngre, si: Cili është niveli i krimit të organizuar transnacional dhe krimit të organizuar me bazë lokale e transnacionale Shqipëri-Kosovë? Cilat janë veprimtaritë kriminale të organizuara më të përhapura në nivel lokal, në nivel transnacional dhe që kanë bazë lokale e transnacionale në Shqipëri dhe në Kosovë? Cilat janë veprimtaritë kriminale më të përhapura në nivel rajonal dhe krahasimi me Shqipërinë dhe Kosovën? Synimi i këtij kapitulli është edhe të provuarit e njëres nga hipotezat e studimit - Siguria kombëtare dhe funksionaliteti i institucioneve demokratike të Shqipërisë dhe Kosovës mbetet e kushtëzuar nga parandalimi, goditja dhe lufta e krimit të organizuar transnacional.


Ky kapitull do të përpiqet të provojë pjesën që lidhet me krimin e organizuar transnacional dhe, në vetvete, ky kapitull së bashku me kapitujt 3,4, 5 dhe 7 përbën përshkrimin e punës zbatuese të studimit. Ky kapitull trajton gjendjen e format e kriminalitetit, kriminaliteti në nivel transnacional që ka bazë lokale, dhe në nivel lokal që ka bazë transnacionale, dhe përmbledhjen krahasuese të veprimtarisë kryesore kriminale të organizuara në Shqipëri, Kosovë dhe kriminalitetit në rajon.

6.2. Veprimtaritë kriminale të organizuara më të përhapura në nivel transnacional që kanë bazë lokale Shqipëri – Kosovë.

Me qëllim njohjen më të mirë të gjendjes së kriminalitetit të organizuar në hapësirën shqiptare, Shqipëri-Kosovë, me hapjen e kufijve dhe me lëvizjen e lirë të shqiptarëve në Kosovë dhe në Shqipëri, siç është e njohur nga të gjithë, u krijuan hapësira dhe mundësi të

reja bashkëpunimi dhe ushtrimi të aktivitetit kriminal edhe nga grupet kriminale të organizuara brenda dhe jashtë Shqipërisë dhe Kosovës. Krahas të dhënave përkatëse, sipas raporteve të ndryshme të organizatave ndërkombëtare për këtë aktivitet kriminal që ushtrohet në bazën lokale, ndërnacionale Shqipëri - Kosovë dhe “akuzave” të tyre për krim të organizuar të fuqishëm të “mafies shqiptare”, (mafia shqipfolëse) etj., u drejtuar me pyetjen të anketuarve dhe të intervistuarve: “Cilat janë veprimtaritë kriminale të organizuara më të përhapura në nivel transnacional që kanë bazë lokale Shqipëri-Kosovë?”

Nëpërmjet pyetësorit, politikanë, zyrtarë të institucioneve ligjzbatuese, ekspertë të strukturave të sigurisë kombëtare, rajonale, ekspertë ndërkombëtarë, pedagogë, profesorë, studiues, juristë, ministra të Brendshëm, ministra të Drejtësisë, drejtues të lartë të shteteve e qeverive në Shqipëri e Kosovë në vite, prokurorë, gjyqtarë, avokatë, drejtues të policisë, oficerë të policisë gjyqësore, si dhe studentë të Fakulteteve të Drejtësisë dhe të Studimeve të Sigurisë u janë përgjigjur pyetjeve të cilat gjejnë pasqyrim në të dhënat e pasqyruara në këtë kapitull.




Burimi: Pyetësi 1 “Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri-Kosovë, 2008-2015” (plotësuar nga personalitete publike dhe ekspertë të sigurisë e drejtësisë në Shqipëri, Kosovë dhe ekspertë ndërkombëtarë).Përpunim i Autorit (2016).

Grafiku 6.1 Krahasimi i veprimtarive kriminale të organizuara në Shqipëri-Kosovë.

Sipas grafikut 6.1 në Shqipëri evidentohet trafiku i drogës me 29.1%, kundrejt 19% në Kosovë, korrupsioni 27.6% me 33%, pastrimi i parave 14.9% me 12%, vrasjet me

pagesë 7.5% me 2%, etj. Pra, trafikimi i drogës përbën nivelin më të lartë në Shqipëri, ndërsa korrupsioni përbën nivelin më të lartë në Kosovë.

Në mënyrë tabelare sipas tabelës 6.1 dhe figurës 6.2 pasqyrohen veprimtaritë kriminale të organizuara në Shqipëri-Kosovë në tërësi dhe në varësi të bazës së saj transnacionale dhe lokale.



Burimi: Pyetësi 1 “Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri-Kosovë, 2008-2015”, plotësuar nga personalitete publike dhe ekspertë të sigurisë e të drejtësisë në Shqipëri, Kosovë dhe ekspertë ndërkombëtarë. Përpunim i autorit (2016).

Figura 6.2 Veprimtaritë kriminale të organizuara më të përhapura në nivel transnacional Shqipëri-Kosovë.


Në tabelën 6.1 evidentoher se shkallën më të lartë të kriminalitetit e përbën veprimtaria e krimit të organizuar *trafikimi i drogës*, i cili ka nivelin më të lartë 40.8% në kriminalitetin transnacional Shqipëri - Kosovë, 36.9% në kriminalitetin transnacional me bazë transnacionale Shqipëri - Kosovë dhe 36.0% në kriminalitetin transnacional me bazë lokale Shqipëri - Kosovë. Ndërkohë, vijon me veprimtarinë *e trafikimit të qenieve njerëzore* 19.1% në kriminalitetin transnacional me bazë lokale Shqipëri-Kosovë dhe 18.4% në kriminalitetin transnacional me bazë transnacionale Shqipëri - Kosovë. Veprimtaria *pastrimi i parave* 15.7%, në kriminalitetin transnacional me bazë lokale Shqipëri - Kosovë. Veprimtaria kriminale *e trafikimit të armëve* 12.6% në kriminalitetin transnacional me bazë transnacionale Shqipëri-Kosovë; veprimtaria kriminale *e korrupsionit* 13.6%, *e pastrimit të*

parave 11.7%, e trafikut të qenieve njerëzore 9.7%, e kontrabandimit të emigrantëve 7.8%, në kriminalitetin transnacional Shqipëri - Kosovë.

Kriminaliteti transnacional Shqipëri, Kosovë, në veprimtarinë *e trafikut të drogës* është 40.8%, në atë të *korruptionit* 13.6%, të *pastrimit të parave* 11.7%, të *trafikut të qenieve njerëzore* 9.7%, të *kontrabandimit të emigrantëve* 7.8%, të *trafikimit të armëve dhe terrorizmit* 5.8%, të *krimin të organizuar kibernetik* 1%. Kriminaliteti transnacional me bazë transnacionale Shqipëri-Kosovë në veprimtarinë *e trafikut të drogës* është 36.9%, në atë të *korruptionit* 4.9%, të *pastrimit të parave* 10.7%, të *vrasjeve me pagesë* 6.8%, të *trafikut të qenieve njerëzore* 18.4%, të *kontrabandimit të emigrantëve* 4.9%, të *trafikimit të armëve* 12.6%, të *terrorizmit* 4.9 %. Ndërsa, kriminaliteti transnacional me bazë lokale Shqipëri-Kosovë në veprimtarinë *e trafikut të drogës* është 36.0%, në atë të *korruptionit* 6.7%, të *pastrimit të parave* 15.7%, të *vrasjeve me pagesë* 4.5%, të *trafikimit të qenieve njerëzore* 19.1%, të *gjobëvënies* 1.1%, të *kontrabandimit të emigrantëve* 3.4%, të *trafikimit të armëve* 6.7%, të *terrorizmit* 5.6 %, të *krimin të organizuar kibernetik* 1.1%.


6.3 Krimi i organizuar transnacional dhe krimi i organizuar me bazë lokale e transnacionale Shqipëri –Kosovë.

Nëpërmjet pyetësorit, politikanë, zyrtarë të institucioneve ligjzbatuese, ekspertë të strukturave të sigurisë kombëtare, rajonale, ekspertë ndërkombëtarë, pedagogë, profesorë, studiues, juristë, ministra të Brendshëm, ministra të Drejtësisë, drejtues të lartë të shteteve e qeverive në Shqipëri e Kosovë në vite, prokurorë, gjyqtarë, avokatë, drejtues të policisë, oficerë të policisë gjyqësore, si dhe studentë të Fakulteteve të Drejtësisë dhe të Studimeve të Sigurisë u janë përgjigjur pyetjeve të cilat gjejnë pasqyrim në të dhënat e pasqyruara në këtë kapitull.



Burimi: Pyetësi 1 “Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri-Kosovë, 2008-2015”, plotësuar nga personalitete publike dhe ekspertë të sigurisë e të drejtësisë në Shqipëri, Kosovë dhe ekspertë ndërkombëtarë. Përpunim i autorit (2016).


Figura 6.3 Veprimtaritë kriminale të organizuara më të përhapura në nivel transnacional Shqipëri-Kosovë.



Burimi: Pyetësi 1 “Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri-Kosovë, 2008-2015”, plotësuar nga personalitete publike dhe ekspertë të sigurisë e të drejtësisë në Shqipëri, Kosovë dhe ekspertë ndërkombëtarë. Përpunim i autorit (2016).

Figura 6.4 Veprimtaritë kriminale të organizuara më pak të përhapura në nivel transnacional Shqipëri-Kosovë.

Në figurën 6.5 paraqiten veprimtaritë kriminale të organizuara më të përhapura në nivel transnacional që kanë bazë lokale Shqipëri-Kosovë, 2008-2015.



Burimi: Pyetësori 1 “Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri-Kosovë, 2008-2015”, plotësuar nga personalitete publike dhe ekspertë të sigurisë e të drejtësisë në Shqipëri, Kosovë dhe ekspertë ndërkombëtarë. Përpunim i autorit (2016).

Figura 6.5 Veprimtaritë kriminale të organizuara më të përhapura në nivel transnacional që kanë bazë lokale Shqipëri-Kosovë.

Sipas kësaj figure, rezulton se veprimtaritë kriminale të organizuara më të përhapura në nivel transnacional që kanë bazë lokale Shqipëri - Kosovë, janë: trafiku i drogës 35.85%, trafiku i qenieve njerëzore 17.92%, trafiku i armëve 12.26% dhe pastrimi i parave 10.38%.

PhD Walter Schwimmer shprehet: “Bazuar në ngjarjet e fundit mes Kosovës dhe Maqedonisë, mund të themi se përbën një problem të madh potencial për të ardhmen, në lidhje me rritjen e numrit të qytetarëve të Kosovës dhe të qytetarëve shqiptarë që lënë vendet e tyre për të luftuar në Irak dhe Siri.¹²⁵” Ndërsa pyetjes: Cilat janë aktivitetet më të përhapura të organizuara kriminale në nivel ndërkombëtar që kanë bazë transnacionale Shqipëri-Kosovë?, dr. Walter Schwimmeri përgjigjet:

“Pastrimi i parave në Kosovë ndryshe nga diaspora të tjera të krimit organizuar shqiptar-ruan rrënjët e saj në vendlindjet e saj. Kjo do të thotë se shumë nga fitimet e realizuara jashtë vendit janë të pastruara në Shqipëri dhe në Kosovë. Fluksi i shumave të tilla të mëdha të parave mund të shtrëmbërojnë ekonominë.”¹²⁶


Një përgjigje e tillë, kur shprehet nga një personalitet i tillë, si dr. Walter Schwimmeri, duhet të jetë një “sirenë alarmi” për lidhshimin politik në Shqipëri dhe në Kosovë, sepse të kujton shprehjet biblike që kanë të bëjnë me mëkatet e mëdha që sjellin shkatërrimin e kombeve, prandaj rekomandohet të veprohet sa më shpejt për “të pastruar” ekonominë dhe shtetin nga informaliteti, kriminalizimi, pastrimi i parave dhe moslejimi më tej i këtij

¹²⁵ Intervista është marrë nga autori, datë 27.11.2015.

¹²⁶ Po aty.

zhvillimi ekonomik mbi bazë kriminale, sepse brezat e ardhshëm do të “shkatërrohen” dhe nuk do të kenë prosperitet, drejtësi dhe mirëqenie.

Figura 6.6 paraqet veprimtaritë kriminale të organizuara, më pak të përhapura në nivel transnacional, që kanë bazë lokale Shqipëri - Kosovë.




Burimi: Pyetëtori 1 “Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri-Kosovë, 2008-2015”, plotësuar nga personalitete publike dhe ekspertë të sigurisë e të drejtësisë në Shqipëri, Kosovë dhe ekspertë ndërkombëtarë. Përpunim i autorit (2016).

Figura 6.6 Veprimtaritë kriminale të organizuara, më pak të përhapura në nivel transnacional, që kanë bazë lokale Shqipëri-Kosovë.

Sipas kësaj figure, rezulton se veprimtaritë kriminale më të përhapura në nivel transnacional që kanë bazë lokale Shqipëri - Kosovë, janë: *vrastet me pagesë* 6.60%, *terrorizmi*, kontrabandimi i emigrantëve dhe korrupsioni me nga 4.72%, krimi i organizuar kibernetik 1.89% dhe *kontrabanda e mallrave* 0.94%. Ndërsa, tabela 6.3, shpjeguese e grafikëve, pasqyron veprimtarinë dhe vlerësimin në përqindje të veprimtarive të tjera të krimit të organizuar.

Mbi bazën e përgjigjeve të pyetëtorit nga studentët e anketuar është prodhuar tabela 6.4 dhe figuren 6.7 ku pasqyrohen 702 përgjigjet, sipas pyetëtorit nr. 2, për vlerësimin e gjendjes së veprimtarive kriminale të organizuara më të përhapura në nivel transnacional Shqipëri- Kosovë, 2008-2015.



Burimi: Pyetësori 2 “Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri- Kosovë, 2008-2015”, plotësuar nga studentët e fakulteteve të Drejtësisë dhe të Sigurisë në Prishtinë dhe Tiranë. Përpunim i autorit (2016).


Figura 6.7 Veprimtaritë kriminale të organizuara, më të përhapura në nivel transnacional Shqipëri-Kosovë (Anketimi i studentëve).¹²⁷

Sipas të dhënave të tabelës 6.4, figurës 6.7 rezulton se 702 studentë i janë përgjigjur pyetësorit nr. 2, për veprimtaritë kriminale të organizuara më të përhapura në nivel transnacional Shqipëri- Kosovë për periudhën 2008-2015. Këto veprimtari paraqiten: 1. trafikimi i drogës 42%, 2. korrupsioni 27%, 3. pastrimi i parave 13%, 4. trafikimi i qenieve njerëzore 6%, 5. trafikimi i armëve 5%, 6. kontrabandimi i emigrantëve 3% etj.

Nga krahasimi i përgjigjeve të pyetësorëve, të plotësuar nga politikanët dhe ekspertët e sigurisë, si dhe nga përgjigjet e anketimit të studentëve për veprimtaritë kriminale të organizuara më të përhapura në nivel transnacional Shqipëri- Kosovë rezulton se, në rastin e parë janë evidentuar: 1. trafikimi i drogës, 2. korrupsioni, 3. pastrimi i parave, 4. trafiku i armëve, 5. kontrabandimi i emigrantëve, 6. trafikimi i qenieve njerëzore, 7. Terrorizmi, 8. krimi i organizuar kibernetik, 9. gjorbëvenia, 10. vrasjet me pagesë. Ndërsa, nga anketimi i studentëve janë evidentuar: trafikimi i drogës, korrupsioni, pastrimi i parave, trafikimi i qenieve njerëzore, trafikimi i armëve, kontrabandimi i emigrantëve. Pra, nga analizimi i përgjigjeve të pyetësorëve të 767 të anketuarve rezulton se tri veprimtaritë kriminale të organizuara më të përhapura në Shqipëri janë: 1. Korrupsioni, 2. trafikimi i drogës, 3. pastrimi i parave. Pra, pasqyruam përgjigjet e studentëve të anketuar, sipas pyetësorit për

¹²⁷ Theksojmë se të anketuarit kanë pasur të drejtën e dhënies vetëm të një përgjigjeje (vetëm një mundësi përzgjedhjeje).

vlërësimin e gjendjes së kriminalitetit ë organizuar në Shqipëri dhe në Kosovë për vitet 2008-2015, si dhe bën një analizë krahasuese midis përgjigjeve të dhëna, sipas rubrikave, për format e manifestimit të krimit të organizuar “kombëtar” nacional në Shqipëri dhe në Kosovë.



Burimi: Pyetëtori 2 “Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri- Kosovë, 2008-2015”, plotësuar nga studentët e fakulteteve të Drejtësisë dhe të Sigurisë në Prishtinë dhe Tiranë. Përpunim i autorit (2016).

Figura 6.9 Veprimtaritë kriminale të organizuara, më të përhapura në nivel transnacional, që kanë bazë lokale Shqipëri- Kosovë (Anketimi i studentëve).¹²⁸

Sipas të dhënave të tabelës 6.5 dhe figurës 6.9, rezultojnë se 702 studentë i janë përgjigjur pyetësit 2, për veprimtaritë kriminale të organizuara më të përhapura në nivel transnacional që kanë bazë lokale Shqipëri- Kosovë për periudhën 2008-2015. Këto veprimtari paraqiten: 1. trafikimi i drogës 48%; 2. korrupsioni 18%, 3. pastrimi i parave 12%, 4. trafikimi i armëve 6%, 5. trafikimi i qenieve njerëzore 5%, 6. nuk e di/pa përgjigje 4%, 7. kontrabandimi i emigrantëve 3%, 8. vrasjet me pagesë 2%, 9. gjobëvënia 1%, 10. terrorizmi 1%.

Nga krahasimi i përgjigjeve të pyetësorëve të plotësuar nga politikanët dhe ekspertët e sigurisë, si dhe nga përgjigjet e anketimit të studentëve për veprimtaritë kriminale të organizuara më të përhapura në nivel transnacional që kanë bazë lokale Shqipëri- Kosovë rezultojnë se në rastin e parë janë evidentuar: 1. trafikimi i drogës, 2. trafikimi i qenieve njerëzore, 3. trafikimi i armëve, 4. pastrimi i parave. Ndërsa, anketimi i studentëve ka evidentuar: 1. trafikimi i drogës, 2. korrupsioni, 3. pastrimi i parave, 4.


¹²⁸ Theksojmë se të anketuarit kanë pasur të drejtën e dhënies vetëm të një përgjigjeje (vetëm një mundësi përzgjedhjeje).

trafikimi i armëve. Pra, nga analizimi i përgjigjeve të pyetësorëve të 767 të anketuarve rezulton se tri veprimtaritë kriminale të organizuara më të përhapura në Shqipëri janë: 1.trafikimi i drogës, 2.korrupsioni; 3. trafikimi i qenieve njerëzore.

6.4. Veprimtaritë kriminale të organizuara më të përhapura në Shqipëri, Kosovë dhe në nivel transnacional që kanë bazë transnacionale Shqipëri-Kosovë, 2008-2015.

Tabela 6.4 paraqet veprimtaritë kriminale të organizuara, më të përhapura në nivel transnacional, që kanë bazë transnacionale Shqipëri -Kosovë. Sipas kësaj tabele rezulton se *trafikimi i drogës* renditet i pari me 32, *trafikimi i qenieve njerëzore* i dyti me 17, *pastrimi i parave* i treti me 14. Pastaj vijojnë *korupsioni* dhe *trafikimi i armëve* me 6, *terrorizmi* 5, *vrastet me pagesë* 4, *kontrabandimi i emigrantëve* 3, *krimi i organizuar e kontrabanda* 2, *gjobëvënie e krimi i organizuar kibernetik* 1. Sipas përgjigjeve të mësipërme, konkludohet se në të ardhmen duhen orientuar dhe zhvilluar masa dhe shërbime operacionale praktike më efçente për veprimtaritë kriminale të organizuara më të përhapura, si: trafikimi i drogës, trafikimi i qenieve njerëzore dhe pastrimi i parave.

Studiuesi, Zamir Poda, në lidhje me dimensionin transnacional të krimit të organizuar shprehet se *krimi i organizuar ekziston edhe në formë të krimit të organizuar nacional dhe në dimensione transnacionale. Grupet funksionojne në të dy format.*¹²⁹



Burimi: Pyetësori 1 “*Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri-Kosovë, 2008-2015*”, plotësuar nga personalitete publike dhe ekspertë të sigurisë e të drejtësisë në Shqipëri, Kosovë dhe ekspertë ndërkombëtarë. Përpunim i autorit (2016).

Grafiku 6.1 Veprimtaritë kriminale të organizuara më të përhapura në Shqipëri, Kosovë dhe në nivel transnacional që kanë bazë transnacionale Shqipëri-Kosovë.

¹²⁹Zamir Poda, autor i cituar.


Mbi bazën e përgjigjeve të pyetësorit është prodhuar grafiku 6.1 për veprimtaritë kriminale të organizuara më të përhapura në Shqipëri, Kosovë dhe në nivel transnacional që kanë bazë transnacionale Shqipëri - Kosovë.

Nga analizimi i përgjigjeve të dhëna nga ekspertët në Shqipëri, në Kosovë dhe ekspertët ndërkombëtarë, për veprimtaritë kriminale të organizuara më të përhapura në Shqipëri, Kosovë dhe në nivel transnacional që kanë bazë transnacionale Shqipëri - Kosovë, rezulton se kriminaliteti i organizuar në Shqipëri, Kosovë dhe kriminaliteti transnacional Shqipëri - Kosovë është i pranishëm dhe bashkëshoqërojnë njëri-tjetrin. Ndërkohë, kriminaliteti transnacional Shqipëri – Kosovë *trafiku i drogës* ka zhvillim dhe përhapje më të gjerë, në Shqipëri dhe në Kosovë më pak. Gjithashtu, edhe *trafiku i qenieve njerëzore e kontrabandimi i emigrantëve* si kriminalitet transnacional Shqipëri - Kosovë është më i zhvilluar, në raport me kriminalitetin e këtij lloji në Shqipëri dhe në Kosovë. *Gjobëvënia* ka bazë lokale dhe jo transnacionale Shqipëri - Kosovë, ndërsa *trafiku i armëve* është më i zhvilluar në Kosovë në raport me Shqipërinë dhe i krahasuar me bazë transnacionale Shqipëri-Kosovë. *Korrupsioni* në Shqipëri dhe në Kosovë paraqiten në pamjen grafike më i zhvilluari në Shqipëri dhe në Kosovë, çfarë tregon se ai zhvillohet “më suksesshëm” brenda secilit shtet dhe, nga ana tjetër, paraqitet në shifra më të ulëta nga krahasimi më këtë lloj kriminaliteti me llojin e këtij krimi si kriminalitet transnacional Shqipëri - Kosovë.

Studjuesi, Zamir Poda, në lidhje me dimensionin transnacional të krimit të organizuar shprehet: “krimi i organizuar kalon kufijtë nacionalë jo vetëm për arsye të tregut, por edhe për t’u shmangur nga elementët e sigurisë dhe të kontrollit financiar të brendshëm.”¹³⁰

Në figurën 6.11 tregohen veprimtaritë kriminale më të përhapura në nivel transnacional që kanë bazë transnacionale Shqipëri-Kosovë.


¹³⁰Po aty.



Burimi: Pyetësi 1 “*Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri-Kosovë, 2008-2015*”, plotësuar nga personalitete publike dhe ekspertë të sigurisë e të drejtësisë në Shqipëri, Kosovë dhe ekspertë ndërkombëtarë. Përpunim i autorit (2016).

Figura 6.11 Veprimtaritë kriminale, më të përhapura në nivel transnacional që kanë bazë transnacionale Shqipëri-Kosovë.

Sipas kësaj figure, rezultojnë se veprimtaritë kriminale të organizuara, më të përhapura në nivel transnacional që kanë bazë transnacionale Shqipëri-Kosovë, për periudhën 2008-2015 janë: *trafikimi i drogës* 34%, *trafikimi i qenieve njerëzore* 18.1% dhe *pastrimi i parave* 14.9%. Ndërsa, në figurën 6.12 paraqiten veprimtaritë kriminale të organizuara, më pak të përhapura në nivel transnacional, që kanë bazë transnacionale Shqipëri - Kosovë.




Burimi: Pyetësi 1 “*Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri-Kosovë, 2008-2015*”, plotësuar nga personalitete publike dhe ekspertë të sigurisë e të drejtësisë në Shqipëri, Kosovë dhe ekspertë ndërkombëtarë. Përpunim i autorit (2016).

Figura 6.12 Veprimtaritë kriminale të organizuara, më pak të përhapura në nivel transnacional, që kanë bazë transnacionale Shqipëri- Kosovë.

Sipas kësaj figure, rezultojnë se veprimtaritë kriminale të organizuara, më pak të përhapura në nivel transnacional, që kanë bazë transnacionale Shqipëri - Kosovë, për periudhën 2008-2015 janë: *korrupsioni* dhe *trafikimi i armëve* me nga 6.4%, *terrorizmi* 5.3%,

vrasjet me pagesë 4.3%, krimi i organizuar 3.2%, kontrabandimi i emigrantëve 3.2%, kontrabanda 2.1%, krimi kibernetik dhe gjobëvënia 1.1%.



Burimi: Pyetësi 2 “Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri- Kosovë, 2008-2015”, plotësuar nga studentët e fakulteteve të Drejtësisë dhe të Sigurisë në Prishtinë dhe Tiranë. Përpunim i autorit (2016).

Figura 6.12 Veprimtaritë kriminale të organizuara, më pak të përhapura në nivel transnacional, që kanë bazë transnacionale Shqipëri- Kosovë (Anketimi i studentëve).¹³¹

Sipas të dhënave të tabelës 6.9 dhe figurës 6.1 rezulton se 702 studentë i janë përgjigjur pyetësit nr. 2 për veprimtaritë kriminale të organizuara, më të përhapura në nivel transnacional që kanë bazë transnacionale Shqipëri- Kosovë për periudhën 2008-2015. Këto veprimtari paraqiten: 1. trafikimi i drogës 41%; 2. korrupsioni 20%; 3. pastrimi i parave 13%; 4. trafikimi i qenieve njerëzore 6%; 5. trafikimi i armëve 5%; 6. kontrabandimi i emigrantëve 4%; 7. nuk e di/pa përgjigje 4%; 8. vrasjet me pagesë 3%; 9. gjobëvënia 2%; 10. terrorizmi 2% dhe 11. Krimi i organizuar kibernetik 1%.


Nga krahasimi i përgjigjeve të pyetësorëve, të plotësuar nga politikanët dhe ekspertët e sigurisë, si dhe nga përgjigjet e anketimit të studentëve, për veprimtaritë kriminale të organizuara, më të përhapura në nivel transnacional që kanë bazë transnacionale Shqipëri- Kosovë rezulton se në rastin e parë janë evidentuar: 1.trafikimi i drogës, 2. trafikimi i qenieve njerëzore, 3. pastrimi i parave. Ndërsa, anketimi i studentëve

¹³¹ Theksojmë se të anketuarit kanë pasur të drejtën e dhënies vetëm të një përgjigjeje (vetëm një mundësi përzgjedhjeje).

ka evidentuar: 1. trafikimi i drogës, 2. korrupsioni, 3. pastrimi i parave, 4. trafikimi i qenieve njerëzore. Pra, nga analizimi i përgjigjeve të pyetësorëve të 767 të anketuarve rezulton se tri veprimtaritë kriminale të organizuara më të përhapura në Shqipëri janë: 1. trafikimi i drogës, 2. korrupsioni; 3. pastrimi i parave.

6.5. Krimi i organizuar transnacional dhe krimi i organizuar me bazë lokale e transnacionale Shqipëri-Kosovë-analizë krahasuese.


Figura 6.14 paraqet analizën krahasuese të krimit të organizuar transnacional dhe krimit të organizuar me bazë lokale e transnacionale Shqipëri - Kosovë. Sipas këtij grafiku rezulton se në kriminalitetin transnacional Shqipëri - Kosovë në nivele më të larta përfshihen trafiku i drogës, korrupsioni dhe pastrimi i parave. në kriminalitetin transnacional me bazë lokale Shqipëri - Kosovë në nivele më të larta përfshihen trafiku i drogës, pastrimi i parave dhe trafiku i qenieve njerëzore. Ndërsa, në kriminalitetin transnacional me bazë transnacionale Shqipëri - Kosovë në nivele më të larta përfshihen trafiku i drogës, trafiku i qenieve njerëzore dhe pastrimi i parave.



Burimi: Pyetësori 1 “Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri-Kosovë, 2008-2015” (plotësuar nga personalitete publike dhe ekspertë të sigurisë e drejtësisë në Shqipëri, Kosovë dhe ekspertë ndërkombëtarë). Përpunim i Autorit (2016).

Figura 6.14 Analizë krahasimore e krimit të organizuar transnacional dhe e krimit të organizuar me bazë lokale e transnacionale Shqipëri-Kosovë.

Figura 6.15 paraqet në formë grafike analizën krahasuese të krimit të organizuar transnacional Shqipëri - Kosovë dhe të krimit të organizuar me bazë lokale e transnacionale Shqipëri-Kosovë.



Burimi: Pyetësori 1 “Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri-Kosovë, 2008-2015”, plotësuar nga personalitete publike dhe ekspertë të sigurisë e të drejtësisë në Shqipëri, Kosovë dhe ekspertë ndërkombëtarë. Përpunim i autorit (2016).

Figura 6.15 Analizë krahasuese e krimit të organizuar transnacional Shqipëri-Kosovë dhe e krimit të organizuar me bazë lokale e transnacionale Shqipëri-Kosovë.

Në mënyrë grafike, evidentohet se nivelin më të lartë e paraqet veprimtaria e krimit të organizuar, trafikimi i drogës, në vendin e dytë është trafikimi i qenieve njerëzore, pastrimi i parave, korrupsioni, trafikimi i armëve, kontrabandimi i emigrantëve, terrorizmi dhe vrasjet me pagesë. Kriminaliteti transnacional Shqipëri, Kosovë vlerësohet në nivelin më të lartë në veprimtarinë: trafikimi i drogës, korrupsioni, pastrimi i parave, trafikimi i qenieve njerëzore, kontrabandimi i emigrantëve, terrorizmi, trafikimi i armëve, vrasjet me pagesë dhe krimi i organizuar kibernetik.

Kriminaliteti transnacional me bazë transnacionale Shqipëri - Kosovë vlerësohet në nivelin më të lartë në veprimtarinë: trafikimi i drogës, trafikimi i qenieve njerëzore, trafikimi i armëve, pastrimi i parave, vrasjet me pagesë, korrupsioni, kontrabandimi i emigrantëve dhe terrorizmi. Ndërsa, kriminaliteti transnacional me bazë lokale Shqipëri - Kosovë vlerësohet në nivelin më të lartë në veprimtarinë: trafikimi i drogës, trafikimi i qenieve njerëzore, pastrimi i parave, korrupsioni, trafikimi i armëve, terrorizmi, vrasjet me pagesë, kontrabandimi i emigrantëve, gjobëvënia dhe krimi i organizuar kibernetik.

6.6. Kriminaliteti në Shqipëri dhe Kosovë, kriminaliteti transnacional ndërmjet dy vendeve, kriminaliteti transnacional me bazë transnacionale dhe me bazë lokale Shqipëri-Kosovë, 2008-2015 – analizë krahasuese.

Në tabelën 6.10 paraqitet analiza krahasuese për krimin e organizuar transnacional dhe për krimin e organizuar me bazë lokale e transnacionale Shqipëri - Kosovë.

Në mënyrë tabelare është paraqitur analiza e trembëdhjetë formave të veprimtarive të krimit të organizuar dhe paraqitja e krahasimi i tyre në tri mënyra: 1. kriminaliteti transnacional Shqipëri-Kosovë; 2. kriminaliteti transnacional me bazë transnacionale Shqipëri - Kosovë, 3. kriminaliteti transnacional me bazë lokale Shqipëri - Kosovë.

Duke krahasuar këto tri aspekte rezulton se në të tria këto drejtime, *trafiku i drogës* renditet në nivelin e parë, *trafiku i qenieve njerëzore* renditet në nivelin e dytë, dhe *korupsioni* renditet në nivelin e tretë. Ndërkohë, kriminaliteti transnacional me bazë lokale Shqipëri - Kosovë renditet në nivele më të ulëta se sa kriminaliteti transnacional Shqipëri - Kosovë dhe kriminaliteti transnacional me bazë transnacionale Shqipëri - Kosovë. Nga analizimi i krahasimeve rezulton se krimi i organizuar më i zhvilluar në Shqipëri dhe në Kosovë është krimi i organizuar me bazë transnacionale Shqipëri - Kosovë, dhe më pak i zhvilluar, është kriminaliteti me bazë lokale Shqipëri-Kosovë. Pra, nga analiza krahasuese e tri veprimtarive kriminale: kriminaliteti transnacional Shqipëri – Kosovë, kriminaliteti transnacional me bazë transnacionale Shqipëri - Kosovë dhe kriminaliteti transnacional me bazë lokale Shqipëri - Kosovë, rezulton se *trafiku i drogës* është forma e kriminalitetit të organizuar që është më e zhvilluar në krahasim me të gjitha llojet e tjera të veprimtarive të krimit të organizuar. Ndërkohë që trafiku i drogës si aktivitet transnacional Shqipëri - Kosovë mbi bazën e përgjigjeve të dhëna paraqitet me numrin më të lartë 42, më pas renditet si aktivitet transnacional me bazë transnacionale Shqipëri-Kosovë me numrin 38, dhe si aktivitet transnacional me bazë lokale Shqipëri - Kosovë me numrin më të ulët 32. Pra, konkludohet se trafiku i drogës në Shqipëri dhe në Kosovë ka më shumë bazë transnacionale se sa bazë lokale.

6.7 Përmbledhje krahasuese e veprimtarive kryesore kriminale të organizuara në Shqipëri, Kosovë dhe kriminaliteti në Rajon.

Tabela 6.11 paraqet një përmbledhje krahasuese e veprimtaritë kryesore kriminale të organizuara në Shqipëri, Kosovë, kriminaliteti transnacional Shqipëri - Kosovë dhe kriminaliteti transnacional me bazë transnacionale dhe me bazë lokale Shqipëri - Kosovë dhe kriminaliteti në rajon.

Në mënyrë tabelare është paraqitur analiza e dhjetë formave të veprimtarive të krimit të organizuar dhe paraqitja e krahasimi i tyre në gjashtë mënyra të krahasimit të veprimtarive kriminale kryesore të organizuara: 1. kriminaliteti në Shqipëri, 2. kriminaliteti në Kosovë, 3. kriminaliteti transnacional Shqipëri-Kosovë, 4. kriminaliteti transnacional me bazë transnacionale Shqipëri - Kosovë, 5. kriminaliteti transnacional me bazë lokale Shqipëri - Kosovë dhe 6. kriminaliteti në rajon.

Në mënyrë tabelare, veprimtaritë kryesore kriminale të organizuara rezultojnë se kriminaliteti në Shqipëri, paraqitet në nivele më të larta në veprimtaritë *e trafikut të drogës* me 29.1%, *korrupsioni* 27.6% dhe *pastrimi i parave* me 14.9%, Ndërsa, kriminaliteti në Kosovë, paraqitet me korrupsionin në nivelin më të lartë me 33%, *trafikun e drogës* me 19%, *pastrimi i parave* me 12%. Kriminaliteti transnacional Shqipëri - Kosovë, paraqitet në nivele më të larta në veprimtarinë *trafikun e drogës* 40.8%, *korrupsioni* 13.6% dhe *pastrimi i parave* 11.7%. Kriminaliteti transnacional me bazë transnacionale Shqipëri - Kosovë paraqitet në nivele më të larta në veprimtarinë *trafikun e drogës* 36.9%, *trafikun e qenieve njerëzore* 18.4%, *trafikun e armëve* 12.6%, *pastrimi i parave* 10.6%. Kriminaliteti transnacional me bazë lokale Shqipëri - Kosovë, paraqitet në nivele më të larta në veprimtarinë: *trafikun e drogës* 36%, *trafikun e qenieve njerëzore* 19.1%, *pastrimi i parave* 15.7%, *korrupsioni* dhe *trafikun e armëve* 6.7%. Kriminaliteti në rajon, paraqitet në nivele më të larta në veprimtarinë: *trafikun e drogës* 27%, *trafikun e qenieve njerëzore* 19.7%, *pastrimi i parave* 13.9%, *korrupsioni* dhe *trafikun e armëve* 6.7%, *terrorizmi* 10.9%, *trafikun e armëve* 8.8%, *kontrabandimi i emigrantëve* 6.6%, *krimi i organizuar kibernetik* 2.2%, *vrastjet me pagesë* 1.5% dhe *gjobëvënja* 0.7%.

Nga paraqitja e mësipërme arrihet në përfundime sipas formave të veprimtarive të krimit të organizuar dhe mënyrave respektive të shprehura nëpërmjet figurës grafike. Sipas

ekspertëve *gjobëvënia* dhe *vrasjet me pagesë* dallojnë veçanërisht për aktivitet kryesisht lokal në Shqipëri, ndërkohë që *kontrabandimi i emigrantëve* më së shumti në Kosovë dhe *krimi kibernetik* më i theksuar në rajon. *Korrupsioni* paraqitet i pranishëm në të njëjtat nivele në Shqipëri dhe në Kosovë, po ashtu edhe trafiku i qënieve njerëzore.


Ajo që konkludohet është se *pastrimi i parave* si veprimtari kriminale gjykohet si e lidhur me të gjitha format e mësipërme dhe përhapjen gjeografike të paraqitur në figurë. Pra, mund të theksohet se rrjeti i funksionimit për realizimin e këtij krimi ka baza të forta në Shqipëri, Kosovë, por funksionon pandashmërisht edhe në rajon, duke nënkuptuar në këtë mënyrë organizimet në formë rajonale dhe ndërshtetërore për realizimin e këtij krimi.

6.8. Veprimtaritë kriminale të organizuara më të përhapura në nivel rajonal.

Ashtu siç trajtuam aspektet e veprimtarive kriminale më të përhapura në nivel transnacional dhe në nivel lokal dhe me bazë lokale e transnacionale të krimit të organizuar, edhe në këtë nënçështje do të trajtojmë këto veprimtari kriminale. Krimi i organizuar transnacional nuk ka kufij dhe atdhe, madje ai sot është i kudondodhur, prandaj edhe rrezikshmëria e tij është e evidente. Kështu, përveç trajtimit të saj në aspektin transnacional dhe lokal, trajtimi në aspektin rajonal dhe më gjerë merr rëndësi të veçantë për të kuptuar shtrirjen e tij dhe mundësitë e bashkëpunimit midis grupeve kriminale, në mënyrë që të orientohet politika dhe institucionet ligjzbatuese për parandalimin, goditjen dhe minimizimin e tij. Dr. Zamir Poda shprehet: “*Normalisht ekzistojnë raporte gjithnjë e më të ngushta dhe të frekuentuara ndërmjet trafikëve dhe veprimtarive kriminale të një vendi dhe atyre të vendeve të tjera.organizimet kriminale synojnë drejtë merkatove që janë përtej kufijve.*¹³²”

Figura 6.16 paraqet veprimtaritë kriminale të organizuara më të përhapura në rajon.


¹³²Dr.Zamir Poda, autor i cituar.



Burimi: Pyetëtori 1 “Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri-Kosovë, 2008-2015”, plotësuar nga personalitete publike dhe ekspertë të sigurisë e të drejtësisë në Shqipëri, Kosovë dhe ekspertë ndërkombëtarë. Përpunim i autorit (2016).

Figura 6.16 Veprimtaritë kriminale të organizuara më të përhapura në rajon.

Sipas kësaj figure rezulton se veprimtaritë kriminale të organizuara më të përhapura në rajon dhe më gjerë, për periudhën 2008-2015 janë: *trafikimi i drogës* 26.6%, *trafikimi i qenieve njerëzore* 19.01%, *pastrimi i parave* 13.90%, *trafikimi i armëve* dhe *korupsioni* nga 8.45%, *terrorizmi* dhe *emigracioni i paligjshëm* nga 6.34%. PhD Walter Schwimmer, në lidhje me të shprehet: “*Trafikimi i njerëzve-në kohën e tashme për shkak të konflikteve në Siri, Irak, Afganistan dhe në disa pjesë të Afrikës që së bashku dëshirojnë përmirësimin ekonomik, ka kërkesë të madhe për të udhëtuar në Evropë. Kjo po krijon një treg për trafikantët për t’i shfrytëzuar.*¹³³” Në figurën 6.17 paraqiten veprimtaritë kriminale të organizuara më pak të përhapura në rajon.




Burimi: Pyetëtori 1 “Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri-Kosovë, 2008-2015”, plotësuar nga personalitete publike dhe ekspertë të sigurisë e të drejtësisë në Shqipëri, Kosovë dhe ekspertë ndërkombëtarë. Përpunim i autorit (2016).

Figura 6.17 Veprimtaritë kriminale të organizuara më pak të përhapura në rajon.

¹³³ Intervista është marrë nga autori, datë 27.11.2015.

Sipas kësaj figure rezulton se veprimtaritë kriminale, më pak të përhapura në rajon, për periudhën 2008-2015 janë: *ekstremizmi* 4.23%, *kontrabanda e mallrave* 2.11%, *krimi kibernetik* 2.11%, *krimi ekonomik* 1.41%, *vrasjet me pagesë* 1.41%, *gjobëvënia* 0.70%. Ndërsa tabela 6.12, shpjeguese e grafikëve, paraqet veprimtaritë dhe vlerësimin në përqindje.



Burimi: Pyetësi 2 "Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri- Kosovë, 2008-2015", plotësuar nga studentët e fakulteteve të Drejtësisë dhe të Sigurisë në Prishtinë dhe Tiranë. Përpunim i autorit (2016).

Figura 6.18 Veprimtaritë kriminale të organizuara, më të përhapura në nivel rajonal ose më gjërë (Anketimi i studentëve).

Sipas të dhënave të tabelës 6.18 dhe figurës 6.18, rezulton se 702 studentë i janë përgjigjur pyetësit nr. 2 për veprimtaritë kriminale të organizuara më të përhapura në nivel rajonal ose më gjerë. Këto veprimtari paraqiten: 1. *trafikimi i drogës* 54%; 2. *korrupsioni* 16%; 3. *pastrimi i parave* 8%; 4. *kontrabandimi i emigrantëve* 7%; 5. *trafikimi i qenieve njerëzore* 6%; 6. *trafikimi i armëve* 2%; 7. *vrasjet me pagesë* 2%, 8. *terrorizmi* 2%, 9. *nuk e di/pa përgjigje* 2% dhe *krimi organizuar kibernetik* 1%.

Nga krahasimi i përgjigjeve të pyetësorëve, të plotësuara nga politikanët dhe ekspertët e sigurisë, si dhe nga përgjigjet e anketimit të studentëve rezulton se në rastin e parë janë evidentuar: *trafikimi i drogës* 26.6%, *trafikimi i qenieve njerëzore* 19.01%, *pastrimi i parave* 13.90%, *trafikimi i armëve* dhe *korrupsioni* nga 8.45%, *terrorizmi* dhe *emigracioni i paligjshëm* nga 6.34%, dhe në rastin e dytë paraqiten: 1. *trafikimi i drogës* 54%; 2. *korrupsioni* 16%; 3. *pastrimi i parave* 8%; 4. *kontrabandimi i emigrantëve* 7%; 5. *trafikimi i qenieve njerëzore* 6%. Pra, nga analizimi i përgjigjeve të pyetësorëve të 767 të

anketuarve rezulton se veprimtaritë kriminale të organizuara më të përhapura në nivel rajonal ose më gjerë janë: 1. trafikimi i drogës, 2. korrupsioni; 3. trafikimi i qenieve njerëzore dhe 4. pastrimi i parave.

6.9. Vlerësim kritik për krimin e organizuar në Shqipëri, Kosovë dhe në Rajon, 2008 – 2015 - analizë krahasuese.


Duke u bazuar në analizat e mësipërme u evidentua se trafiku ndërkombëtar i drogës është ndër trafiqet më të përhapura dhe ndër më fitimprurësit për organizatat kriminale ndërkombëtare dhe në rajon. Studiuesi Zamir Poda shprehet se:

"... dy zonat e mëdha të prodhimit të heroinës, të cilat janë duke u derdhur në Mesdhe dhe godasin drejtpërsëdrejti Europën (nëpërmjet Italisë), janë individualizuar në "Gjysmëhënën e Artë", ndërmjet Kaukazit dhe Afganistanit dhe në "Trekëndëshin e Artë", në Orientin ekstrem, në Tailandën e Veriut."¹³⁴

Në tabelën 6.13 paraqitet analizë krahasuese e vlerësimit të gjendjes së kriminalitetit të organizuar në Shqipëri, Kosovë dhe rajon, 2008 - 2015. Nëpërmjet të dhënave të paraqitura në këtë tabelë, arrijmë të bëjmë një analizë krahasuese të përgjigjeve të dhëna nga të intervistuarit të cilët janë personalitete politike, shtetërore, shoqërore dhe publike. Në mënyrë tabelare evidentohet se *trafikimi i drogës* në Shqipëri është më i larti me shifrën 39, pastaj në rajon me 37 dhe në Kosovë me 19. *Korrupsioni* në Shqipëri 37, në Kosovë 33 dhe në rajon 12, *pastrimi i parave* në Shqipëri 20, në Kosovë 12 dhe në rajon 19, *trafikimi i qenieve njerëzore* në Shqipëri 9, në Kosovë 7 dhe në rajon 27, *terrorizmi* në Shqipëri 4, në Kosovë 6 dhe në rajon 15.

Veprimtaritë kriminale të organizuara në Shqipëri-Kosovë në krahasim me rajonin, paraqiten në grafikun 6.2.

¹³⁴Dr. Zamir Poda, autor i cituar.



Burimi: Pyetësi 1 “*Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri-Kosovë, 2008-2015*”, plotësuar nga personalitete publike dhe ekspertë të sigurisë e të drejtësisë në Shqipëri, Kosovë dhe ekspertë ndërkombëtarë. Përpunim i autorit (2016).

Grafiku 6.2 Veprimtaritë kriminale të organizuara në Shqipëri-Kosovë në krahasim me rajonin.

Në grafikun e mësipërm pasqyrohen kriminaliteti në Shqipëri, kriminaliteti në Kosovë dhe kriminaliteti në rajon sipas veprimtarive të trafikut të drogës, korrupsionit, pastrimit të parave, vrasjeve me pagesë, trafikut të qënieve njerëzore, gjorbëvënies, kontrabandimit të emigrantëve, trafikimit të armëve, terrorizmit dhe krimi të organizuar kibernetik. Nga analizimi i të dhënave të paraqitura, konstatohet se kriminaliteti në Shqipëri, kriminaliteti në Kosovë dhe kriminaliteti në rajon në të gjitha llojet e veprimtarive të shfaqura në grafik është prezent. Ndërkohë, “një nga aspektet më shqetësuese të lidhjeve ndërmjet Europës dhe jugut të Mesdheut ka të bëjë me *transnacionalizimin* e krimit. Me fjalë të tjera, me eventualitetin e lidhjeve ndërmjet krimit të organizuar italian e shqiptar (tashmë të vërtetuar), por edhe fundamentalizmin islamik në aspekte të ndryshme. *Së pari*, mundësia e “absorbimit” të projekteve islamike të destabilizimit nga ana e organizimeve kriminale shqiptare, italiane por edhe europiane.¹³⁵” Ndërkohë, tabela 6.14, shpjeguese për veprimtaritë kriminale të organizuara në Shqipëri - Kosovë në krahasim me rajonin, paraqet në formë tabelare të dhënat që paraqiten edhe në tabelën 6.13.

Tabela 6.15 pasqyron veprimtarinë e manifestimit të krimit të organizuar, kriminalitetin e organizuar Shqipëri-Kosovë- rajon dhe kriminalitetin e organizuar transnacional me bazë lokale dhe transnacionale Shqipëri-Kosovë. Sipas të dhënave tabelare rezulton se në tërësi sipas veprimtarive, *trafikun e drogës* renditet në vendin e parë, me 207, më pas, renditet *korrupsioni* me 107, *trafikun e qënieve njerëzore* me 89, *pastrimi i parave* me 88, *trafikun e armëve* me 50, terrorizmi me 41, *kontrabandimi i emigrantëve* me 37,

¹³⁵Po aty.

vrasjet me pagesë me 29 etj. Ndërkohë, *trafiku i drogës* rezulton të jetë më i lartë në kriminalitetin transnacional Shqipëri - Kosovë 42, në Shqipëri 39, kriminaliteti transnacional me bazë transnacionale Shqipëri-Kosovë 38, kriminaliteti në rajon 37, kriminaliteti me bazë lokale Shqipëri - Kosovë 32 dhe kriminaliteti në Kosovë 19.

Korrupsioni renditet në vendin e parë në Shqipëri me 37, në Kosovë 33, dhe kriminaliteti transnacional Shqipëri - Kosovë 14, dhe në rajon 12. *Trafiku i qenieve njerëzore* në rajon 27, kriminaliteti transnacional me bazë transnacionale Shqipëri - Kosovë 19, kriminaliteti me bazë lokale Shqipëri - Kosovë 17, kriminaliteti transnacional Shqipëri - Kosovë 10, kriminaliteti në Shqipëri 9 dhe në Kosovë 7. *Pastrimi i parave* renditet në vendin e parë kriminaliteti në Shqipëri 20, kriminaliteti në rajon 19, kriminaliteti me bazë lokale Shqipëri - Kosovë 14, kriminaliteti në Kosovë dhe kriminaliteti transnacional Shqipëri - Kosovë 12 dhe kriminaliteti transnacional me bazë transnacionale Shqipëri-Kosovë 11. Ndërsa, tabela 6.16 paraqet një përmbledhje krahasuese të veprimtarive kryesore kriminale të organizuara në Shqipëri, Kosovë, kriminaliteti transnacional Shqipëri - Kosovë dhe kriminaliteti transnacional me bazë transnacionale dhe me bazë lokale Shqipëri - Kosovë dhe kriminaliteti në rajon, për dhjetë veprimtaritë kryesore të formave të krimit të organizuar transnacional të shprehur në përqindje.

6.10. Faktorët e jashtëm që ndikojnë në veprimtaritë kriminale të organizuara në nivelet lokale dhe transnacionale Shqipëri- Kosovë.


Sipas raportit të OKB-së të vitit 2004¹³⁶ gjashtë janë kërcënimet bazë të shekullit të 21-të:

"1. kërcënimet ekonomike dhe sociale, përfshirë varfërinë, sëmundjet infektive dhe degradimin mjedisor, 2. konfliktet midis shteteve, 3. konfliktet e brendshme, përfshirë luftën civile, gjenocidin dhe mizori të tjera të një shkallë të gjerë, 4. armët bërthamore, radiologjike, kimike dhe biologjike, 5. terrorizmi dhe 6. krimi i organizuar transnacional."

Pra, të gjitha këto kërcënime, kanë të bëjnë me sigurinë, në tërësi por, kërcënimi i gjashtë është krimi i organizuar transnacional. Termi dhe nocioni "siguri" prek në mënyrë të drejtpërdrejtë marrëdhëniet njerëzore, duke filluar nga individit, familja, fisi, komuniteti,

¹³⁶UN High Level panel report, 2004 (*Threats Challenges and Change A More Secure World: Our Shared Responsibility*).

shoqëria, shteti, vendi, kombi, rajoni, kontinenti, njerëzimi dhe mbarë bota. Ai prek, gjithashtu, vetë sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare, sepse lidhet, nga njëra anë, me liritë dhe të drejtat e njeriut dhe, nga ana tjetër, me të drejtën dhe detyrimin e shtetit dhe/ose organizatave ndërkombëtare që kanë të bëjnë me sigurimin e jetës, të shëndetit, të lëvizjes së lirë, të komunikimit, pra të vetë ekzistencës. Shtetet, sikurse individët, janë të pasigurtë në proporcion me shkallën e lirisë së tyre.




Burimi: Pyetësi nr. 2 “Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri- Kosovë, 2008-2015”, plotësuar nga studentët e fakulteteve të Drejtësisë dhe të Sigurisë në Prishtinë dhe Tiranë. Përpunim i autorit (2016).

Figura 6.18 Veprimtaritë kriminale të organizuara më të përhapura në nivel rajonal ose më gjërë (Anketimi i studentëve).¹³⁷

Sipas të dhënave të figurës 6.18 rezulton se për periudhën 2008-2015, veprimtaritë kriminale të organizuara më të përhapura në nivel rajonal ose më gjërë rezuëton se, trafiku i drogës 54%, korrupsioni 16%, pastrimi i parave 8%, kontrabandimi i emigrantëve 7%, trafikimi i qenieve njerëzore 6%, etj.

¹³⁷ Të anketuarit kanë pasur të drejtën e dhënies vetëm të një përgjigjeje (vetëm një mundësi përzgjedhjeje).



Burimi: Pyetësi 2 “*Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri- Kosovë, 2008-2015*”, plotësuar nga studentët e fakulteteve të Drejtësisë dhe të Sigurisë në Prishtinë dhe Tiranë. Përpunim i autorit (2016).

Figura 6.19 Faktorët e jashtëm që ndikojnë në veprimtaritë kriminale të organizuara në nivelet lokale dhe transnacionale Shqipëri- Kosovë (Anketimi i studentëve).¹³⁸

Sipas të dhënave të tabelës 6.17, dhe figurës 6.19 rezultojnë se për periudhën 2008-2015, për faktorët e jashtëm që ndikojnë në veprimtaritë kriminale të organizuara në nivelet lokale dhe transnacionale Shqipëri- Kosovë nga përgjigjet e 702 studenteve të anketuar rezultojnë se janë paraqitur faktorët: 1. *krimi i organizuar transnacional* me 315 përgjigje ose 45%; 2. *presionet politike* me 174 përgjigje ose 25%; 3. *pastrimi i parave* me 102 përgjigje ose 15%; 4. *kontrabandimi i emigrantëve* me 35 përgjigje ose 5%; 5. *nuk e di/ pa përgjigje* me 26 përgjigje ose 4%. 6. *terrorizmi* me 125 përgjigje ose 4%; 7. *krimi i organizuar kibernetik* me 24 përgjigje ose 3%.

Pra, faktori i jashtëm më i rëndësishëm që ndikon në veprimtaritë kriminale të organizuara në nivelet lokale dhe transnacionale Shqipëri- Kosovë, është krimi i organizuar transnacional me 315 përgjigje ose 45% dhe, nga ana tjetër, rezultojnë 6 faktorët e tjerë të marrë së bashku me 361 përgjigje ose 51.42%. Ky perceptim i 702 studentëve të Drejtësisë dhe të Studimeve të Sigurisë në Shqipëri dhe në Kosovë, në Tiranë dhe në Prishtinë, është dominant dhe provon se krimi i organizuar transnacional ndikon ndjeshëm në aspektet e

¹³⁸ Të anketuarit kanë pasur të drejtën e dhënies vetëm të një përgjigjeje (vetëm një mundësi përzgjedhjeje).

demokracisë, të institucioneve demokratike, të sigurisë kombëtare dhe të institucioneve të sigurisë.

Në lidhje me faktorët e jashtëm që ndikojnë në aktivitetet e krimit të organizuar në nivelet lokale dhe transnacionale mes Shqipëri -Kosovës u zhvilluan intervista të thelluara me personalitete politike, shtetërore, publike dhe ekspertë të sigurisë dhe të drejtësisë në Shqipëri, Kosovë dhe ekspertë ndërkombëtarë.

Në këtë studim po paraqesim disa prej këtyre intervistave për këtë çështje. Dr. Zef Preçi shprehet se disa nga faktorët e jashtëm janë:

"1. Hapja me botën është një faktor që nuk duhet injoruar si faktor.

2. Qenia në portat e Europës nga Lindja e Mesme, Kina, Azia, Afrika etj.

3. Qenia e vendit me institucionet më të dobëta e bën më atraktiv për investimet anonimë fantazme, organizatat kriminale të natyrave të ndryshme dhe për rrjedhojë krimi i organizuar tenton të zhvendoset drejt këtyre zonave siç është Shqipëria dhe

4. Ka të bëjë me emigracionin masiv të moshave të reja.....Kuptohet periudha e tranzicionit është një periudhë e artë për të uzurpuar tregjet nga krimi i organizuar për të zhvilluar aktivitetin e tyre. Edhe krimi i organizuar deri tani blen pasuritë e patundshme në zonat e bregdetit. Qenia në një vend si Shqipëria që ndodhet në hyrje të portave të Europës mbetet një aset i madh edhe për Krimin e Organizuar. Hapja me botën i krijon kushte dhe mundësi emigracionit. Emigracioni ka të bëjë me hapjen e botës. Krimi i organizuar shqiptar lidhet me botën. Ne kemi pasur një emigracion masiv me forca njerëzore të paedukuara dhe për rrjedhojë shoqëria e lirë dhe moshat e reja ku për fat të keq Krimi i Organizuar shqiptar renditet në nivele të larta dhe renditet krahas mafias tradicionale klasike.¹³⁹"

Dr. Bekim Podrimcaku shprehet:

"1. Krimi i organizuar është transnacional në të gjithë botën dhe ai prek shumë shtete, vende dhe popuj. Pra ai, ka vende që janë burimore, por edhe lokale e tranzite, në këtë kuptim edhe aspekti ndërkufitar Shqipëri-Kosovë është i përfshirë nga elementi transnacional,

2. Shqipëria dhe Kosova kufizohen me shtete jo të fuqishme, jo të zhvilluara e të përparuara, me shtete që kanë pasur dhe vazhdojnë të kenë zhvillim ekonomik jo të kënaqshëm, situata politike dhe problematika me gjendjen e kriminalitetit dhe krimit të organizuar në veçanti, pra nga këto shtete ka pasur dobësi të cilat kanë reflektuar edhe në Shqipëri e Kosovë, përmendim Serbinë, Malin e Zi, Maqedoninë, Bosnje Hercegovinën, por edhe Greqinë me krizat e saj apo Italinë. Në aspektin e krimit të organizuar, disa prej këtyre vendeve kanë qenë vende burimore, vende destinacioni, dhe qenia vend destinacioni , burimi, është shumë më e rëndë, sesa qenia vend tranzit,

3. Shqipëria dhe Kosova, jane vende "urë" komunikimi në rajon, jemi pothuajse "kërthiza" e rajonit dhe si e tillë, krimi i organizuar e veprimtaritë kriminale përshkojnë, kalojnë nëpër këtë "urë" kalimi.

4. Shqipëria dhe Kosova kanë shumë emigrantë (mërgatë) në botë, por edhe në rajon. Dhe siç ka ndodhur edhe gjatë viteve të historisë njerëzore popujt e vegjël dhe sidomos të varfër dhe të pazhvilluar, pasi kanë emigruar në vende të tjera, pjesa dërmuese e tyre kanë qenë "të

¹³⁹Dr. Zef Preçi, Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i Albanian Center for Economic Research (ACER), Ministër i Ekonomisë në qeverinë e viteve, ekspert i fushës ekonomike, profesor (03.11.2015).

punësuar në kriminalitetin e tyre” nga vendet e zhilluara pritëse. Pra, kanë qenë kontigjentet e para të krimit.¹⁴⁰

Prof. as. dr. Iva Zajmi shprehet se *shtetet e dobëta, administrata me aftësi të dobëta, rënia ekonomike, varfëria e pambështetur nga politikat qeveritare, ekstremizmi fetar dhe ideologjik, ndikimi i tensioneve në Siri dhe Ukrainë.¹⁴¹*

Dr. Ilir Panda shprehet se:

"Shqipëria dhe Kosova janë vende gjeografikisht tranzite të krimit të organizuar transnacional, por transnacionaliteti vjen, sepse lidhet me ofertën. Droga nuk qëndron në Shqipëri dhe në Kosovë për dy arsye, së pari, nuk ka fuqi blerëse dhe, së dyti, nuk ka popullsi të madhe. Prandaj ky krim është transnacional, sepse ka ofertë dhe fuqi blerësi më të madhe në vendet e tjera të Europës e më gjerë.¹⁴²

Për prof. Bajram Yzeiri, *faktorët kryesorë janë: liberalizimi i lëvizjes së lirë të njërzëve, mallrave, marrëdhëniet e reja ekonomike, niveli i investimeve dhe sipërmarjes, teknologjia dhe informacioni, dobësia e institucioneve ligjzbatuese dhe sistemit të drejtësisë etj.¹⁴³* Prof. dr. Ermir Dobjani mendon se *faktori kryesor është mbyllja e Kosovës, duke qenë i vetmi vend në rajon që nuk ka liri lëvizje në Europë (BE).¹⁴⁴* Studiuesi Bekim Budo avancoi më tej, kur thotë, *emigracioni dhe kthimi i personave të dënuar shqiptarë nga burgjet e shteteve të tjera në Shqipëri dhe në Kosovë¹⁴⁵*. Ndërsa për Dr. Aldo Bumcin është *emigracioni.¹⁴⁶* Ndërsa, Gjergj Lezhja, *emigracioni shqiptar pas viteve 90.¹⁴⁷* Prof. Besnik Shehu, përmend dy faktorë:

"1. Prania e një numri të madh emigrantësh të të dyja vendeve në Evropë dhe në SHBA, ku individë apo grupe kriminale shqiptare janë lidhur ose po konkurrojnë mafiet vendase dhe ato

¹⁴⁰ Dr. Bekim Podrimcaku, Drejtor i Departamentit për Analizë dhe Politikë të Sigurisë në Sekretariatit e Këshillit të Sigurisë në Qeverinë e Kosovës.

¹⁴¹ Prof. as. dr. Iva Zajmi, zëvendësministre e Brendshme 2005-2013. Professore në disa universitete në Shqipëri dhe Kosovë.

¹⁴² Dr. Ilir Panda, Ministër i Drejtësisë, studiues, profesor, jurist, autor i disa librave dhe shumë shkrimeve e artikujve shkencore, dekan i Fakultetit të Drejtësisë në Universitetin “Marin Barleti”, Tiranë.

¹⁴³ Profesor Bajram Yzeiri, Ministër i Rendit Publik, Zvministër i Rendit Publik, drejtor i Akademisë së Policisë, këshilltar i Ministrit të Brendshëm, këshilltar i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, profesor në disa universitete në Tiranë, Durrës, Prishtinë.

¹⁴⁴ Prof. dr. Ermir Dobjani, Avokat i Popullit 2000-2010 (dy mandate), profesor në disa universitete në Shqipëri.

¹⁴⁵ Bekim Budo, profesor, studiues.

¹⁴⁶ Aldo Bumci, jurist i njohur, Ministër i Drejtësisë, Ministër i Punëve të Jashtme, deputet i Kuvendit të Shqipërisë, studiues dhe pjesëmarrës në shumë konferenca shkencore (16.02.2016).

¹⁴⁷ Gjergj Lezhja, këshilltar i Presidentit të Republikës për Sigurinë Kombëtare, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, zëvendësministër i Brendshëm.

ruse apo të vendeve të tjera, në trafikun e drogës, prostitucionit, qenieve njerëzore dhe armëve. 2. investimi i parave të pista në ekonominë e vendeve tona, në formën e pastrimit të parave.^{148"}

Ndersa gazetari dhe analisti, Erion Kristo, shprehet për: *1. pastrimin e parave, 2. ndonjëherë terrorizmi ekstremist fetar dhe trafikimi i drogës.*¹⁴⁹ Ahmet Prençi¹⁵⁰ dhe dr. Petrit Bushi¹⁵¹, shprehen se *Kosova dhe Shqipëria paraqesin 1 urë lidhëse për veprimtaritë kriminale që synojnë të ushtrohen nga Lindja në Perëndim dhe anasjelltas, dhe 2.faktor ndikuar të zhvillimit të këtyre veprimtarive edhe në Shqipëri-Kosovë.* Deputeti Asllan Dogjani shprehet se:

" Kosova dhe Shqipëria janë një komb pavarësisht se janë dy shtete kanë të njëjtën gjuhë, traditë dhe kulturë. Mungesa e lëvizjes është e madhe dhe kontrollet nuk janë të forta. Krijimi i besimit midis grupeve kriminale dhe për shkak se jemi një komb, por dhe komunikimi është më i lehtë midis tyre. Kosova është një shtet i ri dhe akoma ka institucione që nuk janë të konsoliduara por dhe për shkak të mungesës së përvojës^{152"}

Sipas Andreas Berg,

*"deri diku...faktorët gjeografike..shtetet ulen në rrugët tranzitore logjike ndaj këtyre rrjeteve dhe kimit të organizuar dhe shteteve te tyre relativisht të dobëta, i bëjnë ata të prekshëm. Gjithashtu duhet të kujtohet fakti që këto gjëra të trafikuar në mënyrë ilegale dhe njerëzit vijnë nga Europa Perëndimore dhe bëjnë këtë krim të organizuar.*¹⁵³ Dr. Bajram Rexhepi shprehet se *faktor i parë është konsumi i lëndëve narkotike që bëjnë shtetet e BE-se, sepse është biznes fitimprures.*^{154"}

Edhe dr. Ilir Kulla, shprehet se faktorët janë dy: *1. trafikimin e drogës, i origjinuar nga Afganistani, Irani, Turqia dhe Ballkani dhe 2. Rritja e ekstremizmit fetar tradicional.*¹⁵⁵

Dr. Xhavit Shala evidenton këta faktorë:

"1 Tranzicioni i zgjatur nga regjime totalitare me politikë të ashpër penale drejt një sistemi të brishtë demokratik me institucione të dobëta në një pjesë të vendeve ballkanike. 2. Konfliktet në Ballkan si mundësi potenciale për të përfituar të ardhura nga trafiqe si ai i drogës, armëve,

¹⁴⁸Besnik Shehu, këshilltar i Ministrisë të Punëve të Brendshme, drejtor i kabinetit të Ministrisë të Brendshme, Neritan Ceka dhe Saimir Tahiri, drejtor i kabinetit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së shtetit, Drejtor i Policisë Kriminale, Drejtor i Drejtorisë së Studimeve Strategjike në Akademinë e Policisë, pedagog, profesor, studiues.

¹⁴⁹MA, MBA, Erion Kristo, drejtues i emisionit "Bardhazi" në Scan TV për gazetarinë televizive, dhe dekan i Studentëve në Universitetin "Marin Barleti".

¹⁵⁰ Ahmet Prençi, Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, 2007-2010.

¹⁵¹ Petrit Bushi, dekan i Fakultetit të Ekonomisë në Kolegjin AAB, Oficer i kontaktit të Policisë Shqiptare në Kosovë, drejtor i Drejtorisë së Krimin Ekonomik në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

¹⁵²Asllan Dogjani, deputet i Kuvendit të Shqipërisë, deputet i mazhorancës së Majtë (PS) dhe Deputet i Mazhorancës së djathtë (PD), oficer policie, drejtor i Policisë së Qarkut Gjirokastrë, Fier, Shkodër.

¹⁵³ Andreas Berg, këshillues suedez, zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës.

¹⁵⁴Bajram Rexhepi Kryeministër i Kosovës, Ministri i Brendshëm, deputet i Kuvendit të Kosovës, kryetari i Komunës Mitrovicë (intervista u zhvillua me datë 23.01.2016 në Mitrovicën e Veriut, Kosovë)

¹⁵⁵ Dr. Ilir Kulla, ekspert dhe analist i çështjeve të sigurisë kombëtare dhe rajonale, gazetar, kryetar i Komitetit Shtetëror të Kulteve.

personave të tjerë. 3. Karakteri ndërkombëtar i krimit të organizuar dhe efektet e globalizmit; 4. Mungesa e stabilitetit politik si fenomen i disa vendeve në Ballkan; 5. Pozicioni gjeografik i Ballkanit dhe veçanërisht i dy shteteve shqiptare si mundësi e artë për t'u shfrytëzuar në portat e Evropës. 6. Prezenca e madhe e komuniteteve të vendeve të Ballkanit në perëndim dhe mundësia e shfrytëzimit të tyre si "logjistike" mbështetëse e organizatave kriminale ballkanike. 7. Ekonomia e dobët dhe papunësia e lartë dhe të ardhura të ulëta për frymë e vendeve ballkanike.¹⁵⁶"

Sipas Hydajet Hysenit, *1. trafikimi i drogës, 2. kontrabandimi i emigrantëve dhe 3. pastrimi i parave*.¹⁵⁷ Dr. Marko Bello shprehet se janë pikërisht organizatat tradicionale mafioze, por edhe të tjera nga A.Latine ato që qëmtojnë dhe vendosin lidhje me grupe kriminale në Shqipëri e Kosovë, por edhe anasjelltas.¹⁵⁸ Ndërsa, gazetari dhe analisti Ferdinand Dervishi shprehet për linjat ndërkombëtare të trafikut të drogës, të armëve dhe të qenieve njerëzore.¹⁵⁹ Shyqyri Dekavelli shprehet se:

" forcat dinamike të lidhura kryesisht me ndryshimet politike dhe ekonomike në rajone apo vende të ndryshme që influencojnë në rritjen e veprimtarive ndërkombëtare kriminale apo të grupeve kriminale, dhe 2. Impakti i veprimtarisë kriminale që lidhet me korrupsionin në zhvillimet politike dhe ekonomike në rajone apo vende të ndryshme-Kërcënimi nga krimi i organizuar, aktivitetet kriminale që burojnë nga rajone dhe vende të ndryshme.¹⁶⁰"

Artur Zoto shprehet për globalizmin se:

"ka ndikuar jo vetëm në aspektet ekonomike, sociale, kulturore të një shoqërie, por edhe shtrirjen dhe organizimin e veprimtarive kriminale. Shprehja "think globally, act locally", mendoj se është mjaft relevante për të ilustruar sofistikimin në kryerjen e veprimtarive kriminale. Evoluimi i teknologjisë dhe vënja në përdorim e posedim të mjeteve më të fundit të teknologjisë nga grupet kriminale përbën një faktor shtesë. Nuk duhen anashkaluar konfliktet rajonale që në disa raste kanë shërbyer për "lehtësimin" e veprimtarive kriminale.¹⁶¹"

Dr. Saemira Pino shprehet për krijimin e vatrave të ndryshme të konfliktit apo luftrave jo shumë larg nesh. *Përvoja kriminale e rrjeteve që organizohen e riorganizohen në vendet*

¹⁵⁶Dr. Xhavit Shala, drejtor i Qendrës Kërkimeve Shkencore, Akademia e Sigurisë. Ka qenë drejtor i Drejtorisë së Policisë Kriminale në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, drejtor i Policisë së Qarkut Fier, Lezhe, Drejtues në strukturat qendrore të luftës së krimit në Drejtorinë e Policisë së Shtetit.

¹⁵⁷Hydajet Hyseni, kryetari i Shoqatës së Ish të Burgosurve Politikë të Kosovës, deputet i Kuvendit të Kosovës, deputet i grupit parlamentar të PDK-së dhe i Vetëvendosjes, kryetar i Komisionit Parlamentar të Ligjeve në Kuvendin e Kosovës.

¹⁵⁸ Dr. Marko Bello, Minister i Mbrojtjes, Deputet i Kuvendit të Shqipërisë, Ambasador i Shqipërisë, zëvendëriministër i Ministrisë së Mbrojtjes, gazetar, studjues, pedagog.

¹⁵⁹ Ferdinand Dervishi, Gazetar i mirnjohur, analist, botues, kryeredaktor.

¹⁶⁰Shyqyri Dekavelli, Shefi i Sektorit në DSIK, Drejtor i Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) 2002-2014, Drejtor i Përgjithshëm i SHISH.

¹⁶¹Artur Zoto, Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve në Shqipëri (2013-2015).

*fqinjë. Kufiri relativisht i brishtë dhe jo i vështirë për “t’u thyer”.*¹⁶² Avokat Fahri Danaj shprehet për dy faktorë:

*"1. Shembujt negative dhe organizatat e mirënjohura kriminale të njohura botërisht dhe 2. Problemet e rënda ekonomike, në rritje dhe fakti se jo pak individë që janë marrë me veprimtari kriminale jashtë kanë krijuar të ardhura të mëdha që kanë motivuar njerëz të ndryshëm të ndjekin të njëjtën rrugë, jo të ligjshme.*¹⁶³ "

Sipas Fredi Agastra, *ndikim ka krimi i organizuar ndërkombëtar, ku organizatat ndërkombëtare kriminale kanë shfrytëzuar dhe shfrytëzojnë pozicionin gjeografik të Shqipërisë e të Kosovës për të bërë të mundur trafikimin e drogës nga vendet e prodhimit drejt Europës Perëndimore.*¹⁶⁴ Isuf Celaj, sqaron se lidhjet shoqërore të cilat kanë bazë njohjeje që në periudha emigracioni në një nga vendet e EU-së me persona nga këto vende të cilat janë të përfshira në këto veprimtari, -lidhje gjaku (martesa të ndërsjellta), -lehtësia në komunikim, -niveli i lartë i papunësisë në të dy vendet, -pozicioni gjeografik kufitar.¹⁶⁵

Dr. Florian Qehaja shprehet për tre faktorë: 1. Ekstremizmi i dhunshëm dhe elemente terroriste nga Lindja. 2. Kërkesat për blerje të drogës nga Perëndimi. 3. Kërkesat për trafikimin e qenieve njerëzore për nevoja të klientëve në Perëndim por edhe në Lindje.¹⁶⁶

Ismajl Kurteshi përmend këta faktorë të jashtëm: *pozita gjeografike, mungesa e kontrollit të duhur në vendkalimet kufitare të vendeve të rajonit.*¹⁶⁷ Doktorant Ruzhdi Jashari, u shpreh për: 1. Bashkëpunim të dobët të agjencive të sundimit të ligjit, 2. papunësia dhe gjendja e rëndë sociale e dy vendeve tona, 3. zhvillimi i dobët ekonomik, dhe 4. vonesa e integrimi tona të plota në BE dhe stabilitet të dobët politik.¹⁶⁸ Çlirim Hajdini, përmend faktorët në nivel lokal, si: *mosfunksionimi i shtetit ligjor, papunësia dhe ndikimet e ndryshme, (shoqërore, politike, ideologjike etj.). Ndërsa sa i përket faktorëve në nivele transnacionale shprehet: mosbashkëpunimi dhe koordinimi në fushën e sundimit të ligjit; ndryshimi i*

¹⁶²Dr. Saemira Pino, Dekane e Fakultetit të Shkencave Sociale në Shkollën e Lartë Universitare “Marin Barleti”, Zëvendërs Ministre e Ministrisë së shëndetësisë, Kryetare e Formuit të Grave të Partisë Socialiste, aktiviste shoqërore e mironjohur, studiuese, profesore në Universitetin Shtetëror, në Fakultetin e Shkencave Sociale.

¹⁶³ Fari Danaj, Prokuror i Apelit ne Prokurorine e Pergjithshme, Prokuror ushtarak, avokat, Jurist i njohur.

¹⁶⁴Fredi Agastra, Drejtori i Policise se Rendit ne Drejtorine e Pergjithshme të Policisë së shtetit, Keshilltar i Drejtorit te Policise se Shtetit.

¹⁶⁵ Isuf Celaj, Drejtor i Sherbimeve te Pergjithshme ne Ministrine e Brendeshme 2005-2013.

¹⁶⁶Ph.D Florian Qehaja, drejtor i Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) Kosovë.

¹⁶⁷Ismajl Kurteshi, deputet në Kuvendin e Kosovës, kryetar i Komunës së Gjilanit në Kosovë, aktivist politik i Partisë Vetëvendosja në Prishtinë.

¹⁶⁸Dokrorant Ruzhdi Jashari, drejtori i Agjensisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhenave Personale Kosovë,

*mentalitetit shoqëror; papunësia etj.*¹⁶⁹ Fred Newton përmend *mungesën e inteligjencës së ndarë mes dy shteteve. Një shembull i mirë i bashkëpunimit është ndarja e të dhënave për çdo sistem të Menazhimit të Kufijve, që prodhon rezultate të mira pozitive.*¹⁷⁰

Pra, përgjigjet e të intervistuarve dhe përgjigjet e studentëve të anketuar, japin përgjigje dhe argumente konkrete në shifra dhe me fjale e shprehje konkrete, me mendime, propozime e sugjerime se pyetjet kërkimore janë vërtetuar dhe ata e provojnë hipotezën e studimit se *siguria kombëtare dhe funksionaliteti i institucioneve demokratike të Shqipërisë dhe Kosovës mbetet e kushtëzuar nga parandalimi, goditja dhe lufta e krimit të organizuar transnacional.*

6.11 Përmbledhje.

Në këtë kapitull u trajtuan krimi i organizuar transnacional Shqipëri- Kosovë- rajon- analizë krahasuese. Hulumtimi u realizua mbi baza lokale dhe transnacionale si dhe analizë krahasuese midis dy vendeve. Pyetjet dhe nënpyetjet kërkimore që lidhen me veprimtaritë kriminale të organizuara, më të përhapura në nivel transnacional dhe lokal, që kanë bazë lokale Shqipëri –Kosovë, dhe krimi i organizuar në nivel transnacional me bazë lokale e transnacionale, kriminaliteti transnacional me bazë transnacionale dhe me bazë lokale, u testuan gjatë këtij kapitulli jo vetëm në nivele lokale, por edhe në nivel ndërshtetëror dhe rajonal.

Kapitulli vijon me trajtimin e faktorëve të jashtëm që ndikojnë në veprimtaritë kriminale të organizuara në nivelet lokale dhe transnacionale Shqipëri- Kosovë. Nga hulumtimi i kryer arrihet në disa përfundime:

1. Veprimtaritë kriminale të organizuara më të përhapura në nivel transnacional Shqipëri- Kosovë janë: trafikimi i drogës, korrupsioni, pastrimi i parave etj,
2. Tri veprimtaritë kriminale të organizuara më të përhapura në Shqipëri janë: evidentuar: korrupsioni, trafikimi i drogës, pastrimi i parave,

¹⁶⁹ Çlirim Hajdini, Zyrtar Policor Prishtinë.

¹⁷⁰ Fred Newton QPM, ekspert i pavarur i ligjit.

3. Veprimtaritë kriminale të organizuara më të përhapura në nivel transnacional që kanë bazë transnacionale Shqipëri- Kosovë janë: trafikimi i drogës, korrupsioni, pastrimi i parave;
4. Në tri aspektet, si: kriminaliteti transnacional ndërmjet dy vendeve Shqipëri-Kosovë, kriminaliteti transnacional me bazë transnacionale Shqipëri - Kosovë, dhe kriminaliteti transnacional me bazë lokale Shqipëri-Kosovë, *trafikimi i drogës* renditet në nivelin e parë, *trafikimi i qenieve njerëzore* renditet në nivelin e dytë dhe *korupsioni* renditet në nivelin e tretë;
5. Kriminaliteti transnacional me bazë lokale Shqipëri - Kosovë renditet në nivele më të ulëta se sa kriminaliteti transnacional Shqipëri - Kosovë dhe kriminaliteti transnacional me bazë transnacionale Shqipëri – Kosovë;
6. Nga analiza krahasuese Shqipëri-Kosovë rezulton se krimi i organizuar më i zhvilluar në Shqipëri dhe në Kosovë është *krimi i organizuar me bazë transnacionale Shqipëri - Kosovë*, dhe më pak i zhvilluar, është kriminaliteti me bazë lokale Shqipëri-Kosovë.
7. *Trafikimi i drogës* është forma e kriminalitetit të organizuar që është më e zhvilluar në krahasim me të gjitha llojet e tjera të veprimtarive të krimit të organizuar. Trafikimi i drogës në Shqipëri dhe në Kosovë ka më shumë bazë transnacionale se sa bazë lokale;
8. Faktori i jashtëm më i rëndësishëm që ndikon në veprimtaritë kriminale të organizuara në nivelet lokale dhe transnacionale Shqipëri- Kosovë, është krimi i organizuar transnacional me 315 përgjigje ose 45%. Krimi i organizuar transnacional provohet edhe nga intervistat e zhvilluara se ndikon ndjeshëm në aspektet e demokracisë, institucioneve demokratike, sigurisë kombëtare dhe institucioneve të sigurisë.

Nëpërmjet këtij kapitulli dhe në vijim të verifikimit të pyetjeve kërkimore edhe në kapitujt e deritanishëm konkludohet se provohet hipoteza e studimit: “Siguria kombëtare dhe funksionaliteti i institucioneve demokratike të Shqipërisë dhe Kosovës mbetet e kushtëzuar nga parandalimi, goditja dhe lufta e krimit të organizuar transnacional”. Kapitulli që vijon, paraqet nivelin e bashkëpunimit Shqipëri-Kosovë dhe ndikimin që paraqet ky bashkëpunim për forcimin e shtetit ligjor kundër krimit të organizuar transnacional.

KAPITULLI VII:

NIVELI I BASHKËPUNIMIT SHQIPËRI-KOSOVË DHE NDIKIMI QË PARAQET KY BASHKËPUNIM PËR FORCIMIN E SHTETIT LIGJOR KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR TRANSNACIONAL

7.1 Hyrje.

Në këtë kapitull paraqitet hulumtimi për nivelin e bashkëpunimit Shqipëri - Kosovë dhe ndikimi që paraqet ky bashkëpunim për forcimin e shtetit ligjor kundër krimit të organizuar transnacional. Ky kapitull trajton dy pyetje kërkimore. 1. Cili është niveli i bashkëpunimit Shqipëri-Kosovë dhe ndikimi i tij në forcimin e shtetit ligjor kundër krimit të organizuar? 2. Cili është niveli i bashkëpunimit rajonal e ndërkombëtar midis Shqipërisë dhe Kosovës dhe institucioneve ndërkombëtare në luftën kundër aktiviteteve të krimit të organizuar transnacional?

Kapitulli trajton aspektet e bashkëpunimi ndërshtetëror në luftën kundër krimit të organizuar transnacional dhe parandalimi i krizave të brendshme, për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar transnacional, kuadri juridik bilateral Shqipëri- Kosovë, bashkëpunimi policor dy palësh, bashkëpunimi rajonal, ndërkombëtar, me Interpolin, Europolin, FBI-në, qendrën SECI, me synim përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës për forcimin e shtetit ligjor dhe luftën kundër krimit të organizuar transnacional në të dy vendet.

Synimi i këtij kapitulli është verifikimi dhe të provuarit e hipotezës së studimit, ngritja dhe funksionalizimi i institucioneve bashkëpunuese e bashkërenduese transnacionale ndikon në efektivitetin veprimtarisë së institucioneve të sigurisë për parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar në nivel lokal/nacional dhe rajonal.

7.2. Bashkëpunimi ndërshtetëror në luftën kundër krimin të organizuar transnacional dhe parandalimi i krizave të brendshme.

Krimi i organizuar “*nacional*”¹⁷¹ (i brendshëm), krimi i organizuar “*ndërnacional*”¹⁷² krimi i organizuar “*transnacional*”¹⁷³ (ndërkombëtar) krimi i organizuar “*global*”¹⁷⁴ (shumëkombësh) sot në botë është shndërruar në një problem, dhe madje në një “*fenomen*” global.

Globalizmi- prirja e rendit të ri botëror ka të bëjë me zhvillimet e shumta teknologjike, por jo vetëm, dhe ka ndikuar pozitivisht në zhvillimin ekonomik dhe të teknologjisë botërore. Por, nga ana tjetër, krimi i organizuar transnacional është “*ana e errët*” e globalizmit, prandaj, “problemet globale i përgjigjen inisiativave lokale, por ato gjithashtu kërkojnë zgjidhje globale.” (Anthony Giddens, 1988: 153), marrë nga (Përparim Kabo, 2006: 382)

Krimi i organizuar transnacional ka krijuar probleme sociale e shoqërore, por në aspektin e krimin të organizuar transnacional e shumëkombësh, ka sjellë shqetësime të mëdha: vrasje, vdekje, dhunë, krime të rënda dhe me rrezikshmëri të lartë shoqërore, ka shkaktuar viktima të shumta dhe ka “*nënshtruar*” shtesa shoqërore, klasa, grupe, individë e deri zona, krahina, fshatra, lagje, institucione, qeveri e shtete të veçanta që janë bërë pjesë e varësisë së krimin të organizuar. Krimi i organizuar nuk njeh kombësi, shtete, kufij, atdhe, raca, etni, fe dhe besime fetare. Prandaj “*nuk duhet harruar që organizimet kriminale, nuk kanë probleme kufijsh dhe që veprojnë me siguri të plotë në të gjithë botën.*” (Zamir Poda, 1998:26).

Në këtë drejtim “loja e çrregullt e tregut dhe prirjet anarkike kanë shpënë te kapitalizmi grabitqar, si e çuan Sorosi, këtë lloj anarkie në krijimin e kapitalit privat, që ka sjellë uzurpimin e pasurive kombëtare, mjeteve shtetërore dhe tregjeve nga grupime të caktuara... .”(Përparim Kabo, 2006:385). Por, “këto rregullime mund të quhen pikërisht

¹⁷¹ Krimi i organizuar “*nacional*” (i brendshëm) quhet kur ai kryhet brenda kufijve kombëtar të një vendi

¹⁷² Krimi i organizuar “*ndërnacional*” quhet kur organizimi kriminal i një vendi e shtrin veprimtarinë dhe vepron edhe në vende të tjera.

¹⁷³ Krimi i organizuar “*transnacional*” (ndërkombëtar) quhet organizimi kriminal i një vendi që vepron edhe në vende të tjera, duke bashkëpunuar me organizimet kriminale të këtyre vendeve.

¹⁷⁴ Krimi i organizuar “*global*” (shumëkombësh) quhet organizimi kriminal në formën e ndërmarrjeve, organizatave apo sipërmarrjeve kriminale me përbërje nga shtete e kombe të ndryshme të cilët e ushtrojnë veprimtarinë e tyre kriminale në vende dhe kombe të ndryshme.

kapitalizëm grabitqar, sepse rruga më e efektshme për të grumbulluar kapital privat nga një pikënisje zero ishte të përvetësoheshin mjetet e shtetit.” (George Soros, 1999:154).Për të parandaluar këto veprime Xhovani Falkone shprehet se: “...natyrisht është e praktikueshme rruga e konventave multilaterale, por shumë vende e japin pëlqimin e tyre për to me shumë rezervë, duke i bërë thjesht nominale.”(Zamir Poda, 1998 : 29). Prandaj, mosnjohja, mosvlerësimi dhe neglizhimi i aspekteve të bashkëpunimit ndërkombëtar për të luftuar “fenomenin” e krimit të organizuar transnacional, jo vetëm ndikon negativisht për shtetet, organizatat ndërkombëtare, por, nga ana tjetër, ndihmon pozitivisht dhe bëhet një kusht shumë i rëndësishëm dhe i favorshëm për grupet, organizatat dhe ndërmarrjet e sipërmarrjet kriminale për të arritur qëllimet e tyre.

Dukuritë më shqetësuese për rendin e ri botëror janë format e reja të krizave që po provohen prej figurave konfliktuale ndërkombëtare, siç janë: krimi i organizuar, terrorizmi ndërkombëtar dhe pastrimi i parave, të cilat nuk njohin dhe nuk kanë kufij, nuk kanë atdhe, nuk mbartin ngjyra ideologjike, fetare, racore e kulturore.“Krimi i organizuar dhe terrorizmi kanë për institucion financiar paranë e zezë.” (Lisen Bashkurti, 2008:18).Ato i kanë rrënjët te boshti i së keqes dhe i shërbejnë atij. *Në kohën mbas Luftës së Ftohtë po vërehet edhe një përplasje në rritje midis tendencave hapëse të globalizmit dhe tendencave mbyllëse të nacionalizmit.*”(George Soros, 1999:19). Xhovani Falkone, duke u referuar disa analistëve shprehet se:

“janë shumë të rrezikshme, me dëme të pallogaritshme dhe paradoksale, disa tentativa të përsëritura, që kërkojnë të përcaktojnë se krimi i organizuar nuk ekziston, si një shoqëri kriminale”, dhe se të tilla koncepte,“të shprehura herë-herë edhe nga politikanë, por edhe juristë, paraqiten tepër naïve.” (Zamir Poda,1998:29).

Këto përcaktime janë shumë të rrezikshme dhe me dëme të pallogaritshme aq më tepër sot ku krimi i organizuar transnacional ka fituar terren, është shtrirë më gjerë dhe ka depërtuar më thellë nëpërmjet korrupsionit të zyrtarëve shtetërorë. Prandaj, është detyrë e domosdosshme ashkëpunimi ndërqeveritar dhe ndërinstitutional në këtë luftë të përbashkët kundër kësaj të keqeje që i ka përfshirë të gjitha shtetet, kombet, popujt dhe vendet ne botë, kush më shumë e kush më pak. Sulmet terroriste të 11 Shtatorit 2001 në SHBA, por jo vetëm, si dhe aktet e fundit të terrorizmit nga ISIS-i apo dhe krime te tjera të rënda që po ndodhin sot në botë, tregojnë se krimi i organizuar transnacional dhe kriminelët *qëndrojnë një hap përpara “stay one step ahead”* zbatimit të ligjit “*of law enforcement.*”

Krimi i organizuar, terrorizmi dhe pastrimi i parave etj., janë kërcënime të sigurisë globale dhe burim krizash lokale, rajonale e ndërkombëtare. Ballkani Perëndimor ka një pozitë të rëndësishme, por edhe të komplikuar gjeostrategjike. Sipas Prof. Lisen Bashkurti:

“...Ballkani Perëndimor është përballë nevojës për të marrë një sërë masash. Rajoni ynë përfaqëson një terren me të kaluar krizash, konfliktesh dhe luftërash. Le të kujtojmë se Bosnja, Serbia, Kosova, Kroacia u përfshinë në luftë, ndërsa Shqipëria dhe Maqedonia kaluan kriza serioze në këtë mjedis destabilizues, potenciale të mëdha armësh janë të lira ose në duart e popullsisë së rajonit. Nga ana tjetër, në disa zona janë evidentuar pjesëmarrës në luftëra lokale disa vullnetarë me precedentë terroristë apo me origjinë dhe lidhje nga vende sponsorizuese të terrorizmit.” (Lisen Bashkurti, 2008:11).

Shtetet e dobëta, demokracitë në tranzicion dhe rregjimet totalitare janë mjedise për kriza të tilla. Shtetet e Ballkanit Perëndimor duhet pranuar në tërësinë e tyre se janë shtete të dobëta, sepse janë karakterizuar nga paqëndrueshmëria ose nga krizat politike, nga funksionaliteti i ulët a mosfunksionaliteti i ulët ose ndryshe nga mosfunksionaliteti i institucioneve publike, nga shkalla e dobët e sigurisë ose pasiguria, nga kapacitetet e pamjaftueshme ushtarake mbrojtëse, si dhe nga një sistem ekonomik i varfër dhe i prapambetur.

Natyrshëm lind pyetja. Si duhet luftuar krimi i organizuar? Përgjigjen na e jep gjykatesi, Giovanni Falcone¹⁷⁵ i cili është shprehur:

“Realiteti kriminal mafioz, është tepër i rëndë, por nuk duhet harruar që janë njerëz si ne, edhe ata që i përkasin krimit të organizuar, i cili si të gjitha gjërat njerëzore, mund të përballohet dhe fitohet ..., por kërkohet impenjim i mprehtë i forcave të rendit dhe magistraturës, kordinuar edhe me punën për zhdukjen graduale të disponibilitetit të popullsisë për të toleruar fenomene e dukuri të tilla, që jo rrallë janë ndeshur... .” (Zamir Poda,1998:18).

Godson Roy & Williams Phil theksojnë:

“Krimi transnacional i organizuar është një sfidë kritike për qeverisje demokratike dhe të tranzicionit dhe modernizimit të proceseve në shumë pjesë të botës. Në përgjigje të kësaj sfide kërkon një strategji gjithëpërfshirëse që kombinon zbatimin e ligjit dhe përgjigjet rregullatore, siç janë analiza të zgjeruara të inteligjencës dhe ndarjen e inteligjencës, ndërtimit të shtetit, dhe bashkëpunimin ndërshtetëror, me qasjet jorregullatore, të tilla si zgjerimin e strategjisë në shoqërinë civile dhe sektorin privat. Kjo e fundit do të përfshijë ndryshimin e qëndrimeve kulturore ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit.” (Godson Roy & Williams Phil¹ : 1998).

Bashkëpunimi ndërkombëtar është një çështje jashtëzakonisht e rëndësishme dhe mjaft komplekse. Në radhë të parë, ai ka të bëjë me ndërgjegjësimin për aftësinë destabilizuese të fenomeneve kriminale transnacionale, dhe, në radhë të dytë, me aftësinë për t'u dhënë shtysë proceseve të përafrimit ligjor dhe përputhjes së politikave kombëtare të

¹⁷⁵Martiri i Drejtësisë Italiane.

qëndrueshme. Për këtë citojmë datën 28 prill 1997, viti i adoptimit të Planit të Veprimit kundër Krimit të Organizuar (akt i Këshillit të Evropës). Prandaj, nevojitet që lufta kundër krimit të organizuar duhet bërë ashtu siç funksionojnë organizatat më të mëdha ndërkombëtare, si bie fjala: OKB^{-ja}, BE^{-ja}, INTERPOLI, EUROPOLI, qendra e SECI^{-t} etj. Por, nga ana tjetër, nuk duhet të harrojmë se mirëfunksionojnë edhe ndërmarrjet, organizatat, mafia dhe grupet kriminale në botë të cilat kërkojnë të shtrijnë aktivitetin e tyre në të gjithë vendin, rajonin dhe në botë. Prandaj, lypet të njohim fillimisht dhe të dimë se shtetet e dobëta ose shtetet e dështuara, si vendet e Botës së Tretë apo vendet që kanë institucione të brishta, politika të paqëndrueshme, shtete totalitare, demokraci të pazhvilluara, ekonomi të dobëta, varfëri e papunësi të madhe, mungesë investimesh, drejtues shteti dhe politikanë të lartë shtetërorë, diktatorë, totalitaristë, të korrumpuar, arrijmë të përcaktojmë, fillimin e duhur të punës për hartimin e politikave, strategjive, programeve e planeve të veprimit të institucioneve për ta luftuar në maksimum krimin e organizuar transnacional.

Si përfundim, mund të themi që vetëm një bashkëpunim ndërqeveritar dhe ndërinstitucional në luftën kundër krimit të organizuar transnacional, trafiqeve të paligjshme dhe terrorizmit, është parakusht për parandalimin e konflikteve dhe krizave të brendshme dhe të jashtme, rajonale e ndërkombëtare, dhe veçanërisht sigurimin e jetës, shëndetit, lirive e të drejtave të njeriut jo vetëm në rajonin e Ballkanit, por edhe në vendet e tjera kudo në botë.

7.3 Bashkëpunimi ndërshtetëror Shqipëri - Kosovë dhe rajon për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar transnacional.

Në kapitullin e pestë dhe të gjashtë analizuam në mënyrë krahasimore veprimtaritë kriminale të organizuara më të përhapura dhe krimin e organizuar transnacional në nivelin dy palësh Shqipëri - Kosovë për periudhën 2008-2015, dhe evidentuam se niveli dypalësh merr një rëndësi strategjike dhe është më vendimtar në kuadër të bashkëpunimit dhe

bashkëndimit të strukturave shtetërore, të agjencive të zbatimit të ligjit dhe nga niveli institucional dhe praktik i këtij bashkëpunimi do të varet edhe bashkëpunimi rajonal dhe bashkëpunimi ndërkombëtar me shtete dhe organizata ndërkombëtare relevante.

Shqipëria dhe Kosova kanë ngjashmëritë e dallimet e tyre, dhe është e jo e lehtë të bëhet një analizë e mirëfilltë krahasimore, për arsye se statusi i shteteve është i ndryshëm dhe për rrjedhojë edhe legjislacionet, edhe format e kriminalitetit dhe gjendja e funksionimi i institucioneve shtetërore dhe të drejtësisë penale, janë në faza të ndryshme të formimit, dhe të zhvillimit të tyre.

Analiza krahasuese e bërë në kapitujt e mëparshëm na jep një pasqyrë të qartë mbi bazën e së cilës në të ardhmen mund të ndërtohet më mirë bashkëpunimi në këtë drejtim për luftë më të efektshme ndaj krimit të organizuar transnacional. Prandaj, me qëllim parandalimin dhe goditjen e veprimtarive kriminale të organizuara transnacionale e lokale që kanë prekur të dy vendet, kërkohet intensifikim i bashkëpunimit midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës.

Për të pasur bashkëpunim të mirë midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës në tërësi në të gjitha fushat, si dhe në luftë kundër veprimtarive kriminale të organizuara transnacionale e lokale që kanë prekur të dy vendet, kërkohet që në radhë të parë, bashkëpunimi i mirë të ekzistojë brenda institucioneve ligjzbatuese në Shqipëri¹⁷⁶ dhe brenda institucioneve ligjzbatuese në Kosovë, dhe më pas të identifikohen projektet e bashkëpunimit Kosovë - Shqipëri, të përgatiten, miratohen dhe të zbatohen me rigorizitet nga të dy palët. Ernst Florian Winter-i shprehet se:

“Bashkëpunimi midis Kosovës dhe Shqipërisë duhet të lirohet nga kompleksët, por edhe nga patetika e fjalëve të mëdha. Kjo kërkon kalimin në identifikimin e projekteve me interes reciprok. Të dyja qeveritë kanë mundësi të bëjnë shumë lidhur me projektet e infrastrukturës (rrugët, energjia, portet), të edukimit dhe të shëndetësisë: në të tri këto segmente ka shumë probleme. Të dy vendet ndoshta të vetmet në Europë, ende nuk janë në gjendje të sigurojnë energji, ujë, edukim të standardeve të larta dhe shërim dinjitoz për qytetarët. Projektet e përbashkëta në këto fusha duhet të menazhohen mirë në tërë ciklin e tyre, pra deri në realizëm. Qeveritë, gjithashtu, duhet të nxisin dhe të lehtësojnë inisiativën private, bizneset, shoqatat dhe shoqërinë civile që të promovojnë projekte bashkëpunimi.”(Ernst Florian Winter, 2007:113).

¹⁷⁶Analiza vjetore e Policisë së Shtetit 2015. Bashkëpunimi me agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit dhe organizmat policore ndërkombëtare, është konkluduar me nënshkrimin e 14 marrëveshjeve dhe memorandumeve të bashkëpunimit me agjenci të vendeve të ndryshme, kryesisht ato të rajonit dhe janë miratuar 3 protokolle për harmonizimin e veprimtarive policore mes vendeve nënshkruese.

Mbledhjet e përbashkëta të dy qeverive shqiptare në Kosovë dhe në Shqipëri, kanë bërë të mundur nënshkrimin e një sërë marrëveshjeve të përbashkëta, dhe është bërë punë e mirë nga institucionet respektive në terrenin e veprimeve të përbashkëta.

Bashkëpunimi i mirë në radhë të parë, ekziston brenda institucioneve ligjzbatuese në Shqipëri dhe në Kosovë. Për të konkretizuar këtë po i referohemi zhvillimit të operacioneve të përbashkëta ndërmjet institucioneve ligjzbatuese në Kosovë. Në Kosovë nga policia e Kosovës, dogana e Kosovës dhe Njësia e Inteligjencës Financiare, për periudhën 2010-2013, (LPP/LFT Këshilli Evropës:2014) janë zhvilluar operacione të përbashkëta për parandalimin e veprimtarive të organizuara kriminale në fushat e krimeve ekonomike, lëndëve narkotikëve dhe të krimit të organizuar, që kanë lidhje me lëvizjet ndërkuftare të parave. Kështu, gjatë vitit 2010 janë organizuar 98 operacione të përbashkëta, gjatë vitit 2011-115 operacione gjatë vitit 2012- 32 operacione, gjatë vitit 2013 - 50 operacione të përbashkëta. Pra, në total për periudhën 2010-2013, janë organizuar 295 operacione të përbashkëta, me synimin kryesor konfiskimin e parave të gatshme. Në aspektin e bashkëpunimit ndërmjet agjencive të brendshme, ky bashkëpunim konsiderohet i suksesshëm.

Bashkëpunimi i mirë midis Shqipërisë dhe Kosovës është manifestuar edhe në drejtim të goditjes së veprimtarisë kriminale ndërnacionale dhe të arrestimit, burgosjes dhe të dënimit të autorëve të veprave penale në të dy anët e kufirit. Kështu, në bazë të ligjit Nr.9496, datë 20.3.2006 “Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Misionit të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) për transferimin e personave të dënuar” ka pasur bashkëpunim të mirë midis dy vendeve. Tabela 7.1 pasqyron numrin e të paraburgosurve dhe të burgosurve të shtetasve shqiptarë kosovarë në Shqipëri, për periudhën 2010-2015.¹⁷⁷

Në mënyrë tabelare, evidentohet se numri i shtetasve shqiptarë të paraburgosur nga Kosova gjithsej janë 26, nga të cilët për prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve 14, vrasje 13, trafikim të narkotikëve 9, grup i strukturuar kriminal 2. Ndërsa, numri i shtetasve shqiptarë nga Kosova të burgosur janë gjithsej 10, nga të cilët 7 persona për trafikim të narkotikëve dhe 1 person për grup i strukturuar kriminal. Në tabelën 7.2 paraqitet numri i

¹⁷⁷Këto të dhëna, të përpunuara nga autori, janë marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Tiranë.

shtetasve shqiptarë nga Kosova të paraburgosur dhe të burgosur, sipas veprave penale të kryera në Shqipëri, për periudhën 2010-2015. Në mënyrë tabelare, numri i shtetasve nga Kosova të paraburgosur për periudhën 2010-2015, evidentohet se janë 4 të paraburgosur për trafikim të narkotikëve, 2 të paraburgosur për trafikim të qënieve njerëzore, dhe një i paraburgosur për pastrimin e parave. Ndërsa, janë dënuar me burgim, 2 persona për trafikim të narkotikëve, dhe një person për trafikim të armëve dhe municioneve në bashkëpunim. Në tabelën 7.3 paraqitet numri i të dënuarve shtetas nga Kosova, të ekstraduar nga Shqipëria, për periudhën 2008-2015. Në mënyrë tabelare, rezulton se në total janë 21 persona, nga të cilët, 3 të ekstraduar në vitin 2010 - 7 të ekstraduar në vitin 2011, nga 3 të ekstraduar në vitet 2012, 2013 dhe 2014, si dhe 2 të ekstraduar në vitin 2015.

7.4 Kuadri juridik bilateral Shqipëri- Kosovë.

Këshilli i Sigurimit i OKB-së më 10 qershor 1999 miratoi Rezolutën 1244 (mbledhja 4011, 10 qershor 1999) të KS-së të OKB-së, e cila konfirmoi kufijtë ndërkombëtarë të Serbisë, duke hequr Kosovën nga juridiksioni i Serbisë dhe duke e zëvendësuar atë me një zgjidhje të përkohshme të një administrate të mbikëqyrtur nga bashkësia ndërkombëtare me qëllim të mbështetjes së zhvillimit të institucioneve funksionale dhe të mëvetësishme në Kosovë. Këshilli i Sigurimit i OKB-së krijoi Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), dhe i dha këtij misioni, kompetenca administrative, legjislative dhe gjyqësore në Kosovë. Më 17 shkurt 2008 në Seancën plenare të jashtëzakonshme solemne të Kuvendit të Kosovës Kosova shpalli pavarësinë nga Serbia. Kuvendi i Republikës së Kosovës me vendimin nr. V-027, datë 9 prill 2008 miratoi Kushtetutën e cila hyri në fuqi me 15 qershor të vitit 2008. Por, Kosova nuk është anëtare e Kombeve të Bashkuara. Megjithatë, Kosova u bë anëtare e Bankës Botërore (BB) dhe e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) më 29 qershor 2009. Gjithashtu, Kosova u bë anëtarja e 66 e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) më 16 nëntor 2012. Kosova është në proces e sipër të anëtarësimit edhe në organizata të tjera ndërkombëtare. Statusi i Kosovës duke qënë ende në proces njohjeje dhe miratimi nga shtete e organizata të ndryshme ndërkombëtare, përsëri vazhdojnë të qëndrojnë rreth 4,882

trupa nga 31 vende kontribuese të Forcës së Kosovës (KFOR)¹⁷⁸ me qëllim për të ndihmuar në mbajtjen e sigurisë dhe të qetësisë. Nga ana tjetër, KFOR-i bashkëpunon dhe ndihmon Kombet e Bashkuara dhe Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit (EULEXⁱ), si dhe aktorët e tjerë ndërkombëtarë, sipas nevojës për të mbështetur zhvillimin e një Kosove stabile, demokratike, shumëtnike dhe paqësore. EULEXⁱ filloi funksionimin në fushën e sundimit të ligjit më 9 dhjetor 2008 në kuadër të kornizës së Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244 (1999) dhe u bë operacional në prill të vitit 2009.¹⁷⁹ Në bazë të ligjit 04-L-273 i cili hyri në fuqi me datën 23 prill 2014, u bë ndryshimi dhe plotësimi i tetë ligjeve lidhur me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosove (EULEXⁱ). Ndërsa, Ligji nr. 04/L-274, ratifikoi marrëveshjen ndërkombëtare në tërësi, duke përfshirë këtu, edhe zgjatjen e mandatit të EULEX^{it} në fushat e parapara në marrëveshje deri më 15 qershor 2016, me përjashtim të Task Forcës Speciale Hetuese.¹⁸⁰ Gjithashtu, Republika e Kosovës ka miratuar bazën ligjore për marrëveshjet ndërkombëtare,¹⁸¹ për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale,¹⁸² si dhe për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare,¹⁸³ të cilat kanë ndikuar pozitivisht për përafrimin dhe besimin më të madh të saj në institucionet ndërkombëtare dhe shtetet respektive. EULEXⁱ, Misioni Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, e ka arritur funksionalitetin e plotë në prill të vitit 2009. EULEXⁱ përbëhet nga rreth 2, 250 të punësuar ndërkombëtarë dhe vendor, dhe është i ndarë në dy “divizione”: “Divizioni Ekzekutiv” dhe “Divizioni i Fuqizimit”. Divizioni Ekzekutiv heton, përndjek dhe gjykon rastet e ndjeshme duke përdorur pushtetin ekzekutiv, ndërsa, Divizioni i Fuqizimit monitoron, mentoron, dhe këshillon homologët vendorë në polici, gjyqësor dhe fushën e veprimtarisë së doganës së Kosovës. Detyra kryesore e EULEX^{it} është të monitorojë, të mentorojë dhe të këshillojë institucionet e Kosovës, në të gjitha fushat e lidhura me shtetin ligjor, si dhe të investigojë,

¹⁷⁸KFORⁱ u vendos në Kosovë në bazë të Rezolutës 1244, Këshilli i Sigurimit, OKB.

¹⁷⁹ Veprimi i Përbashkët i BE-së (VP) i shkurtit 2008 (2008/124/CFSP) i ndryshuar me VP 2009/445/CFSP) dhe Vendimin e Këshillit 2010/322/CSFP) i qershorit 2010. Për më shumë 2012/291/CFSP i qershorit 2012 dhe 2014/349/CSFP i qershorit 2014 ofrojnë bazën ligjore për Misionin. EULEX-i mbështetet nga 28 shtetet anëtare të BE-së dhe 5 shtetet kontribuese.

¹⁸⁰Ligji nr. 04/L-274 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi misionin e Bashkimit Evropian për sundim të ligjit në Kosovë”.

¹⁸¹Ligji nr. 04/L-052 “Për marrëveshjet ndërkombëtare”.

¹⁸²Ligji nr.04/L-31 “Për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale”, i shfuqizuar. Ligji “Mbi bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale” (Ligji nr. 04/L-213, datë 31/07/2013).

¹⁸³Ligji nr. 03/L-183 “Për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare”.

ndëshkojë dhe përforcojë disa kategori të krimeve. Mandati dhe kompetencat e prokurorëve dhe të gjyqtarëve të EULEX-it janë të rregulluara me ligjin nr.03/L-053 ”Mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë” (i ndryshuar).¹⁸⁴ Sipas këtij ligji, prokurorët e EULEX-it janë kompetentë për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve që janë kompetencë e veçantë e Prokurorisë Speciale të Kosovës. Mandati është zgjeruar më datën 17 qershor 2016, edhe për dy vjet të tjera nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe përfundon me datën 15 qershor 2018. EULEX-i përveç të Drejtës Evropiane duhet të operojë edhe nën të drejtën ndërkombëtare.

Disa nga problemet dhe kufizimet e evidentuara në lidhje me EULEX-in janë: mungesa e legjitimitetit; konfuzion dhe mbivendosje të autoritetit dhe të kontrollit; shumë mekanizma, pak besim dhe pak mekanizma/kapacitete lokale; kontradikta mes “statusit neutral” dhe statusit të pavarur të Kosovës dhe nevojës për forcim kapacitetesh lokale.

Qeveritë shqiptare në Shqipëri dhe në Kosovë, ministritë përkatëse, institucionet shtetërore dhe Policia e Shtetit, kanë intensifikuar veçanërisht vitet e fundit bashkëpunimin me njëra-tjetrën. Ndërkohë, bashkëpunimi policor midis dy vendeve tona, ka konsistuar në shkëmbimin e informacioneve policore midis oficerit të kontaktit, Interpol-it dhe Europol-it, në fushat e hetimit të veprave penale për narkotikët, trafiqet e paligjshme, pastrimin e parave, krimin ekonomik e financiar, krimin kompjuterik dhe krimet e rënda. Një bashkëpunim më i gjerë është zhvilluar në fushën e hetimit të narkotikëve dhe trafiqeve, jo vetëm në shkëmbimin e informacioneve policore, por edhe në zhvillimin e hetimeve paralele, operacioneve të përbashkëta ndërkombëtare në fushën e trafikimit të lëndëve narkotike, ashtu si edhe hetimet në rastet e kontrabandës, që zhvillohen në Pikat e Kalimit të Kufirit me Republikën e Kosovës, nëpërmjet shkëmbimit të informacionit dhe zhvillimit të takimeve të përbashkëta mes përfaqësuesve të dy policive, mbi fusha të ndryshme që kanë të bëjnë me krimin ekonomik dhe atë financiar.

Gjatë viteve 2002 - 2015 midis qeverive, ministrive të brendshme dhe Policive të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës, janë nënshkruar 21 marrëveshje, memorandume mirëkuptimi dhe protokolle të përbashkëta .

¹⁸⁴Ligji nr. 03/L-053, i datës 13.3.2008) “Mbi juridiksionin dhe kompetencat e gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, i ndryshuar me ligjin nr. 4/L-273 “Për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve në lidhje me mandatin e misionit të sundimit të ligjit të Bashkimit Evropian në Kosovë”.

. Qeveritë e Shqipërisë dhe të Kosovës kanë nënshkruar 6 marrëveshje, 1 memorandum bashkëpunimi dhe dy protokolle të përbashkëta. Ministritë e Brendshme kanë nënshkruar 2 marrëveshje, 4 memorandume bashkëpunimi dhe 8 protokolle të përbashkëta. Ndërkohë, policitë e dy vendeve kanë nënshkruar 1 marrëveshje, 1 memorandum bashkëpunimi dhe 1 protokoll të përbashkët. Në zbatim të marrëveshjeve, memorandumeve të mirëkuptimit dhe protokolleve të përbashkëta janë kryer hetime paralele, nëpërmjet shkëmbimit të informacioneve dhe veprimeve operacionale për ndihmë të ndërsjelltë. Gjykatësi Falkone shprehet se:

“Edhe këtu do të duhet të urojmë, një harmonizim të legjislacionit nacional, i cili të bëjë të mundur konfiskimin, ndërsa në profilin ndërkombëtar, do të duhet të krijohen instrumenta të zhdërvjellta legjislative, për të lejuar në pritje të shpejtë të letërporosive ndërkombëtare, në mënyrë të drejtë dhe deri në fund”(Zamir Poda,1998:30).

Marrëveshjet, memorandumet e mirëkuptimit dhe protokollat e përbashkëta, të nënshkruara midis dy vendeve tona, për periudhën 2002 - 2015 janë si më poshtë:

Memorandumi i Mirëkuptimit midis Republikës së Shqipërisë dhe Kosovës “Mbi bashkëpunimin policor midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë” (UNMIK) është nënshkruar me datën 9 shtator 2002.

Memorandum i Mirëkuptimit për hapjen e dy pikave të kalimit kufitar, vendkalime kufitare në jug të Dragashit, nënshkruar më 16.10.2002.

Ndërkohë, me datën 2 nëntor 2005 është nënshkruar protokollin në zbatim të Memorandumit të Mirëkuptimit “Mbi bashkëpunimin policor midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK)”. Ky protokoll u nënshkrua me qëllim parandalimin më të efektshëm të luftës kundër krimit të organizuar, terrorizmit, trafikut të drogave dhe lëndëve psikotrope, trafikimit të qenieve njerëzore dhe pastrimit të parave, duke parashikuar krijimin e nënkomisioneve të përbashkëta për krimin dhe informacionin të specifikuar për çështjet e kufirit, çështjet e sigurisë, çështjet e qarkullimit rrugor, zhvillimet policore, dokumentet e udhëtimit dhe ato personale. U emëruan bashkëkryetarët dhe asistentët e tyre për trajtimin e çështjeve nga takimi i mëparshëm, çështje të Policisë së shtetit shqiptar, çështje të UNMIK-^{ut} (Policisë dhe Drejtësisë) dhe çështje aktuale.

Në muajin qershor të vitit 2008 u nënshkrua Memorandum mirëkuptimi ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës. Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal të Republikës së Kosovës, në fushën e qeverisjes vendore dhe decentralizimit, nënshkruar më 6.10.2009.

Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për ripranimin e personave, nënshkruar më 06.10.2009, hyrë në fuqi më 12.03.2010.¹⁸⁵

Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për bashkëpunimin policor ndërkufitar, nënshkruar më 06.10.2009, hyrë në fuqi më 20.03.2010.¹⁸⁶

Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për kryerjen e procedurave të përbashkëta të kontrollit të hyrje-daljeve ndërmjet pikave të kalimit kufitar Morinë (Kukës) - Vërmicë (Prizren) midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës dhe Protokollit për kryerjen e veprimtarive të përbashkëta në këtë PKK, nënshkruar më 30.4.2011, hyrë në fuqi më 21.6.2011.¹⁸⁷

Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për kryerjen e procedurave të përbashkëta të kontrollit të hyrje/daljeve ndërmjet pikave të kalimit kufitar Qafë Morinë (Tropojë)-Qafë Morinë (Gjakovë) midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës dhe Protokollit për kryerjen e veprimtarive të përbashkëta në këtë PKK, nënshkruar më 30.4.2011, hyrë në fuqi më 21.6.2011.¹⁸⁸ Protokoll ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës mbi patrullimin e përbashkët përgjatë kufirit shtetëror midis Republikës së Shqipërisë edhe Republikës së Kosovës, nënshkruar më 10.3.2012, hyrë në fuqi më 10.4.2012.¹⁸⁹

¹⁸⁵ www.kryeministria.al/ www.kryeministri-ks.net/

¹⁸⁶ www.kryeministria.al/ www.kryeministri-ks.net/

¹⁸⁷ www.punetebrendshme.gov.al/

¹⁸⁸ www.mpb-ks.org/

¹⁸⁹ www.punetebrendshme.gov.al/

Protokoll ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës mbi organizmin dhe zhvillimin e takimeve ndërmjet drejtuesve të policive kufitare të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal, nënshkruar më 10.3.2012, hyrë në fuqi 10.4.2012.¹⁹⁰ Protokoll shtesë për intensifikimin e bashkëpunimit në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe për përmirësimin e identifikimit, njoftimit, referimit dhe kthimit vullnetar të ndihmuarve të viktimave si dhe viktimave të mundshme të trafikimit, në veçanti të fëmijëve në plotësim të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës “Mbi bashkëpunimin policor ndërkufitar”, nënshkruar në Prishtinë më 12.06.2012, hyrë në fuqi më 11.7.2012.¹⁹¹

Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për hapjen e pikave të përbashkëta të kalimit Ndërkufitar Borje-Glloboçicë, Orgjost (Kukës) - Orçush (Dragash) dhe Shishtavec (Kukës)-Krushevë (Dragash) dhe Protokolleve të kryerjes së veprimtarive të përbashkëta në këto pika të kalimit kufitar, nënshkruar në Tiranë, më 16.4.2013.¹⁹²

Marrëveshja ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës, për krijimin dhe funksionimin e një qendre të përbashkët të bashkëpunimit policor, nënshkruar në Tiranë, më 16.4.2013, hyrë në fuqi më 16.5.2013.¹⁹³

Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për bashkëpunim të ndërsjellë në fushën e sigurisë, nënshkruar më 23.3.2015.¹⁹⁴

Protokoll ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës në Kosovës për ndjekjen e menjëhershme ndërkufitare, nënshkruar më 23.3.2015 dhe hyrë në fuqi në të njëjtën datë.¹⁹⁵

¹⁹⁰ www.kosovopolice.com/

¹⁹¹ www.punetebrendshme.gov.al/

¹⁹² www.kryeministria.al/al/qeveria/ministrat

¹⁹³ www.kosovopolice.com/

¹⁹⁴ www.kryeministria.al/

¹⁹⁵ www.punetebrendshme.gov.al/

Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës në Kosovës mbi forcimin e bashkëpunimit në fushën e kontrollit të brendshëm, nënshkruar më 23.3.2015 dhe hyrë në fuqi në të njëjtën datë.¹⁹⁶ Protokoll ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës në Kosovës mbi shfrytëzimin e përbashkët të pajisjeve për kontrollin e kufirit, nënshkruar më 23.3.2015 dhe hyrë në fuqi më 22.4.2015.¹⁹⁷

Gjithashtu, të një rëndësie të veçantë kanë qenë edhe takimet rajonale të zhvilluara në kuadër të Shoqatës së Drejtorëve të Përgjithshëm të Policive të Vendeve të Europës Juglindore (SEPCA-^s) e krijuar me datën 20 janar 2002 në Valbandon të Kroacisë nga Drejtorët e Përgjithshëm të Policive të Shqipërisë, Bullgarisë, Kroacisë, Rumanisë, Serbisë dhe të Bosnjë Hercegovinës. Ndërkohë, me datën 24 tetor 2002 në Bukuresht të Rumanisë u nënshkrua statuti, misioni dhe detyrimet e kësaj shoqate për bashkëpunimin dhe bashkërendimin në zhvillimin dhe implementimin e strategjive të policimit, të sistemeve dhe të procedurave në rajon. U krijuan pesë borde ekzekutive të cilat kanë funksionuar mirë midis kolegëve të policive respektive. Gjatë kësaj periudhe, roli i kësaj shoqate është rritur dhe ka ndikuar ndjeshëm në përafrimin e policive, bashkëpunimin, trajnimet dhe kryerjen e operacioneve të përbashkëta në luftën kundër krimit ndërkufitar dhe të gjitha formave të manifestimit të krimit të organizuar.

Megjithëse, Kosova ka miratuar legjislacionin e duhur të brendshëm, si dhe marrëveshje me shtete e ndryshme, në zbatim të ligjit nr. 04/L-052 “Për marrëveshjet ndërkombëtare”, ajo vazhdon të ketë një pozitë të veçantë si subjekt i së drejtës ndërkombëtare, sepse nuk është njohur ende nga pesë shtete të BE-së si dhe vende të tjera si shtet i pavarur. Kjo gjendje e vështirë e ka penguar Kosovën në nënshkrimin e konventave multilaterale evropiane apo rajonale për ndihmën juridike ndërkombëtare. Megjithatë, Kosova nuk ka detyrime multilaterale që burojnë nga traktatet për ndihmën juridike në çështjet penale, ajo megjithatë ka nënshkruar disa marrëveshje të dyanshme në këtë fushë. Kështu, Kosova, ka ratifikuar Marrëveshjet për Ekstradimin me Shqipërinë, Belgjikën, Turqinë, Austrinë dhe Maqedoninë, por edhe Marrëveshjet që lidhen me

¹⁹⁶ www.mpb-ks.org/

¹⁹⁷ www.punetebrendshme.gov.al/

bashkëpunimin gjyqësor-çështje penale me Shqipërinë, Turqinë, Republikën Çeke, Maqedoninë, Austrinë dhe me Kroacinë.

Për njohjen reciproke dhe për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore penale është nënshkruar marrëveshje me Austrinë. Ndërsa, në lidhje me marrëveshjet për transferimin e personave të dënuar-është palë, Shqipëria, Zvicra, Belgjika, Turqia, Republika Çeke, Maqedonia, si dhe Marrëveshjet e nënshkruara (2013) për ekstradimin dhe për Marrëveshjet që lidhen me bashkëpunimin gjyqësor-çështje penale-me Italinë. Tabela 7.3 pasqyron marrëveshjet e bashkëpunimit policor midis Kosovës dhe Shteteve të tjera për periudhën 2008-2015.

Sipas kësaj tabele, rezultojnë se janë gjithsej 62 marrëveshje nga të cilat, marrëveshje të bashkëpunimit policor, 23 ose 37.09%, marrëveshje të bashkëpunimit në fushën operative, 6 ose 9.67%, marrëveshje të bashkëpunimit me EULEXⁱⁿ, 8 ose 12.90% dhe marrëveshje të bashkëpunimit në fushën e kufirit, 25 ose 40.32%. Duke krahasuar numrin e marrëveshjeve të nënshkruara gjatë viteve 2008-2015, rezulton se në vitet 2008-2012, janë nënshkruar 28 marrëveshje, ose 45.16%, ndërsa në vitet 2013, 2014 dhe 2015 janë nënshkruar gjithsej 34 marrëveshje ose 54.83 %.

Këto marrëveshje nga Republika e Kosovës janë lidhur me 18 shtete, konkretisht me Austrinë, Bullgarinë, Britaninë e Madhe, Francën, Finlandën, Gjermaninë, Hungarinë, Kroacinë, Lituaninë, Maqedoninë, Malin e Zi, Suedinë, Serbinë, Slloveninë, Shqipërinë, SHBA-në, Turqinë dhe me Zvicrën. Ndërsa, me organizatat ndërkombëtare "Frontex" janë nënshkruar marrëveshje mulaterale (Kosovë, Shqipëri, Maqedoni, Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina, Serbi). Gjithashtu, pritet nënshkrimi edhe me disa shtete të tjera. Ministria e Brendshme me Doganën ka nënshkruar gjithsej 12 marrëveshje të bashkëpunimit me 12 shtete, ndërsa me 10 shtete janë përgatitur projekt marrëveshjet dhe janë në proces studimi e negocimi. Ministria e Brendshme me Njësinë e Inteligjencës Financiare ka nënshkruar gjithsej: 13 marrëveshje të bashkëpunimit me 11 shtete, ndërsa, me 9 shtete janë përgatitur projekt marrëveshje.

7.4.1. Bashkëpunimi policor midis dy akademive policore Shqipëri – Kosovë.

Në lidhje me bashkëpunimin policor midis dy akademive të Policisë së Republikës së Shqipërisë dhe të Republikës së Kosovës, në Tiranë me datën 12 janar 2006 është nënshkruar “Protokolli i Binjakëzimit midis Akademisë së Policisë “Arben Zylyftari dhe Shkollës së Shërbimit Policor të Kosovës”, të nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë Shqiptare, Drejtues Bajram Ibraj dhe Komisioneri i Policisë së UNMIK-^{ut}, zoti Kai Vittrup. Ky protokoll i binjakëzimit konsistoi në rritjen e nivelit dhe thellimin e bashkëpunimit dypalësh për të avancuar në standardet e trajnimit dhe edukimit të anëtarëve të policive të të dy vendeve, vendosjen e marrëdhënieve të drejtpërdrejta midis dy shkollave policore, njohjen reciproke të veprimtarive të tyre për formimin, kualifikimin dhe specializimin e personelit të shërbimit policor, njohjen dhe shkëmbimin e eksperiencave reciproke, shkëmbim lektorësh, ekspertësh. Gjithashtu, parashikohej edhe bashkëpunimi për mënyrën e organizimit dhe realizimit të kualifikimeve policore, nëpërmjet programeve të specializimeve sipas fushave e shërbimeve të veçanta (anti drogë, antiterror, antikorrupsion, etj. Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Akademisë së Kosovës për Siguri Publike dhe Akademisë Policore të Shqipërisë, nënshkruar më 26.11.2014, hyrë në fuqi ditën e nënshkrimit.¹⁹⁸

7.4.2. Planet e veprimit të përbashkëta, patrullime dhe trajnime.

Mbi bazën e marrëveshjeve, memorandumeve të bashkëpunimit dhe protokolleve të përbashkëta midis qeverive, ministrive të brendshme dhe Policive të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës, janë hartuar plane veprimi të ndryshme, janë hapur pika kontroll kalimi kufitar në zonat kufitare, janë organizuar patrullime të përbashkëta dhe operacione të përbashkëta, si dhe janë zhvilluar trajnime për personelin e policive të dy vendeve tona.

Një rëndësi të veçantë ka Protokolli ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës mbi patrullimin e përbashkët përgjatë kufirit shtetëror midis Republikës së Shqipërisë edhe

¹⁹⁸ www.kosovopolic.com/

Republikës së Kosovës, nënshkruar më 10.3.2012, hyrë në fuqi më 10.4.2012,¹⁹⁹ ka ndikuar pozitivisht midis dy vendeve tona.

Përsa i përket ruajtjes së kufijve, strukturat e Policisë së Shtetit në Shqipëri dhe strukturat e Policisë në Kosovë kanë bashkëpunim të mirë, të konkretizuar nga takimet reciproke të drejtuesve të Policisë të dy vendeve tona. Ky bashkëpunim ka qënë i mirë në zbatimin e marrëveshjes për kryerjen e procedurave të përbashkëta të kontrollit të hyrje-daljeve nëpërmjet pikave të kalimit kufitar; në marrjen e masave të plota për mbarëvajtjen e sezonit turistik; në lehtësimin e qarkullimit ndërkufitar dhe në parandalimin e krimit ndërkufitar.

Bashkëpunimi policor ndërkufitar Shqipëri - Kosovë, realizohet me takime në tri nivele: 1. në nivel qendror zhvillohen *një herë në tre muaj*; 2. në nivel rajonal *një herë në muaj* dhe 3. në nivel lokal *një herë në javë*. Aktualisht po zbatohet Protokollin ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Shqipërisë “Për ndjekjen e menjëhershme ndërkufitare” dhe Protokollin ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Shqipërisë “Mbi shfrytëzimin e përbashkët të pajisjeve për kontrollin e kufirit”, të miratuara nga Këshilli i Ministrave në 23 Mars 2015.

Si rezultat i masave të marra dhe bashkëpunimit të mirë të strukturave të policisë, në kufirin me Kosovën janë arritur rezultate në parandalimin dhe luftën ndaj krimit të organizuar, trafikimit të lëndëve narkotike, të qenieve njerëzore, të kontrabandës së mallrave të ndryshme, të parandalimit të kalimeve ilegale të kufirit, të menazhimit të fluksit të hyrje-daljeve të shtetasve dhe të mjeteve gjatë festave dhe periudhës së verës etj. Gjithashtu, janë organizuar operacione të përbashkëta kundër trafikëve ndërkufitare dhe patrullime të përbashkëta për mbikëqyrjen e vijës së kufirit në zona malore.

Në kuadër të lehtësimit të lëvizjes së shtetasve gjatë sezonit të verës, janë marrë masat që nga 4 (katër) kabina dhe korsi kalimi në kushte normale, në rast fluksi bëhen 6 (gjashtë) kabina dhe korsi kalimi, ku kabinat janë në funksion të plotë, sipas standardeve dhe të pajisura me kompjutera, sinjal për sistemin, kontrollues pasaportash etj. Për të gjitha rastet e kalimit të grupeve sportivo-turistike në zonën e alpeve (Valbonë-Tropojë etj.) në

¹⁹⁹ www.punetebrendshme.gov.al/

vendet ku nuk ka PKK, kryhet shkëmbim permanent i informacionit midis policive kufitare përkatëse të të dy vendeve.

Në kuadrin e luftës kundër terrorizmit, veçanërisht gjatë vitit 2015, ka pasur shkëmbim të shpejtë dhe në kohë reale për verifikimin e informacioneve për disa individë të dyshuar për terrorizëm. Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe bashkëpunuese nëpërmjet trajnimeve të personelit, ka luajtur një rol shumë pozitiv jo vetëm në ngritjen e nivelit profesional e ligjor, por edhe në krijimin e njohjeve më të gjera dhe të thella reciproke dhe në krijimin e kushteve për takime, patrullime e operacione të përbashkëta në luftën kundër krimit të organizuar ndërnacional.

Tabela 7.4 pasqyron trajnimet për çështjet e krimit të organizuar nga policia e Kosovës, 2008-2013. Sipas kësaj table nga policia e Kosovës në periudhën 2008-2013 në 32 module apo trajnime për çështjet e krimit të organizuar, janë zhvilluar gjithsej 116 trajnime me 793 pjesëmarrës. Trajnimet më të shumta janë organizuar për pastrim të parave dhe gjurmimie i pasurisë (aseteve) -17 trajnime, kursi i inteligjencës - 14 trajnime, kursi për hetimin e drogave -11, trafikimi me qenie njerëzore -10 trajnime. Ndërsa, numri më i lartë i pjesëmarrësve të trajnuar është evidentuar për trafikimin me qenie njerëzore me 408 pjesëmarrës, kursi i avancuar për hetime të krimit me 218 pjesëmarrës, kursi për hetimet e korrupsionit me 139 pjesëmarrës pastrimi i parave dhe gjurmimi i pasurisë (aseteve) me 108 pjesëmarrës, kursi bazik i dokumenteve të falsifikuara me 107 pjesëmarrës, kursi për hetime të specializuara me 104 pjesëmarrës.

Tabela 7.5 pasqyron trajnimet e ofruara për strukturat kundër krimit të organizuar, 2012 dhe 2013. Sipas kësaj table evidentohet se vetëm për vitet 2012-2013, janë zhvilluar gjithsej 234 trajnime, me 2513 pjesëmarrës. Ndërkohë, janë zhvilluar 112 trajnime të përbashkëta ku janë trajnuar 698 punonjës.

Këshilltari i ICITAP^{-it}, Walter Conrad, në kumtesën e tij, mbajtur në konferencën “Lufta kundër krimit në 100 vjet” është shprehur:

”ICITAP⁻ⁱ ka trainuar dhjetëra mijëra hetues përgjatë 12 viteve të fundit në disiplina të ndryshme që lidhen me hetimin e Krimeve të Rënda. Këto kurse përfshijnë hetimet kriminale bazë, dhunën në familje, menaxhimin e informacionit kriminal, profilizimin kriminal, menaxhimin e hetimeve, teknikat e intervistimit dhe marrjes në pyetje, hetimet e vendngjarjes dhe hetimet e vrasjeve dhe çështjeve të ftohta. Në këto kurse trainimi ICITAP⁻ⁱ ka përfshirë prokurorë, agjentë të shërbimit doganor, personelin e Akademisë së Policisë dhe oficerë policie nga i gjithë rajoni.”(Walter Conrad, 2012: 219).

7.5. Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar.

Me qëllim thjeshtimin dhe lehtësimin e masave në lidhje me kontrollin kufitar në qarkullimin ndërkufitar ndërmjet dy vendeve, me shumë rëndësi ka qenë hapja e së parës dhe të vetmes çikë të përbashkët kufitare Muriqan-Sukobin, në Ballkan midis dy vendeve, Shqipërisë dhe Malit të Zi.²⁰⁰ Më pas, me datën 21.4.2008 nga Kryeministri Berisha dhe Kryeministri Gjokanoviç, në prani të shefit të delegacionit të Komisionit Evropian në Tiranë, zotit Helmut Lohan, u inagurua fillimi i punimeve dhe përfunduan punimet dhe filloi nga funksionimi në vitin 2009.

Kjo pikë e përbashkët kufitare deri më sot ka treguar nivelin më të lartë të bashkëpunimit shtetëror, ndërqeveritar, ndërinstitutional, në tërësi dhe në veçanti në fushën policore e doganore midis dy vendeve, Shqipërisë dhe Malit të Zi. Lufta kundër krimit të organizuar nëpërmjet kontrollit të kësaj veprimtarie në këtë pikë kontrolli të përbashkët, ka qenë shumë me efektive dhe me rezultate të larta në raport me pikat e tjera kufitare, jo vetëm të dy vendeve, por edhe në raport me vendet e tjera kufitare në rajon.

Në lidhje me bashkëpunimin policor ndërkombëtar për menazhimin e integruar të kufijve sipas standardeve “Shengen”, sipas raporteve vjetore të Policisë së Shtetit për vitet 2008-2013²⁰¹ evidentohet fakti se forcimi i bashkëpunimit me agjencitë e tjera ligjzbatuese që operojnë në kufi, paraqitet si më poshtë: Gjatë vitit 2008 janë zhvilluar 25 operacione të përbashkëta. Gjatë vitit 2009 nga Interpoli, Qendra SECI dhe oficerët ndërlidhës të vendeve të tjera janë organizuar 22 operacione të përbashkëta, nga të cilat 10 operacione në fushën e trafikut të narkotikëve; 2 operacione në fushën e krimit financiar dhe pastrimit të parave; 1 operacion kundër trafikut të makinave të vjedhura. Gjatë vitit 2010, janë evidentuar 193 patrullime të përbashkëta me Malin e Zi dhe 119 patrullime me Maqedoninë. Janë evidentuar edhe 8 operacione të përbashkëta me Greqinë për kontrollin e kalimeve të paligjshme të kufirit të gjelbër, 29 operacione në fushën e narkotikëve dhe 7 kundër trafikeve të tjera të paligjshme. Ky vit ka qenë i suksesshëm edhe në lidhje me operacionet e përbashkëta ndërkombëtare. Gjatë vitit 2010 janë zhvilluar 44 operacione ndërkombëtare,

²⁰⁰Vendim nr.837, datë 13.12.2006 “Për miratimin në parim të Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Malit të Zi, për hapjen e Pikës së Përbashkët Kufitare Muriqan-Sukobin, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Malit të Zi, në Muriqan”.

²⁰¹ Raporti vjetor i veprimtarisë së Policisë së Shtetit, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2013.

nga të cilat janë evidentuar 33 operacione ndërkombëtare ose 3 herë më shumë se sa në vitin 2009. Gjatë vitit 2011 janë zhvilluar 65 operacione të përbashkëta, nga të cilat 8 operacione të përbashkëta me Greqinë për kontrollin e kalimeve të paligjshme të kufirit të gjelbër, 29 operacione të përbashkëta në fushën e narkotikëve dhe 7 kundër trafikëve të tjera të paligjshme. Gjithashtu, janë realizuar 2 ushtrime trajnuese me temë “Vëzhgimi ndërkufitar” me Maqedoninë dhe me Malin e Zi në kuadër të Konventës së Vienës për bashkëpunimin policor në Evropën Juglindore. Gjatë vitit 2012 si rezultat i bashkëpunimit ndërkombëtar me policinë shqiptare me strukturat homologe si dhe me Interpol, Europol, Qendra SECI dhe oficerët ndërlidhës janë organizuar 75 operacione të përbashkëta nga të cilat 54 operacione të përbashkëta në fushën e narkotikëve dhe 13 operacione kundër trafikëve të tjera të paligjshme, si dhe gjatë vitit 2013 janë zhvilluar gjithsej 77 operacione të përbashkëta.

Në kuadër të bashkëpunimit rajonal, rëndësi të veçantë ka marrë zgjerimi i bashkëpunimit ndërkombëtar. Institucionet e policisë kanë manifestuar rritjen e besimit tek agjencitë e huaja të zbatimit të ligjit, zgjerimin e rrjetit të oficerëve ndërlidhës policorë në Prishtinë, Athinë, Selanik, Romë, Stamboll, Bukuresht, Hagë, Lion, Londër, Bruksel, Berlin dhe në Washington D.C. Gjithashtu, ka pasur një periudhë të rritjes së intensifikimit të bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë, e konkretizuar kjo me rritje të numrit të operacioneve ndërkombëtare policore të përbashkëta.

Kështu, në kuadër të fuqizimit të bashkëpunimit me agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit, si dhe organizmat policore ndërkombëtare, në Shqipëri vetëm gjatë vitit 2015 janë nënshkruar 14 marrëveshje dhe memorandumë bashkëpunimi me agjenci të vendeve të ndryshme, kryesisht ato të rajonit dhe janë miratuar 3 protokolle për harmonizimin e veprimtarive policore mes vendeve nënshkruese.²⁰²

Tabela 7.6 pasqyron operacionet ndërkombëtare sipas Policisë së Shtetit Shqipëri për periudhën 2008-2012. Në mënyrë tabelare sipas të dhënave të Policisë së Shtetit paraqiten numri i operacioneve ndërkombëtare për periudhën 2008-2012 dhe rezulton se në total janë zhvilluar gjithsej 229 operacione ndërkombëtare. Operacionet ndërkombëtare të zhvilluara vetëm në vitet 2011 e 2012 përbëjnë 60.26% të operacioneve ndërkombëtare.

²⁰² Analiza vjetore e Policisë së Shtetit 2015, publikuar në 23 korrik 2015. web: www.punetebrendshme.gov.al

Ndërkohë, në vitet 2008 dhe 2009 janë zhvilluar gjithsej 47 operacione ndërkombëtare ose 20.52%. Gjatë vitit 2015 janë zhvilluar mbi 16 operacione të përbashkëta (me shtrirje në disa shtete), 70 operacione policore të përbashkëta me partnerët ndërkombëtarë.²⁰³

Bashkëpunimi ndërkombëtar është një çështje jashtëzakonisht e rëndësishme, prandaj, nevojitet që lufta kundër krimit të organizuar duhet bërë ashtu siç funksionojnë organizatat më të mëdha ndërkombëtare si: OKB-^{ja}, INTERPOLI, EUROPOLI, BE-^{ja}, qendra e SECI-^l etj. Por gjithsesi, nuk duhet të harrojmë se mirëfunksionojnë edhe ndërmarrjet, organizatat, mafia dhe grupet kriminale në botë, të cilat kërkojnë të shtrijnë aktivitetin e tyre në të gjithë vendin, rajonin dhe në botë. Prandaj, lypet të njohim fillimisht dhe të dimë se shtetet e dobëta ose shtetet e dështuara, si vendet e Botës së Tretë apo vendet që kanë institucione të brishta, politika të paqëndrueshme, shtete totalitare, demokraci të pazhvilluara, ekonomi të dobëta, varfëri e papunësi të madhe, mungesë investimesh, drejtues shteti dhe politikanë të lartë shtetërorë diktatorë, totalitaristë, të korruptuar arrijnë të përcaktojnë më qartë dhe më saktë që të fillojë puna për hartimin e politikave, strategjive, programeve e planeve të veprimit të institucioneve për ta luftuar në maksimum krimin e organizuar transnacional. Krimi i organizuar dhe korrupsioni janë pengesat kryesore për zhvillimin e Europës Juglindore, të identifikuar edhe nga BE-^{ja}, si pengesat më të mëdha për rrugën e integritit. (Valbona Zeneli:2013).

Për bashkëpunimin dhe kordinimin ndërsistitucional në fushën e krimit të organizuar, merr një rëndësi të veçantë zbatimi i planeve të veprimit, monitorimi i instrumenteve përkatëse të marrëveshjeve të nënshkruara, shkëmbimi i informacioneve mes institucioneve të përfshira veçanërisht në çështjet e krimit të organizuar, krijimi dhe mirëfunksionimi i njërive të përbashkëta hetimore, aktiviteteve të përbashkëta trajnuese dhe zhvillimi i analizave të përbashkëta për shkëmbimin e informacionit dhe operacionet e përbashkëta ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit.

Bashkëpunimi ndërkombëtar i qeverive, shteteve, organizatave ndërkombëtare dhe i shërbimeve policore, i zyrave të prokurorive e misionëve ndërkombëtare policore dhe të prokurorive, përbëjnë kanale dhe mjete shumë të rëndësishme komunikimit për ndërtimin e mirëfunksionimit të institucioneve shtetërore nëpërmjet luftës së organizuar kundër krimit

²⁰³Shih: *Po aty. web: www.punetebrendshme.gov.al*

të organizuar nacional, ndërnacional, ndërkombëtar e global. Këto kanale dhe mjete komunikimi janë: Interpoli, Europoli, zyrtarët (oficerët) ndërlidhës shqiptarë jashtë vendit, zyrtarët ndërlidhës të vendeve të tjera në Shqipëri, Qendra SECI në Bukuresht, kontaktet e drejtpërdrejta midis strukturave të specializuara, iniciativat dhe projektet rajonale dhe ndërkombëtare, si dhe bashkëpunimi ndërkombëtar me oficerët e policisë europiane “Europol”.

7.5.1. Bashkëpunimi me INTERPOLIN.

“Për herë të parë Shqipëria është anëtarësuar në Interpol në vitet ‘30”, ndërsa nga koha e Luftës së Dytë Botërore e deri në vitin 1990, ajo nuk ka qënë anëtare e kësaj organizate” (Hasan Shkëmbi, 2006:212). Shqipëria u pranua anëtare e INTERPOL-it me 4 nëntor 1991, në Konferencën e 60-të të INTERPOL-it. Në emër të qeverisë dhe Policisë Shqiptare mori pjesë në këtë konferencë Ministri i Rendit Publik, Bajram Yzeiri. Shqipëria u bë anëtare me të drejta të plota. (Bajram Yzeiri, 2002:28).

Ndërkohë, në vitin 2008 u miratua ligji për aderimin e Shqipërisë në INTERPOL. (Bajram Yzeiri, 2002:28). Sipas Kushtetutës së Interpolit²⁰⁴ në nenin 1 shprehet se: “Organizata e quajtur “Komisioni Ndërkombëtar i Policisë Kriminale” do të titullohet më poshtë: “Organizata Ndërkombëtare e Policisë Kriminale-Interpol”. Qendra e saj do të jetë në Francë.²⁰⁵ Më pas vijon me nenin 2, ku përcakton se qëllimet e saj janë: *1. Të sigurojë dhe të nxisë sa më gjerë që të jetë e mundur bashkëpunimin e ndërsjellë midis të gjitha autoriteteve të policisë kriminale brenda kufijve të ligjeve ekzistuese në vende të ndryshme dhe nën frymën e Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut.*²⁰⁶” Ndërsa, në neni 31 shprehet se: “*Në mënyrë që të plotësojë detyrat, organizata ka nevojë për bashkëpunimin aktiv dhe të qëndrueshëm të anëtarëve të saj, të cilët duhet që me fuqinë e tyre në përputhje me legjislacionin e vendeve të tyre të marrin pjesë aktive në veprimtaritë e saj.*²⁰⁷” Gjatë

²⁰⁴ Kjo Kushtetutë ka hyrë në fuqi më 13 qershor 1956 (neni 50 i ligjit).

²⁰⁵ Neni 1 i Ligjit nr.8427, datë 14.12.1998 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në organizatën ndërkombëtare të policisë kriminale, INTERPOL”.

²⁰⁶ Neni 2, po aty.

²⁰⁷ Neni 31, po aty.

vitit 2015 në Shqipëri evidentohet se “janë mbi 12 mijë informacione të shkëmbyera me agjencitë partnere, përfshirë Interpolin dhe Europolin.”²⁰⁸”

Republika e Kosovës nuk është pranuar ende në OKB, në Interpol, në Europol etj., prandaj, me qëllim për të ndihmuar dhe lehtësuar shkëmbimin e informacionit midis autoriteteve të zbatimit të ligjit, në Policinë e Kosovës në vitin 2011, është krijuar Drejtoria e Bashkëpunimit Ndërkombëtar për Zbatimin e Ligjit (ILECU). ILECU ose INTERPOL-i do të kanalizojnë kërkesën, por në rast të INTERPOL-it duhet po ashtu të ketë kërkesë përmes kanaleve diplomatike, e cila bëhet brenda 30 ditëve. Pra, në këtë mënyrë kemi të bëjmë jo me një rrugë të drejtëpërdrejtë, por me një rrugë të tërthortë apo me një proces të ndërmjetëm. Republika e Kosovës duke mos qenë pjesë e këtyre organizatave ndërkombëtare, pra edhe e Interpolit, paraqet vështirësi serioze, pa bashkëpunimin e të cilave është shumë e vështirë lufta e efektshme kundër krimit të organizuar. Prandaj mbetet një obligim shumë i madh i institucioneve zyrtare kryesisht i Policisë së Shtetit për të mbështetur e ndihmuar me shkëmbimin e informacioneve përkatëse, deri në pranimin e Kosovës në Interpol, etj.

Në lidhje me bashkëpunimin ndërkombëtar, Ministria e Drejtësisë për periudhën 2010-2013, ka shkëmbyer informacione reciproke si dhe ka pasur dhjetëra e dhjetëra letërporosi për “ndihmë juridike të natyrave të ndryshme” dhe “letërporosive”. Ministria e Drejtësisë, ka pranuar gjithsej 10, 274 kërkesa të reja për ndihmë, nga të cilat: 7, 488 kërkesa për shërbimin e dokumenteve, 489 kërkesa për ndihmë juridike të natyrave të ndryshme; 1,169 kërkesa për letërporosi, 512 kërkesa për verifikim të dokumenteve; 57 kërkesa për ekstradime; 114 kërkesa për transferim të procedurave gjyqësore; 178 kërkesa për ekzekutim të vendimeve gjyqësore; 43 kërkesa mbi rrëmbimet ndërkombëtare të fëmijëve; 43 kërkesa për transferim të personave të dënuar; 13 kërkesa mbi krimet e luftës; 193 kërkesa për lëshim të letërkërkimeve ndërkombëtare.²⁰⁹

Ekstradimi është përgjithësisht i zbatueshëm për çdo vepër penale në Kosovë, duke përfshirë gjithashtu, të gjitha veprat penale fiskale, me kusht që vepra penale dënohet me burgim për një periudhë maksimale prej të paktën një viti. Ekstradimi mund të kryhet vetëm në qoftë se si rregull i përgjithshëm, akti që përbën veprën penale plotëson kërkesat e

²⁰⁸ Analiza vjetore e Policisë së Shtetit 2015, publikuar në 23 korrik 2015. *web:* www.punetebrendshme.gov.al

²⁰⁹ Raporti vjetor i punës së Ministrisë së Drejtësisë Kosovë, 2010,2011,2012,2013.

inkriminimit të dyfishtë, ashtu siç është përcaktuar me nenin 9 - Inkriminimi i dyfishtë, të ligjit për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale. “*Ekstradimi lejohet vetëm për veprat penale të dënueshme sipas ligjit vendor dhe ligjit të shtetit kërkues.*”²¹⁰ ”

Mbi bazën e statistikave vjetore të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve në Ministrinë e Drejtësisë në Tiranë, për vitet 2008 - 2015, rezulton që janë ekstraduar nga Shqipëria gjithsej 21 shtetas të dënuar nga Kosova. Tabela 7.7 pataqet numrin e të dënuarve shtetas nga Kosova, të ekstraduar nga Shqipëria, për periudhën 2008-2015.²¹¹

Autoritetet e Kosovës kanë ofruar të dhëna në vijim, në lidhje me statistikave mbi kërkesat e huaja për ekstradim. Në vitin 2013, janë evidentuar, 2 ekstradime, njëri në Francë për krimin e organizuar dhe tjetri për vjedhje të rëndë në Malin e Zi. Në vitin 2014, janë bërë 4 ekstradime për vrasje të rëndë; vjedhje e rëndë, veprat penale kundër ekonomisë. Ndërkohë, gjatë kësaj periudhe, 6 persona janë ekstraduar nga Kosova në vende të ndryshme.

7.5.2. Bashkëpunimi me Zyrën Europiane të Policisë EUROPOL.

Në muajin janar 2010, është aprovuar rregullorja për bashkëpunim me Zyrën e Policisë Europiane, në muajin prill 2010, u krijua “ILECU” i Shqipërisë, pika e kontaktit të Europolit (një anëtar i stafit) modernizuar për Zyrën Kombëtare të Europolit (3 anëtarë të stafit), si dhe është ndryshuar, më 7 nëntor 2011, marrëveshja bilaterale midis Europolit dhe Republikës së Shqipërisë për ndërlidhjen e rrjeteve kompjuterike. Në muajin nëntor 2010 në Tiranë është organizuar konferenca (Roadshow) "Shqipëria-Europol rrjetet e inteligjencës". Në muajin mars 2012 është bërë instalimi i Rrjetit të Aplikimit (SIENA), shkëmbimi i sigurtë i informacioneve të Europolit. Me datën 9 dhjetor 2013, u nënshkrua marrëveshja operative me Europolin.

Në luftën ndaj krimit të organizuar dhe terrorizmit, Shqipëria zyrtarizon marrëveshjen me Europol-in, me 13 prill 2014. Shqipëria do të bashkëpunojë me të për shkëmbimin e informacionit në luftën ndaj krimit të organizuar, kundër terrorizmit apo formave të tjera të krimit ndërkombëtar. Kjo përcaktohet në marrëveshjen ndërmjet

²¹⁰ Ligji nr. 04/I-213 Për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale. Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 33 / 2 shtator 2013, Prishtinë.

²¹¹ Shih: Po aty.

Shqipërisë dhe Zyrës së Policisë Europiane për bashkëpunim strategjik dhe operacional. Në vendimin e Këshillit të Europol-it²¹² kjo marrëveshje e shtrin aktivitetin dhe veprimtarinë e saj midis Shqipërisë dhe çdo shteti anëtar të Bashkimit European. Në bazë të ligjit nr.28/2014 datë 20.3.2014 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Policisë Europiane (EUROPOL) për bashkëpunimin strategjik dhe operacional”,²¹² është arritur marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shërbimit Policor European për parandalimin dhe luftën kundër krimit të organizuar. Mbi bazën e kësaj marrëveshje institucionet që do të bashkëpunojnë me Europol-in për palën shqiptare do të jenë: Shërbimi Informativ Shqiptar, Prokuroria, Drejtoria për Parandalimin e Pastrimit të Parave në Ministrinë e Financave dhe Zyra e Europolit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë pranë Ministrisë së Brendshme.

Republika e Kosovës pa bashkëpunimin e drejtpërdrejtë me Europolin, paraqet vështirësi serioze në arritjen e bashkëpunimit për luftën e efektshme kundër krimit të organizuar. Prandaj, mbetet një obligim shumë i madh i institucioneve zyrtare të Shqipërisë, veçanërisht i Policisë së Shtetit për të mbështetur e ndihmuar me shkëmbimin e informacioneve përkatëse, deri në pranimin e Kosovës në Europol. “Është më e lehtë kur analistët dhe hetuesit janë të caktuar në një detyrë zyrtare me marrëveshje, megjithatë shpërndarja e informatave nuk është e kufizuar në këto situata. Ekziston një rrjet i gjerë i inteligjencës për zbatimin e ligjit i shpërndarë nga organizatat, qëllimi i të cilave është të prodhojnë inteligjencën me kohë në shumëllojshmëri të gjërë të aktiviteteve penale”.²¹³

7.5.3. Bashkëpunimi me FBI-në.

Në programin e qeverisë 2013-2017, në lidhje me krimin e organizuar, terrorizmin dhe me trafikimin thuhet: “Qeveria do të angazhohet intensivisht dhe në mënyrë të qëndrueshme në goditje të krimit të organizuar dhe të trafikut të qenieve njerëzore e substancave narkotike, në respekt të plotë të ligjeve të vendit dhe të angazhimeve të saj ndërkombëtare. Qeveria do të angazhohë të gjitha burimet e duhura njerëzore, teknike dhe

²¹²Ligj nr.28/2014 datë 20.3.2014 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Policisë Europiane (EUROPOL) për bashkëpunimin strategjik dhe operacional”, miratuar në datë 20.3.2014, shpallur me dekretin nr. 8534, datë 3.4.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, fletore zyrtare nr. 47, datë 9 prill 2014, faqe 1266. www.qbz.gov.al/botime/fletore.../PDF.../47-2014.pdf

²¹³(shiko web-site Europol: <http://www.europol.eu.int>)

financiare për një bashkëpunim të plotë dhe efektiv me partnerët rajonalë e ndërkombëtarë në luftën kundër terrorizmit dhe krimit ndërkombëtar. Për këtë qëllim, qeveria do të themelojë Byronë Kombëtare të Hetimit, si një njësi e specializuar në luftën kundër krimit të organizuar, luftës kundër trafikeve, veçanërisht trafikut të qenieve njerëzore dhe lëndëve narkotike, krimit ekonomik dhe luftës kundër korrupsionit, për të garantuar një standard të lartë të evidentimit dhe hetimit të veprave penale. Sofistikimi i veprimtarisë kriminale kërkon përgjigje të menjëhershme, ndaj ngritja dhe fuqizimi i Byrosë Kombëtare të Hetimit do t'i japë një ritëm të ri luftës me krimin e organizuar dhe korrupsionin në çdo nivel. Ngritja e kësaj byroje do të jetë në zbatim të strategjisë së re dhe të planit të veprimit kundër krimit të organizuar, të cilën qeveria do ta hartojë gjatë vitit të parë të qeverisjes e do ta vërë në zbatim në vitet në vijim”.²¹⁴ Por, përpara se të arrihet kjo, duhet të përfundojë reforma e plotë ligjore në drejtësi dhe në sistemin legjislativ dhe ekzekutiv.

FBI-ja gjatë kësaj periudhe ka pasur bashkëpunim të konsiderueshëm me Shqipërinë, por veçanërisht në të ardhmen në kuadrin e reformës në drejtësi mendohet se do të ketë një bashkëpunim edhe më të madh në Shqipëri. Drejtimet e këtij bashkëpunimi lidhen me shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunimin në kuadër të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, dhe veçanërisht luftën kundër korrupsionit, si dhe për trajnimin e zyrtarëve të zbatimit të ligjit dhe asistencën për ngritjen e Byrosë Kombëtare të Hetimit. FBI ka një bashkëpunim të mirë edhe me Kosovën. Në intervistën me Dr. Zef Preçi, ai shprehet se, Shqipëria lypet të mbështesë më shumë Kosovën dhe të bashkëpunojë në shkëmbimin e informacionit si dhe të ndihmës për të pranuar Kosovën në institucionet e sigurisë ndërkombëtare.²¹⁵

7.5.4 Bashkëpunimi me qendrën SECI.

Qendra SECI u krijua nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës në vitin 1996 me qëllim që të nxiste bashkëpunimin midis vendeve të rajonit dhe të lehtësonte hyrjen e Evropës Juglindore në integrimin evropian. SECI - Qendra Rajonale për Luftën kundër Krimit

²¹⁴Programi i qeverisë, 2013-2017, pjesa për luftën kundër krimit të organizuar, terrorizmit dhe trafikimit.

²¹⁵Intervista është marrë nga autori në Tiranë më datën 03.11.2015.

Ndërkufitar, u krijua në Bukuresht, Rumani më 26 maj të vitit 1999 me iniciativën e bashkëpunimit të Europës Juglindore. Nëpërmjet marrëveshjes për bashkëpunimin për parandalimin dhe luftimin e krimit ndërkufitar²¹⁶ u pranua nga shtetet që u bënë pjesë e kësaj marrëveshjeje se interesi i tyre është i përbashkët në luftën kundër krimit ndërkufitar, pasi shtete palë në këtë marrëveshje që në fillim ishin të bindur se krimi i kryer përgjatë kufijve të palëve është një kërcënim serioz për sovranitetin dhe krimet ndërkufitare janë të dëmshme për interesat ekonomike, fiskale dhe tregtare të vendeve përkatëse. Shqipëria ka marrë pjesë aktive në këtë qendër me përfaqësuesit e saj në fushën policore dhe doganore, duke u bërë mjaft aktive në operacionet policore të përbashkëta midis vendeve respektive. Kjo qendër ka arritur objektivin e saj të përafrimit të vendeve të Europës Juglindore në luftën kundër krimit ndërkufitar.

7.5.5 Përmirësimi i bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës me institucionet ndërkombëtare relevante.

Bashkëpunimi midis Shqipërisë dhe institucioneve ndërkombëtare relevante si me INTERPOL, EUROPOL, FBI, etj merr një rëndësi vendimtare për luftën e organizuar të krimit të organizuar transnacional. Pa një bashkëpunim efikas me këto organizma ndërkombëtarë, do të ishte shumë e vështirë të kishte efektivitet dhe rezultate pozitive në luftën ndaj krimit të organizuar. Gjatë vitit 2015, policia shqiptare evidentoi se *ishin 12 mijë informacione të shkëmbyera me agjencitë partnere, përfshirë Interpolin dhe Europolin dhe mbi 16 operacione të përbashkëta (me shtrirje në disa shtete), 70 operacione policore të përbashkëta me partnerët ndërkombëtarë. Gjë që tregon besimin e shtuar të tyre ndaj Policisë së Shtetit.*²¹⁷ Gjithashtu, në bashkëpunim edhe me partnerët ndërkombëtarë, si: ICITAP, PAMECA etj., janë vënë në zbatim edhe disa projekte të tjera të cilat kanë synuar parandalimin e luftën ndaj kriminalitetit dhe zbatimit të ligjit.

Në intervistat e zhvilluara me personalitete politike dhe ekspertë të sigurisë jemi fokusuar në këtë çështje të rëndësishme dhe kemi marrë përgjigje, vlerësime dhe sugjerime me shumë interes. Dr.Aldo Bumçi, Ministër i Drejtësisë (2005-2007) shprehet për

²¹⁶Ligj nr.8541, datë 21.10.1999 “Për ratifikimin e marrëveshjes së SECI-t mbi bashkëpunimin për parandalimin dhe luftën kundër krimit ndërkufitar”.

²¹⁷ Analiza vjetore e Policisë së Shtetit, 2015.

rëndësinë e bashkëpunimit në unifikimin e praktikave që lidhen me lëvizjen, komunikimin, shkëmbimin e njerëzve, mallrave dhe shërbimeve midis Shqipërisë dhe Kosovës. Prof. asoc. Bajram Yzeiri, Ministër i Rendit Publik (1991-1992) shprehet për rëndësinë e shkëmbimit të informacionit reciprok dhe veprimeve të përbashkëta operativo-hetimore për dokumentimin e goditjen e krimit të organizuar. Sipas Bledar Dervishaj, sugjerimet në luftën kundër veprimtarive kriminale të organizuara (transnacionale) konsistojnë në tri drejtime:

*“1. Krijimi i bashkëpunimit policor në planin operacional nëpërmjet shkëmbimit të informacionit; 2. Lehtësimi i ndërsjellë që palët do të mbështesin për pjesëmarrjen në skuadrat e përbashkëta hetimore; 3. Konsultimi me njëri-tjetrin rregullisht për çështjet policore dhe për çështjet e interesit të përbashkët për të realizuar objektivat dhe për të bashkërenduar aktivitetet e tyre përkatës”.*²¹⁸

Ndërsa, Besnik Shehu shprehet:

*“Ky lloj bashkëpunimi është i domosdoshëm për vetë natyrën e krimit të organizuar si krim ndërnacional, por edhe për faktin për të përfutur nga eksperiencia e këtyre organizmave të specializuara, me kapacitete teknologjike dhe financiare që mundësojnë luftën efektive ndaj krimit të organizuar ndërkombëtar. Krijimi dhe prania e këtyre organizmave është diktuar nga vetë nevoja për të qënë të bashkuar ndërkombëtarisht në luftën ndaj krimit të organizuar e terrorizmit, si format më të rrezikshme për vendet demokratike”.*²¹⁹

Sipas Gjergj Lezhja, Zëvendësministër i Brendshëm (2005-2008) dhe Këshilltar i Presidentit të Republikës për Çështjet e Sigurisë Kombëtare (2012-2015) kërkohet vullnet politik dhe transparencë në bashkëveprim me këto institucione.²²⁰ Ndërsa Prof. asoc. Dr Iva Zajmi shprehet për anëtarësim të plotë në to dhe dhënie të besimit dhe kompetencave direkte të bashkëpunimit me autoritetet vendase.²²¹

Figura 7.1 pasqyron në mënyrë skematike sugjerimet më të rëndësishme për bashkëpunimin me strukturat ndërkombëtare. Sipas kësaj figure evidentohet paraqitja skematike e sugjerimeve më të rëndësishme për bashkëpunimin me strukturat

²¹⁸ Intervista është marrë nga autori me datën 13.11.2015.

²¹⁹ Besnik Shehu, drejtor i kabinetit të Ministrit të Brendshëm (1997-1998), (2013-2015), këshilltar i Ministrit të Brendshëm (2015-2016), drejtor i kabinetit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit (2002-2007), Drejtori i Policisë Kriminale (1992-1993), pedagog në Akademinë e Policisë, jurist, avokat, oficer i kontaktit të Policisë Shqiptare në Kosovë.

²²⁰ Intervista është marrë nga autori në Tiranë me datën 10.11.2015.

²²¹ Prof. asoc. Dr. Iva Zajmi, autore e cituar.

ndërkombëtare. Të pyeturit sipas pyetjes Nr. 11²²² të pyetësorit janë përgjigjur si më poshtë: Ekspertët në Shqipëri, në Kosovë, dhe ekspertët ndërkombëtarë janë përgjigjur në tërësi se bashkëpunimi midis dy shteteve të Shqipërisë dhe të Kosovës me institucionet ndërkombëtare revelante INTERPOL, EUROPOL, FBI, etj. në luftën kundër veprimtarive kriminale të organizuara (ndërnacionale dhe transnacionale) është shumë e domosdoshme dhe shumë e rëndësishme, veçanërisht për Kosovën e cila akoma nuk është njohur ndërkombëtarisht nga të gjitha shtetet dhe vendet dhe nuk ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi më të gjitha institucionet ndërkombëtare që luftojnë veprimtaritë kriminale të organizuara transnacionale.

Nga përpunimi i përgjigjeve të të pyeturve kemi përpunuar të dhënat, duke sjellë një paraqitje skematike të sugjerimeve më të rëndësishme për bashkëpunimin me strukturat ndërkombëtare. Nga kjo paraqitje skematike e sugjerimeve rezulton se: “Rikonceptimi dhe forcimi i bashkëpunimit reciprok dhe transparent” është vlerësuar me 41.8% të përgjigjeve; “rregulla të qarta të bashkëpunimit dhe të korrektesës në ndarjen e informacionit dhe shkëmbimin e përvojave”, është vlerësuar me 9%; “ të tjera” është vlerësuar me 9% të përgjigjeve; “lidhja e marrëveshjeve të veçanta me këto struktura për marrjen e kompetencave direkte nga bashkëpunimi”, është vlerësuar 7.5%; “rritja e edukimit profesional dhe rritja e kapaciteteve institucionale”, është vlerësuar 3 %; “forcimi i bashkëpunimit ndërshtetëror në Republikën e Kosovës dhe Republikën e Shqipërisë, objektiva, axhenda, stërvitje të përbashkëta policore dhe ushtarake”, është vlerësuar 9%; “anëtarësim i plotë dhe pjesëmarrja e të dy vendeve në të gjitha organizmat ndërkombëtarë kundër korrupsionit”, është vlerësuar 14.9%; “operacione të përbashkëta policore-hetimore”, është vlerësuar me 6 % të përgjigjeve të të pyeturve apo të intervistuarve.

Pra, për sa më sipër, arrijmë në përfundimin se nga vlerësimi prej 41.8% të përgjigjeve të ekspertëve në Shqipëri, në Kosovë dhe ekspertëve ndërkombëtarë, për rikonceptimin dhe forcimin i bashkëpunimit reciprok dhe transparent midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës me institucionet ndërkombëtare relevante si INTERPOL, EUROPOL, FBI etj., lypet të shndërrohet në detyrë urgjente për lidhshpirt politik dhe institucional shqiptar të Shqipërisë dhe Kosovës. Ndërsa, vlerësimi prej 14.9%,

²²²Pyetja Nr.11:”Çfarë sugjeroni për bashkëpunimin midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës me institucionet ndërkombëtare revelante INTERPOL, EUROPOL, FBI, etj.) në luftën kundër veprimtarive kriminale të organizuara (transnacionale)?”.

të të pyeturve për anëtarësim të plotë dhe pjesëmarrje të të dy vendeve në të gjitha organizmat ndërkombëtarë kundër korrupsionit është një propozim i shprehur nga ekspertët, por që lypet të bëhen realitet edhe nga institucionet ndërkombëtare relevante, pas zhvillimit të reformave të thella për reformimin e sistemeve të drejtësisë, luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Është për t'u theksuar fakti se: “operacione të përbashkëta policore-hetimore ”midis dy vendeve tona është vlerësuar me 6%, por sugjerohet që shqiptarët në dy shtetet respektive nëpërmjet dy anëve të kufirit nuk duhet të quhen më kufi, por një “*vend i përkohshëm*” kontroll-kalimi kufitar, dhe shumë shpejt të dëshmohet vullneti i fortë politik, institucional dhe ligjor për parandalimin, zbulimin, dokumentimin, dhe goditjen e shkatërrimin e veprimtarisë së krimit të organizuar nacional, ndërshtetëror, transnacional dhe rajonal. Pra, lypet që të punohet së bashku, në luftën kundër së keqes së shqiptarëve që i ka “*damkosur*” opinionin ndërkombëtar për krim të organizuar, korrupsion dhe mafia e mafiozë shqiptarë jo vetëm në Shqipëri dhe në Kosovë, por edhe mafia shqipfolëse. Nëse kjo do të bëhet në përputhje me konventat e marrëveshjet e nënshkruara ndërkombëtare dhe ligjet në fuqi, edhe mbështetja e institucioneve ndërkombëtare dhe pranimit në këto institucione e Republikës së Kosovës do të jetë e shpejtë.

Rekomandohet se është më shumë se e rëndësishme që vullneti politik, bashkëpunimi institucional, serioziteti, ruajtja e sekreteve të hetimeve dhe kryerja e operacioneve hetimore të përbashkëta Shqipëri-Kosovë dhe anasjelltas, Kosovë-Shqipëri, në të ardhmen do të fuqizohet e intensifikohet edhe me institucionet ndërkombëtare relevante në luftën kundër krimit të organizuar nacional, ndërshtetëror, transnacional dhe rajonal e më gjërë.

Tabela 7.8 paraqet shpjeguese skematike të sugjerimeve më të rëndësishme për bashkëpunimin me strukturat ndërkombëtare. Kjo tabelë pasqyron numrin e vlerësimeve dhe vlerësimin në përqindje për tetë aspekte të bashkëpunimit me institucionet ndërkombëtare. Ndërsa, figura 7.2 evidenton paraqitjen skematike të opsioneve të tjera, ku evidentohet paraqitja skematike e opsioneve të tjera për bashkëpunimin nga Republika e Shqipërisë dhe Republika e Kosovës me strukturat ndërkombëtare relevante. Në këtë mënyrë rezulton se vullneti politik është parësori dhe që i “*hap dyert*”, përfaqësive të këtyre strukturave në vend, unifikimit të licencave për profesionet e lira, si dhe mediatizimi i

duhur i bashkëpunimit për rritjen e besimit në popull. Këto do të ndikojnë fuqishëm në luftën e suksesshme dhe të vendosur kundër veprimtarive kriminale të organizuara nacionale, ndërshtetërore e transnacionale, Shqipëri - Kosovë.

7.6 Bashkëpunimi Shqipëri - Kosovë për forcimin e shtetit ligjor në të dy vendet.

Në të gjitha progres raportet e Bashkimit Evropian për Shqipërinë dhe për Kosovën, theksohet forcimi i shtetit ligjor, rendit, luftës kundër krimit të organizuar dhe respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Këto çështje janë treguesit kryesorë për funksionimin e demokracisë, në të kundërt, krimi i organizuar mbetet shqetësim madhor dhe ai pengon objektivat dhe synimet e shqiptarëve për t'u integruar në strukturat e Bashkimit Evropian. Krimi i organizuar, kur nuk luftohet me vendosmëri dhe vullnet të hekurt politik, minon punën dhe gangrenizon strukturat dhe institucionet e shtetit dhe shoqërinë. Prandaj, ky punim do të trajtojë shkurtimisht tri çështje: *Së pari*, përdorimin e konceptit “shtet” sipas të drejtës ndërkombëtare dhe forcimin e shtetit ligjor dhe të rendit kundër krimit të organizuar. *Së dyti*, Strategjinë e Sigurisë Kombëtare dhe forcimin e shtetit ligjor dhe të rendit kundër krimit të organizuar, dhe, *së treti*, progres raportin për pranimin e Shqipërisë vend kandidat për në BE dhe forcimi i shtetit ligjor dhe të rendit kundër krimit të organizuar.

Sipas grafikut 7.2 Forcimi i shtetit ligjor (Shqipëri - Kosovë) në luftën kundër veprimtarive kriminale të organizuara transnacionale, të pyeturit sipas pyetjes Nr. 9²²³ sugjerojnë: *agjencitë e zbatimit të ligjit* 44%, ligjet dhe edukimi nga 14%, shoqëria civile, 12%, media 10% dhe 7% Kushtetuta. Pra, agjencitë e zbatimit të ligjit kanë peshën kryesore për forcimin e shtetit ligjor Shqipëri-Kosovë.(Tabela 7.9 është shpjeguese e grafikut.)

²²³Pyetja nr. 9: *Çfarë sugjeroni për forcimin e shtetit ligjor (Shqipëri-Kosovë) në luftën kundër veprimtarive kriminale të organizuara ndërnacionale dhe transnacionale?*




Figura 7.4 Sugjerime për forcimin e shtetit ligjor (Shqipëri-Kosovë) në luftën kundër veprimtarive kriminale të organizuara (Anketimi i studentëve).²²⁴

Ndërsa, studentët e anketuar sipas figurës 7.4, sugjerojnë: agjencite e zbatimit te ligjit, 42 % , ligjet, 29%, edukimi, 13 , Kushtetuta dhe shoqeria civile nga 6%., media 3%.

Sipas Bledar Dervishaj Drejtor i Kabinetit dhe Këshilltar i Ministrit të Drejtësisë (2013-2016):

*“Lufta kundër veprimtarive kriminale duhet të drejtohet në shumë fronte. Së pari, vendosja e një kuadri ligjor të plotë do t’i pengonte autorët t’i shmangen përgjegjësisë penale, duke përdorur boshllëqet ligjore. Së dyti, agjencitë ligjzbatuese kanë një rol thelbësor në zbatimin me efektivitet të ligjeve dhe në këtë prizëm nevojitet një bashkëpunim i ngushtë ndërmjet tyre”.*²²⁵

Ndërsa, sipas Dr. Dilaver Bengasi Drejtor i Përgjithshëm i Policisë Popullore (1985-1990), Jurist dhe avokat i njohur, shteti ligjor forcohet kur *policia*, kuadrot drejtuese të saj dhe *drejtësia* janë strukturat më të kualifikuara nga ana profesionale.²²⁶ ”

Analisti dhe gazetari i njohur Ferdinand Dervishi, shprehet se: *“Agjencitë e zbatimit të ligjit duhet të kenë semafor jeshil nga politika. Mediat duhet të ndihmojnë me kryesisht pasqyrim pozitiviteti.”*²²⁷ ” Ndërsa, sipas Prof. asoc. Bajram Yzeirit,


²²⁴ Të anketuarit kanë pasur të drejtën e dhënies vetëm të një përgjigjeje (vetëm një mundësi përzgjedhjeje).

²²⁵ Intervista është marrë nga autori me datën 13.11.2015.

²²⁶ Intervista është marrë nga autori në Tiranë me datën 10.9.2015.

“forcimi i institucioneve të zbatimit të ligjit do të ndryshojë standardet e shërbimit të policimit ndaj qytetarëve, nivelin dhe efikasitetin e parandalimit e hetimit të krimit dhe njëherësh goditjen e tij në fushën e korupsionit e krimit të organizuar”. Prof. Dr. Ermir Dobjani, shprehet se duhen përmirësuar veprimtaritë në agjensitë e zbatimit të ligjit, duhen pastruar ato nga të korruptuarit, të paafët, duhen ngritur profesionalisht, duhet shmangur apo garantuar pavarësia e tyre nga partitë politike.²²⁸ Sipas avokatit Fahri Danaj, lufta kundër korupsionit dhe krimit lidhet me politikën e personelit dhe të rekrutimit të funksioneve të larta shtetërore dhe të pushtetit.

Figura 7.5 pasqyron rezultatet e përgjigjeve të pyetjeve për forcimin e shtetit ligjor Shqipëri-Kosovë në luftën kundër veprimtarive kriminale të organizuara (ndështetërore dhe transnacionale).



Burimi: Pyetëtori 1 “Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri-Kosovë, 2008-2015” (plotësuar nga personalitete publike dhe ekspertë të sigurisë e drejtësisë në Shqipëri, Kosovë dhe ekspertë ndërkombëtarë). Përpunim i Autorit (2016).

Figura 7.5 Rezultatet e përgjigjeve të pyetjeve dhe sqarimet për forcimin e shtetit ligjor Shqipëri-Kosovë në luftën kundër veprimtarive kriminale të organizuara (ndështetërore dhe transnacionale).


Sipas kësaj tablele rezulton se; bashkëpunim i agjensive të zbatimit të ligjit 37%, bashkëpunimi i agjencive të specializuara 26%, bashkëpunimi i politikave ndërqeveritare 22%, dhe bashkëpunimi legjislativ 15%. Pra, vlerësohet në tërësi bashkëpunimi midis të

²²⁷ Intervista është marrë nga autori në Tiranë me datën 21.11.2015.

²²⁸ Intervista është marrë nga autori në Tiranë me datën 10.11.2015.

gjitha institucioneve shqiptare, Shqipëri-Kosovë, por në shifra më të larta paraqiten, bashkëpunimi i agjencive të zbatimit të ligjeve dhe bashkëpunimi i agjencive të specializuara.

Ekspertët në Shqipëri, në Kosovë dhe ekspertët ndërkombëtarë, janë përgjigjur në tërësi se bashkëpunimi midis dy shteteve të Shqipërisë dhe të Kosovës për parandalimin dhe luftën kundër veprimtarive kriminale të organizuara ndërshtetërore dhe transnacionale, ka një rëndësi shumë të madhe dhe nevojitet që ky bashkëpunim të jetë i vazhdueshëm dhe konkret. Rekomandohet se është e rëndësishme që midis këtyre agjencive në të ardhmen duhet të fuqizohet e të intensifikohet bashkëpunimi i këtyre institucioneve shqiptare në Shqipëri e në Kosovë.



Burimi: Pyetëtori 2 “*Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri-Kosovë, 2008-2015*”, plotësuar nga studentët e fakulteteve të Drejtësisë dhe të Sigurisë në Prishtinë dhe Tiranë. Përpunim i autorit, 2016.

Figura 7.6 Sugjerime për forcimin e shtetit ligjor (Shqipëri-Kosovë) në luftën kundër veprimtarive kriminale të organizuara (Anketimi i studentëve).²²⁹

Sipas PhD Walter Schwimmer, theksohet se:

²²⁹ Theksojmë se të anketuarit kanë pasur të drejtën e dhënies vetëm të një përgjigjeje (vetëm një mundësi përzgjedhjeje).

“...ndërsa është e rëndësishme që të ketë ligje të mira është më e rëndësishme në perspektivën e Shqipërisë dhe të Kosovës që të ketë vullnet politik për këto ligje që të zbatohen. Reagimi im fillestar ishte për të shënuar "bashkëpunimin e politikave nderqeveritare", por kam frikë se kjo do të shihet nga Serbia si fillimi i një Shqipërie të Madhe dhe do të destabilizonte rajonin. Prandaj do të ishte më e mundur për të harmonizuar legjislacionin dhe për të zhvilluar mënyrat e ndjekjes përtej kufijve kombëtarë.”²³⁰

Ndërsa, sipas Bledar Dervishait, jurist dhe Drejtor i Kabinetit të Ministrisë të Drejtësisë (2013-2015) *“nevojitet një bashkëpunim më i madh në formë asistence në hetimin penal, forcimin e kapaciteteve të agjencive ligjzbatuese, ngritjen e grupeve të përbashkëta të hetimit, shkëmbimin efektiv të të dhënave në kohë reale, bashkëpunimin gjyqësor etj.”²³¹* Bekim Podrimcaku shprehet se:

“Bashkëpunimi ndërshetëror dhe ndërkufitar çalon shumë midis Shqipërisë dhe Kosovës, por edhe anasjelltas. Problemet e mëdhaja janë brenda vetes, domethënë brenda Kosovës dhe Shqipërisë dhe pastaj edhe brenda për brenda dy shteteve tona. Fatkeqësisht ne vazhdojmë të jemi dhe të mbetemi problem, për veten dhe brenda vetes sonë. Prandaj, zgjidhja duhet të fillojë nga ne, nga ndryshimi i mentaliteteve për zbatimin e ligjit, respektimin e forcimin e shteteve tona dhe për “bashkimin” tonë në luftën ndaj krimit të organizuar. Ne nuk duhet të vazhdojmë ta quajmë apo të jemi akoma vende tranzicioni, të varfëra, me mungesë stabiliteti politik, ekonomik, shoqëror etj. Në Gjermani thonë: nuk je gjithmonë student që ke kartën e studentit dhe përfiton disa favore si student. Pra, edhe ne nuk duhet të mbetemi gjithmonë shtet i ri dhe shtet në tranzicion, por duhet të shohim përpara për zhvillimin dhe forcimin tonë si shtetet e tjera të forta apo të zhvilluara.”²³²

Në lidhje me forcimin e shtetit ligjor Shqipëri-Kosovë në luftën kundër veprimtarive kriminale të organizuara ndërshtetërore dhe (transnacionale), të intervistuarit janë përgjigjur si më poshtë;

Dr. Alfred Moisiu, Presidenti i Republikës së Shqipërisë (2002 - 2007), shprehet se: *“Kushtetuta, ligjet, agjencitë e zbatimit të ligjit, media, edukimi, shoqëria civile, theksojmë që të gjitha janë të domosdoshme për forcimin e shtetit ligjor.”²³³* Profesor Fatmir Sejdiu shprehet:

“Kushtetuta, ligjet dhe i gjithë korpusi ligjislativ i vendit ka rëndësi të jetë i harmonishëm me kushtetutat dhe ligjet e tjera të Bashkimit Europian. Qëllimi i ligjit nuk nënkupton vetëm vrapimin e policit apo prokurorit për ta kapur autorin, kriminelin, por nënkupton në esencë një edukatë të hershme që lidhet me familjen, me rrethin shoqëror, prej qarqeve të tjera, të jetë e përhershme kontunuele, vazhduese. Kjo na mungon. Pjesa e shoqërisë civile edhe në Kosovë edhe në Shqipëri nuk është shumë e gatshme për t'i mbështetur dhe të jetë një mbartëse e projekteve të rëndësishme të cilat do të jenë në një funksion real, por këto janë pjesë e

²³⁰ Intervista është marrë nga autori me datën 27.11.2015.

²³¹ Intervista është marrë nga autori me datën 13.11.2015.

²³² Intervista është marrë nga autori me datën 11.12.2015.

²³³ Intervista është marrë nga autori në Tiranë, më datë 12.12.2015.

shëndërrimeve. Mund të jenë më shumë se 2 mijë OJQ në Kosovë dhe sejcila prej tyre mund ta ketë në fokus shoqërinë dhe të drejtat e qytetarëve. Unë mendoj se media, duhet pak më ndryshe të sillet, asnjëherë nuk kuptoj këtë se media duhet të kontrollohet në kuptimin e censurës. Ata nxjerrin efekte negative dhe si e tillë është absolutisht irritues. Do të duhej të transformoheshin në një media që të ishte e pavarur dhe në funksion real të qytetarëve.²³⁴

Dr. Bajram Rexhepi, shprehet:

“Institucionet e zbatimit të ligjit duhet të jenë shumë më efikase, në Polici, Prokurori dhe institucione të tjera të zbatimit të ligjit. Një mungesë tjetër është ligji antimafia në lidhje me konfiskimet e pasurive të pajustificueshme. Por kur dikush me vetëdije mund ta bëjë këtë krim dhe me vetëdije i bën disa vite burg dhe duke mos ju konfiskuar pasuritë ai del me fitim, prandaj duhet të behet sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurive kriminale. Çfarë rroge ka patur, çfarë përfitimesh ka patur dhe ai duhet të provojë ai pronën e vënë. Duhet të miratohet legjislacioni që barrën e provës ta provojë i akuzuari dhe jo shteti, jo prokurori sipas ligjit për krimin e organizuar”.²³⁵

Dr. Zef Preçi, është shprehur se:

“Themelore mbetet ligjzbatimi. Nuk ka ligje të këqija, por ka zbatues të këqinj të ligjit dhe qytetarë të papërgjegjshëm për fatin e përbashkët. Krijimi i agjensive të reja që kanë karakter të përbashkët panshqiptar. Qoftë agjensitë e specializuara qoftë agjensitë e zbatimit të ligjit duhet të krijohen agjensi të përbashkëta qoftë për kontrabandën, trafiqet e paligjshme, drogën etj, duke ndryshuar ligjet për fushat e krimit të organizuar”.²³⁶

Analisti i njohur, Mentor Nazarko, është i mendimit se Shqipëria dhe Kosova duhet të kenë marrëveshje dhe bashkëpunim shumë të ngushtë në luftën kundër krimit të organizuar si dhe përmes agjencive të përbashkëta.²³⁷ Ndërsa, Profesore Iva Zajmi shprehet se: *të pavarësohen dhe fuqizohen me profesionistë agjencitë e zbatimit të ligjit në çdo nivel.*²³⁸ Dr. Bashkim Kopliku, Zëvendëskryetar i Këshillit të Ministrave të Shqipërisë dhe Ministër i Rendit Publik (1992-1993) shprehet se *është shumë e rëndësishme edukimi e shoqëria civile.*²³⁹ Studiuesi dhe autori i disa librave për Policinë dhe Sigurinë Hilë Lushaku, këshilltar i Kryeministrit për Sigurinë Kombëtare (2002-2004), Drejtor i Drejtorisë Qendrore të Forcave Speciale në Policinë e Shtetit (1997-2000), thekson se: *“Shqipëria dhe Kosova duhet të punojnë së bashku me institucione e struktura panshqiptare që luftojnë krimin e organizuar me vendosmëri dhe vullnet të fortë.”*²⁴⁰ Ndërsa,

²³⁴ Intervista është marrë nga autori në Prishtinë, më datë 11.12.2015.

²³⁵ Intervista është marrë nga autori në Mitrovicën e Veriut, në Kosovë më datë 23.01.2016.

²³⁶ Intervista është marrë nga autori në Tiranë me datën 3.11.2015.

²³⁷ Intervista është marrë nga autori në Tiranë me datën 11.09.2015.

²³⁸ Intervista është marrë nga autori në Tiranë me datën 22.12.2015.

²³⁹ Dr. Bashkim Kopliku, Zëvendëskryetar i Këshillit të Ministrave të Shqipërisë dhe Ministër i Rendit Publik (1992-1993), Zëvendëskryetar i Këshillit të Ministrave të Shqipërisë (1992-1994), deputet në Kuvendin e Shqipërisë (1991-1997).

²⁴⁰ Intervista është marrë nga autori në Tiranë me datën 22.12.2015.

Dr. Ilir Panda, shprehet lidhur me bashkëpunimin se duhet të ketë koncepte të njëjta ligjore, por para kësaj duhet të ketë fjalor dhe terminologji të njëjtë. Duhet të fillojë nga abetarja deri te ligjet.²⁴¹ Dr. Petrit Bushi shprehet kështu: “Kosova dhe Shqipëria në proceset e tyre integruese kanë miratuar legjislacion mjaft të avancuar për luftimin e kriminalitetit, korrupsionit etj., por problematika qëndron në zbatimin e këtyre ligjeve dhe politikave”.²⁴² Analisti i çështjeve të sigurisë rajonale, Dr. Ilir Kulla sqaron: “Bashkëpunimi i agjencive të zbatimit të ligjeve. Kushtetutat dhe ligjet janë bashkëkohore, por zbatimi i tyre është deficitar.”²⁴³ Profesor Xhavit Shala shprehet për agjencitë e zbatimit të ligjit,²⁴⁴ ndërsa, deputeti Asllan Dogjani shprehet për agjencitë e zbatimit të ligjit, media, edukimi, shoqëria civile.²⁴⁵

Këshilltari i Presidentit të Republikës për çështjet e sigurisë kombëtare, (2013-2016) Gjergj Lezhja shprehet se: “kërkohet vullnet politik i palëkundur, bashkëpunim shtetëror nëpërmjet agjensive të zbatimit të ligjit për goditjen e kriminalitetit dhe drejtësi e pavarur dhe serioze në zbatim të ligjit”.²⁴⁶ Gazetari i njohur, Erion Kristo thekson se: agjencitë shqiptare janë më të përlyera, për shkak se në Kosovë agjencitë varen nga të huajt. E vetmja mënyrë është presioni ndërkombëtar në kuadrin e integritetit evropian ose ndërhyrja e partnerëve si NATO-ja.²⁴⁷ Dr. Marko Bello shprehet se:

“ ligjet dhe edukimi janë të rëndësishme, por mendoj se forcimi dhe mirëfunksionimi i agjencive të ngarkuara me ligj për të luftuar kundër krimit dhe korrupsionit është më i rëndësishmi. Është momenti që të punohet për identifikimin dhe rekrutimin e njerëzve të zotë profesionalisht, me integritet moral, të vendosur të punojnë në të mirë të vendit dhe shoqërisë. Kushdo që devijon nga ligji dhe korruptohet duhet të procedohet menjëherë.”²⁴⁸

Analisti, gazetari i njohur Ferdinand Dervishi, shprehet se bashkëpunimi i agjencive të zbatimit të ligjit dhe agjencive të specializuara duhet të kenë semafor jeshil nga politika”.²⁴⁹ Sipas Bledar Dervishait, Drejtor i Kabinetit të Ministrit të Drejtësisë (2013-2015):

²⁴¹ Intervista është marrë nga autori në Tiranë me datën 26.11.2015.

²⁴² Dr. Petrit Bushi, autor i cituar.

²⁴³ Intervista është marrë nga autori në Tiranë me datën 25.11.2015.

²⁴⁴ Dr. Xhavit Shala, Drejtor i Qendrës Kërkimeve Shkencore, Akademia e Sigurisë Tiranë.

²⁴⁵ Intervista është marrë nga autori në Tiranë me datën 08.10.2015.

²⁴⁶ Intervista është marrë nga autori me datën 10.11.2015.

²⁴⁷ Intervista është marrë nga autori me datën 15.11.2015.

²⁴⁸ Dr. Marko Bello, autor i cituar.

²⁴⁹ Intervista është marrë nga autori me datën 22.11.2015.

*"lufta kundër veprimtarive kriminale duhet të drejtohet në shumë fronte. Së pari, vendosja e një kuadri ligjor të plotë do t'i pengonte autorët t'i shmangen përgjegjësisë penale duke përdorur boshllëqet ligjore. Së dyti, agjencitë ligjzbatuese kanë një rol thelbësor në zbatimin me efektivitet të ligjeve dhe në këtë prizëm nevojitet një bashkëpunim i ngushtë ndërmjet tyre. Kjo nënkupton forcimin e kapaciteteve hetimore të agjencive ligjzbatuese dhe kryerjen e hetimeve proaktive dhe efektive."*²⁵⁰

Dr. Enver Bytyci thekson forcimin dhe zbatimin e ligjit në mënyrë të barabartë për të gjithë qytetarët, pavarësisht nga pozita sociale, funksionet dhe imunitetet që disa pushtetarë e politikanë i gëzojnë".²⁵¹ Ndërsa Dr. Saemira Pino shprehet: "Në këtë periudhë të gjatë tranzicioni, krimi merr formë të ndryshme, herë intensifikohet, herë e ul rrezikshmërinë, por mbetet produkt i pashmangshëm e sistemit, por e sigurtë është që nëse i kundërpërgjigjet ai tkurret dhe e ka të vështirë mbijetesën".²⁵² Artur Zoto, shprehet në këtë mënyrë: "Shoqëria shqiptare shfaqet ngurruese në lidhje me denoncimin e veprimtarive kriminale e cila mund të vijë si rrjedhojë e mungesës së besimit në institucionet shtetërore".²⁵³ Në përgjigjen e tij, profesor Besnik Shehu shpjegon se:

"siç theksohet, jo për retorikë, në të gjitha raportet e BE-së për të dyja vendet, i rëndësishëm është forcimi i zbatimit të ligjit që realizohet nëpërmjet punonjësve të mirë trainuar dhe duke luftuar korrupsionin. Çlirimin e mediave nga censura dhe vetcensura e imponuar nga pronarët e mediave të lidhur me krimin dhe politikanë të korruptuar. Forcimin e rolit aktiv të shoqërisë civile të pavarur nga politika dhe financimet korruptive".²⁵⁴

PhD Florian Qehaja, shprehet: "Forcimi i edukimit do të përbënte element esencial në zvogëlimin e aktiviteteve kriminale dhe strategjikisht do të kishte efekt në funksion të vetëdijësimit të të rinjve në shmangjen nga këto aktivitete".²⁵⁵ Hydajet Hyseni shprehet se për të agjensitë e zbatimit të ligjit dhe edukimi janë më kryesoret.²⁵⁶ Edhe Kujtim Bytyci shprehet në mbështetje të agjencive të zbatimit të ligjit.²⁵⁷ Deputeti i Kuvendit të Kosovës, Ismajl Kurteshi shprehet: "Po të zbatohen ligjet ekzistuese do të pengohet krimi në masë të

²⁵⁰ Bledar Dervishaj, autor i cituar.

²⁵¹ Dr. Enver Bytyci, Drejtor Ekzekutiv i Institutit të Studimeve të Europës Juglindore në Tiranë, studiues, publicist, analist i çështjeve rajonale, profesor në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës, Prishtinë.

²⁵² Dr. Saemira Pino, autore e cituar.

²⁵³ Artur Zoto, Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve, Shqipëri (2013-2015).

²⁵⁴ Besnik Shehu, autor i cituar.

²⁵⁵ Intervista është marrë nga autori me datën 15.11.2015.

²⁵⁶ Hydajet Hyseni, kryetar i Shoqatës së Ish të Burgosurve Politikë të Kosovës, deputet i Kuvendit të Kosovës, deputet i Grupit Parlamentar të PDK-së dhe i Vetvendosjes, kryetar i Komisionit Parlamentar të Ligjeve në Kuvendin e Kosovës.

²⁵⁷ Kujtim Bytyqi, zyrtar i lartë, analist për Politikën e Sigurisë në Republikën e Kosovës.

madhe. Efikasiteti i institucioneve shtetërore sidomos atyre të sigurisë do ta përmirësonin shumë gjendjen ekzistuese.”²⁵⁸ Ndërsa, Bekim Podrimcaku sqaron se:

"forcimi i shtetit ligjor ka të bëjë me zbatimin e ligjit, legjislacionit në tërësi dhe në veçanti, ka të bëjë me mirëzbatimin e tre shyllave kryesore, ndarja e pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Nëse janë të ndarë këto tre pushtete në zbatimin e ligjit dhe qënien e tyre të pavarur, vetëm atëherë mund të flitet për zbatueshmërinë e pikave të përshkruara më sipër. Veprimet kriminale janë asimetrike, çfarë do të thotë që asnjë shtet në botë nuk është në gjendje të luftojë e vetme krimin e organizuar pa bashkëpunimin ndërkombëtar midis vendeve dhe gjithë organizmave të tjera ndërkombëtare, rajonale e deri në ato institucione e organizata në nivelet kombëtare.”²⁵⁹

Sipas Ruzhdi Jasharit, rolin kyq në këtë drejtim mendoj se do ta luanin agjencitë e zbatimit të ligjit, natyrisht bashkë me mediat, edukimin dhe shoqërinë civile.²⁶⁰ Gjithashtu, edhe Gjeneral Reshat Maliqi, përforcon forcimin e shtetit, sidomos në ato të agjencive të zbatimit të ligjit.²⁶¹ Prof. Dr. Ermir Dobjani shprehet: “...Duhet përmirësuar veprimtaritë në agjencitë e zbatimit të ligjit, duhet pastruar ato nga të korrumpuarit, të paafët, duhet ngritur profesionalisht, duhet shmangur apo garantuar pavarësia e tyre nga partitë politike”.²⁶² Sipas Peter Linden Jones, “...ndërsa është e rëndësishme që të ketë ligje të mira është më e rëndësishme në perspektivën Shqipëri-Kosovë të ketë vullnet politik për këto ligje që të zbatohen.”²⁶³ Ndërsa, Andreas Berg-u shprehet kështu:

“Kosova ka shumë ligje të mira dhe struktura kushtetuese, por problemi qëndron në forcimin e tyre dhe për ta mbajtur qeverinë përgjegjëse për luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar. Shumë politikanë dhe parti politike vazhdojnë të mbështetën edhe pse nuk e marrin krimin e organizuar dhe korrupsionin seriozisht, shpesh janë të përfshirë në të gjithashtu.”²⁶⁴

Sipas Fred Newton-it, ka potencial për t’u zhvilluar legjislacioni paralel me të njëjtat parime të forcimit dhe të ndarjes së inteligjencës.²⁶⁵

Si konkluzion, i referohemi Lordit Robertson, i cili në lidhje me përmbushjen e kërkesave të raportit përfundimtar të Samitit të Pragës dhe të Rigës për pranimin e Shqipërisë në NATO, theksoi rëndësinë e ndryshimit të mentalitetin, sepse në NATO hyhet

²⁵⁸ Ismajl Kurteshi, deputet në Kuvendin e Kosovës, kryetar i Komunës së Gjilanit në Kosovë, aktivist politik i Partisë “Vetvendosja”, Prishtinë.

²⁵⁹ Intervista është marrë nga autori me datën 11.12.2015.

²⁶⁰ PhD Kandidat Ruzhdi Jashari, Drejtor i Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Kosovë.

²⁶¹ Intervista është marrë nga autori me datën 15.11.2015.

²⁶² Intervista është marrë nga autori me datën 10.11.2015.

²⁶³ Intervista është marrë nga autori me datën 17.12.2015.

²⁶⁴ Intervista është marrë nga autori me datën 18.12.2015.

²⁶⁵ Intervista është marrë nga autori me datën 19.12.2015.

me kapital njerëzor të ndryshuar dhe jo me topa dhe aeroplanë,”²⁶⁶ Për konsekuencë edhe pranimi i Shqipërisë dhe i Kosovës në BE parakupton, në radhë të parë, ndryshimin e mentalitetit, pra, të kapitalit njerëzor.

Politika, në përgjithësi, dhe parimet qeverisëse në mënyrë të veçantë lypet të mbështetën në katër kolonat e Bashkimit Evropian që janë: legjitimiteti i institucioneve përfaqësuese në të tri pushtetet, transparenca e informim-komunikimit në nivele vertikale dhe horizontale, llogaridhënia e të gjithë përfaqësuesve dhe të institucioneve përballë qytetarëve dhe të shoqërisë civile si dhe baza e gjerë demokratike në politikëbërje dhe vendimarrje e të gjithë aktorëve dhe faktorëve të politikës, të shtetit dhe të shoqërisë.

7.7 Përmbledhje.

Studimi vjen në mënyrë të natyrshme te kapitulli i shtatë, pasi në kapitujt e mëparshëm janë zhvilluar analiza lokale, ndërshtetërore, nacionale, por edhe në krahasim me rajonin. Janë identifikuar problematikat serioze të demokracisë, sfidat kryesore të sigurisë, veprimtaritë kriminale të organizuara më të përhapura, krimi i organizuar transnacional Shqipëri, Kosovë, Rajon, problematikat e përbashkëta, të veçanta dhe dallueshmëritë midis dy vendeve.

Ky kapitull trajtoi nivelin e bashkëpunimit Shqipëri - Kosovë dhe ndikimin që paraqet ky bashkëpunim për forcimin e shtetit ligjor kundër krimit të organizuar transnacional. Ky kapitull hulumtoi në mënyrë të veçantë bashkëpunimin në fushën e shkëmbimit të informacionit, të ndërmarrjes të analizave, veprimeve e operacioneve të përbashkëta në luftën kundër krimit të organizuar dhe menazhimin e zgjidhjen e problemeve të përbashkëta.

Nëpërmjet çështjeve që u trajtuan në këtë kapitull, janë identifikuar probleme dhe janë nxjerrë konkluzione duke rekomanduar forcimin e shtetit ligjor kundër krimit të organizuar dhe krimit të organizuar transnacional. Pra, u argumentua dhënia e përgjigjes për pyetjet kryesore dhe mbrojtjen e hipotezave fillestare - ngritja dhe funksionalizimi i institucioneve bashkëpunuese e bashkërenduese trans-nacionale ndikon në efektivitetin e

²⁶⁶Communique (21-22 Nov. 2002) 127: Prague Summit Declaration issued by the Heads of State and Government participating in the meeting of the North Atlantic Council, internet sources.

veprimtarisë së institucioneve të sigurisë për parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar në nivel lokal/nacional dhe rajonal. Konkluzione dhe rekomandime vijnë pas këtij kapitulli.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

- Sikundër u theksua në hyrjen e studimit, teza e paraqitur trajtoi aspekte themelore që kanë të bëjnë me sigurinë, me zhvillimin e institucioneve demokratike, në kontekst të një rajoni që ecën në rrugën e integritit europian dhe euroatlantik. Bazuar në sfidat dhe nivelet e sigurisë, studimi argumentoi ekzistencën dhe ndërveprimin e problemeve të sigurisë në nivel lokal, transnacional, rajonal dhe më gjerë.
- Analizat krahasuese i shërbyen mbrojtjes dhe argumentimit të tezës themelore mbi sigurinë dhe demokracinë, në nivele lokale dhe transnacionale, identifikim të qartë të problemeve lokale dhe të integritit në kuadrin e prirjeve globalizuese. Analiza provoi karakterin kompleks dhe afatgjatë të sfidave kryesoretë sigurisë në të gjitha nivelet.
- Në funksion të realizimit të qëllimit të studimit u plotësuan objektivat kryesore të tij në lidhje me: identifikimin dhe analizën e vështrimit historiko-teorik të aspekteve të sigurisë, të krimit të organizuar dhe të krimit të organizuar transnacional; hulumtimin e detajuar në të tri nivelet, lokale (Shqipëri-Kosovë) dhe transnacionale; analizën në dinamikë të krimit të organizuar dhe të krimit të organizuar transnacional, të pastrimit të parave, trafiket e paligjshme dhe të terrorizmit në nivele të ndryshme; analizën e institucioneve demokratike dhe të sigurisë kombëtare në përballjen e tyre me sfidat e sigurisë që burojnë kryesisht nga krimi i organizuar transnacional; analizimin në nivelin e bashkëpunimit të strukturave të sigurisë kombëtare Shqipëri-Kosovë.
- Iu dhanë përgjigje pyetjeve kërkimore bazë që u ngritën në punim, si:
 - Cilat janë problematikat më serioze të demokracisë, të institucioneve demokratike dhe sfidat kryesore të sigurisë?;
 - Cilat janë veprimtaritë kriminale të organizuara më të përhapura dhe të krimittë organizuar transnacional me bazë lokale e transnacionale dhe në nivele lokale e transnacionale?;
 - Cili është niveli i bashkëpunimit Shqipëri-Kosovë dhe ndikimi që paraqet ky bashkëpunim për forcimin e shtetit ligjor kundër krimit të organizuar?
- Në studim u vërtetuan hipotezat e parashturara se: - siguria kombëtare dhe funksionaliteti i institucioneve demokratike të Shqipërisë dhe Kosovës mbeten të

kushtëzuara nga parandalimi, goditja dhe lufta kundër krimit të organizuar transnacional dhe anasjelltas niveli i krimit të organizuar është në përpjestim të drejtë me shkallën e brishtësisë së institucioneve demokratike dhe të sigurisë;- ngritja dhe funksionalizimi i institucioneve bashkëpunuese e bashkërenduese transnacionale ndikon në efektivitetin e veprimtarisë së institucioneve të sigurisë për parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar në nivel lokal/nacional dhe transnacional.

- *Ndër problematikat më kryesore për demokracinë në Shqipëri dhe në Kosovë rezultuan se janë: korrupsioni, krimi i organizuar e veprimtaritë e tij, problematika ekonomike, mosfunksionimi i sistemit të drejtësisë, mungesa e shtetit ligjorëj. Nga studimi u arrit në përfundimin se problematika e parë serioze për demokracinë në Shqipëri është korrupsioni, për Kosovën mbeten ende sfida për të ardhmen ndërsa dy problematika të demokracisë me karakter të jashtëm, por edhe me ndikim të brendshëm, si: prania e faktorit ndërkombëtar dhe influenca e politikave serbe dhe e krimit të organizuar serb.*
- Nga analiza krahasuese e të dhënave, të intervistave dhe të anketimeve janë evidentuar 25 problematika kryesore të demokracisë në Shqipëri dhe 22 problematika kryesore të demokracisë në Kosovë. Prej tyre, 16 janë problematika të përbashkëta midis Shqipërisë dhe Kosovësose 64% e problematikave kryesore të demokracisë në Shqipëri dhe 72.7% e problematikave kryesore të demokracisë në Kosovë janë të përbashkëta, duke sjellë përfundimin se politikat e përbashkëta për targetimin e tyre do të ishin të efektshme.
- Nga analiza krahasuese janë evidentuar 15 sfida kryesore për *sigurinë kombëtare* në Shqipëri dhe 17 sfida kryesore për sigurinë kombëtare në Kosovë, nga të cilat, Shqipëria dhe Kosova kanë 11 sfida të përbashkëta të sigurisë kombëtareose, e shprehur në përqindje, Shqipëria ka 73.3% sfida të përbashkëta të sigurisë me Kosovën dhe Kosova ka 64.7% sfida të përbashkëta të sigurisë me Shqipërinë. Ndërsa Shqipëria ka 4 sfida të veçanta të cilat janë: siguria gjeopolitike në Ballkanin Jugperëndimor, kapja e pushtetit, mosfunksionimi i institucioneve të ekonomisë në vend/nivel profesional, moral i ulët në administratë dhe informaliteti. Kosova ka 6 sfida të veçanta: sfida e marrëdhënieve me shtetin serb dhe impakti në vend (e lidhur, më së shumti, me çështjen e Mitrovicës dhe që mbetet shumë e rëndësishme, të paktën, për të ardhmen e afërt),

prania e faktorit ndërkombëtar, sovraniteti territorial i vendit, sfida të konsolidimit të demokracisë dhe të shtetformimit, nevoja e përmirësimit të kapaciteteve të administratës dhe sfida të kequshtrimit të pushtetit.

Pra, dallueshmëria e sfidave të sigurisë kombëtare të Shqipërisë me Kosovën qëndron vetëm katër sfida ose 26.7% e ndryshme nga sfidat që ka Kosova, dhe vetëm 6 sfida ose 36% e ndryshme nga sfidat që ka Shqipëria.

- Nga analiza krahasimore e trajtimittëkrimit të organizuar dhe krimin të organizuar transnacional Shqipëri, Kosovë dhe Shqipëri-Kosovë, nga hulumtimi i kryer, arrihet në disa përfundime:

1. Veprimtaritë kriminale të organizuaramë të përhapura në Shqipëri janë: trafikimi i drogës, korrupsioni dhe pastrimi i parave.
2. Veprimtaritë kriminale të organizuaramë të përhapura në Kosovë janë: korrupsioni, trafiku i drogës dhe pastrimi i parave.
3. Veprimtaritë kriminale të organizuara më të përhapura në nivel transnacional Shqipëri- Kosovë janë: trafikimi i drogës, korrupsioni, pastrimi i parave.
4. Tri veprimtaritë kriminale të organizuara më të përhapura në Shqipëri janë evidentuar: korrupsioni, trafikimi i drogës dhe pastrimi i parave.
5. Veprimtaritë kriminale të organizuara më të përhapura në nivel transnacional që kanë bazë transnacionale Shqipëri- Kosovë janë: trafikimi i drogës, korrupsioni, pastrimi i parave.
6. Në të tre zërat, si: kriminaliteti transnacional ndërmjet dy vendeve Shqipëri-Kosovë, kriminaliteti transnacional me bazë transnacionale Shqipëri - Kosovë dhe kriminaliteti transnacional me bazë lokale Shqipëri-Kosovë, *trafikimi i drogës* renditet në nivelin e parë, *trafikimi i qenieve njerëzore* renditet në nivelin e dytë dhe *korupsioni* renditet në nivelin e tretë.
7. Nga analiza krahasuese Shqipëri-Kosovë rezulton se krimi i organizuar më i zhvilluar në Shqipëri dhe në Kosovë është *krimi i organizuar me bazë transnacionale Shqipëri - Kosovë*, dhe më pak i zhvilluar, është kriminaliteti me bazë lokale Shqipëri-Kosovë.

8. *Trafiku i drogës* është forma e kriminalitetit të organizuar që është më e zhvilluar në krahasim me të gjitha llojet e tjera të veprimtarive të krimit të organizuar. Trafiku i drogës në Shqipëri dhe në Kosovë ka më shumë bazë transnacionale se sa bazë lokale.
- Sa i përket trajtimittëfaktorëve të jashtëm që ndikojnë në veprimtaritë kriminale të organizuara në nivelet lokale dhe transnacionale Shqipëri-Kosovë, nga hulumtimi i kryer, rezulton:
 1. Faktorët “*kriminaliteti i organizuar* dhe “*veprimtaritë e grupeve kriminale shqiptare në botë*” si dhe “*pozicioni gjeografik*” i Shqipërisë dhe Kosovës, rezulton se kanë peshën më të madhe;
 2. Faktorë shumë të rëndësishëm janë edhe “*mosfunksionimi i demokracisë dhe shtetit ligjor*”, “*rrjetet ndërkombëtare kriminale*” dhe “*linjat ndërkombëtare të trafikimit*”. Faktori *kriminaliteti i organizuar* dhe veprimtaritë e grupeve kriminale shqiptare në botë përbëhet nga katër nënfaktorë: *krimi i organizuar, grupet kriminale shqiptare në botë, trafiku i drogës dhe pastrimi i parave dhe kthimi i të dënuarvenë Shqipëri dhe Kosovë.*
 3. Faktorët që ndikojnë në shkallën e kriminalitetit të organizuar janë: *mosfunksionimi i demokracisë dhe shtetit ligjor, kapja e shtetit, demokracia e dobët, probleme të brendshme vendore, shtete të dobëta, institucione në Kosovë ende të pakonsoliduara, si dhe dobësia dhe moskordinimi i institucioneve ligjzbatuese.* Faktorë të tjerë ndikues janë: vonesat në procesin e integritit, ndikimet e ndryshme shoqërore dhe ndryshimi i mentalitetit, nepotizmi, presioni politik ndërkombëtar, lidhja etnike e të dy vendeve, mungesa e lëvizjes së lirë të shtetasve kosovarë dhe tranzicioni i zgjatur.
 - Megjithëse informacionet apo të dhënat zyrtare u evidentuan në formë të regjistruar, domethënë të evidentuara nga Policia e Shtetit apo nga policitë e tjera, të krijuara me ligj të veçantë (statistika policore), informacionet apo të dhënat mbi të akuzuarit (statistika e prokurorisë), të dhënat mbi të gjykuarit (statistika të gjykatave), si dhe të dhënat mbi sanksionet e ekzekutuara penale (statistika të institucioneve për ekzekutimin e sanksioneve penale, dënimi i të dënuarve, sekuestrimet e konfiskimet e pasurive etj.):-

u konstatua një mospërputhje, mosrakordim në disa drejtime të statistikave zyrtare të disa institucioneve ligjzbatuese, mbi veprimtaritë kriminale të organizuara.

Lind nevoja të bëhet *unifikimi i statistikave zyrtare të institucioneve shtetërore, të drejtësisë penale dhe ligjzbatuese*, si në Shqipëri ashtu dhe në Kosovë. Në këtë mënyrë do të reduktohet shifra e “panjohur” e kriminalitetit, do të reduktohen shifra “*të numrit të errët*” (krime që kanë ndodhur, por janë ose të panjohura ose të padenoncuar); shifrat e “*numrit të përhimtë*” të kriminalitetit (rastet e njohura, të denoncuar e të rregjistruara të kriminalitetit, të cilat nuk janë zbuluar, zbardhur, ndriçuar e dokumentuar ligjërisht deri në fund nga organet kompetente). Kjo, në mënyrë që të njihet gjendja e vërtetë e kriminalitetit dhe të mos bihet pre e “*numrit të tepërt*”, “*eerrësimit të gjendjes*” (shifra të ekzagjeruara të kriminalitetit, që kryesisht paraqiten nga burime në konflikt interesi apo me synime të caktuara).

Ndaj një sfidë për të ardhmen mbetet njohja e gjendjes reale të veprimtarive kriminale të organizuara në Shqipëri dhe Kosovë. Shqipëria dhe Kosova lypet të trajtojnë më me seriozitet çështjet e evidentimit, e regjistrimit, e zbulimit të autorëve të veprave penale, e dokumentimit ligjor dhe e goditjes dhe e luftimit të grupeve kriminale të organizuara.

- Sa i përket *bashkëpunimit Shqipëri - Kosovë dhe ndikimit që paraqet ky bashkëpunim për forcimin e shtetit ligjor kundër krimit të organizuar transnacional*, nga hulumtimi i kryer, rezultoi:
 1. Në aspektin e bashkëpunimit lokal, ndërshtetëror dhe transnacional, pas analizës së mbështetur në metodologjinë sasiore (statistika), cilësore (intervista) dhe analizës krahasuese nëpërmjet tabelimeve, figurave dhe grafikëve në të dy vendet, të interpretuara mbi një bazë të përbashkët, u arrit në konkluzionin se është i domosdoshëm ndërtimi i strategjivetë përbashkëta në fushën e sigurisë.
 2. Fakti që kemi hapje kufijsh, të shoqëruara me lëvizje në dinamikë që tejkalon kufijtë shtetërore, e bën shumë të komplikuar dhe të limituar suksesin e faktorëve lokalë pa koordinim, bashkëpunim dhe ndërveprim në nivele më të larta lokale, shtetërore dhe ndërshtetërore. Analiza krahasuese çoi në konkluzionin se ka një vakum juridik dhe institucional që të adresojë këtë ndërvarësi dhe ndërveprim në të gjitha nivelet kundër krimit të organizuar transnacional.

3. Krimi i organizuar transnacional dhe grupet kriminale të organizuara Shqipëri-Kosovë kanë kapërcyer “pengesat” ligjore midis të dy vendeve, duke u integruar më së miri me njëri-tjetrin, si dhe duke bashkëpunuar edhe me grupet kriminale shqipfolëse jashtë kufijve në bashkëpunim me grupet kriminale të vendeve të rajonit dhe më gjerë.
4. Problematikat e përbashkëta të demokracisë dhe të sfidave kryesore të sigurisë kombëtare, veprimtaritë kriminale të organizuara më të përhapura në Shqipëri-Kosovë, si dhe faktorët e jashtëm që ndikojnë në veprimtaritë kriminale, të organizuara në nivelet lokale dhe transnacionale Shqipëri-Kosovë, e bëjnë të domosdoshme krijimin e mekanizmave të përbashkët studimorë dhe operacionale e hetimorë, duke organizuar struktura të përbashkëta funksionale të përhershme për parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar transnacional Shqipëri-Kosovë.
 - Do të ishte e nevojshme zhvillimi i aktiviteteve të përbashkëta midis agjencive të specializuara dhe agjencive të zbatimit të ligjit në Shqipëri-Kosovë për shkëmbimin e menjëhershëm të informacionit, zhvillimine analizeve, veprimeve praktike dhe operacioneve të hetimit të përbashkët në luftën kundër krimit të organizuar transnacional dhe menazhimit e zgjidhjen e problemeve të përbashkëta. Pra, agjencitë e zbatimit të ligjit dhe agjencitë e specializuara kanë peshën kryesore për forcimin e shtetit ligjor Shqipëri-Kosovë. Rekomandohet të krijohet një strukturë e përbashkët e analizës strategjike dhe operacionale-hetimore Shqipëri-Kosovë për parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar transnacional Shqipëri-Kosovë. Kjo strukturë është e nevojshme të ndjekë dhe të zbatojë detyrimet që rrjedhin nga konventat ndërkombëtare, marrëveshjet, protokollet e instrumentet përkatëse, legjislacioni procedural penal për parandalimin, luftimin e krimit të organizuar transnacional Shqipëri-Kosovë dhe sekuestrimin e pasurive të krimit.
5. Krimi i organizuar dhe krimi i organizuar transnacional, nuk është vetëm një problem juridik e ligjor, por dhe social e psikologjik, ekonomik e politik, lokal, ndërshtetëror, kombëtar, rajonal e ndërkombëtar.
 - Në këtë kontekst, rekomandohet që lënda mësimore e krimit të organizuar të zhvillohet jo vetëm në Fakultetet e Drejtësisë dhe të Studimeve të Sigurisë në nivelin "Master",

por edhe në shkencat politike e marrëdhëniet ndërkombëtare, në shkencat sociale, dhe në degët e ekonomikut: financë, bankë, menazhim-biznesi etj.

Si përfundim, konkludam se vetëm një bashkëpunim ndërqeveritar, ndërinstytucional dhe ndëroperacional në luftën kundër krimit të organizuar transnacional, kundër trafikimit të drogës dhe të substancave narkotike, kundër trafikeve tjetra të paligjshme, pastrimit të parave, terrorizmit dhe korrupsionit, është parakusht për parandalimin e konflikteve dhe të krizave të brendshme dhe të jashtme, lokale, ndërshtetërore, kombëtare dhe rajonale e veçanërisht për sigurimin e jetës, shëndetite të respektimit të lirive e të drejtave të njeriut.

LISTA E REFERENCAVE/BIBLIOGRAFIA:

A.Literaturë

Abazoviq, M., Elmedin Muratbegoviq, Haris Haliloviq, Muhamed Budimli, Edina Bećirević, *Politika e Luftimit të Kriminalitetit*, Sarajevë, Prishtinë, 2006.

Albrow, M., *The Global Age*, Stanfrod University Press,1997.

Arlacchi, P., *Mafia Business.The Mafia Ethic and the Spirit of Capitalism*. Oxford University Press, [1983] 1988.

Bain, W., *Perandoria e Sigurisë*, Routledge, 2006.

Baliqi, B., *Hyrje në diplomaci dhe politikë të jashtme*, Prishtinë, 2010.

Barry B., Ole Waever ^ Jaap de Wilde, *Security: A new Framework for Analysis*, Lynne Rienne (1998).

Bashkurti, L., *Krizat ndërkombëtare*,Tiranë 2008.

Booth, K.1991, *Security and Emancipation, Review of International Studies*,vol. 17.

Busan, B., *Njerëzit, shtetet dhe frika*, ECPR, 2007.

Busan, B., *Security: A new Framework for Analysis*,1998.

Collins, A., *Studime bashkëkohore të sigurisë*, botuar nga UET Press, 2010.

Falcone, G.& Marcelle Padovani, *Cose di Cosa Nostra*, Edition 1/Austral, 1991.

Falcone, G., *Interventi e propositi*, Sansoni Editore, 1994.

Florian, E. Winter, *Disa vëzhgime mbi problemet sociale të Kosovës*, Tiranë, 2007.

Floyd, R.,*Drejt një vlerësimi konseguentalist të sigurisë*, 2007.

Giddens A., *The consequences of Modernity*, (Polity Press,1990).

Giddens A., *The third Way* ,botimi anglisht, 1988.

Godson, R. and Williams Ph., *Strengthening Cooperation against Transnational Crime*, Survival,Vol.40, No.3, Autumn 1998.

Hansen, L., *The Little Mermaid's Silent Security Dilemma and the Absence of gender in the Copenhagen School*, Millennium-Journal of International Studies, 29, 2000.

- Held, D.&Anthony Mc Grew, *The Global Transformation Reader*, 2000.
- Held, D., Anthony Mc Grew, David Goldblatt, *Global Transformations*, 1999.
- Hough, P., *Kuptimi i sigurisë globale*, Routledge, 2004.
- Huysmans, *Revisiting Copenhagen and Johan Erikson, 'Observers or Advocates? On the Political Role of Security Analysts*, Cooperation and Conflict 34, no. 3, 1999.
- Jameson, F, Masao Miyoshi, *Runaway World*, Routledge, 2000.
- Kabo, P., *Autoritarizëm në tranzicion. Antropologjia shqiptare përmes globalizimave*, Tiranë, 2006.
- KCSS, Kosovar Center for Security Studies, *Vlerësim i rëndësisë së Këshillit të Sigurisë së Kosovës në sektorin e Sigurisë*, Prishtinë, Dhjetor 2008.
- Kenichi, O., *The end of the Nation –State*, 1995.
- Krasniqi, A., *Partitë politike në Shqipëri(1920-2006), Historia dhe tiparet e partive parlamentare dhe të zhvillimeve politike*, Tiranë 2006.
- Menzel, U, *Konstelacioni pasvestfalian, mjerimi i kombeve dhe barra e globalizimit dhe e fragmentimit*.
- Mlagjenoviq, R. *Kriminologjia*, FSHK, Sarajevë 2000.
- Moisiu, A., Fjala e mbajtur në Konferencën ndërkombëtare për sigurinë dhe paqen në Ballkan, Tiranë, 22 nëntor 2015.
- Muratbegoviq, E., *Parandalimi i Kriminalitetit* (compendium of crime prevention and crime control) Sarajevë/Prishtinë, 2007.
- Mutimer, D., *Critical Security Studies: A Schismatic History in Contemporary Security Studies*, A.Collins (eds.) Oxford University Press, 2007.
- Nazarko, M., *Balanca e forcave rajonale dhe ndërkombëtare në tri marrëveshje*, Tiranë, 2006.
- Nye, J., *Globalism Versus Globalization*.
- Omari, L., “Referenca territoriale të Kushtetutës së Kosovës”, ese, *Revista Gjeopolitika*, Botim i Universitetit “Marin Barleti”, Tiranë, numri 1, Ura Shqiptare, Tiranë, Korrik 2008.
- PAOLI, L., *The Oxford Handbook of Organize Crime*, Oxford University Press 2014.

- Papandile, J., Eugen Papandile, *Kriminologji*, Tiranë, 2010.
- Papandile, J., Mandro I., *Kriminologji-Penologji*, Tiranë, 2002.
- Poda Z., *Krimi i organizuar*, Tiranë 1998.
- Policia e Kosovës, *Raport vlerësimi i kërcënimit të krimit serioz dhe krimit të organizuar*, 2013.
- Projekti Rajonal CARPO, *Raport mbi gjendjen e krimit të organizuar dhe krimit ekonomik në Evropën Juglindor*, Strasburg, gusht 2006.
- Raduloviq, L., *Politika kriminale*, Beograd, 1999.
- Rodriges, Z. L. *Organizata kriminale dhe sistemi i drejtësisë penale*, Edit. Conares S.L. 2009.
- Rupert, M., *Ideologies of Globalization*, Routledge, 2000.
- Sababi, A., Muhamed Budimiliç, *Kriminologjia*, Prishtinë, 2007.
- Soros, G., *Kriza e kapitalizmit global, shoqëria e hapur e rrezikuar*. Xh. Lloshi (përkth.), Tiranë, Toena, 1999.
- Shala, D., *Kriminologjia*, 2013, Prishtinë.
- Shkëmbi, H., “*Tipologjitë e policimit të vendeve të Bashkimit Europian*” (Vështrim krahasues), Tiranë, 2006.
- The Globalization Syndrome*, Princeton University Press, 2000.
- The Oxford handbook of Organize Crime, *Edited by Letizia PAOLI*, Oxford University Press, 2014.
- UN High Level panel report, 2004, *Threats Challenges and Change A More Secure World: Our Shared Responsibility*.
- Vaughn-Williams, N. *Studimet kritike të sigurisë: një hyrje*, Abingdom, Routledge, Columbia, 2010.
- Waeber, *Shkolla e re në teorinë e sigurimit dhe origjina e tyre midis qendrës dhe periferisë*, Ole paper Quebec, 2004.
- Wilkinson, *The Copenhagen School on Tour in Kyrgyzstan: Is Securitization Theory Useable Outside Europe?*, Security Dialogue March 2007, vol. 38 no.1.2007.

Williams, P.& Dimitri Vlassis, *Combating Transnational Crime, Concepts, Activities and Responses*, Great Britain 2001-Gerhard O.W.Mueller, *Transnational Crime:Definitions and Concepts*, 2001.

Williams, P. & Carl Florez, “Transnational Criminal Organizations and Drug Trafficking”, *Bulletin on Narcotics* 46(2), 1994.

Yzeiri, B., *Ligji dhe policia*, Tiranë, 2002.

Zhilla, F., Lamallari, B., *Krimi i organizuar-vlerësimi i riskut në Shqipëri*, Tiranë, 2015.

-Burime Parësore:

A. Akte normative

- Council of Europe, 2002
- Council of the European Union.1997a, Action Plan to Combat Organized Crime Adopted by the Council on 28 April 1997, *Official Journal of the European Communities*, 15.8.1997,C251:1–16-.1997b. Doc. 6204/2/97. Enfopol 35 rev.2, adopted by the Council on 21 April 1997-. 2002, Council Decision of 28 February 2002 Setting Up Eurojust with a View to Reinforcing the Fight against Serious Crime, (2002/187/JHA) *Official Journal of the European Communities* L 63.
- Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, 1948.
- Europol.2013.*SOCTA 2013:EU Serious and Organised Crime Threat Assessment*‘s-Gravanzande:Deventer Marrë nga Letizia PAOLI, *The Oxford Handbook of Organize Crime*, Oxford University Press 2014.
- Karta e Kombeve të Bashkuara, 1945.
- Konferenca e organizuar nga Qendra për Studimet Strategjike dhe Ndërkombëtare në Uashington, 1994.
- Konventa e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar (Palermo 2000), ratifikuar me ligjin nr. 8920 datë 11.07.2002, *Për ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar*.
- Konventa e Këshillit të Evropës, *Për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual*, (Ratifikuar me ligjin nr.10071,datë 09.02.2009.

- Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (bashkë me protokollet e saj).
- *Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Tiranë, 15.6.2008.*
- Ligj nr.28/2014 datë 20.3.2014, *Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Policisë Europiane (EUROPOL) për bashkëpunimin strategjik dhe operacional.*
- Ligj nr.8427, datë 14.12.1998, *Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në organizatën ndërkombëtare të policisë kriminale, INTERPOL.*
- Ligj nr.8541, datë 21.10.1999, *Për ratifikimin e Marrëveshjes së SECI-t mbi bashkëpunimin për parandalimin dhe luftën kundër krimit ndërkufitar.*
- Ligj nr.9496, datë 20.3.2006 *Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Misionit të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) për transferimin e personave të dënuar.*
- Ligji nr. 03/L-183, *Për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare.*
- Ligji nr. 9284, datë 30.09.2004, *Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar.*
- Ligji nr. 10192, datë 03.12.2009, *Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë.*
- Ligji nr.24/2014, datë 20.3.2014, *Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10192, datë 03.12.2009, Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë.*
- Ligji nr.03/L-053, datë 13.3.2008, *Mbi juridiksionin dhe kompetencat e gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë.*
- Ligji nr.04/L-052, *Për marrëveshjet ndërkombëtare.*
- Ligji nr.04/L-213, d. 31/07/2013, *Mbi bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale*
- Ligji nr.04/L-31 *Për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale.*
- Ligji nr.4/L-273 *Për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve në lidhje me mandatin e Misionit të Sundimit të Ligjit të Bashkimit Evropian në Kosovë.*

- Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës italiane *në luftën kundër kriminalitetit* (Ratifikuar me ligjin nr. 9799, datë 10.09.2007)
- Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, *Për lëvizjen e ndërsjelltë të shtetasve dhe të protokollit të saj gjatë qarkullimit në zonat kufitare*, (Ratifikuar me ligjin nr. 10203, datë 23.12.2009)
- Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Maqedonisë, *Për lëvizjen e ndërsjelltë të shtetasve dhe të protokollit të saj për qarkullimin në zonat kufitare*, (Ratifikuar me ligjin nr. 9894, datë 27.03.2008).
- Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Serbisë, *Mbi ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar dhe protokollit të saj të zbatimit*, (Ratifikuar me ligjin nr. 10453, datë 21.07.2011).
- Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Serbisë, *Për lëvizjen e ndërsjelltë të shtetasve*, (ligji nr.10474).
- Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Greqisë, *Për mbrojtjen dhe asistencën e fëmijëve, viktimave të trafikimit*, (Ratifikuar me ligjin nr. 9544, datë 29.05.2006).
- Marrëveshja ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës, *Për krijimin dhe funksionimin e një qendre të përbashkët të bashkëpunimit policor*, nënshkruar në Tiranë më 16.4.2013, hyrë në fuqi më 16.5.2013.
- Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, *Për ripranimin e personave*, nënshkruar më 06.10.2009, hyrë në fuqi më 12.03.2010.
- Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, *Për bashkëpunimin policor ndërkufitar*, nënshkruar më 06.10.2009, hyrë në fuqi më 20.03.2010.
- Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, *Për kryerjen e procedurave të përbashkëta të kontrollit të hyrje/daljeve ndërmjet pikave të kalimit kufitar Morinë (Kukës)-Vërmicë (Prizren)* midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës dhe

Protokollit për kryerjen e veprimtarive të përbashkëta në këtë PKK, nënshkruar më 30.4.2011, hyrë në fuqi më 21.6.2011.

- Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, *Për kryerjen e procedurave të përbashkëta të kontrollit të hyrje/daljeve ndërmjet pikave të kalimit kufitar Qafe Morine (Tropojë)-Qafe Morinë (Gjakovë) midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës dhe Protokollit për kryerjen e veprimtarive të përbashkëta në këtë PKK*, nënshkruar më 30.4.2011, hyrë në fuqi më 21.6.2011.
- Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, *Për hapjen e pikave të përbashkëta të kalimit ndërkufitar Borje-Glloboçicë, Orgjost (Kukës)-Orçush (Dragash) dhe Shishtavec (Kukës)-Krushevë (Dragash) dhe Protokolleve të kryerjes së veprimtarive të përbashkëta në këto pika të kalimit kufitar*, nënshkruar në Tiranë, më 16.4.2013.
- Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, *Për bashkëpunim të ndërsjellë në fushën e sigurisë*, nënshkruar më 23.3.2015.
- Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës në Kosovës, *Mbi forcimin e bashkëpunimit në fushën e kontrollit të brendshëm*, nënshkruar më 23.3.2015.
- Memorandum mirëkuptimi ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës, nënshkruar më 25.6.2008.
- Memorandumi i Mirëkuptimit, *Mbi bashkëpunimin policor midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK)*, 9 shtator 2002.
- Paul Nesbitt, Bresler, 1993.
- Përmbledhje e Akteve Ndërkombëtare, botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare, Qershor 2010.
- Progres raporti i Komisionit European për Shqipërinë 2013.
